



KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

REVISTA USHTARAKE

**Organ teoriko-shkencor
i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes**

Nr. 2/2013

Tiranë, qershor 2013

Këshilli Botues i Revistës Ushtarake
Miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 1721, datë 10.10.2012

Kryetar

Gjeneral Brigade Bardhyl Hoxha, Komandant i KDS

Anëtarë

Kolonel Ahmet Leka

Kolonel Dr. Agim Sula

Gjeneralmajor ® Prof. Dr. Ruzhdi Gjataja

Gjeneralmajor ® Prof. Dr. Kostaq Karoli

Kolonel ® Prof. Dr. Pëllumb Danaj

Kolonel ® Thimi Hudhra

Shef i Redaksisë së Botimeve

Nënkolonel Adriatik Domazeti

Kryeredaktor

Ajet Nuellari

Redaktore

Silvana Markgjonaj

Art design

Teuta Mullisi

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2012 nga Qendra e Doktrinës (QD) të Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes).

Copyright © 2012 by the Center for Doctrine (CD) of the Albanian Training and Doctrine Command.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në Revistën Ushtarake janë tërësisht të autorit/ autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes.

Autori/Autorët e shkrimeve të Revistës Ushtarake nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve e pozicioneve të tyre individuale edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes.

Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Ky botim i Revistës Ushtarake gjendet në website <http://www.tradoc.mil.al/>

Në rast se nuk mund të merrni informacionin që kërkoni në internet lutemi të kërkoni një kopje të tij në adresën: e-mail: revistaushtarake@aaf.mil.al ose qd@aaf.mil.al

Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes

Qendra e Doktrinës

Dega e Botimeve

Shtypur: qershor 2013

PËRMBAJTJA

RUBRIKA E PARË: Analiza dhe vlerësime për sigurinë

| | |
|--|----|
| <i>Terrorizmi dhe interneti</i> _____ | 9 |
| MSc. Mimoza (Duka) Xharo, Shefe e Analizës në AIM | |
| <i>Të njohim dhe edukojmë ushtarakët me vlerat më të mira morale e psikologjike</i> _____ | 21 |
| Ajet Nuellari, Kryeredaktor i RU, QD, KDS | |
| <i>Konsensusi, kryeffjala në paktet për sigurinë</i> _____ | 31 |
| Kolonele Manushaqe Shehu, Drejtoreshë e Drejtorisë së Marrëdhënieve Civilo-Ushtarake, SHPFA | |
| <i>Komunikimi publik, element i rëndësishëm i veprimtarisë së FA</i> _____ | 42 |
| Jaup Zenuni, Pedagog në AFA | |
| <i>Shkenca dhe Strategjia Ushtarake</i> _____ | 52 |
| Nënkolonel @ MSc. Kanan Himaj, Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe Mbrojtjes | |
| <i>Lidershipi dhe përgjegjshmëria e tij shoqërore</i> _____ | 60 |
| Dr. Fatmir Zanaj, Zëvendësrektor në Universitetin “Justiniani I” | |
| <i>Menaxhimi i stresit në misionet paqeruajtëse</i> _____ | 72 |
| Nënkolonele Dr. Edlira Kukeli, Shefe e Edukimit Shëndetësor dhe Doktrinës SUQU | |

RUBRIKA E DYTË: Punime nga Akademia e Forcave të Armatosura

| | |
|--|----|
| <i>Rruga 55-vjeçare e Akademisë së Forcave të Armatosura arritjet dhe vizioni për të ardhmen</i> _____ | 77 |
| Kolonel Dr. Agim Sula, Komandant/Rektor i Akademisë së Forcave të Armatosura | |

Gjeneralmajor ® Prof. Dr. Ruzhdi Gjataja,
Pedagog në Departamentin e Strategjisë dhe Historisë, AFA
Kolonel ® Selim Shiroka,
Pedagog në Departamentin e Operacioneve, AFA

Mendimi i Klauzeviçit për rolin dhe karakteristikat e komandantit _____ 84

Nënkolonel Behar Mara,
Kursant KLO
Nënkolonel MSc. Enrik Ago,
Pedagog i DO, AFA

Përqendrimi i forcës dhe kundërveprimi i saj _____ 93

Nënkolonel Arben Hoxha,
Kursant KLO
Kolonel Selim Troci,
Shef i G3, BrMR

Rëndësia e rezervës ushtarake në veprimet luftarake _____ 110

Nënkolonel Halil Myrteza,
Kursant KLO
Kolonel Eduart Bala,
Shef i Departamentit S&H, AFA

Përmbajtja dhe kuptimi i ekonomizimit të forcave _____ 118

Nënkolonel Arben Kingji,
Kursant KLO
Kolonel MSc. Fatmir Lokaj,
Shef i Sektorit të Operacioneve, AFA

Mbi përmbajtjen e strategjisë së Aleancës sipas AJP-01(D) _____ 127

Nënkolonel Leonard Çoku,
Kursant KLO
Gjeneral Brigade Ylber Dogjani,
Komandant i QPR

Arti e shkenca ushtarake dhe zbatimi i tyre në doktrinat ushtarake të FA _____ 132

Nënkolonel MA. Ardian Lulaj
Shef/Pedagog i Grupit të Studimeve Strategjike, AFA

Marrëdhëniet civilo-ushtarake dhe pasqyrimi i tyre në doktrinat ushtarake të Aleancës _____ 144

Nënkolonel Alda Sula,
Kursant KLO
Profesor Dr. Pëllumb Danaj,
Pedagog e DO, AFA

Planifikimi i kohës dhe drejtimi _____ 151

Kolonel Dr. Edmond Braneshi,

Zëvendësrektor i Akademisë së Forcave të Armatosura

Puna kërkimore, pjesë e misionit të AFA_____ 161

Nënkolonel ® Prof. Asoc. Dr. Agron Agolli,
Koordinator i punës kërkimore-shkencore, AFA

Legjislacioni shqiptar dhe ai evropian, në fushën e sigurisë_____ 177

Dr. Ardian Myslimaj,
Drejtor i Programeve Master dhe Doktoraturës në AFA
MSc. Etleva Metaj

RUBRIKA E TRETË: Studime historike

Disa veçori të mendimit dhe strategjisë ushtarake izraelite_____ 187

Gjeneralmajor Viktor Bërdo,
Zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA

Formimi i UÇK-së dhe roli i saj në çlirimin e Kosovës_____ 195

Gjeneral Brigade Bashkim Jashari

Fillesat e Shtypit Ushtarak Shqiptar_____ 206

Kolonel Dr. Zaho Golemi

Çështjet e pazgjidhura me Pakistanin_____ 215

Kolonel Dritan Demiraj,
Komandant i Batalionit të Forcave Speciale

Përmbledhja në anglisht_____ 225

Kujtesë për bashkëpunëtorët_____ 238

RUBRIKA E PARË

Analiza dhe vlerësime për sigurinë

Në shkrimet e kësaj rubrike, specialistë të fushës analizojnë probleme të rëndësishme të aktualitetit të lidhura me sigurinë dhe mbrojtjen.

Në shkrimin “Terrorizmi dhe Interneti” autorja thekson se: *Interneti me përdorimin e tij gjithmonë e më të gjerë dhe në rritje në jetën e përditshme, si dhe me mundësitë e mëdha që ofron, po tërheq në mënyrë të veçantë vëmendjen e organizatave terroriste.*

Në shkrimin “Të njohim dhe edukojmë ushtarakët me vlerat me të mira morale e psikologjike”, faktori moral është trajtuar si parësor, sepse kur lidhet drejt me faktorët e tjerë materialë, teknikë e ushtarakë, ai përmbys vlerësime dhe raporte të ndryshme forcash. Morali i lartë është forcë lëvizëse, me rëndësi përcaktuese “*armë gjithmonë e re, mjeti për të fituar luftën, apo për të shndërruar disfatën në fitore*”.

Shkrimi “Konsensusi, kryefjala për paktet e sigurisë”, fokusohet kryesisht në aspektin studimor teorik të konsensusit si një koncept politiko-filozofik. Në këtë shkrim trajtohet roli dhe rëndësia e konsensusit në marrjen e vendimeve të rëndësishme, në mbarëvajtjen e punës për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurimit kombëtar të vendit, si pjesë përbërëse e strukturave euroatlantike.

Në artikullin: “Komunikimi publik, element i rëndësishëm i FA”, autori thekson se: *Për shumëkënd duket sikur diplomacia publike apo komunikimi publik është mjaft larg FA, sepse ka institucione dhe aktorë të tjerë që duhet të merren me këtë element të rëndësishëm të komunikimit ndërkombëtar. Një qasje e tillë jo vetëm është e vjetëruar por edhe frenuese sepse në kuadrin e betejës për të “fituar mendjet dhe zemrat”, e cila përbën një nga shtyllat e “pushtetit të butë”, FA zhvillojnë sot një luftë asimetrike e cila kërkon përfshirjen e kontributeve për diplomacinë publike edhe në veprimtarinë e tyre.*

Shkrimi “Shkenca dhe strategjia ushtarake” nënvizon rëndësinë e shkencës ushtarake si teori, metodë dhe praktikë e prodhimit të aftësive ushtarake, në mënyrë të qëndrueshme me politiken e mbrojtjes kombëtare.

Në vijim në trajtesën mbi lidërsipin theksohet se: *Vlerat e lidërsipit duhen parë në procesin e udhëheqjes, drejtimit dhe vendimmarrjes cilësore. Lideri duhet që ato që thotë t’i zbatojë me vepra, të jetë i sakrificës dhe mbrojtës i së drejtës.*

Terrorizmi dhe interneti

MSc. Mimoza (Duka) Xharo,
Shefe e Analizës, AIM

Trajtesë e shkurtuar. *Interneti është cilësuar si promotor dhe integrator i kulturave, bizneseve, konsumatorëve dhe qeverive për të komunikuar me njëri tjetrin. Duket se ka ofruar një mundësi për krijimin e një forumi “qyteti global” ku mund të takohen dhe shkëmbehen ide, duke stimuluar dhe mbështetur demokraci, kulturë dhe zhvillim në gjithë botën. Gjithsesi, rritja e madhe në sasi dhe cilësi po sfidohet nga webfaqe të dhunshme si dhe nga përdorimi nga organizata ekstremiste të çdo lloj natyre. Grupe të ndryshme apo individë me synime politike apo ideologjike të ndryshme, të bashkuar në gatishmërinë e tyre për të përdorur taktika terroriste, kanë filluar të përdorin internetin për të bërë propagandë, për të komunikuar mes tyre dhe me mbështetësit apo simpatizantët, të bëjnë publike synimet dhe tërheqin mbështetës deri në ekzekutim aktesh terroriste.*

Sot terroristët të bindjeve të ndryshme ideologjike, politike dhe fetare, kanë mësuar si të nxjerrin përfitime maksimale nga përdorimi i internetit. Aksesit i lehtë, mungesa e rregullave, audienca e gjerë, rrjedha e shpejtë e informacionit, etj., e kanë shndërruar internetin një mjet mjaft efikas në shërbim të synimeve të tyre. Shumë grupe apo organizata terroriste, kanë shkuar drejt një transformimi, nga një organizatë strikte hierarkike, në gjysmë të pavarur, me celula të vogla të izoluara dhe që nuk kanë një linjë komandimi hierarkik. Nëpërmjet përdorimit të internetit, këto grupe të ndërlidhura, janë në gjendje të mbajnë kontakte me anëtarët e tyre dhe me grupe të tjera.

Në të ardhmen vlerësohet se terroristët do të organizohen në një mënyrë edhe më shumë të decentralizuar, në grupime të vogla transnacionale, të lidhura nëpërmjet internetit, me komunikim dhe koordinim horizontal më shumë se vertikal, çka e bën më të vështirë punën e shërbimeve të inteligjencës për evidentimin, monitorimin dhe parandalimin e kësaj veprimtarie.

“Terrorizmin e sotëm nuk duhet ta përfytyrojmë me një kallashnikov në krahë, por me një kompjuter portativ”.

Gerd Schlinder

Interneti, me përdorimin e tij gjithmonë e më të gjerë dhe në rritje në jetën e përditshme,

si dhe me mundësitë e mëdha që ofron, po tërheq në mënyrë të veçantë vëmendjen e organizatave terroriste. Terrorizmi dhe interneti janë të lidhura mes tyre në dy mënyra: *Së pari*, interneti është shndërruar në një forum për grupet terroriste dhe individët me prirje terroriste, për të shpërndarë mesazhe dhune dhe të komunikojnë mes tyre dhe me simpatizantët e tyre. *Së dyti*, individët dhe grupet janë përpjekur të kryejnë akte terroriste apo sulmojnë rrjete kompjuterike.

Në kohën e sotme terroristët po e përdorin internetin dhe ndërkohë po e sulmojnë atë. Të paktën 12 nga 30 grupet e listuara në Departamentin e Shtetit si organizata terroriste, po e përdorin internetin dhe kanë web faqet e tyre në internet.¹ Interneti po përdoret nga të gjitha llojet e terrorizmit, pavarësisht orientimit të tyre politik apo ideologjik. Është përdorur nga islamistët, racistët, nacionalistët, anarkistët. Sot të gjithë organizatat, grupet terroriste kanë prezencën e tyre në internet.² Teknologjitë e reja kanë reduktuar mjaftueshëm dhe dukshëm kohën e komunikimit dhe transmetimit, duke u mundësuar aktorëve të koordinojnë dhe komunikojnë në mënyre efektive dhe në kohë. Duke integruar kompjuterizimin me komunikimin kanë rritur substancialisht llojshmërinë dhe kompleksitetin e informacionit që mund të shkëmbehet.

Mënyrat dhe synimet e përdorimit të internetit nga terroristët

Si mjet presioni apo luftë psikologjike: Interneti u jep mundësi terroristëve dhe organizatave radikale të përhapin idetë e tyre në publik, pa iu drejtuar funksionit të mediave dhe duke anashkaluar çensurën, ndërkohë që gëzojnë një numër të madh mjetesh dhe teknikash për të arritur efektin e dëshiruar. Terroristët nëpërmjet internetit shpërndajnë dizinformacion, publikojnë pamje horror të akteve të tyre. Sulmi terrorist i 11 shtatorit të vitit 2001 pati dëme në dy drejtime: efekt psikologjik dhe ekonomik (rënia e dollarit, rënia e stock marketit amerikan).³ Përdorimi i internetit për të përhapur dizinformim, frikë, ndjenja të ankthit dhe mungesës së shpresës, pamje të tmerrshme nga sulmet (video ekzekutimi pengu) janë pjesë e luftës psikologjike, që bëhet hapur në hapësirën kibernetike. Interneti është veçanërisht i përshtatshëm për grupe të vogla, të cilët përpiqen të përhapin mesazhin e tyre, për të rritur rëndësinë dhe për të theksuar kërcënimin që ata paraqesin. Ai përbën një mjet, me ndihmën e të cilit, individë dhe grupe mund të fitojnë famë si dhe aftësi për të ndikuar mbi opinionin publik, madje edhe vendimmarrjen politike.

Përdorimi i parë i internetit për presion psikologjik besohet të datojë me krijimin e një faqeje interneti nga “*Tupac Amaru Revolutionary Movement*”.⁴ Kjo faqe u përdor

¹Gabriel Weinann in “How modern terrorism uses the internet”.

² Idem.

³ Prof Michel Chossudovski, The 9/11 reader. the september 11, 2001 terror attacks, global research, 2012.

⁴Tupac Amaru Revolutionary Movement ose: Movimiento Revolucionario Túpac Amaru, (MRTA) ishte një grup revolucionar aktiv në Peru në fillimet e viteve 1980 deri 1997, dhe një nga aktorët kryesorë të konflikteve të brendshme në Peru. Kryesohej nga Víctor Polay Campos (“Rolando”) dhe Néstor Cerpa Cartolini (“Evaristo”) deri me vdekjen e tij në 1997.

⁵Shining Path filloi aktivitetin në fund të vitit 1960, si një grup revolucionar i vogël, i udhëhequr nga profesori i filozofisë, Abimael Guzmán. Guzmán i kundërvihet elitës politike të Perusë. Ndjekësit e

nga disa media botërore për informacion mbi ngjarjen dhe tregoi epërsitë e internetit për produksionin mediatic dhe një instrument për propagandë dhe presion psikologjik.

Ditët e sotme, çdo grup terrorist është i pranishëm në hapësirën kibernetike, duke publikuar rregullisht lajme dhe mbështetje mbi një çështje të caktuar, duke shpërndarë informacion të drejtpërdrejtë anëtarëve dhe ndjekësve të tyre. Veçanërisht aktivë në këtë drejtim janë sidomos grupet terroriste, të bazuara në islam radikal. Ata përdorin një numër të gjerë faqesh statike dhe dinamike të internetit, chat rooms, forume diskutimi, blogje dhe rrjete sociale popullore dhe web faqe të bashkëndarjes së videove si Yahoo!, Facebook, MySpace dhe You Tube.

Si mjet propagande: Nëpërmjet internetit terroristët propagandojnë dhunën si mjet i vetëm, demonizojnë kundërshtarin, delegjitimojnë armikun, duan të kalojnë përgjegjësinë e kalimit dhe përdorimit të dhunës, si i vetmi mjet adekuat të kundërshtari, bëjnë propagandë për rritjen e moralit dhe për të demonstruar fuqinë e tyre. P.sh. video të prodhuara nga terroristët në Irak, Afganistan, Bosnje. Abu Musarah Al-Iraqi shërbeu si përfaqësues i medias për *Al-Qaeda*-ën në Irak. Ai reklamonte online përgjegjësi për akte terroriste, postonte video për propagandë, deklarata etj. Webfaqet e organizatës terroriste peruane "*Shining Path*"⁵ psh përmbajnë propagandë marksiste-leniniste. Organizatat islamiste përdorin internetin për të shpërndarë propagandën e tyre antiperëndimore dhe antiizraelite. Shumë web faqe të krijuara nga mbështetësit e Hamasit psh japin strukturën organizative të organizatës dhe komunikatat e tyre, të cilat përmbajnë thirrje për vrasje dhe vdekje të çifutëve. Të tjera si "*Hizb ut-Tahrir*",⁶ një organizatë radikale, më bazë në Britaninë e Madhe, përdor web faqet e saj për t'i dhënë publikut hollësi mbi takimet e tyre të rregullta në Britani.

Si mjet informimi dhe shkëmbimi informacioni: Web faqe përdoren për të përçuar informacion anëtarëve aktualë dhe atyre potencialë, simpatizuesve, kundërshtarëve dhe publikut në të gjithë botën, për të publikuar materiale audio dhe video të liderëve ose të komandantëve të terrenit, ekzekutime dhe sulme me bomba, urdhëresa fetare, gazeta elektronike, materiale trajnimi, lajme, thirrje për t'u bashkuar xhihadit global, kërcënime ndaj "*të pafeve*" dhe softe të ndryshme." *Terrorist handbook*"⁷ apo "*Anarhist handbook*"⁸ ofrojnë detaje si të ndërtosh një bombë. "*Muxhajdin poison hand book*"⁹, i publikuar në faqen e Hamasit, jep instruktazhe si të bëhen helme dhe materiale të tjera vdekje prurëse, për t'u përdorur në akte terroriste. Ky aktivitet mbështetet nga një rrjet organizatash gjysmë të ligjshme, të cilat përgatisin dhe

këtij grupi u bazuan në marksizmin nën shembullin e Fidel Castro-s, dhe përfundoi në një guerrila të dhunshme që përdori rregullisht taktika terroriste në përpjekjet e tyre për të destabilizuar dhe rrëzuar qeverinë peruane. E disponueshme në: www.cfr.org/terrorism/shining-path-tupac-amaru-peru.../p9276
Council of Foreign relations, Publications

⁶www.hizb.org.uk/ Hizb ut-Tahrir është një parti politike, bazuar në islam.

⁷www.capricorn.org/~akira/home/terror.html

⁸archive.org/details/TheAnarchistHandbook

⁹www.thepoisonreview.com/2010/02/21/the-poisoners-handbook/

¹⁰Open Source Center_Information for intelligence (CIA Library E..Resources.available at opensource.gov.

shpërndajnë publikimet xhihadiste dhe ofrojnë kanale dhe servera për web faqet e përdorura. Në shumë raste, materialet mbartin dhe logon e grupit dhe të qendrës mediatike, që e ka krijuar produktin. Tre qendrat më të mëdha janë: *Al Fajr Media Center*, *As-Sahab Institute of Media for Media Production* dhe *Global Islamic Media Front*¹⁰. Ato nxjerrin produkte të cilësisë së lartë, të cilat kanë dhe versione në gjuhë të ndryshme dhe në formate që suportohen nga sisteme të ndryshme operimi. Duke marrë parasysh që këto produkte transmetohen më vonë nga media si CNN dhe Al Jazeera, audienca e tyre rritet në disa herë. Në një shkëmbim grafik, në një chat room të Al-Qaeda në fillim të shtatorit 2003, një fanatik islamist i panjohur, me user name “*Redemption Is Close*,” shkruan, “*Vëllezër si mund të shkoj në Irak për xhihad? A ka atje kampe dhe a ka njeri që i komandon ato?*” Katër ditë më pas ai merr një përgjigje nga “*Merciless Terrorist*”: “*I dashur vëlla rruga është e hapur, atje ka shumë grupe, shko dhe gjej dikë që beson, bashkohu me të, ai do bëhet mbrojtësi yt dhe me ndihmën e Allahut ju do bëheni një nga muxhajdinët.*” “*Redemption Is Close*” kërkon më pas më shumë detaje dhe “*Merciless Terrorist*” i dërgon atij një video me instruksione si të përdorë softin e quajtur Pal Talk, i cili u mundëson përdoruesve të flasnin me njëri tjetrin në internet, pa patur frikë se monitorohen.¹¹

Si mjet për kryerjen e akteve terroriste: Sulmet kibernetike terroriste mund të konsiderohen si një element tjetër i luftës psikologjike nga grupet terroriste. Sulmi i parë u regjistrua në 1997. Ai u krye nga një grup që kishte lidhje të afërta me *Tamil Ealam Liberation Tigers*.¹² Me një bombardim me mesazhe elektronike, grupi mbajti të bllokuar për dy javë postat elektronike të ambasadave në Sri Lanka. Përveç se mundëson kryerjen e këtyre sulmeve, interneti ofron dhe instrumentet e nevojshme për kryerjen e tyre. Kështu që dhe ata, që nuk janë ekspertë në radhët e organizatave terroriste, janë në gjendje të shkaktojnë dëme dhe humbje ekonomike, që prodhon efekte të mëdha psikologjike, me kosto dhe rrezik, nga çdo anë e botës. Kjo arrihet me postimin në forumet xhihadiste të manualeve, që udhëzojnë se si shkatërrohet një software apo një burim, që është në shënjestër të sulmit kibernetik. Përveç manualeve të piraterisë informatike, p.sh. forumi *Minbar ahl al Sunna wal-Jama*, ofronte një chat room, ku diskutoheshin, objektiva të mundshëm, pika të dobëta, mënyra sulmi dhe dëmtime të mundshme financiare.¹³ Rastet e xhihadit elektronik shoqërohen shpesh dhe me ngjarje konkrete. P.sh. publikimi i filmave vizatimorë danezë për Profetin Muhamed në vitin 2006, shkaktuan protesta në rrugë dhe një sërë sulmesh kibernetike në vendet perëndimore. Vlerësohet se në të ardhmen e afërt, organizatat

¹¹ Dorothy e. Denning in *Terror's web*: “How the internet is transforming terrorism”

¹² Liberation Tigers of Tamil Eelam (LTTE) është grupi i vetëm terrorist që posedonte këmbësori, Sea Tigers (detare) dhe Air Tigers (ajrore). LTTE përshkruhet si një nga grupet terroriste më të trezikshme nga shumë shtete si: India, Malaysia, USA, Canada, UK, Australia, BE, vende në të cilat LTTE ka infrastrukturë të fuqishme.

¹³ Ahlu Sunna Waljama'a (ASWJ) është një grup parashtarak somalez, që konsiston në sufi të moderuar, që i kundërvihen grupeve islamiste radikale Al-Shabaab. Ata luftojnë për të ndaluar vendosjen në Somali të sharitit strikte dhe wahabizmin, duke dashur të mbrojnë traditat suni sufiste të vendit. Gjatë luftës së përgjakshme civile në Somali organizata bashkëpunonte me lordin e luftës Mohamed Farrah Aidid.

¹⁴ CIA/ analysis on terrorism; 2010/opensource-gov

terroriste do kërkojnë të kenë kapacitetet për të kryer sulme kibernetike, të ngjashme me atë të bllokimit të faqeve elektronike të qeverisë estoniane ose si lufta kibernetike mes Armenisë dhe Azerbaxhanit në vitin 2007.

Si mjet rekrutimi anëtarësh të rinj: Mundësitë që ofron interneti për përhapjen e informacionit dhe të propagandës, zhvillimin e takimeve, forcimin e marrëdhënieve dhe rritjen e besimit fetar, e ka kthyer atë në një mjet të rëndësishëm për të përhapur ide radikale. Disa forume të internetit janë të një rëndësie të veçantë për rekrutimin e anëtarëve të rinj. Personat “online” kanë mundësinë të flasin, duke qenë në gjendje të formësojnë mentalitetin e tyre me pikëpamje radikale. Ky proces shfrytëzon forume të zakonshme, ku pikasen targete që më pas indoktrinohen me anë të një fushate të vazhdueshme. Nga ana tjetër, interneti i krijon mundësinë kujtdo, që dëshiron të bashkohet me një rrjet zyrtarisht ose jo, si dhe të veprojë në mënyrë të pavarur, pa pasur ndonjë kontakt direkt me qendrën komanduese. Një forum që reklamonte aktivitetet e Al-Qaeda udhëzonte të gjithë ata që duan të bashkohen të ndjekin këto hapa: *Të kuptojnë dhe pranojnë identitetin, ideologjinë dhe qëllimet e Al- Kaedës; Të pregatisin veten fizikisht, intelektualisht dhe shpirtërisht dhe të bashkohen me ndonjë grup xhihadist ose të nisin të vetëm rrugën e xhihadit.*¹⁴ Disa forume kërkojnë firmosjen e një pakti besnikërie, por në përgjithësi pikëpamja është që çdo mysliman, pavarësisht mënyrës me të cilën mbështet *Al-Qaeda*, mund ta konsiderojë veten pjesë të xhihadit. Kjo e bën *Al-Qaeda* një organizatë të decentralizuar, të përbërë nga shumë celula të palidhura dhe të aftë ofrojë një numër të madh opsionesh të mbështetjes nga ofrimi i njohurive të deri tek sulmet terroriste kibernetike.

Propaganda e internetit nuk shënjestron vetëm të rriturit, por edhe adoleshentët. Ky trend ka qenë në rritje vitet e fundit. Filma dhe video disponohen “online” për të ndihmuar kultivimin e pikëpamjeve islamike tek fëmijët dhe për të frymëzuar urrejtje ndaj vendeve perëndimore. Kështu psh Hamasi shënjestron fëmijët me anë të webfaqes *Al Fateh*,¹⁵ duke ofruar filma komikë, të cilët sidoqoftë përmbajnë mesazhe të dhunës, urrejtje ndaj Izraelit dhe lavdinë e xhihadit dhe të të bërit martir. Hezbollahu ka zhvilluar një *videogame*, të quajtur “*Forcat Speciale*”, që imiton operacionet ushtarake kundër ushtarëve izraelitë. Një mesazh brenda lojës thotë që “*në këtë lojë ti mund të bëhesh pjesë e fitores. Lufto, rezisto dhe shkatërroje armikun*”. Loja disponohet në arabisht, anglisht dhe Farsi¹⁶.

Vëmendje po i kushtohet dhe afrimit të vajzave me anë të internetit, edhe pse tradita i kufizon këto kontakte. Ato flasin me gra, burra, me të cilët në jetën e përditshme nuk lejohet të flasin. Vajzat e reja rekrutohet për të përkthyer literaturë xhihadiste dhe për të ndërtuar faqe interneti xhihadiste.

Interneti ka ndryshuar metodat e trajnimit të rekrutëve të rinj terrorist, duke u ofruar një mënyrë të shpejtë të studimit të ideologjisë, mënyrës e të operuarit dhe targetet

¹⁴Al-Fateh është revista për fëmijë e Hamasit. Publikohet dy herë në javë në Londër, gjendet edhe në internet në adresën “www.al-fateh.net”. Revista përmban histori, poema, lojra të ndryshme, fjalëkryqe etj. Në këtë web faqe thuhet që kjo revistë është për ndërtuesit e së ardhmes dhe është e lidhur me web faqen zyrtare të Hamasit.

¹⁵www.downtownbeirut.com/government-sites/hezbollah-official-website

¹⁶www.jihadwatch.org/2004/01/al-qaedas-online-training-camp.html

potencialë të organizatave terroriste. “Në vitin 2006, një nga liderët e Al-Kaedas, i quajtur Abu Musab al Suri, pati thënë se duke përhapur njohuritë mbi teknologjitë e informacionit, myslimanët do të jenë në gjendje të islamizohen në të gjithë botën”.¹⁷ Mjetet ndihmëse kryesore të mësimin janë forumet dhe libraritë “online”, të cilat përmbajnë manualë, instruksione, mjete piraterie etj. Shumica e tyre përmbajnë përshkrime të hollësishme mbi armë të vogla të këmbësorisë, të minave dhe të sistemeve raketore kundërajrore. Gjithashtu përmbajnë dhe formula kimike, diagrama dhe metoda se si ndërtohen pajisjet eksplozive. Në internet jepen edhe këshilla se si të evitohen skanerat në aeroport, leksione mbi mbledhjen e informacioneve, zhvillimin e negociatave, rrëmbimet, planifikimin e sulmeve, sigurimin e operacioneve, drejtimi i një celule terroriste, përzgjedhje dhe rekrutim të anëtarëve të ardhshëm, fshehjen e kompjuterit në hapësirën kibernetike, maskimin e adresës IP, metoda kriptimi etj.

Që prej vitit 2004 deri në 2006, Al Fajr Media Center, ka publikuar tre revista elektronike për trajnimin e terroristëve “online”. E para “*Al Batar Training Camp*”, përmban informacion për strukturën e celulave terroriste (numri i anëtarëve, aftësitë, metodat e komunikimit dhe kontrollit) dhe leksione e stërvitje me armë të lehta. E dyta “*Base of the Vanguard*”¹⁸ i dedikohet teknikave të ruajtjes së mbulimit në publik dhe sigurisë në planëzimin e operacioneve terroriste. “*The Technical Mujahid*”¹⁹ diskuton çështje të sigurisë së informacionit, kriptimit, programeve stenografike dhe përdorimit të e-mailit. Instruksionet dhe manualet e nxjerra në internet janë përdorur nga xhihadistët në mënyrë aktive për planëzimin e sulmeve. Në vitin 2006 autoritetet britanike parandaluan një përpjekje të një kamikazi për të shpërthyer një seri IED-sh²⁰ të përgatitura sipas instruksioneve në videot e Youtube. Përveç kësaj, xhihadistët kanë filluar të interesohen edhe për simulatorët virtualë, që mund të përdoren për të mësuar si të përdorin armët e lehta dhe raketat tokë-ajër dhe si të vendosin e shpërthejnë pajisje plasëse. Megjithëse trajnimi virtual s’mund të krahasohet me trajnimin në kampe me instruktorë me përvojë, ai është shumë i përshtatshëm për anëtarët e grupeve të vogla që e njohin njëri-tjetrin. P.sh. rasti i Umar Farouk Abdulmutallab, i cili tentoi të hidhte në erë një avion në Detroit, ditën e krishtlindjeve. Ai ishte kontaktuar, rekrutuar, radikalizuar në internet për gjashtë javë.

Si mjet grumbullimi të dhënash, ose mjet grumbullimi inteligjence: Përveç trajnimit në bazë të materialeve të postuara në faqen e internetit, një tjetër qëllim i përdorimit të internetit nga terroristët, është grumbullimi i informacioneve të zbulimit. Hartat e *Google* dhe një sërë faqesh të tjera interneti, përmbajnë informacione lehtësisht të aksesueshme, me fotografi, harta, planimetri dhe diagrama të tjera të infrastrukturave dhe ndërtesave publike. Informacione të tilla mund të shërbejnë për planëzimin dhe ekzekutimin e sulmeve terroriste. Interneti mund të konsiderohet si

¹⁷www.weatherbynation.com/spikecamp/.../24/vanguard...base.../0/?...

¹⁸Al-Fajr Information Center është një organizatë xhihadiste, dhe Technical Mujahid është publikim i saj. U publikua rishtaz në shkurt 2007. (<http://www.arabteam2000-forum.com>, March 13). Sipas kryeredaktorit të Technical Mujahid, Abu al-Mothanna al-Najdi, objektivat e revistës janë të çrrënjosin fobinë dhe ankthin e atyre që kanë marrë pjesë në xhihad.

¹⁹Mjete eksplozive të improvizuara

²⁰Dan Verton: “The Invisible Threat of Cyber terrorism” (2003),

një librari dixhitale, ai ofron informacion pa fund, nga i cili mund të ketë edhe informacion që i intereson organizatave terroriste. Celulat e Al-Qaedës p.sh. ndërhyjnë me asistencën e bazës së gjerë të të dhënave, që përmbajnë hollësi mbi targete të mundshme të saj. Ata grumbullojnë inteligjencë në këto targete, identifikojnë pika të dobëta dhe studiojnë dobësi strukturore, të cilat mund të afektojnë disa sisteme.”²¹ Përdorimi i burimeve të hapura, dhe pa përdorur mënyra të jashtëligjshme, po bëhet mundësi grumbullimi, rreth 80% e informacionit të kërkuar nga armiku.²²

Si mjet grumbullimi fondesh financiare: Interneti dhe shërbimet “online” të ofruara prej tij, kanë thjeshtësuar shumë operacionet e organizatave terroriste si grumbullimi, transferimi, menaxhimi dhe fshehja e parave, nëpërmjet metodave të ligjshme dhe të paligjshme. Teknikat kryesore të grumbullimit të parave “online” kanë të bëjnë me veprimtari bamirësie (zakonisht në mbështetje të kauzave fisnike) dhe krimin virtual (vjedhja e kartave të kreditit, skemave mashtruese) etj.

Si mjet planëzimi dhe koordinimi aktesh terroriste: Rasti i Al-Qaedës për planëzimin e sulmit të 11 shtatorit është tregues i qartë i përdorimit të internetit për akte terroriste. Me mijëra mesazhe të krijuara të postuara në webfaqe të mbrojtura u gjetën në kompjuterët e të arrestuarve. Mesazhi i fundit datonte në 9 shtator 2001, frekuenca e mesazheve ishte më e madhe në periudhën gusht 2001. Mesazhet e para të gjetura në kompiuterin e Zubaydah-ut datonin maj 2001 dhe të fundit qenë dërguar në 9 shtator 2001. Në mënyrë që të ruanin anonimatin e tyre, disa nga terroristët e Al-Qaedës, përdornin internetin në vende publike dhe dërgonin emaile nga adresa publike emaili. Mesazhi i fundit i Muhamed Atta, dërguar 18 terroristëve në sulmin e 11 shtatorit ishte: “*Kemi marrë 19 konfirmime për studimet në fakultetin juridik, urbanistike, artet dhe inxhinieri (referenca e fakulteteve të përmendur ishte kodi për targetet e sulmit).*”²³ Hamasi përdor *chat rooms* për të koordinuar akte si në Gaza, West Bank, Liban dhe Izrael. Nëpërmjet përdorimit të internetit, terroristët shkatërrojnë p.sh. sistemin e komunikimit të kontrollit ajror, apo dëmtim ekonomik, duke shkatërruar sistemet që rregullojnë tregjet, përhapin viruse, operativët e Al-Qaedës p.sh. njihen për teknikat e hackersave.²⁴ Terroristët mund të thyejnë sisteme kompiuterike dhe të realizojnë sulme në një shtet bërthamor, duke sjellë impakt global.²⁵ Kjo do ishte një rrugë më e lehtë për ta në vend të ndërtimit të një bombe bërthamore.

²¹According to Secretary of Defense Donald Rumsfeld, speaking on January 15, 2003, an al Qaeda training manual recovered in Afghanistan.

²² Opencource.goc/CIA/analysis on terrorism 2008

²³Timothy L. Thomas in Al Qaeda and the internet: the danger of “cyber planning”

²⁴Gareth Evans and Yoriko Kawaguchi in International Commission on Nuclear Non-Proliferation and Disarmament. Time to reconsider the role of nuclear weapons: the international commission on nuclear non-proliferation and disarmament welcomes positive signs. Article: Published in the Vremya Novostey on 18 June 2009, ose shih Bobbie Johnson at guardian.co.uk, 24 July 2009, Terrorists could use internet to launch nuclear attack: report, the risk of cyber-terrorism escalating to a nuclear strike is growing daily, according to a study.

²⁵Collin, Barry C. “The Future of Cyber Terrorism” Proceedings of 11th annual international symposium on criminal justice Issue. The University of Chicago, IL, 1996

Si mjet shkatërrimi, baza të dhënash, informacioni sensitive apo kritik: Webfaqja e shfrytëzuar nga “*Klubi i hakerave Myslimanë*” ka mundur të krijojë linke me synim marrje informacioni sensitiv nga shërbimet sekrete amerikane, ata shpërndajnë viruse, sabotojnë rrjete dhe çbllokajnë kode. Një kompjuter i kapur përmbante të dhëna strukturore dhe inxhinierike, të cilat ishin shkarkuar nga interneti dhe të cilat u mundësonin inxhinierëve të Al Qaedës dhe planëzuesve të saj të simulonin dështime katastrofike.²⁶

Si mjet për të avancuar axhenda individuale idiosinkratike: Interneti mundëson që jo vetëm grupe apo organizata terroriste të veprojnë dhe ndërveprojnë mes tyre, por edhe individë, duke u mundësuar atyre të përparojnë axhendat e tyre idiosinkratike. Kështu p.sh. në 1999, David Copeland, vuri bombë në vende të ndryshme të Londrës. Gjatë tre javëve, ai vrau tre persona dhe plagosi 139. Në gjyq ai dëshmoi se kishte mësuar këto teknika vdekjeprurëse nga interneti, duke shkarkuar “*The Terrorist’s Handbook*”. Të dyja këto web faqe janë lehtësisht të mundshme në internet. Do mjaftonte një kërkim me fjalët “terrorist” dhe “handbook” në Google search dhe mund të gjenden me dhjetëra manuale të tjera. Në Finlandë p.sh. një student brilant në kimi, në 2002, i cili e quante veten “RC”, diskutonte teknikat e bërjes së bombave në një web faqe interneti. Në disa raste ai kërkonte tema si prodhimi i gazit të nervave në kushte shtëpie. Dhe më pas u pa se RC ndërtoi një bombë, që vrau shtatë veta, duke përfshirë edhe veten në një qendër tregtare. Webfaqja që ai frekuentonte online quhej “*Home Chemistry Forum*”, e cila u mbyll më vonë nga sponsori i saj.²⁷

Përparësitë, objektivat dhe struktura retorike

Objektiv i terroristëve nëpërmjet përdorimit të internetit janë mbështetësit e tyre, opinionin publik ndërkombëtar, publiku kundërshtar. Përparësitë e realizimit të synimeve të terroristëve nëpërmjet përdorimit të internetit mund të përmbliidhen në: mundësi e lehtë; pak forma kontrolli qeveritare, jo rregulla strikte; audience e gjerë; anonimati komunikimi; shpërndarje apo grumbullim i shpejtë informacioni; zhvillime dhe mirëmbajtje të pakushtueshme; mjedis multimediatik (aftësi për të kombinuar tekste, grafike, video etj); mundësi maskimi.

Terroristët kanë sofistikuar mjetet e komunikimit duke përdorur kriptime p.sh. steganografi²⁸ apo përdorimi i adresave anonime²⁹.

Webfaqet terroriste përdorin tre struktura retorike, të treja për të justifikuar dhunën.³⁰ **Retorika e parë** dhuna paraqitet si një domosdoshmëri dhe si mjeti i vetëm për t’iu përgjigjur armikut. Organizata terroriste e konsideron veten si të persekutuar në mënyrë konstante, se liderat e tyre janë subjekt vrasjesh dhe se mbështetësit e tyre janë masakruar. **Retorika e dytë** lidhet me legjitimitetin e përdorimit të dhunës si

²⁶ Open Source Center-Information for intelligence (CIA/analysis on terrorism).

²⁷ Teknikë e përdorur për të fshehur mesazhet dhe grafikët.

²⁸ Mbledhje emailësh në emaile të sigurta që nuk i përkasin asnjë individi konkret.

²⁹ Eben Kaplan Updated: January 8, 2009, Terrorists and the Internet.

³⁰ Simon Shercliff and Sue Hemming OBE in The use of the internet for terrorist purposes, in collaboration with the United Nations Counter-Terrorism Implementation Task Force. Unodoc.org

demonizim dhe degjelitimim i kundërshtarit. Anëtarët e lëvizjes apo organizatës janë paraqitur si luftëtarë lirie, të detyruar të përdorin dhunë kundër vullnetit të tij, pasi një armik ka shkelur të drejtat dhe dinjitetin e tij apo dinjitetin e popullit të tij. Në shumë webfaqe citohet: “*dhuna jonë është minimale në krahasim me agresionin*”. Ky duket si argument i përbashkët. Retorika terroriste tenton të çojë përgjegjësinë nga terroristët te kundërshtarët. **Retorika e tretë** ka të bëjë me përdorimin ekstensiv të gjuhës së mosdhunës, në një tentativë për të përballur imazhin e dhunës së terroristëve. Edhe pse janë organizata terroriste shumë nga webfaqet e tyre duket sikur kërkojnë zgjidhje paqësore apo zgjidhje diplomatike.

Hapësira kompjuterike është nën presion. Spiunët kompjuterikë, hajdutët, sabotatorët, të cilët me një energji të paparë kërkojnë të futen në sisteme kompjuterike, të dhënat personale dhe ato sekrete, vandalizojnë faqet e internetit, shërbimet e shpërndarjes, sabotojnë të dhënat dhe sistemet, lëshojnë viruse kompjuterike, kryejnë transaksione mashtruese, dhe ngacmojnë individë apo kompani.³¹ Këto sulme janë lehtësuar me rritjen dhe përdorimin e mjeteve elektronike të fuqishme, të cilat janë lehtësisht të shtënëshme në dorë përmes shërbimeve të ndryshme të web faqeve të internetit. Në periudhën 2011-2012, rrjetet sociale Facebook dhe Twitter u përdorën gjerësisht për qëllime propagandistike dhe komunikim midis anëtarëve të organizatave terroriste, në kuadër të proceseve në Afrikën e Veriut. Rrjetet sociale po përdoren edhe për të shkëmbyer informacione taktike, instruksione si të përgatiten pajisje shpërthyes dhe si të përdoren lloje të ndryshme armësh, për të përhapur ideologji radikale, duke postuar edhe linke që të çojnë në faqet e internetit dhe në forume xhihadiste për të grumbulluar informacione në funksion të objektivave të ardhshëm.

Masat parandaluese, të marra gjatë muajve të fundit në shkallë globale, për të kufizuar apo parandaluar përdorimin e internetit nga organizatat terroriste, kanë bërë që terroristët të marrin kundërmasa për të përmirësuar teknikat e tyre të sigurisë virtuale. Kjo përfshin përdorimin e klubeve të internetit, servera e-mailesh anonimë, kutitë postare anonime, e-maile të koduara e kriptuara, skedarë dhe dosje të fshehura, akses të kujdesshëm në forume e faqe interneti, adresa IP të maskuara dhe servera të ndërmjetëm. Programet kriptuese që japin një siguri të lartë përdoren për të mbrojtur skedarët që përmbajnë informacione diskrete.

Për këtë qëllim, përveç programeve komerciale, xhihadistët kanë programuar produkte speciale për qëllimet e tyre. Një prej tyre “*Mujahideen Secrets*”, i bën rivalitet produkteve të mirënjohura si “*Pretty Good Privacy*”. Ky program ofron një çelës asimetrik publik 2048 bit dhe një çelës simetrik 256-bit sipas Standarteve të Kriptimeve të avancuara.³² Revista në internet “*The technical Mujahid*” përveç instruksioneve të ndryshme, përmban edhe teknikat për përdorimin e stenografisë (fshehja e mesazheve në fotografi apo skedarëve audio/video). Janë interceptuar imazhe që kanë patur tekste të kriptuara të fshehura në to, por ato nuk janë zbërthyer ende. Shkëmbimi i skedarëve të fshehur praktikohet në mënyrë aktive nëpërmjet përdorimit të “kutive postare anonime”, një adresë e-maili me shumë përdorues, ku skedarë shkëmbehen jo nëpërmjet dërgimit nga një korrespondent tek tjetri, por duke

³¹ CIA home/study/analysis on internet and terrorists

³² Terrorist activities on the internet in Terrorism update, 1998.

Është ruajtur ato si një e-mail draft, ku tërhiqen më pas nga përdoruesi tjetër i kësaj adrese. Kështu nuk gjenerohet trafik në internet dhe mesazhi s' mund të interceptohet.

Terrorizmi kibernetik

Ka shumë përkufizime mbi cyberterrorizmin, por dot'i referohesha atij më të thjeshtit të bërë nga James Lewis i Qendrës së Studimeve Strategjike dhe Ndërkombëtare: Përdorimi i internetit, rrjeteve, mjeteve, programeve elektronike për të dëmtuar, ndërprerë, sabotuar infrastrukturë kombëtare kritike si energji, transport, operacione qeveritare ose të presionojë një qeveri ose popullsi civile. Terrorizmi kompjuterik është një ndërthurje e terrorizmit dhe hapësirës kompjuterike. Ai është përkufizuar si një sulm i paramenduar, politik, i motivuar kundër informacionit, sistemeve, programeve kompjuterike, dhe të dhënave, të cilat pasojnë në dhunë, kundër shënjestrave nga grupe ndërkombëtare apo agjentë klandestinë. Sulmet që shkaktojnë vdekje, dëmtime trupore, shpërthime, rënie avionësh, kontaminim uji apo humbje të ndryshme ekonomike, mund të jenë shembuj. Sulme të rrezikshme mund të kryhen ndaj infrastrukturës dhe të jenë krime kompjuterike, në varësi të impaktit të tyre. Sulmet nëpërmjet internetit mund të jenë sulme ndaj infrastukturës dhe ndaj jetëve njerëzore.

Ato synojnë mohimin e një shërbimi apo ndalimin e sistemit për përdorim. Shumë prej sulmeve janë serioze dhe me dëme. Në vitin 1998, një 12-vjeçar piratoi në mënyrë të suksesshme në kontrollin e digave të njohura Rossvelt Dam, mbi Lumin Salt në Arizona. Ai mund të lëshonte portat e digës, të cilat mund të kishin përmbytur pa frikë banorët përreth, duke kërcënuar rreth 1 milion njerëz. Dhe në vitin 2002, faqe të njohura interneti në Indi, u dëmtuan. Mesazhe të lidhura me sigurinë e Kashmirit ishin ngjitur në *home paget* e këtyre faqeve. Klubi i Piratëve të Pakistanit, të drejtuar nga “Doktori Nuklear”, besohet se ishte pas këtij sulmi.³³

Epërsitë e përdorimit të kësaj forme të terrorizmit janë:

- është më pak e kushtueshme se metodat tradicionale të akteve terroriste;
- akti është më i vështirë të kapet apo gjurmohet;
- mundëson fshehjen e personalitetit apo vendodhjen e individit;
- s'ka barriera fizike;
- mund të aktivizohet pavarësisht nga vendndodhja;
- sulmi jep ndikim më të madh publik;
- siguron automatikisht publicitet të gjerë;
- eliminon audiencë shenjash me të gjera;

Duke përdorur internetin terroristët mund të shkaktojnë një dëm më të madh ndaj një vendi se sa dikush me aktin e tij vret disa njerëz. Duke dëmtuar p.sh. kapacitetin komandues apo mbrojtës të një shteti, terroristët mund të afektojnë më shumë njerëz, me më pak risk për ta.³⁴ Cyberterroristët mund të shkatërrojnë ekonominë e një vendi, duke atakuar infrastukturën në qytete të mëdha, si furnizimin me energji, ujë. “Akoma

³³Jemmy, Sprdes & Will, Brars “Examples of Cyber Terrorism”

³⁴Senator Jon Kyl, chairman of the senate judiciary subcommittee on terrorism, technology and homeland security report, 2010.

*nuk është shpjeguar ndërprerja totale e energjisë në Amerikën veriore në 15 gusht 2003, kishim të bënim me një akt cyber apo jo, apo sulmi ndaj sistemit bankar dhe institucioneve financiare”*³⁵Anëtarët e Al-Qaidës kanë tentuar të shënjojnë sisteme furnizimi me energji, sisteme transporti apo institucione financiare. Në Angli, Njësia e Kriminologjisë së Lartë (NHTCU), në një raport shkruante se 97% e kompanive në Britaninë e Madhe ishin viktime të krimit kibernetik gjatë periudhës qershor 2002, qershor 2003.

Përfundime

Përdorimi aktiv i internetit nga organizatat terroriste ka bërë që shërbimet e sigurisë të angazhojnë burime dhe mjete shtesë (sipas studiuesve një aspekt i dëshiruar nga terroristët) për sigurinë kombëtare në dëm të vëmendjes dhe aftësisë për të luftuar kërcënimet në fusha më kritike të sigurisë.

Pavarësisht thellimit të bashkëpunimit në shkallë ndërkombëtare të shërbimeve të sigurisë, dhe të gjithave masave parandaluese të marra prej tyre, deri më tash veprimtaritë për të ulur përdorimin e internetit nga terroristët nuk kanë patur rezultatet e dëshiruara nga mungesa e një legjislacioni të njëjtë për të trajtuar problemet e krimit dhe terrorizmit virtual në shkallë globale, e jo e fundit për nga rëndësia, hapësira gjigande e internetit, ku vetëm një pjesë e vogël e saj mund të monitorohet.

Sfidat bashkëkohore, dinamika e zhvillimit dhe përdorimi gjithnjë e më i madh i internetit si mjet për shkëmbimin e informacionit, përfshi midis terroristëve, e bëjnë të detyrueshme që shtetet demokratike dhe shërbimet e tyre inteligjente e të sigurisë të përmirësojnë vazhdimisht kapacitetet e tyre për të përballuar kërcënimet që vijnë nga përdorimi i internetit nga organizatat terroriste.

Bibliografia:

- Gabriel Weinann in “How modern terrorism uses the internet”.
- Prof Michel Chossudovski, The 9/11 reader. the september 11, 2001 terror attacks, global research, 2012.
- www.cfr.org/terrorism/shining-path-tupac-amaru-peru.../p9276 Council of Foreign relations, Publications
- www.hizb.org.uk/ Hizb ut-Tahrir është një parti politike, bazuar në islam.
- .capricorn.org/~akira/home/terror.html
- archive.org/details/TheAnarchistHandbook
- www.thepoisonreview.com/2010/02/21/the-poisoners-handbook/
- Open Source Center_Information for intelligence (CIA Library E..Resources. available at opensource.gov.
- Dorothy e. Denning in Terror’s web: “How the internet is transforming terrorism”
- CIA/ analysis on terrorism; 2010/opensource.gov
- www.downtownbeirut.com/government-sites/hezbollah-official-website
- www.jihadwatch.org/2004/01/al-qaedas-online-training-camp.html
- www.weatherbynation.com/spikecamp.../24/vanguard...base.../0/?...
- Dan Verton: “The Invisible Threat of Cyber terrorism” (2003),
- Opencource.goc/CIA/analysis on terrorism 2008
- Timothy L. Thomas in Al Qaeda and the internet: the danger of “cyber planning”

- Gareth Evans and Yoriko Kawaguchi in International Commission on Nuclear non-Proliferation and Disarmament. Time to reconsider the role of nuclear weapons: the international commission on nuclear non-proliferation and disarmament welcomes positive signs. Article: Published in the Vremya Novostey on 18 June 2009, ose shih Bobbie Johnson at guardian.co.uk, 24 July 2009, Terrorists could use internet to launch nuclear attack: report, the risk of cyber-terrorism escalating to a nuclear strike is growing daily, according to a study.
- Collin, Barry C. "The Future of Cyber Terrorism" Proceedings of 11th annual international symposium on criminal justice Issue. The University of Chicago, IL, 1996
- Open Source Center-Information for intelligence (CIA/analysis on terrorism).
- Eben Kaplan Updated: January 8, 2009, Terrorists and the Internet.
- Simon Shercliff and Sue Hemming OBE in The use of the internet for terrorist purposes, In collaboration with the United Nations Counter-Terrorism Implementation Task Force. Unodoc.org
- CIA home/study/analysis on internet and terrorists
- Terrorist activities on the internet in Terrorism update, 1998.
- Jemmy, Sprdes & Will, Brars "Examples of Cyber Terrorism"
- Senator Jon Kyl, chairman of the senate judiciary subcommittee on terrorism, technology and homeland security report, 2010.

Të njohim dhe edukojmë ushtarakët me vlerat më të mira morale e psikologjike

Ajet Nuellari,
Kryeredaktor i RU

Trajtesë e shkurtuar. *Mendimi ushtarak e ka vlerësuar historikisht, nga luftërat primitive deri tek ato modernet, faktorin moral si parësor, sepse kur lidhet drejt me faktorët e tjerë materialë, teknikë e ushtarakë, ai përmbys vlerësime dhe raporte të ndryshme forcash. Morali i lartë është forcë lëvizëse, me rëndësi përcaktuese, “armë gjithmonë e re, mjeti për të fituar luftën, apo për të shndërruar disfatën në fitore”.*

Në Forcat tona të Armatosura, akademitë dhe shkollat ushtarake, e gjithë përgatitja ushtarake, edukata politike, përgatitja psikologjike, po rishikohen me synim të veçantë për të formuar tek ushtarakët proceset e duhura volitive, për të kalitur karakterin, si dhe për të realizuar detyrat ndaj atdheut e kombit.

Dashuria për atdheun vlerësohet si faktori më i rëndësishëm në edukimin e ushtarakut me moral të lartë luftarak. Njohja dhe edukimi i vetive moralo-psikologjike, në stërvitje por edhe në luftë, është një nga problemet më të vështira për komandat e shtabet, për kuadrot dhe specialistët ushtarakë. Ato janë sintezë e pasqyrim i një vargu faktorësh politikë, ushtarakë, ekonomiko-shoqërorë etj. Të marrë së bashku, ata përbëjnë bazën objektive të edukimit, të normave e parimeve morale. Analiza e çdonjërit nga këto elemente, për të evidentuar rolin dhe ndikimin e tyre në treguesit e gjendjes moralo-psikologjike, është objekt i studimeve të veçanta.

Në këtë material po ndalemi vetëm në njërin prej këtyre faktorëve, në atë ushtarak, në lidhjet, ndikimin dhe bashkëveprimin e tij me faktorët moralo-psikologjikë. Studimin e shikoj në një spektër më të ngushtë, në aspektin e depolitizimit të faktorëve moralo-politikë e psikologjikë, për arsye se edukimi moralo-psikologjik, duke mos i shpëtuar dot politizimeve dhe duke e parë atë disi të shkëputur nga faktorët e tjerë, u absolutizua e u idealizua deri në kult, madje deri në atë masë sa mendohej se forca dhe veprimi i faktorëve moralo-psikologjikë nuk njeh as ligje lufte e as faktor material e ushtarak.

I politizuar deri në këtë shkallë, edukimi moral nuk siguronte bindje të qëndrueshme te njerëzit, prandaj ai erdhi vazhdimisht duke u zbehur. Vlerat e vërteta ai i merr në

kushtet e depolitizimit, të çideologjizimit e të departizimit, kur në bazë të tij vihen interesat e Atdheut e të kombit, të lirisë e pavarësisë së vendit dhe të politikës shtetërore, e ndërtuar mbi bazën e kushtetutës.

Depolitizimi i faktorëve moralë në përmbajtje do të thotë vlerësim real e objektiv i dukurive ushtarake, i rolit të pazëvendësueshëm të stërvitjes, të organizimit, të drejtimit e të komandimit, të teknikës e armatimit, të faktorëve materialo-teknikë të mjedisit dhe të gjendjes moralo-psikologjike të njerëzve që përgatiten për mbrojtjen e vendit.

Është e vërtetë se faktorët moralë nuk kanë as tavan dhe as dyshemë. Megjithatë kjo kurrsesi nuk do të thotë se ata janë të pamatshëm.

Mbështetur në përvojën e luftërave, mendimi ushtarak e ka vlerësuar faktorin moral si parësor, sepse kur lidhet drejt me faktorët e tjerë materialë, teknikë e ushtarakë, ai përmbys vlerësimet e raporte të ndryshme forcash. Në të kundërt, kur morali vlerësohet nga pozita burokratike në mënyrë të njëanshme, si qëllim në vetvete, i idealizuar e i politizuar, në situata luftarake si vështirësia, po ashtu dhe pengesa më e vogël e komprometon përmbajtjen e tij, krijon zbrazëti shpirtërore e krizë që të çojnë drejt katastrofës. Parë në këtë prizëm, përgatitja moralo-psikologjike është e pandashme nga ajo ushtarake, nga aspekti komandues e drejtues. Edukimi moralo-psikologjik, që bëhet në mënyrë dogmatike në ushtri, në kohën e monizmit solli në shumë raste një shkëputje të tij nga faktorët ushtarakë. Absolutizimi i moralit dhe glorifikimi i tij sollën moralizime të pafund, skema, formalizëm dhe eufori. Të ashtuquajturat “gjendje e lartë moralo-politike”, “uniteti i çeliktë”, “bindje e besim absolut në drejtësinë e çështjes” etj., jo vetëm ishin pjellë e dukurive të mësipërme, por edhe u kthyen në një kod moral të mërzitshëm e pa jetë, që shoqëronte të gjithë jetën në ushtri.

Ndikimi i faktorëve materialë e ushtarak, sidomos në luftë, ndaj faktorëve moralë e psikologjikë është shumë fleksibël. Ato, duke qenë rezerva të fuqishme morale, përbëjnë një bazë të fortë që siguron besimin në fitore. Teorikisht kjo është pranuar edhe më parë, madje duke përgjithësuar përvojën e luftërave të ndryshme në botë; është thënë se “ushtarit në luftë po i munguan ushqimet, fishekët, atëherë ai ikën e të lë frontin në një kohë kur ata duhet ta mbajnë me çdo kusht”. Por ç’vlera e formë bindëse kishte kjo kur në praktikë zhvillimet regresive ekonomike diktuan edhe një përmbajtje të theksuar në aspektin material e teknik, stanjacionin kronik. Përsa i përket armatimit e teknikës çdo pohim në sens pozitiv kompromentohej.

Lidhjet dhe raportet ndërmjet edukatës atdhetare dhe faktorit moral janë shumë të dukshme dhe me ndikime të forta, megjithëse sot nga autorë të ndryshëm propagandohet se pesha specifike e tij ka rënë, se në kushtet e zhvillimeve të reja të brendshme e botërore s’ndihet shumë nevojë për të, se ai më shumë i takon të kaluarës se sa të sotmes etj.

Natyrisht këto janë vështrime të skajshme, sepse edukimi atdhetar, si pjesë e rëndësishme e edukimit moralo-politik, përfshin jo vetëm të kaluarën historike, por edhe të sotmen, zhvillimet e reja, proceset reformuese që po ndodhin në vendin tonë. Brenda hapësirës së edukimit atdhetar, jo vetëm bëhen bilance historike, pra si të thuash bëhet “gjqyqi i historisë” me të mirat e mangësitë e saj, por nëpërmjet tij

infiltruhet sot politika shtetërore që përbën drejtimin bazë të edukimit moralo-politik në ushtri.

Edukata moralo-politike e shoqërore, që jepet sot nëpërmjet një cikli lëndësh humanitare, sistemit të punës edukative dhe përgatitjes ushtarake, luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e duhur psikologjike të ushtrisë për të realizuar detyrat ndaj atdheut dhe për depolitizimin e saj. Konceptimi i drejtë e i plotë i këtij procesi kaq të rëndësishëm bëhet nga njerëz me dije të thellë shkencore, me kulturë politike, me pikëpamje të shëndoshë morale e personalitet të spikatur; ndërsa mungesa e kulturës profesionale bën që të vlerësohet depolitizimi si apolitizim, si alergji ndaj çdo lloj edukimi moralo-politik. Qëndrime të tilla të gabuara e dëmtojnë rëndë edukimin moralo-psikologjik, si dhe realizimin e një depolitizimi të vërtetë e të plotë. Në fakt, “alergjia” që ndihet për edukimin moral e politik ka një bazë. Për shkak të zhgënjimit nga edukata moniste e frymëzuar nga ideologjia komuniste, për shkak të lënies mënjane të edukatës atdhetare dhe të rendjes pas politizimeve të shumta, disa mohojnë vlerat e edukimit moralo-politik e atdhetar. Sot, në veçanti në ushtri, nuk ka më vend, madje ndalohen me ligj rrymat e mësipërme ideologjike.

Bazë e edukimit moralo-politik tani është politika zyrtare e shtetërore, legjisllacioni në fuqi, problemet e mëdha e kapitale të ruajtjes së lirisë e të pavarësisë së atdheut. Që të bëhet mirë kjo, vetë procesi i stërvitjes dhe puna edukative po shikohen nga komandat dhe drejtuesit, të lidhura e me ndikim të ndërsjellë ndërmjet tyre. Parë në kushtet aktuale, sidomos në shkollë, ky proces ka vlerësim, trajtim shkencor dhe një riorganizim të tërë të punës nga vetë komandat dhe departamentet për formimin e duhur të kuadrove të reja të ushtrisë. Në këtë kuadër, nuk duhet të shkojmë drejt ngushtimit të orëve të lëndëve humane, përkundrazi t’i shtojmë ato, të gjenden zgjidhje optimale, forma e metoda tërheqëse e të larmishme të punës për edukimin atdhetar. Nëpërmjet këtij edukimi, ushtarakët do të përvetësojnë, ngulitin e do të bëjnë të tyret cilësitë më të mira të popullit tonë, si: ndjenjën e krenarisë kombëtare, të atdhedashurisë, besën, trimërinë, humanizmin, respektin e të drejtave të njeriut, si një përmasë e re e moralit njerëzor.

Në kushtet e zhvillimit tekniko-shkencor e bashkëkohor ekzistojnë të gjitha mundësitë si të nënvleftësimit, ashtu edhe të mbivlerësimit të faktorëve moralo-politikë. Vlerësimi i njëanshëm i teknikës e i armatimit mund të bëhet shkak për nënvleftësimin e faktorëve shpirtërorë. Kjo është karakteristikë për qëndrimet burokratike, ku pas raporteve të thata në teknikë, qoftë edhe raporteve njerëzore, lënë mënjane faktorin moralo-psikologjik të njerëzve.

Po kaq e dëmshme është edhe kur fetishizohen faktorët moralë. Duke nënvleftësuar e përçmuar situatën objektive ushtarake, teknike dhe materiale në emër të moralit të lartë, në fakt deformon moralin e njerëzve, kultivon euforinë, aventurizmin, abstraksionin, empirizmin, duke dëmtuar rëndë psikikën e ushtarakut. Ato nuk mund të zhvillohen në zbrazëti jashtë ligjësisë, mundësive e kushteve materiale teknike e pedagogjike, por të lidhura ngushtë me faktorët materialë. Këta të fundit luajnë rol kryesor për të fituar ose humbur luftën. Ata i japin moralit bazën materiale, pasi nuk ka moral në “hava”, këtë gjë e ka vërtetuar politika e luftërave. Politika e ngurtësuar moniste këto raporte i shikonte gabim, nga një optikë antishkencore.

Mesazhi i historisë së luftërave nga ato primitive e deri tek ato moderne është se, ato gjithmonë i kanë fituar njerëzit dhe jo armët. Kushdo që e ka harruar këtë, shpejt ose vonë, është detyruar ta kujtojë. “Një divizion me gjendje të lartë morale, thekson Klauzeviçi, mund të zëvendësojë së paku tre divizione që nuk e kanë këtë cilësi. Morali i lartë është forcë lëvizëse me rëndësi përcaktuese, armë gjithmonë e re e në veprim, mjeti për të fituar luftën apo për të shndërruar disfatën në fitore”¹. Cilado ushtri qoftë nuk mund të quhet e shkatërruar, përderisa nuk përshkohet nga ndjenja e disfatës, sepse disfata është përfundim i arsyes dhe jo një gjendje fizike. Në të vërtetë popujt, ushtritë, kombet për sa kohë që tek ata ka ekzistuar vullneti, vendosmëria, idealet e aspiratat për të mos iu nënshtruar asnjë lloj pushtimi, dhune fizike e morale, nuk janë mposhtur, qoftë dhe në situata më të rënda, ata kanë ditur të luftojnë, janë organizuar, kanë gjetur forma e metoda lufte origjinale, duke iu kundërvënë me sukses armikut.

Përmbajtja e moralit është e lidhur me cilësitë e njeriut, me karakterin e ushtrisë e të luftës. E keqja sot nuk vjen më shumë nga sulme që nuk i përballon trupi, sesa nga ato sulme që godasin psikikën. Cilësia e materialit njerëzor parakupton jo vetëm një grup idesh, parimesh e normash etike të shkruara në një të vetme, por edhe cilësitë fiziko-ushtarake të njeriut dhe faktorët e tjerë ushtarakë, teknikë e organizativë që nuk varen nga ushtari, të cilët ndikojnë e përcaktojnë në tërësi gjendjen e tij morale. Këtë unitet strategët e mëdhenj e kanë njohur dhe e kanë parë si burim të moralit të lartë. Në këtë mënyrë ata e kanë bërë luftën e mendjes po aq intensive sa atë të topave e të bajonetave.

Mendimi për moralin në luftë vazhdimisht ka ardhur duke ndryshuar. Tashmë ai nuk shihet si një sistem normash e marrëdhëniesh brenda kuadrit etik apo rregullave e normave morale të shprehura në manualët e kodet ushtarake. Përkundrazi koncepti për moralin kudo po shikohet në një spektër më të gjerë. Përmbajtja e re e tij sot përcaktohet jo vetëm nga faktorët politikë, ekonomikë, jetikë, nga karakteri i luftës etj., por ai po lidhet gjithnjë e më ngushtë edhe me përgatitjen luftarake, me masat organizativo-teknike, me armatimin, me drejtimin, me mënyrat dhe metodat e luftës, të cilat ndikojnë ndjeshëm mbi gjendjen moralo-psikologjike në luftë. Faktorë të tillë me të drejtë vlerësohen si faktorë force, besimi e uniteti luftarak. Klauzeviçi kur theksonte se, “*morali është faktor i padukshëm dhe gjithmonë në veprim*”², mban parasysh, ndërmjet të tjerave, dhe ndikimin mbi gjendjen morale të përgatitjes e aftësive luftarake të ushtarit, të besimit të tij në fitore. Fuqia kombëtare, shkruan anglezi Robert Thomson, është e barabartë me forcat ushtarake plus popullin, shumëzuar me vullnetin. Këtu koncepti i fuqisë kombëtare, vullneti dhe forca luftarake shfaqen si produkt i potencialit kombëtar, i vlerave shpirtërore e kulturore të tyre, i organizimit, i nivelit të prodhimit, i shkallës së zhvillimit, i unitetit kombëtar, i traditave luftarake, i nivelit dhe zhvillimit ushtarak. Elemente të tilla përbëjnë një nga bazat e edukimit moralo-psikologjik të ushtrisë e të popullit.

Por, duke iu shmangur trajtimit të përciptë e formal të tezës së mësipërme, vlen të veçohen e të trajtohen elementet përbërëse të vullnetit. Kjo për faktin që shpesh

¹ Kamil Drizhe, Aktualiteti i Klauzeviçit, bot. shqip, f. 48.

² Ibid f. 16.

vlerësohet numri i njerëzve, madhësia e popujve, e kombeve dhe nënvlerësohet vullneti, këmbëngulja e njerëzve për të realizuar qëllimet e tyre, detyrat e ngarkuara.

Në Forcat tona të Armatosura dhe në akademitë e shkollat ushtarake e gjithë përgatitja ushtarake, edukata politike, përgatitja psikologjike po rishikohen me synimin e veçantë për të formuar tek ushtarakët proceset e duhura volitive, për të kalitur në maksimumin e mundshëm karakterin, ku të jenë në unitet përjetimet, ndjenjat me aftësitë e vendosmërinë e ushtarakut për të realizuar detyrat ndaj atdheut e kombit.

Dashuria për atdheun vlerësohet si faktori më i rëndësishëm në edukimin e ushtarakut me moral të lartë luftarak. Që të realizohet një edukatë e shëndoshë moralo-psikologjike, “duhet vazhdimisht t’i mësohet ushtarit një gjeografi e histori e gjallë, shkruan Pol Zhinebski, duke e zhytur atë në të kaluarën për t’i rrënjosur në shpirt një substancë magjike siç është dashuria për vendin e tij, ku në çdo detyrë që kryen të kuptojnë që ka një atdhe”.³

Morali nuk shfaqet si një madhësi konstante që mund të peshohet një herë dhe gjithçka quhet e mbaruar. Përkundrazi, ai ekziston në një shkallë të caktuar te çdo njeri. Morali është produkt i faktorëve dhe i ngjarjeve të ndryshme. Gjeneral Brigade Ulio është shprehur se “morali është njëherësh cilësi dhe kusht i mendjes, i trupit dhe i shpirtit, një synim i përhershëm për çdo njeri.”

Edhe pse në përcaktime të tilla ka edhe zmadhime e hiperbolizime, ideja që duhet të mbrohet në këtë rast është rëndësia që ka marrë sot lufta moralo-psikologjike, mjetet me të cilat ajo realizohet. Kur thuhet se objekti i ndeshjeve nuk është thjesht veprimi fizik në hapësirë, por një veprim për të thyer moralin e njerëzve, për t’i detyruar ata të heqin dorë nga qëndresa e të tregohet se kur ka efekt lufta psikologjike nuk arrihet deri në ndeshje fizike. Në të vërtetë, efekti moral i zhvillimit të betejës është një koncept shumë më i mprehtë se sa një shkatërrim fizik. Beteja sipas Johan Kacgonit, është në mënyrë thelbësore, një konflikt moral.

Në këto e vlerësime të tjera, duket qartë roli parësor i moralit në luftë. Por në pamje të parë, nga përcaktimet e mësipërme, të krijohet përshtypja se faktorët moralë jo vetëm kanë dalë në plan të parë, por edhe përmasa njerëzore në luftë ka zëvendësuar, ose së paku, ka zbehur faktorët ushtarakë, teknikë e organizativë. Në të vërtetë, më shumë se një ndarje ose parcelizim të faktorëve të luftës, tani shikojmë një ngushtim e bashkërendim të tyre. Aq shumë janë forcuar lidhjet dhe ndikimi i ndërsjellë ndërmjet tyre, sa që është vështirë të mendosh se kjo betejë ose ky operacion u fitua, se morali është i lartë apo se u përdor një armë e re, apo se merita e fitores i takon një vendimi të zgjuar. Më shumë se kurdoherë tjetër, faktorët e luftës vlerësohen në unitet, në lidhje e ndikime të ndërsjella. Këto lidhje mendojmë se duhen parë në disa drejtime:

Së pari, problemet e luftës sot janë bërë më të ndërlikuara në aspektin moral; njerëzit, ushtritë, shtetet, grup-shtetet nuk mund të hidhen lehtë në luftë si në kohët e para. Shkalla e ndërjegjjes dhe e emancipimit të tyre është ngritur mjaft, prandaj ato janë tepër inerte ndaj problemeve, sidomos të luftërave pushtuese, ndaj edhe ata reagojnë me forcë për çdo politikë luftënxitëse e pushtuese.

³ Ibid f. 38.

Së dyti, në kushtet e zhvillimeve demokratike roli dhe pjesëmarrja e masave është rritur së tepërmi, ato i njohin dhe i vlerësojnë frytet e jetës së lirë. Në pamje të parë duket se kjo atmosferë e zbeh frymën luftarake, se njerëzit përtej mirëqenies e bollëkut nuk duan të shohin luftën, fatkeqësitë e shkatërrimet që vijnë prej saj, por kur ato lindin, fuqia morale e njerëzve, e ushtrive, e kombeve të tilla është mjaft e fuqishme, pasi i shohin ato si mjete mbrojtjeje të interesave të tyre.

Së treti, njeriu sot përfaqëson një cilësi të re në të gjitha planet morale, intelektuale, shkencore, ushtarake e teknike. Të gjitha këto e kanë bërë atë më të aftë e më të zotë në fushën e luftës, në zotërimin e teknikës e të armatimit, në konceptimin e vlerësimin e situatave luftarake, në zotërimin e gjendjes e rritjen e besimit në fitore. Të gjitha këto i kanë dhënë një hapësirë dhe rol të ri njeriut në luftë. E kanë bërë atë më të guximshëm, të vendosur, të aftë e me frymë të lartë luftarake. Pas kësaj cilësie të re të materialit njerëzor, në të vërtetë, qëndrojnë edhe elemente të tjera të luftës, të cilat, të vëna në veprim nga ai, do të shfaqin vlera edhe më të mëdha.

Së katërti, në përcaktimin e mësipërm krijohet përshtypja se në luftërat e sotme është zbehur roli i elementëve të luftës, si i armës apo i terrenit, ndërsa morali i njerëzve duket se u ka hyrë në pjesë atyre. Në të vërtetë një ndarje e tillë është metafizike, që nxit njëanshmërinë e subjektivizmin. Njeriu në fushën e luftës zakonisht ka moral të lartë, kur ka besim tek arma e terreni dhe tek ideja se lufton për një çështje të drejtë.

Konceptimi i problemeve morale dhe lidhja e tij me faktorë të tjerë është njëra anë e problemit. Po kaq rëndësi i është kushtuar nga studiues moralistë, psikologë e ushtarakë edhe formave e metodave konkrete të edukimit e të vetive morale. Ato janë të shumta e më karakter politik, psikologjik, pedagogjik etj. Por edhe pse këto rrugë e forma kanë rëndësi në edukimin e cilësive morale, ne nuk do të ndalemi në to. Synimi është që në këtë pjesë të trajtimit të evokojmë sadopak përvojën botërore dhe atë shqiptare në kalitjen e cilësive moralo-psikologjike nëpërmjet përgatitjes luftarake, nga ku do të shprehen dhe lidhjet me faktorët dhe rrugët e mësipërme. Le ta trajtojmë këtë problem në disa drejtime:

Dihet se nga elementet subjektive të luftës, disa nga më të rëndësishmet e gjendjes moralo-psikologjike kanë qenë dhe janë: trimëria, guximi, burrëria dhe vendosmëria. Me shumë të drejtë këto cilësi Klauzeviçi i quan motori i luftës, forcë kryesore lëvizëse, parime thelbësore të saj⁴. Ne e dimë se postulati i Skënderbeut ishte: “*trimat përgatiten në stërvitje e në jetë dhe se askush nuk lind trim. Është zotësi e komandantëve t’i bëjnë luftëtarët të guximshëm, heronj, legjendarë të betejave.*” Skënderbeu jepte vetë i pari shembullin në këtë drejtim. Si kryekomandant u nguliste thellë në shpirt ushtarëve dhe komandantëve idenë se: “*Shpëtimi është vetëm në duart dhe në shpatën e tyre*”.⁵

Stërvitjen ai e vlerësonte si rrugën kryesore për ta përgatitur ushtrinë të fortë dhe trime. Me këdo pranonte me kënaqësi dyluftimet, merrte pjesë në gara, zhvillonte stërvitje nga më të rëndat e në kushte deri në më të vështirat. Nga epërsia me të cilën

⁴ Ibid f. 48.

⁵ Komandant dhe strateg i madh, Tiranë, 1970, f. 33.

zhvillohej stërvitja, shpesh nuk dallohej nga lufta e vërtetë. Këtu ishte fusha ku ai dallonte trimat e të guximshmit nga frikacakët e të mefshtit, ata që kishin besim te forca e shpatës së tyre nga ata të lëkundurit. Komandantëve, përveç aftësive luftarake e forcës fizike, për të qenë trima u kërkohej të ishin organizatorë e drejtues të mirë, me nismë e kurdoherë në veprim. Mjeshtërinë në përdorimin e armëve e vlerësonte si faktor force dhe trimërie. Duke e vënë veten në rol të psikologut, ai njihte veçoritë psikologjike të ushtarëve dhe të komandantëve, pra ishte një mjeshtër i përpunimit psikologjik. Ai dinte mirë se si të edukonte ndjenjën e trimërisë te të tjerët. Pas betejave, komandantët dhe ushtarët e rinj i çonte për të parë armikun e mundur, robërit e kapur.

Po sot? Në aspektin teknik, organizativ e metodik të mjeshtërisë së komandave e kuadrove për të edukuar efektivat me ndjenjën e guximit e të trimërisë ka mjaft përvojë. Për të edukuar ndjenjën e trimërisë, amerikanët në luftimet e zhvilluara zbatojnë shumë masa me sens të theksuar praktik. Kështu, forcat e reja të porsaardhura në front nuk i fusin menjëherë në luftim. Ato në mënyrë të organizuar e të maskuar, sipas specifikës së detyrës, disa ditë rresht i shpien në afërsi të frontit për të parë e jetuar me vështirësitë e luftës, me natyrën e veprimeve luftarake, me mënyrën e veprimtimit të forcave të tyre, por dhe të kundërshtarit. Sidomos në veprimet luftarake natën, bashkë me efektivin ekzistues dhe me përvojën luftarake, fusin në përbërje të tyre edhe ushtarë nga repartet e tjera, të cilët e ndiejnë veten të sigurt nga shokët e tyre. Në kursin e “shikimit të armikut” parashikojnë masa të tilla, si zënien e pozicioneve të shtigjeve të sigurta nga ku dihet se kalojnë kundërshtarët natën. Këtu ushtarët e rinj, në pozita të përshtatshme, mësohen se si të asgjësojnë kundërshtarin, si duhet të manovrojnë në rast rreziku, si duhet të sulmojnë apo të tërhiqen. Ushtarëve u mësohet se armiku është pa fytyrë e pa emër, por ai ka për detyrë të vrasë dhe vrasja nuk është ndonjë gjë e vështirë.

Kur vinte koha që repartet e reja duhet të futeshin në luftim, fillimisht ato duhet të vendoseshin në krah të reparteve që kishin fituar titullin “ujqërit gjuetarë”, të cilët, me krenari pohonin se “ne s’kemi frikë nga vdekja, vdekja s’ka punë me ne”. Po kështu veprohej edhe me kuadrot pa përvojë në luftë. Për t’u hequr emocionet e fillimit në drejtimin e veprimeve luftarake, ata mbaheshin pranë nga kuadro me përvojë dhe caktoheshin me detyra shërbimi pranë tyre, si dhe ushtronin veprimtarinë përkatësisht nën kontrollin e kuadrove me përvojë. Psikoza e vdekjes në të cilën jetojnë ushtarë e kuadro, si dhe përpjekja për të mbijetuar në këto situata luftarake i bën ata të jenë të vëmendshëm, gjakftohtë, gjithmonë vigjilentë, të guximshëm e kurajoz për të shpëtuar veten.

Në përgjithësi, pas marrjes fund të Luftës së Ftohtë dhe shpërbërjes së Traktatit të Varshavës, si dhe në kohën kur organizmat e KSBE-së për problemet ushtarake po ushtrojnë një pushtet më të plotë, kanë lindur probleme të reja edhe në planin edukativ. Sot po i kushtohet shumë kujdes sfondit politik në të cilën zhvillohen stërvitjet, përcaktimit të kundërshtarit, të mjeteve dhe të mënyrave të realizimit të stërvitjeve, hapësirës ku zhvillohen ato etj. Është e pakëshillueshme, madje edhe e ndaluar, që si kundërshtar në këto stërvitje të përcaktohet një shtet konkret, pasi kjo do të quhet shantazh politik e trysni psikologjike ndaj shtetit që bëhet fjalë. Prandaj stërvitjet në përgjithësi luhen me organika tip, pa përkatësi shtetërore, konfliktet dhe idetë e

stërvitjeve ndërtohen në mënyrë të tillë që nuk implikojnë asnjë vend apo ushtri. Atëherë lind problemi se në kushtet kur në linjën ushtarake bëhen konceptime të tilla, pra kur nuk kemi të bëjmë me një armik konkret, a duhet të bëhet edukimi moralo-psikologjik, si duhet ndërtuar kundërpropaganda, ç'formë e metodë duhet ndjekur për të edukuar e nxitur frymën luftarake? Është e qartë se nëse ideja dhe planet e stërvitjeve nuk bëjnë fjalë për një kundërshtar real, atëherë s'ka si të ndodhë që puna efektive të bëjë objekt të përpunimit moralo-psikologjik, një armik konkret. Pra siç shihet, vështirësia këtu qëndron se puna edukative e propagandistike, që në këto rrethana bëhet e përgjithshme, pa objekt konkret, disi memece, nxit disi shabllonizimin. Ndonëse përvoja qoftë edhe ajo botërore në këtë drejtim është në fillimet e veta, disa forma e metoda të reja në edukimin moralo-psikologjik të ushtrive të tyre kanë dalë në pah.

Analiza konkrete e situatave politike ushtarake dhe reflektimi ndaj ngjarjeve e dukurive të ndryshme përbën një objekt të veçantë të punës edukative në ushtritë e huaja. Këto në përgjithësi, shërbejnë si subjekt për ndërtimin e planeve dhe të programeve të stërvitjeve. Kështu konteksti politik mbi të cilën u ndërtua një stërvitje komando-shtabi e flotës italiane, kohë më parë, ishte përballimi i eksodeve në vende të ndryshme të Lindjes. Mbi këtë bazë u ndërtua konflikti ushtarak, ideja e stërvitjes, ndërhyrja e aleatëve, masat e përpunimit moralo-politik, kundërpropaganda etj. Ndërsa stërvitja e NATO-s Sellinxher 1991 u ndërtua mbi bazën e një “konflikti” të brendshëm të forcave antiqeveritare në Gjermani, të disa incidenteve e provokimeve të kryera prej tyre, të cilat shkallë-shkallë u zgjeruan duke marrë përmasat e një konflikti të gjerë, që përligji ndërhyrjen e forcave aleate të NATO-s. Pra kur është fjala për kundërshtarin potencial, është më lehtë të përcaktohet sfondi politik i stërvitjes, të shmangët emërtimi i kundërshtarëve, ndërsa përpunimi psikologjik e moral bëhet mbi bazën e problemeve të ngritura në idenë e stërvitjes.

Por, krahas kundërshtarit potencial, ekziston edhe kundërshtari real, i cili për shumë vende e shtete përbën një rrezik serioz. Në këto raste, edhe pse mund të ruhet etika, ku të mos përmendet emri i kundërshtarit, përpunimi moral psikologjik realizohet më lehtë.

Megjithatë, edhe këtu dallohen dy probleme të punës për edukimin moralo-psikologjik: kur situatat ndërkombëtare janë disi të qeta dhe kur ato janë të acaruar e me shumë probleme. Në rastin e parë temat e edukimit dhe mjetet e propagandës, që ndikojnë në përpunimin moralo-psikologjik, bëjnë objekt problemet që kanë të bëjnë me edukimin e ndjenjës së atdhetarizmit, të krenarisë kombëtare, të rolit të ushtrisë në zbatimin e politikës shtetërore, të ndjenjës së detyrës, ato i referohen shumë historisë së luftërave, evakujnë traditat e ushtrisë së vendit të tyre, flasin për rreziqet potenciale. Ndërsa kur situata acarohet, vendin e temave të mësipërme e zënë ato që flasin për problemet e pretendimeve nacionale, për shkeljen e të drejtave të pakicave kombëtare, që jetojnë në shtetin fqinj. Me rrugë e forma të ndryshme nxisin urrejtjen dhe frymën agresive ndaj kundërshtarit.

Në këtë situatë, propagandës dhe edukimit që duhet të zhvillohet në ushtrinë tonë, u jepet mundësia të hedhin poshtë me argumente këtë propagandë shoviniste, të argumentojnë me fakte historike të vërtetën, si dhe të vënë theksin në forcimin e

vigjilencës e të gatishmërisë luftarake, se propaganda dhe tërë sistemi i edukimit në këto ushtri synon të mbajë gjallë ndjenjën e urrejtjes dhe frymën luftarake ndaj vendit tonë.

Një drejtim tjetër ku synon edukimi moralo-politik në situatat e reja është pasqyrimi i rolit dhe i misionit të ushtrisë për ruajtjen e paqes në botë. Kështu, edukimi synon të argumentojë rolin e ushtrisë, në veçanti të atyre shumëkombëshe në shërbim të lirisë dhe sigurisë në botë, për ruajtjen e karakterit demokratik dhe respektimin e sovranitetit të vendeve të tjera. Përvoja e ushtrive shumëkombëshe në Luftën e Gjirit tregoi se baza e edukimit moralo-politik e psikologjik ishte sqarimi i karakterit pushtues të luftës së irakianëve, shkeljen flagrante nga ana e tyre të konventave ndërkombëtare, pushtimi i paligjshëm ndaj shtetit të Kuvajtit, torturat dhe masakrat çnjerëzore të bëra prej tyre etj. Po kështu një vend të rëndësishëm zinin temat dhe veprimtaritë edukative që u bënin jehonë solidaritetit ushtarak, traditave luftarake të çdonjërës nga ushtritë pjesëmarrëse, rolit të kësaj aleance, respektimit të zakoneve e traditave luftarake të popullit kuvajtian,⁶ por edhe në vendet e tjera që e përkrahen aleancën në Luftën e Gjirit. Tipare e karakteristika të tilla vërehen sot në planin e përpunimit moralo-psikologjik të forcave shumëkombëshe të vendosura në ish-Jugosllavi. Edukimi këtu argumenton qëllimin politik të misionit të këtyre forcave, rolin e tyre për shmangien e konflikteve nacionale në ish-Jugosllavi, uljen e tensionit në vatra të tilla të nxehta dhe evitimin e luftës në këto vende.

Funksionet e reja që po marrin ushtritë në kushtet e ndryshimeve demokratike në botë detyrimisht po diktojnë edhe probleme të reja në planin edukativ. Në këtë drejtim në ushtritë e vendeve perëndimore po zënë vend gjithnjë e më shumë tema që argumentojnë rolin dhe detyrat e ushtrisë jo vetëm si forcë luftarake në shërbim të atdheut, por edhe detyrat e reja që ka ajo për furnizimin e vendit, shpërnguljen e popullsisë dhe përballimin e përmytjeve, si dhe mjaft detyrat të tjera të kësaj natyre. Masa të tilla e rritin autoritetin e ushtrisë, forcojnë besimin se ajo është në shërbim të kombit, të lirisë e të pavarësisë së vendit.

Shkenca ushtarake si një koncept dijesh për karakterin dhe ligjet e luftës, shërben për përgatitjen e vendit e të Forcave të Armatosura për luftë dhe për mënyrat e kryerjes së saj. Pikërisht kjo studion vartësinë e përgatitjes e të zhvillimit të luftës nga politika dhe ekonomia, raportet e mundësive moralo-politike, shkencore, teknike dhe ushtarake të palëve, si dhe mënyrat e përgatitjes dhe të zhvillimit të luftës. Por, shkenca ushtarake hedh vështrimin në historinë për të përgjithësuar përvojën që ajo mbart, si dhe problemet e perspektivës së afërt e të largët të luftës e të çështjeve që lidhen me të. Pra pjesët përbërëse të saj, si teoria e përgjithshme, historia ushtarake dhe e doktrinave kanë nevojë të studiohen dhe analizohen së bashku.

Bibliografia:

- Kamil Drizhe, Aktualiteti i Klauzeviçit, bot. shqip.
- Aleksandër Bek, Udhë e Volaholamskit, bot. shqip.
- N. Kuplend, "Psikologjia dhe ushtari", Tiranë, 1971, përkthim.
- M. E. Morris, "Rruga drejt triumfit", Tiranë, 1992, përkthim.

⁶ M. E. Morris, "Rruga drejt triumfit", Tiranë, 1992, përkthim, f. 8.

- OWE Viktorin, Vjenë, 1991, përkthimi në shqip.
- Velson, Seminari i Vjenës, Përkthim shqip, 1991.
- Doktrina mbrojtëse austriake, Vjenë, 1991.
- Studim “Mbi luftën në Vietnam”.
- Gabriel Bone, “Lufta revolucionare në Vietnam”.
- Roberta Batalia, “Lufta e Dytë Botërore”.
- Simpoziumi Ndërkombëtar Egjiptian, material në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, 1988, dosja 5.
- D. O. Smith, “Doktrina Ushtarake e SHBA-së, Tiranë, 1968.
- N. E. Morris, “Rruga drejt triumfit”, përkthim nga anglishtja, Tiranë.
- Dupuy, The Encyclopedia of Military History, London, 1980.
- F. S. Noli, Shkrime historike, Tiranë, 1989.
- Engelsi, Vepra të Zgjedhura Ushtarake, Vëll. 2, Tiranë, 1976.
- Revista “Për Mbrojtjen e Atdheut” 2, Tiranë, 1987.
- Norman Kuplend “Psikologjia dhe ushtari”, Tiranë, 1973.
- KB Smith Bask, “To the trenches”, Military review, nr, 2, 1990.
- Gazeta “Ushtria dhe Koha”, Tiranë, 1992, nr. 12.
- K. Rokosovski, “Detyra e një ushtari”, MM, përkthim, Tiranë, 1981.
- K. Kanoli, “Veprimet luftarake natën”, Tiranë, 1986.
- Studime Historike, Tiranë, 1987, nr. 2.
- Army, october, 1989.
- Rregullorja amerikane, viti 1994.

Konsensusi, kryefjala në paktet për sigurinë

Kolonele Manushaqe Shehu,
Drejtoreshë e Drejtorisë së Marrëdhënieve Civilo-Ushtarake, SHPPFA

Trajtesë e shkurtuar. *Konsensusi është një element kyç, i cili duhet të mbisundojë tryezat e takimeve të pakteve mbi sigurinë. Me anë të konsensusit, fuqia ushtarake kthehet në efekte politike të tilla që të mund t'i bëjnë ballë një konflikti të ri që mund të lindë apo që është në vazhdimësi. Shkrimi i mëposhtëm fokusohet kryesisht në aspektin studimor teorik të konsensusit, si një koncept politiko-filozofik.*

Fillimisht shkrimi orientohet në përcaktimin e konsensusit si koncept, ç'përfaqëson ai si nocion, si është përkufizuar nga studiues dhe rryma të ndryshme filozofike, rolin që ka luajtur në ngrirjen dhe funksionimin e shtetit të së drejtës. Domosdoshmëria e arritjes së tij qëndron në përbërjen dhe funksionimin e organizatave të rëndësishme ndërkombëtare, që nga OKB, NATO-ja e OSBE-ja.

Dhe së fundi, do të trajtojmë në përgjithësi rolin e konsensusit në marrjen e vendimeve të rëndësishme, në mbarëvajtjen e punës për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurimit kombëtar të vendit si pjesë përbërëse e strukturave euroatlantike, rëndësinë e arritjes së tij në strukturat e sigurisë kombëtare duke filluar nga Parlamenti (korumet parlamentare), Presidenti, Qeveria e deri në hartimin e dokumenteve bazë në fushën e strategjisë së sigurimit kombëtar: Politikës së Mbrojtjes dhe Strategjisë Ushtarake në Republikën e Shqipërisë.

Arritja e tij me një mbështetje më të madhe të aktorëve përfshirës do të shoqërohet me vendime më jetëgjata e të qëndrueshme, që rrjedhimisht do të jenë edhe më lehtësisht të zbatueshme. Trajtimi i konsensusit në nivele akademike do të ndikojë, goftë edhe sadopak, në njohjen teorike dhe në ndërgjegjësimin e personelit vendimmarrës për çështjet e sigurimit kombëtar në Republikën e Shqipërisë.

Ç'është konsensusi?

Që në këndvështrimin e parë për lexuesin krijohet përshtypja, madje edhe bindja, se para së gjithash, ky element i rëndësishëm për arritjen e bashkëpunimit është një nocion politik. Si i tillë, në masën më të madhe të vendosjeve të rëndësishme, ai i përket organizmave politike vendimmarrëse, të cilat, nëse e arrijnë atë mbi bazën e një logjike dhe arsyeje të shëndoshë, me urtësi dhe gjakftohtësi,

duke respektuar parimet themelore të një shoqërie demokratike, patjetër që do të arrijnë objektiva dhe qëllime mjaft të rëndësishme në favor të interesave jetike të një shoqërie, sikurse është edhe çështja e sigurisë.

Bazuar në fjalorin e Oksfordit, me fjalën “konsensus” kuptojmë një opinion ku të gjithë anëtarët (pjesëtarët) e një grupi janë të një mendimi¹. Maks Veber (Max Weber) e përcaktonte konsensusin si diçka që ekziston kur parashikimet tona lidhur me sjelljet e të tjerëve janë realiste, sepse të tjerët zakonisht do t'i pranojnë këto parashikime si të vlefshme për veten e tyre, edhe pa ndonjë marrëveshje të lidhur shprehimisht.

Në analizat e politikës së pasluftës në Britani dhe në vendet e tjera të Perëndimit, fjala “konsensus” përdorej për të treguar një lloj marrëveshjeje midis partive, rreth procedurave dhe rregullave kushtetuese, por edhe rreth objektivave politike në kuptim të gjerë, të tillë si mbajtja e sistemit shëndetësor kombëtar dhe shtetit të mirëqenies, si dhe zbatimi i metodave *keynesiane* të administrimit të kërkesave për të siguruar punësim të plotë.

Kavanagh dhe *Morris* e përcaktojnë konsensusin sipas kuptimit në të cilin ai zbatohet në politikën britanike të pasluftës, domethënë si një sërë parametrash që përkufizojnë një sërë opsionesh politike, për të cilat “Koalicioni i Madh” në Gjermani u bë shkas për shfaqjen e një opozite jashtëparlamentare në të djathtë dhe në të majtë, të përbërë nga qytetarë që e ndjenin veten të përjashtuar nga konsensusi centrist mbisundues. Në Britani, vështirësitë ekonomike, përherë e më të mëdha në vitet 1970, vunë në dyshim drejtësinë e një politike konsensusi që bazohet në shtimin e shpenzimeve publike pa marrë parasysh zhvillimin ekonomik.

Nën udhëheqjen e Margaret Theçerit, Partia Konservatore u largua nga politika e konsensusit, për të kaluar në një politike të bazuar në bindje, e cila e shikonte ndryshe zhvillimin nga Partia Laburiste, ndërsa në fillim të viteve 1980, Partia Laburiste bëri një kthesë të fortë nga e majta. Vitet 1990 u shoqëruan me një kthim të pjesshëm në një politikë konsensusi. Edhe gjatë periudhës së Margaret Theçerit u mbajt, në përgjithësi, konsensusi lidhur me procedurat politike, por për funksionimin e shtetit u pa e domosdoshme edhe një farë marrëveshjeje rreth procedurave të vendimmarrjes.

Roli i konsensusit në ngritjen dhe funksionimin e shtetit

Një shembull tipik i trajtimit të konsensusit nga pikëpamja historike në konstituimin e shtetit, është rasti i ngritjes dhe formimit të qeverisë në SHBA. Pasi fituan pavarësinë në luftën revolucionare (1775-1783), shtetet u ballafaquan me problemin e ngritjes së një qeverie në kohë paqeje. Shtetet duhet të vendosnin ligjin dhe rregullin, të mbledhnin taksat, të paguanin borxhet e mëdha shtetërore dhe të organizonin mbi baza ligjore tregtinë midis tyre. Ato duhet të merreshin gjithashtu edhe me fiset indiane dhe të hynin në bisedime me qeveritë e tjera. Udhëheqësit kryesorë si Xhorxh Uashingtoni² dhe Aleksandër Hamiltoni filluan të shqyrtonin krijimin e një qeverie të fuqishme kombëtare, të dalë nga një kushtetutë e re.

¹ Oxford Advanced Learner's Dictionary, (Seven edition 2005), fq. 323.

² George Washington (Xhorxh Uashington) ishte politikan dhe i pari President i ShBA prej 1789 deri 1797.

Hamiltoni dha ndihmesën e tij për thirrjen e një Kuvendi Kombëtar që u mbajt në Filadelfia të Pensilvanisë në vitin 1787, për rishikimin e neneve të Konfederatës. Por shumica e delegatëve në Kuvend vendosi hartimin e një programi të ri për qeverisjen e vendit, të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara. Kushtetuta nuk krijoi thjesht një bashkim mekanik shtetesh, por një qeveri që ushtroi pushtetin e saj të drejtpërdrejtë mbi të gjithë shtetasit. Kushtetuta përcaktoi qartë, midis të tjerave, kompetencat e qeverisë kombëtare. Krahas kësaj, ajo vendosi mbrojtjen e të drejtave të shteteve dhe të çdo individi. Detyra për krijimin e një qeverie të re nuk u krye me shumë lehtësi. Kishte raste kur Kuvendi rrezikohej të mbyllej nga polemikat midis delegatëve. Kështu për shembull, pati mosmarrëveshje midis delegatëve të shteteve të mëdha dhe të vogla, për numrin e përfaqësuesve të legjislaturës kombëtare. Shtetet e mëdha përkrahnin planin *Virxhinia*, sipas të cilit, numri i përfaqësuesve përcaktohej nga numri i popullsisë. Shtetet e vogla ishin për planin *Nju Xhersi*, sipas të cilit, të gjitha shtetet duhet të kishin numër të njëjtë përfaqësuesish. Delegatët e shtetit *Konektikat* bënë një propozim që e zgjidhi problemin. Plani i tyre parashikonte që numri i përfaqësuesve në Senat të ishte i barabartë, ndërsa në dhomën e përfaqësuesve ky numër do të përcaktohej në raport me numrin e popullsisë. Ky propozim u njoh me emrin “*Kompromisi Konektikat*” ose “*Kompromisi i Madh*”.

Kompromiset zgjidhën gjithashtu mosmarrëveshjet për çështjen e skllavërisë. Delegatët e shteteve të Veriut kërkonin që kongresi të kishte të drejtë të ndalonte tregtinë e huaj të skllavëve. Ndërsa shumica e delegatëve të shteteve të Jugut nuk ishin për një gjë të tillë. Me kompromis u vendos që kongresit t’i ndalohej kontrolli mbi tregtinë e huaj të skllavëve deri në vitin 1808. Një kompromis tjetër kishte të bënte me problemin se si do të kryhej numërimi i skllavëve, prej nga ku do të përcaktohej edhe numri i kongresmenëve për çdo shtet. Skllavërit nuk konsideroheshin si shtetas, ndaj dhe kuvendi ra dakord që të numëroheshin vetëm tre të pestat e tyre.

Për t’iu përgjigjur nevojave të ndryshme të Shteteve të Bashkuara, me kalimin e viteve, Kushtetuta është zgjeruar dhe përsosur më tej. Xhems Medison³ ka deklaruar: “Në ndërtimin e një sistemi që do të dëshironim të zgjaste në shekuj, nuk duhet të harrojmë ndryshimet që do të sjellin këto shekuj”. Kushtetuta u hartua për t’i shërbyer interesave të njerëzve, qofshin të pasur apo të varfër, banorë të Veriut apo të Jugut, punëtorëve dhe afaristëve.

Për shkak të konsensusit, në hartimin e kësaj kushtetute, megjithëse për t’iu përgjigjur kërkesave të një shoqërie amerikane në zhvillim të pandërprerë, kushtetuta është përsosur vazhdimisht, fryma dhe teksti i kushtetutës nuk ka ndryshuar. Njerëzit e çdo brezi e kanë zbatuar atë në rrugët që iu janë dukur atyre më të përshtatshme. Shtetari anglez Uilliam E. Gledstoun e ka cilësuar kushtetutën si veprën më të shkëlqyer që mund të ketë nxjerrë ndonjëherë mendja dhe vendosmëria njerëzore.

Konsensusi, baza e ekzistencës së organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare

Aktorët që dalin jashtë nivelit shtetëror, zakonisht karakterizohen me termin përfshirës organizatat ndërkombëtare. Këto organizata i kapërcejnë kufijtë shtetërorë.

³ James Madison (Xhejms Medison) ishte i katërti President i SHBA-ve (1809-1817).

Organizatave ndërkombëtare ndryshojnë shumë nga pikëpamja e llojit dhe anëtarësisë, shkalla e integritetit dhe arsyet e ekzistencës. Edhe pse organizatat ndërkombëtare janë shfaqur për më tepër se një shekull më parë, shekulli i njëzetë ka parë një zgjerim të numrit të tyre, sidomos mbas mbarimit të LIB. Fillimisht, ato modeloheshin si institucione ndërkombëtare për të koordinuar dhe bashkëpunuar në fusha të veçanta përtej kufijve kombëtarë. Pavarësisht se nga pikëpamja e politikës ndërkombëtare këta aktorë konsiderohen sekondarë ndaj shtetit, rëndësia e tyre po rritet vazhdimisht për shkak të numrit dhe përpjekjeve të tyre për koordinimin e veprimtarive ndërshtetërore, koordinim i cili krijohet mbi bazën e konsensusit ndërmjet palëve apo anëtarëve të organizatës, duke iu vënë përballë parimet themelore (të cilat duhet t'i respektojnë), parime këto të miratuara me konsensus. Mbi bazën e konsensusit ato bashkëpunojnë dhe krijojnë aleanca.

Bashkëpunimi

Pse duhet bashkëpunuar? Mund të duket një çështje e qartë, por pse duhet të shqetësohen shtetet për çfarë ndodh jashtë kufijve të tyre? Ç' mund të thuhet thjesht për ekzistencën në botë, pa ndërhyrë në punët e të tjerëve, siç bëjnë disa shtete neutrale? Përgjigja e thjeshtë, por thelbësore, është se shtetet nuk janë të pavarura në një botë të ndërvarur. Siç kemi vërejtur, kjo ndërvarësi është rritur tepër gjatë këtij shekulli. Por edhe në një botë më pak të integruar, vendet përsëri ndërveprojnë. Kjo bëhet nga nevoja dhe me zgjedhje.

Nga nevoja, sepse qytetarët kalojnë kufijtë ndërkombëtarë. Vendet mund të bazohen në burime natyrore ose energji që importohen nga vende të tjera. Shtetet kërkojnë të sigurojnë kufijtë e tyre duke vendosur marrëdhënie të mira me shtetet fqinjë. Në këtë aspekt mund të gjenden arsye pa fund.

Me zgjedhje, sepse vendet mund të përfitojnë ekonomikisht dhe politikisht nëpërmjet marrëdhënieve me vendet e tjera. Si rregull i përgjithshëm, bashkëpunimi kryhet atëherë kur prej këtij bashkëpunimi përfitojnë të dy palët. Kështu, bashkëpunimi është pasojë e natyrshme dhe e domosdoshme e të qenit në një grup prej shumë vendesh. Si i tillë, bashkëpunimi bëhet në tre forma kryesore: ekonomike, politike dhe ushtarake.

Mjeti kryesor me të cilin realizohet bashkëpunimi në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare është Politika e Jashtme apo e quajtur ndryshe Diplomacia. Diplomacia bëhet sipas situatës, që do të thotë se ajo kryhet edhe për veprime dhe bisedime në lidhje me rrethana të veçanta, jo thjesht për veprimet e përditshme. Pikërisht, në kohë të tilla, aftësitë për bisedime dhe ndërmjetësi marrin rëndësi të veçantë. Në kohë konflikti, mund të përdoren taktika të tjera, si ndërhyrja diplomatike (përpjekja për ta bindur një vend të bëjë diçka nëpërmjet mjeteve diplomatike) dhe propagandimi. Së fundi, diplomacia është jetike për menaxhimin e krizave. Në momente të tilla, diplomatët më të lartë dhe kryetarët e shteteve ndërhyjnë për të zgjidhur problemet.

Diplomacia sot karakterizohet nga kontakte shumëpalëshe (nëpërmjet traktateve, konferencave dhe organizimeve ndërkombëtare); nga debati dhe votimi në forumet e organizatave ndërkombëtare më shumë sesa nga kompromisi dhe konsensusi në

marrëveshje dypalëshe sekrete; nga kontaktet midis të gjitha shteteve më shumë sesa nga ato midis fuqive të mëdha; nga diplomatë që vijnë nga segmente të gjera të shoqërisë dhe nga rritja e ndikimit të organeve ligjvënëse dhe opinionit publik. Së fundi, diplomatët dhe ambasadorët, në njëfarë mase, janë zëvendësuar nga praktika e samiteve. Samitet janë takime midis vendimmarrësve të nivelit të lartë që udhëtojnë nëpër botë për të takuar dhe biseduar me homologët e tyre në vendet e tjera. Ky është një koncept i ri, i mundur nga lehtësitë e komunikimit dhe të transportit në shekullin e 20-të⁴.

Aleancat

Aleancat janë përdorur shumë gjatë kohës së balancës së fuqisë, në shek. e 19-të dhe të 20-të. Ato përfaqësonin një angazhim të fortë për të grupuar veprimet në rast agresioni dhe, në këtë sens, ishin zakonisht mbrojtëse. Ushtria e Napoleonit u kundërsulmua p.sh. nga aleanca e Anglisë, Austro-Hungarisë, Prusisë dhe Rusisë. Lufta I Botërore ballafaqoi aleancën dypalëshe të Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë me Antantën trepalëshe midis Rusisë, Francës dhe Anglisë. Më vonë, me të u bashkuan edhe SHBA-të. Në Luftën e II Botërore, Bashkimi Sovjetik, Franca, Anglia dhe Shtetet e Bashkuara iu kundërvunë Gjermanisë dhe aleatëve të saj. Fundi i LIIB shënoi një ndryshim në mënyrën e formimit dhe të funksionimit të aleancave. Aleancat moderne, në kontrast me ato të mëparshmet, kanë tendencën të jenë më të mëdha dhe më të institucionalizuara. Ato zakonisht kanë një planëzim konkret, organe ushtarake dhe janë shumë të integruara (NATO 1949, T. i Varshavës, 1955)⁵.

Duhet të përmendim edhe diçka në lidhje me efektet e armëve bërthamore ndaj aleancave. Aleancat zakonisht duhen për të grupuar forcat dhe për të sulmuar një armik të fuqishëm. Prandaj, forca ushtarake e anëtarëve të saj është më se e rëndësishme. Armët bërthamore e sfidojnë të gjithë këtë. Një vend që ka armë bërthamore të mjaftueshme, nuk ka nevojë për aleat. Megjithatë, aleancat e ruajnë avantazhin e tyre: është gjithmonë e dobishme të kesh aleatë për të marrë ndihmë ushtarake konvencionale, për të grumbulluar informacion dhe për të siguruar një mburojë diplomatike. Për këto arsye, aleancat mbeten shumë të rëndësishme në politikën ndërkombëtare edhe në kohën bërthamore. Një arsye e fundit është se, armët bërthamore, për shkak të fuqisë së tyre, nuk përdoren në konflikt, ndërsa operacionet ushtarake konvencionale përdoren (sfera e aleancave). Për sa kohë armët bërthamore nuk do të përdoren, por thjesht do të zotërohen, aleancat do të ruajnë rëndësinë e tyre në politikën ndërkombëtare⁶.

Një ndër produktet më të rëndësishme të nismave konsensuale dhe vendimmarrjeve të rëndësishme politike ndërkombëtare është OKB. Karta e Kombeve të Bashkuara u arrit të nënshkruhej në San Françisko, më 26 qershor 1945, nga 50 kombe. Me 24 tetor 1945, Kombet e Bashkuara u krijuan edhe formalisht. Që nga krijimi, gjatë

⁴ Henning Boekle, Volker Rittberger, Wolfgang Wagner, Normat dhe Politika e jashtme (Norms and Foreign Policy).

⁵ Pettman, Ralph. 1991. International Politics: Balance of Power, Balance of productivity, Balance of Ideologies. Sydney: Longman Cheshire Pty, Ltd.

⁶ Viotti and Kauppi, International Relations Theory, 1-16, 532-40 (normative theory).

gjithë historisë së saj si organizatë, vendimet janë marrë kryesisht me konsensus, ndaj dhe ajo ka qenë e suksesshme dhe ka kontribuar në mënyrë shumë domethënëse në ruajtjen dhe vendosjen e sigurisë ndërkombëtare. Në vijimësi të kryerjes së misionit, OKB-ja ka ngritur edhe strukturat përgjegjëse, të cilat i kanë dhënë tonin historisë së saj në këto 6-7 dekadat e fundit të historisë botërore. Neni 51 i Kartës së OKB shpreh të drejtën e natyrshme të mbrojtjes individuale apo kolektive të të gjitha vendeve anëtare të OKB-së. Ai sanksionon masat që mund të merren në ushtrimin e kësaj të drejte, deri në atë kohë kur Këshilli i Sigurimit të ketë marrë hapat e nevojshëm për të ruajtur paqen dhe sigurinë kombëtare.

Nga viti 1945 deri në vitin 1949, përballë nevojës së madhe për rindërtim ekonomik, Vendet e Unionit Perëndimor dhe aleatët e tyre të Amerikës së Veriut i shikonin me brengosje politikën ekspansioniste dhe metodat e BRSS. Duke patur parasysh synimet e deklaruara ideologjike të Partisë Komuniste Sovjetike, ishte e qartë se thirrjet për respektimin e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe respektimin e zgjedhjeve ndërkombëtare të arritura në fund të luftës, nuk do të garantonin sovranitetin kombëtar apo pavarësinë e shteteve demokratike, të përballura me kërcënimin e agresionin nga jashtë apo me subversionin e brendshëm. Këtyre frikësimeve iu shtoheshin imponimi i formave jodemokratike të qeverisjes dhe represioni i opozitës efektive dhe të drejtave themelore njerëzore dhe qytetare të shumë vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe të botës⁷.

Midis viteve 1947 dhe 1949, një sërë ngjarjesh politike i sollën punët deri në pikën më të lartë të krizës. Ndër to përmendim kërcënimet për sovranitetin e Norvegjisë, të Greqisë, të Turqisë dhe vendeve të tjera të Evropës Perëndimore, bllokadën e paligjshme të Berlinit etj. Në këtë kuadër nënshkruhet traktati i Brukselit, i marsit 1948, për zhvillimin e sistemit të përbashkët të mbrojtjes së Belgjikës, Francës, Holandës, Luksemburgut dhe Mbretërisë së Bashkuar.

Negociata me SHBA dhe Kanadanë vazhduan më pas rreth krijimit të një Aleance të vetme të Atlantikut të Veriut, të bazuara në garantimin e sigurisë dhe në angazhime të ndërsjella midis Evropës dhe Amerikës së Veriut. Danimarka, Islanda, Norvegjia, Portugalia u ftuan nga fuqitë e Traktatit të Brukselit të bëheshin pjesëmarrëse në këtë proces. Këto negociata kulmuan në nënshkrimin e traktatit të Uashingtonit, në prill 1949, duke jetësuar një sistem të përbashkët sigurie, të bazuar mbi partneritetin midis këtyre 12 vendeve. Më vonë, në këtë traktat u anëtarësuan edhe vende të tjera, proces i cili vazhdon edhe sot.

Qëllimi themelor i NATO-s është të ruajë lirinë dhe sigurinë e të gjitha vendeve anëtare të saj me mjete politike dhe ushtarake, në përputhje me traktatin e Atlantikut të Veriut dhe me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara. Aleanca ka punuar që nga krijimi i saj për themelimin e një rendi paqësor të drejtë dhe të qëndrueshëm në Evropë, të bazuar mbi vlerat e përbashkëta të demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe të shtetit ligjor.

Mjetet, me të cilat Aleanca kryen politikën e vet të sigurisë, përfshijnë mirëmbajtjen e një aftësie të mjaftueshme ushtarake, për të parandaluar luftën, një aftësi të

⁷ Henry Kissinger, "Diplomacia", Dilemat e fituesve, fq: 246-266.

përgjithshme për të menaxhuar krizat që ndikojnë në sigurinë e anëtarëve të saj, një shtysë aktive të dialogut me kombet e tjera dhe të një qasjeje bashkëpunuese ndaj sigurisë evropiane, duke përfshirë masat për të sjellë progres të mëtejshëm në fushën e kontrollimit të armëve dhe të çarmatimit.

Për të arritur qëllimin e saj themelor, aleanca kryen edhe detyrat themelore të sigurisë që janë:

Siguria, për të hedhur një nga themelet më të domosdoshme për një mjedis sigurie të qëndrueshëm të Euroatlantikut, të bazuar në institucionet demokratike dhe në angazhimin për zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve.

Konsultimi, për të shërbyer, ashtu siç thuhet në Nenin 4 të Traktatit të Uashingtonit, si një forum themelor transatlantik për konsultime aleate, për çfarëdojloj çështjesh që ndikojnë në interesat jetësore, duke përfshirë zhvillimet e mundshme që paraqesin rreziqe për sigurinë e anëtarëve, si dhe për koordinimin e duhur të përpjekjeve të tyre në fusha të interesit të përbashkët.

Sprapsja dhe mbrojtja, për t'u sprapsur dhe për t'u mbrojtur nga çfarëdojloj kërcënimi apo agresioni, kundër cilitdo shtet, ashtu siç parashihet në Nenin 5 dhe 6 të Traktatit të Uashingtonit dhe me qëllim shtimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajonin euroatlantik.

Menaxhimi i krizës, për të qëndruar të gatshëm, rast për rast dhe me konsensus, konform nenit 7 të Traktatit të Uashingtonit, për t'i kontribuar parandalimit efektiv të konfliktit dhe për t'u angazhuar aktivisht në menaxhimin e krizës, duke përfshirë operacionet në përgjigje të krizës.

Partneriteti, për të çuar më tej partneritetin e një game të gjerë bashkëpunimi dhe dialogun me vende të tjera në rajonin e euroatlantikut, me synim rritjen e transparencës, besimit të ndërsjellë dhe kapacitetit për aksion të përbashkët me Aleancën.

Konsultimi politik midis anëtarëve të Aleancës nuk kufizohet në ngjarjet që ndodhin brenda rajonit të NATO-s. Gjithnjë e më shumë, ngjarje jashtë rajonit gjeografik që mbulohet nga NATO, kanë implikime për Aleancën dhe prandaj dalin në axhendën e Këshillit dhe të komiteteve dytësore. Makineria konsultative e NATO-s është gjithnjë në dispozicion dhe përdoret gjerësisht nga kombe anëtare, në rrethana të tilla, madje edhe nëse NATO si Aleancë mund të mos jetë e përfshirë drejtpërsëdrejti. Duke u konsultuar së bashku, vendet anëtare janë në gjendje të identifikojnë, në një fazë të hershme, rajonet ku, në interes të sigurisë dhe stabilitetit, mund të ndërmerret aksion i koordinuar. Konsultimi brenda aleancës merr shumë forma. Në nivelin e saj më themelor, përfshin thjesht këmbimin e informacionit dhe të mendimeve. Mund të përfshijë diskutimin, me qëllim arritjen e një konsensusi rreth politikës që do të adoptohet apo të vendimeve që do të ndërmerren paralelisht.

Praktika e këmbimit të informacionit dhe e konsultimit, së bashku, sigurojnë që qeveritë të mund mblidhen, me paralajmërim të shkurtër kur të jetë nevoja, shpesh duke i ditur që më parë shqetësimet e tyre përgjegjëse, në mënyrë që të pajtohen rreth politikës së përbashkët. Në qoftë se duhet, përpjekja për të pajtuar ndryshimet midis tyre do të bëhet në mënyrë që veprimet e përbashkëta të mbështeten nga forca

e plotë e vendimeve me të cilat të gjitha vendet anëtare pajtohen. Mbi këtë frymë, të gjitha vendet anëtare të NATO-s marrin pjesë plotësisht në nivelin politik të bashkëpunimit brenda Aleancës dhe angazhohen njësoj ndaj termave të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe jo vetëm ndaj ndërmarrjeve reciproke, sipas Nenit 5, që simbolizon pandashmërinë e sigurisë së tyre e që do të thotë që një sulm ndaj një apo më shumë prej tyre, do të konsiderohet si një sulm mbi të gjithë ata⁸.

Strukturat e sigurisë kombëtare dhe konsensusi, si element i rëndësishëm

Parlamenti, Presidenti, Qeveria, komisionet parlamentare të sigurisë janë strukturat kryesore të zhvillimit, integritimit dhe zbatimit të Strategjisë së Sigurimit dhe Politikës së Mbrojtjes së një shteti demokratik. Si të tilla, ato funksionojnë edhe në vendin tonë.

Që në fillimet e njerëzimit, sovraniteti dhe siguria kombëtare janë konsideruar thelbësore për një shtet të qëndrueshëm. Roli i atyre që kanë detyrë të garantojnë sigurinë po ndryshon në mënyrë të ndjeshme, në ditët e sotme. Llojet e reja të konflikteve të armatosura dhe lidhjet, gjithnjë në rritje, midis shteteve kanë nxitur kundërpërgjigje të tjera dhe një mendim të ri, lidhur me vetë konceptin e sigurisë. Sulmet e 11 Shtatorit 2001 dhe pasojat e tyre e kanë theksuar më tepër këtë nevojë.

Mbikëqyrja parlamentare merr rëndësi vendimtare që këto kundërpërgjigje të reja të hartohen dhe të zbatohen me transparencë dhe përgjegjshmëri të plotë. Në mungesë të saj ekziston rreziku që shërbimet e sigurisë ta keqinterpretojnë misionin e tyre dhe të veprojnë si shtet brenda shtetit, qoftë duke i vënë burimet e pakta nën trysinë e kërkesave të mëdha, qoftë duke ushtruar ndikim të tepruar politik dhe ekonomik. Ato mund të pengojnë demokratizimin dhe madje t'i rrisin mundësitë për konflikt. Ndërsa shoqëritë në tranzicion, të lodhura nga luftërat apo të prekura nga krizat, ndodhen në rrezik të veçantë, demokracive të qëndrueshme iu duhet të merren me marrëdhëniet mes civilëve dhe ushtarakëve, duke i shndërruar dhe drejtuar në mënyrë të tillë që ato të ecin me mjedisin e sigurisë gjithnjë e në ndryshim.

Natyra e brendshme e fushës së sigurisë dhe dinamika e saj përfaqësojnë një sfidë të vërtetë për mbikëqyrjen dhe efektshmërinë parlamentare. Shumëllojshmëria e çështjeve, shumë herë teknike, numri i konsiderueshëm dhe organizimi i ndërlikuar i personelit të angazhuar në fushën e sigurisë, si dhe ligjet, rregullat dhe praktikat në lidhje me fshehtësinë, shpeshherë e bëjnë shumë të vështirë faktin që parlamentarët të punojnë në mënyrë të efektshme, pa shfrytëzuar kërkimet dhe ekspertizën e pavarur.

Jo të gjitha konfliktet përbëjnë kërcënim për paqen dhe sigurinë. Në çdo shoqëri ekzistojnë pikëpamje konkurruese dhe, shpeshherë, të kundërta për një numër të madh problemesh. Në demokraci, liria e shprehjes lejon që njerëzit t'i ua transmetojnë këto pikëpamje përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Këta, nga ana tjetër, kanë për detyrë që, përmes debatit publik, t'i diskutojnë dhe t'i vlerësojnë çështjet që rrezikojnë të shpërthejnë. Kjo procedurë bën të mundur që demokracitë të zbusin konfliktin dhe të kërkojnë kompromise të frytshme, të cilat kanë mbështetjen e shoqërisë në

⁸ "North Atlantic Treaty Organisation" tekst, ribotim 2009.

përgjithësi. Nuk është çudi që pikërisht, për shkak të mungesës të institucioneve mirëfunktionuese demokratike, shpeshherë tensionet përshkallëzohen përtej kontrollit dhe shndërrohen në konflikt të dhunshëm. Duke pasur parasysh mekanizmin e saj të brendshëm për kanalizimin e konfliktit, demokracia shihet në thelb si e lidhur me paqen dhe sigurinë.

Siguria kombëtare, boshti i të cilës është mbrojtja e shtetit, bëhet siguri njerëzore që vendos në radhë të parë individin dhe komunitetin. Në praktikë, kjo ka bërë që shtetet të kundërveprojnë në shkallë të gjerë ndaj rreziqeve që kërcënojnë sigurinë, duke përfshirë:

Veprimin parandalues, nismat për parandalimin e konflikteve siç janë veprimet për zgjidhjen e konflikteve dhe atyre për ndërtimin e paqes, të cilat kanë në qendër njerëzit.

Ndërrhyrjen, në raste të skajshme, kur përpjekjet e tjera dështojnë, për të ndërrhyrë në konfliktet e brendshme, me qëllim që të mbrohen popullsitë të cilat ndodhen në rrezik të madh.

Veprimin kundërveprues, veprimi për dhënien e ndihmave që është i nevojshëm gjatë ose pas një lufte civile, me qëllim që të mbështeten civilët të cilët vuajnë nga lufta. Kjo përfshin ngritjen e kampeve për të shpërngulurit, dhënien e azilit për refugjatët ose dhënien e ndihmave.

Nga siguria ushtarake në sigurinë e përgjithshme

Zhvendosja e fokusit tek “siguria e njerëzore” shkon krahas konceptit të sigurisë, përtej gjykimeve të mirëfillta ushtarake. Ekziston një konsensus në rritje, se çështja e sigurisë duhet të trajtohet në mënyrë të përgjithshme, duke marrë gjithashtu parasysh faktorët joushtarakë. Rreziqet e tjera për sigurinë sot përfshijnë veçmas ose të kombinuara:

Rreziqet politike si qëndrueshmërinë e brendshme politike, shtetet e dështuara, terrorizmin dhe shpërdorimet me të drejtat e njeriut.

Rreziqet ekonomike si varfërinë, hendekun në rritje mes vendeve të pasura dhe vendeve të varfra, recesionin financiar ndërkombëtar, ndikimin e një shteti fqinj ekonomikisht të fuqishëm ose të paqëndrueshëm dhe piraterinë.

Rreziqet e mjedisit ose rreziqet e shkaktuara nga njeriu si katastrofat bërthamore, ndryshimet e përgjithshme ekologjike, degradimin e tokës ose të ujit, mungesën e ushqimit dhe të burimeve të tjera.

Rreziqet shoqërore si konfliktet pakicë-shumicë, mbipopullimin, krimin e organizuar, kontrabandën e drogës midis vendeve, tregtinë e kundërligjshme, integrimin masiv të pakontrolluar dhe sëmundjet.

Avantazhi i një kalendari më të gjerë të sigurisë është se ai ndihmon për t’i kuptuar, në mënyrë më të plotë, rreziqet ndaj sigurisë dhe kundërveprimet e nevojshme.

Bashkëpunimi për sigurinë

Siguria kombëtare nuk mund të arrihet vetëm me “forcat kombëtare”, por është i ne-

vojshëm edhe bashkëpunimi midis shteteve. Shembujt janë të shumtë, të shtrirë në kohë ashtu dhe në hapësirë. Rreziqet aktuale të sigurisë karakterizohen nga aftësia për t'u përhapur me lehtësi dhe për të destabilizuar rajone apo pjesë të botës. Ky realitet, së bashku me zgjerimin e kalendarit të sigurisë, i ka dhënë shtysë të mëtijshme bashkëpunimit ndërkombëtar për sigurinë. Në këtë kuadër, sot flitet për "*Partneritet për Paqe*", "*Mbrojtje Kolektive*", "*Siguri Kolektive*", "*Siguri Bashkëpunuese*".

Shqipëria është duke u konsoliduar në një proces të vazhdimtë të reformave, të cilat kërkojnë kohë dhe përpjekje të vazhdueshme. Mundësia e shfaqjes së rreziqeve të brendshme është e pranishme dhe mund të vijë si rezultat i trafiqeve të paligjshme, krimit të organizuar, ekzistencës së një pjese të armëve akoma në duart e popullsisë, lëvizjes së pakontrolluar të njerëzve, korrupsionit, mangësive në konsolidimin e funksionimit të shtetit ligjor etj.

Ka ikur tashmë koha kur sigurimi i një vendi imagjinohej vetëm si sigurim i territorit të shtetit nga ana e ndonjë agresioni të mundshëm ushtarak. Koncepti i sigurisë ka marrë një kuptim më të gjerë nga ai që ka patur më parë. Pra, krahas ruajtjes së kufijve të shtetit, a është i sigurtë populli që jeton brenda këtyre kufijve; a është i çliruar ai nga krimi, nga mungesa e ushqimit, e strehimit, nga rreziku i epidemive; a i ka liritë politike e fetare; a jeton secili i barabartë brenda shtetit, pavarësisht nga përkatësitë politike, fetare e etnike? Të gjitha këto janë sfida me të cilat duhet të përballemi nëpërmjet parashikimit, planifikimit dhe masave parandaluese ose masave zbutëse.

Ridimensionimi i problemeve të Sigurisë Kombëtare përbën edhe bazën e Strategjisë së re Ushtarake, e cila i merr në konsideratë të gjithë elementët e sipërpërmendur të sigurisë dhe orienton krijimin e një force profesionale më të vogël në numër dhe të përgatitur për një spektër më të gjerë misionesh. Në strategjinë e re ushtarake kërkohet krijimi i strukturave për misione humanitare, për mbrojtjen dhe në ndihmë të popullsisë civile në situata të vështira natyrore, industriale ose të shkaktuara nga njeriu.

Siç u theksua dhe më lart, sigurimi i vendit nuk është vetëm ekskluziviteti i Forcave të Armatosura. Sigurimi i vendit është kompleks dhe kërkon njohjen, zbatimin e harmonizimin e mjaft masave në fushën e politikës, diplomacisë, ekonomisë, legjislacionit, mbrojtjes, rendit publik, shëndetësisë, ruajtjes së mjedisit etj. Të gjitha këto realizohen nga drejtues civilë e ushtarakë së bashku, të cilët kërkohet që të njohin në nivel të lartë, krahas të tjerave, edhe çështjet e sigurimit e të mbrojtjes.

Përfundime

Konsensusi është kryefjala në të gjitha takimet e përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare me drejtuesit politikë të vendit. Ndaj dhe mbetet detyrë e përhershme e të gjithë faktorit politik në vend që ta zhvillojë më tej atë, sidomos për çështje të rëndësishme të sigurisë dhe të së ardhmes së vendit. Vendimet e marra me konsensus dhe me mbështetje të gjerë politike janë natyrshëm vendimet më jetëgjata në kohë, lehtësisht të zbatueshme. Ato akumulojnë në vetvete pjekurinë, përvojat dhe eksperiencat e një mase më të madhe individësh dhe vendesh.

Në këtë aspekt, edhe strukturat e sigurimit kombëtar gjenerojnë siguri brenda dhe jashtë vendit, vetëm kur vendimet e rëndësishme të tyre përshkohen nga një konsensus i gjerë. Konsensus, mbi bazën e të cilit nuk cenohet asnjëra palë, ku në themel të tij qëndrojnë mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të individit, familjes, shoqërisë, shtetit e më gjerë, konsensus ku zgjidhjet për një çështje madhore duhet të kenë për bazë gjetjen e rrugëve më të frytshme për zgjidhjen e një problemi midis palëve.

Duhet të jemi koshientë se demokracia e një vendi nuk funksionon realisht vetvetiu, duke përdorur parimet apo procedurat teknike të votimit (zgjedhjeve), kur ende ekzistojnë mentalitete dhe praktika të ndryshme, sidomos në ish-sistemet totalitare. Shoqëria demokratike e një vendi ka nevojë për përkushtimin e qytetarëve të kulturuar, të cilët duhet ta kuptojnë shmangshmërinë e konfliktit dhe domosdoshmërinë e tolerancës, sidomos për zgjidhje madhore. Kjo tolerancë arrihet mbi bazën e një konsensusi të gjerë. Arritja e konsensusit për çështje të rëndësishme, jo vetëm tregon pjekuri të klasës politike, por është një tregues i qartë i konsolidimit të demokracisë. Mungesa e konsensusit në vendimmarrje, për çështje të rëndësishme politike dhe ekonomike, ka zgjatur periudhën e tranzicionit në Shqipëri.

Shpesh dëgjojmë të flitet për fuqinë kombëtare të një vendi. Por mendoj se, përveç burimeve të dukshme të fuqisë, ekzistojnë edhe disa të padukshme, të cilat mund të kontribuojnë për faktorin fuqi. Para së gjithash, qeveria e një vendi të fuqishëm, zakonisht është efektive, e aftë dhe gëzon një reputacion të shëndoshë ndërkombëtar. Udhëheqësit e saj janë të ndershëm, të aftë dhe frymëzojnë popullsinë e tyre por, mbi të gjitha, me aftësitë kulturore të tyre dinë të negociojnë dhe të imponohen në organizmat ndërkombëtare për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme për vendin e vet.

Bibliografi:

- Henning Boekle, Volker Rittberger, Wolfgang Wagner, Normat dhe Politika e jashtme (Norms and Foreign Policy);
- Pettman, Ralph (1991), International Politics: Balance of Power, Balance of productivity, Balance of Ideologies. Sydney: Longman Cheshire Pty, ltd.;
- Viotti and Kauppi, International Relations Theory, 1-16, 532-40 (normative theory);
- Henry Kissinger, “Diplomacia”, fq: 246-266 (Dilemat e fituesve);
- “North Atlantic Treaty Organisation” tekst, ribotim 2009;
- Historia e Ushtrisë Shqiptare (pjesa e parë 1912 deri 1944);
- Strategjia Ushtarake e RSH,
- Ligji Nr. 9858, datë 27.12.2007;
- Oxford Advanced Learner’s Dictionary; (Seven edition 2005);
- Histori e Amerikës (përkthyer nga Shtëpia Botuese Toena.

Komunikimi publik, element i rëndësishëm i veprimtarisë së FA

Jaup Zenuni,
Pedagog në AFA

Trajtesë e shkurtuar. Në epokën e informacionit dhe zhvillimit të vrullshëm teknologjik, Forcat e Armatosura si pjesë e strukturave të NATO-s kanë përpara tyre sfida të reja që burojnë nga zhvillimet e vrullshme globale, nga Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s, nga kërkesat për zbatimin në praktikë të “mbrojtjes së zgjuar”, por edhe nga veçoritë e vendit tonë. Në kuadrin e Konceptit të Ri Strategjik të Aleancës edhe komunikimi strategjik i saj, pjesë e të cilit është gjithashtu diplomacia publike, ka pësuar ndryshime të ndjeshme. Për shumëkënd duket sikur diplomacia publike është mjaft larg Forcave të Armatosura, sepse ka institucione dhe aktorë të tjerë që duhet të merren me këtë element të rëndësishëm të komunikimit ndërkombëtar.

Një qasje e tillë jo vetëm është e vjetruar, por edhe frenuese sepse në kuadrin e betejës për të ‘fituar mendjet dhe zemrat’, e cila përbën një nga shtyllat e ‘pushtetit të butë’, Forcat e Armatosura zhvillojnë sot një luftë asimetrike, e cila kërkon përfshirjen e kontributeve për diplomacinë publike edhe në veprimtarinë e tyre. Në këtë kuadër FA-të nuk duhen konsideruar thjesht mekanizëm i “pushtetit të fortë”, por edhe si kontribuese, me vlera për diplomacinë publike të vendit tonë.

Fjalët kyçe: NATO, FA, komunikim strategjik, diplomaci publike, “pushtet i butë”.

Hyrje

Fundi i Luftës së Ftohtë shtoi shpresat për ekzistencën e një paqeje të përhershme në të gjithë botën, por gjallërimi i terrorizmit, me kulmin e vet më 11 Shtator, dhe konfliktet në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Irak, Afganistan, Çad dhe së fundi në Lindjen e Mesme tregojnë se arritja e një paqeje të qëndrueshme në gjithë globin është e vështirë. Ato treguan gjithashtu se fundi i Luftës së Ftohtë u shoqërua edhe me një ndryshim në natyrën e rreziqeve, nga rreziqe simetrike në rreziqe asimetrike.

Në shkrimin e saj “Diplomacia Publike: Ilaç për Çështjen e Imazhit të NATO-s” E. Akçada” nënvizon se:

“Si rrjedhjojë e ndryshimeve të vrullshme pas Luftës së Ftohtë, çështjet thjesht ushtarake me të cilat merreshin Forcat e Armatosura, janë zëvendësuar nga rreziqet për sigurinë të cilat kanë në qendër të tyre individin dhe shoqërinë. Njëra nga karakteristikat kryesore të rreziqeve ndaj sigurisë është se ato në natyrë janë ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, këto rreziqe nuk shfaqen thjesht si veprime të një shteti të caktuar, por as përbëjnë kërcënim vetëm për një shtet. Kështu që, në botën ku kemi “globalizim të pasigurisë”, problemet e sigurisë kanë fituar rëndësi shumë të madhe.”¹

Në botën që ndryshon mjaft shpejt dhe që ndërtohet nëpërmjet revolucionit në informacion dhe komunikim, mjeti më efektiv për krijimin e imazhit pozitiv, për rifreskimin e imazhit ekzistues, për të siguruar prestigj dhe besueshmëri apo për të përcjellë mesazhe për publikun në vendet e tjera është diplomacia publike. Për këtë arsye, dhënia e rëndësisë së duhur diplomacisë publike edhe në FA, si dhe ndërtimi i një veprimtarie efektive në këtë drejtim, duke bashkëpunuar me institucione dhe aktorë të tjerë, do të ishte një aspekt i spikatur i përpjekjeve për integrim të mëtijshëm në strukturat e NATO-s.

Si vend anëtar i NATO-s, Forcat tona të Armatosura e kanë të nevojshme të njohin mirë politikën e saj për Komunikimin Strategjik ku trajtohen me theks të veçantë edhe kërkesat për një diplomaci publike efektive. Në dokumentin e Komandës së Aleancës për Operacionet (ACO) me titull “Komunikimi Strategjik i Komandës së Aleancës për Operacionet”, të paraqitur në Prill 2012, jepet ky përkufizim për komunikimin strategjik të Aleancës:

“Përdorim i koordinuar dhe ashtu si duhet i aftësive dhe veprimtarive të komunikimit të NATO-s i Diplomacisë Publike (DP), i Çështjeve Publike (ÇP), i Çështjeve Ushtarake me Publikun (ÇUP), i Operacioneve të Informimit (OI) dhe i Operacioneve Psikologjike (OPs) në mbështetje të politikave, operacioneve dhe veprimeve të Aleancës dhe me qëllim që të arrihen synimet e NATO-s.”²

Sikundër shihet nga ky përkufizim, Diplomacia Publike renditet si një ndër komponentët kryesorë të Komunikimit Strategjik, prandaj Forcat e Armatosura të secilit vend anëtar duhet ta vlerësojnë këtë komponent jo vetëm nga pikëpamja politike, por edhe nga pikëpamja operacionale dhe praktike. Për Forcat tona të Armatosura të cilat nuk kanë trashëgimi në këtë fushë, kjo përbën një risi dhe nevojë të domosdoshme. Nga ana tjetër, duke qenë se në kuadrin e Aleancës ne jemi pjesëmarrës aktiv në operacionet paqeruajtëse, në stërvitjet e përbashkëta, në veprimtaritë trajnuese apo Shtabet Drejtuese të NATO-s, lipset që në dokumentet strategjike të FA-ve, por edhe në sistemin e arsimimit dhe në njësitë prioritare, çështjet e Komunikimit Strategjik në përgjithësi dhe të Diplomacisë Publike në veçanti, të zënë vendin e duhur.

Qasje strategjike ndaj Diplomacisë Publike

Bruce Gregory (2005:7) në kumtesën e tij “Diplomacia Publike dhe Komunikimi Strategjik: Kulturat, Barrierat dhe Normat e Importuara”, mbajtur në Konferencën e

¹ Akçadağ, E. (2012). “Public Diplomacy: a Remedy for NATO’s Image Problem”, *Bilge Strateji, Cilt 4, Sayı 6, p.106.*


² ACO Directive (ad) 95-2, ACO Strategic Communications (2012), p.4. www.carlisle.army.mil

organizuar nga Shoqata Amerikane e Shkencave Politike mbi “Komunikimin Ndërkombëtar dhe Konfliktet”, midis të tjerash shkruan:

“Strategjia është një term që i jep përgjigje pyetjes “Si”. Interesat dhe vlerat përshkruajnë synimet e strategjisë dhe i japin përgjigje pyetjes “Përse”. Strategjia është një plan për veprim, i cili përcakton prioritetet dhe përdor burimet për arritjen e objektivave. Logjika strategjike në çdo përpjekje përfshin përcaktimin e objektivave specifike dhe të alternativave midis instrumenteve apo mjeteve që lipsen për t’i arritur ato. Diplomacia Publike është një instrument i rëndësishëm mes mjaft mjeteve të tjera bindëse, bashkëpunuese dhe shtrënguese në dorën e atyre që hartojnë strategjinë.”³

Po ç’është Diplomacia Publike si instrument efektiv në luftën për të fituar ‘mendjet dhe zemrat’? Termi Diplomaci Publike u përdor për herë të parë nga ish-diplomati amerikan Edmund Gullion në vitin 1965, i cili në atë kohë ishte dekan i Shkollës së Diplomacisë Fletcher të Universitetit të Tuft-it. Sipas Gullion-it Diplomacia Publike ‘merret me ndikimin mbi qëndrimet e publikut ndaj hartimit dhe zbatimit të politikave të jashtme. Ajo përfshin dimensionet e marrëdhënieve ndërkombëtare te diplomacisë tradicionale’. Në thelb Diplomacia Publike është negociim. Nëse para Luftës së Ftohtë ajo ishte një mjet në konfliktin Lindje Perëndim si kundërvënie ndaj makinerisë së rëndë të propagandës komuniste kundër vlerave të Perëndimit, Diplomacia Publike moderne ka ndryshuar mënyrat e kryerjes së negociatave. Sot ajo i shërben një qëllimi të dyfishtë: përdoret ose si instrument negociimi ose si mjet për zhvillimin e luftës jokonvencionale, pra si pjesë e “pushtetit të butë”.

Po t’i referohemi skemës që vijon, të ndërtuar nga Komanda e Aleancës për Transformimin (2012), Diplomacia Publike është mjet i nivelit politik së bashku me



³ Gregory, B. (2005). “Public Diplomacy and Strategic Communication: Cultures, Firewalls, and Imported Norms”, paper presented at American Political Science Association Conference on International Communication and Conflict. <http://www8.georgetown.edu>

Çështjet Publike. E para për komunikimin me audiencat e huaja dhe e dyta për komunikimin me audiencat brenda vendit. Sipas Direktivës së Komandës së Aleancës për Operacionet mbi Çështjet Publike (2008) *“Mbështetja e publikut për misionet dhe detyrat buron nga mënyra se si publiku e kupton që Aleanca përbën një ndryshim në lidhje me paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.”*⁴

Sikundër shihet, instrumentet e të dyja niveleve si atij politik, dhe atij ushtarak janë pjesë e së njëjtës skemë që përbën thelbin e përmbajtjes së Komunikimit Strategjik të NATO-s. Këto elemente janë komplementarë dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në funksion të strategjisë së Aleancës. Fakti që diplomacia publike si instrument përfshihet në nivelin politik nuk presupozon që ajo do të përdoret vetëm nga drejtuesit politik të NATO-s apo të shteteve anëtare. Çdo pjesëtar i FA-ve, së pari duhet të kuptojë thelbin e politikës së NATO-s për komunikimin strategjik, synimet e tij dhe rrugët për përdorimin praktik të instrumenteve të këtij komunikimi.

Kjo nevojë shtrohet qoftë për interesat e mëdha të Aleancës, e cila duhet t’u drejtohet audiencave me mesazh të unifikuar, qoftë edhe për interesat e ngushta kombëtare dhe më ngushtë akoma për interesat e FA-ve. Sipas Akçada” (2012:108):

*“Në një botë të globalizuar opinioni publik merr rëndësi më shumë se kurrë. Kjo sepse, si rezultat i revolucionit në komunikim dhe informacion, publiku sa vjen e bëhet më mosbesues ndaj qeverive dhe organizatave ndërkombëtare. Ja pse aftësia për të ndikuar mbi opinionin publik (me fjalë të tjera, diplomacia publike) është kthyer në një prej elementëve kyç të politikës së jashtme. Ky tipar i diplomacisë publike mund të gjendet në përkufizimin e Huns Tuch-it: “...Procesi i komunikimit të qeverisë me publikun e huaj, në përpjekje që ky publik të kuptojë idetë dhe idealet e shtetit, të kulturës dhe institucioneve të tij, të synimeve kombëtare, si dhe të politikave aktuale.”*⁵

Ndryshe nga diplomacia tradicionale që këtë komunikim e realizon me anën e elitave të angazhuara në shërbimin diplomatik dhe drejtuesve të lartë të shtetit, diplomacia publike e realizon këtë komunikim nëpërmjet: ekspertëve të fushave të ndryshme si oficerë, inxhinierë, artistë, aktorë, sportistë, diplomatë në pension etj. që angazhohen në veprimtari të diplomacisë publike me anën e misioneve, projekteve, shkëmbimeve të biznesit, veprimtarive trajnuese, kulturore, artistike, sportive; me anën e organizatave joqeveritare dhe; me anën e mediave të ndryshme të shkruara dhe audio-vizive.

Nga ky këndvështrim shtrohet pyetja se cili mund të jetë kontributi i FA-ve në fushën e diplomacisë publike?

Diplomacia Publike risi dhe nevojë në veprimtarinë e FA-ve

Kërkesa për përfshirjen e FA-ve në veprimtaritë e diplomacisë publike përbën një risi në kushtet e vendit tonë, për shkak se ajo përbën një terren pak a shumë të ri dhe për shkaqe historike, na mungon përvoja e trashëguar në këtë fushë. Veprimtari të

⁴ Allied Command Operations (ACO) Public Affairs, ACO Directive Number 95-1, (2008), p.1-1. <http://info.publicintelligence.net/NATO-PA-Directive.pdf>

⁵ Akçada”, E. (2012). “Public Diplomacy: a Remedy for NATO’s Image Problem”, *Bilge Strateji*, Cilt 4, Sayı 6, p.108.

tilla si: fushatat e ndryshme për domosdoshmërinë e anëtarësimit në NATO në shtypin e shkruar, sidomos në atë ushtarak dhe në mediat audio-vizive; veprimtaritë e përbashkëta trajnuese dhe stërvitore me kontekst bilateral apo multilateral; veprimtaria e gjerë politike e drejtuesve të shtetit dhe institucioneve kryesore për të bindur opinion brenda dhe jashtë vendit mbi vendosmërinë e faktorit shqiptar për të qenë pjesë e Aleancës; botimet e ndryshme mbi rolin dhe rëndësinë e NATO-s dhe veprimtari të tjera kanë qenë kontribute të karakterit të diplomacisë publike.

Sidoqoftë, kemi arritur në një stad të ri. Prej Prillit të vitit 2009, Shqipëria është anëtare me të drejta të plota në NATO. Ky ndryshim statusi për FA-të ka një domethënie të madhe. Politikisht, ne jemi pjesë e një Aleance që sikundër e trajton ish Sekretarja Amerikane e Shtetit Madeline Albright është “*një Aleancë demokratish që përbën themelin e vet Aleancës, dhe që qartas do të thotë se publiku ynë ka nevojë ta kuptojë se çdo të thotë e gjitha kjo në shekullin e 21-të.*”⁶ Nga ky këndvështrim, veprimtaria e diplomacisë publike të NATO-s mbështetet në dy shtylla: së pari, në punën për bindjen dhe qartësimin e publikut të vendeve anëtare të saj mbi rolin dhe rëndësinë e Aleancës për paqen dhe sigurinë jo vetëm për vendet anëtare dhe; për një rend demokratik të qëndrueshëm në hapësirën Euro-Atlantike; së dyti, në punën me audiencat e huaja për të shpalosur vlerat dhe kontributet e NATO-s për paqen dhe sigurinë. Shtylla e dytë është e lidhur ngushtësisht me shtyllën e parë, sepse, pa besimin dhe bekimin e publikut brenda hapësirave të Aleancës, diplomacia publike në audiencat jashtë kësaj hapësire nuk mund të jetë e suksesshme.

Në betejën për fitimin e ‘mendjeve dhe zemrave’ dhe si pjesë e Aleancës, FA-të mund të shtojnë kontributet edhe në diplomacinë publike të saj. Për ta realizuar këtë është e rëndësishme që:

Së pari, të kuptohet politika e NATO-s për diplomacinë publike. Duke rikonsideruar rëndësinë që ka puna me imazhin e vet, Aleanca NATO ka filluar të ushtrojë një diplomaci publike më efikase, të mbështetur në Komunikimin e ri Strategjik, që rrjedh nga Koncepti i ri Strategjik. Aleanca ka tani strukturën përgjegjëse që merret me hartimin e politikave dhe organizimin e diplomacisë publike. E gjithë kjo veprimtari mbështetet në një strategji të caktuar, e cila nga ana e vet është ndërtuar mbi gjashtë parime të parashtruara mjaft qartë nga Stefanie Babst, zv/ndihmëse e Sekretarit të Përgjithshëm për Diplomacinë Publike (2009:4-7), në fjalimin e mbajtur në Simpoziumin e NATO-s për Partneritetin për Paqe.⁷

- 1. Diplomaci Publike do të thotë të dëgjosh.** Sipas Babst “...*dëgjimi ka rëndësi për dy arsye: së pari, grumbullimi dhe analizimi i opinionëve të grupeve apo segmenteve të publikut, të synuara, duhet të jetë detyrë. Për fat të keq, jo të gjitha qeveritë dhe organizatat investojnë sistematikisht në organizimin e anketimeve për të parë prirjet e publikut...*” Së dyti, *dëgjimi duhet të jetë një përpjekje serioze për të kuptuar motivet dhe bindjet e bashkëbiseduesit.*”⁸

⁶ Cituar në Robert Helbig (2011). “Defining its future, engaging its public: NATO’s new Strategic Concept as a tool for survival”, ISU Conference Paper, p.19. <http://lilt.ilstu.edu>

⁷ Babst, S. (2009). “Public Diplomacy – the art of engaging and influencing”. Speech delivered at the NATO PFP Symposium, p. 4-7. <http://www.atlantic-community.org>

2. **Diplomacia Publike duhet të jetë e lidhur me politikën.** Politikën e shëndoshë nuk e zëvendëson asgjë. Sipas Babst “*e rëndësishme nuk është ajo çfarë thoni, por ajo që bëni. Ja pse diplomacia publike nuk mund dhe nuk duhet të përpiqet ta portretizojë një krizë serioze apo një luftë me ngjyra rozë. Kurrë nuk mund t’i shmangesh një problemi. Mund të përpiqesh, por përvoja tregon se këto përpjekje janë të destinuara të dështojnë.*”⁹ Shembuj të dështimit ka nga përvoja në Irak dhe Afganistan që tregojnë se nxitimi në politikë dhe shpallja e fitores para kohe kanë sjellë dëme të cilat kanë kërkuar investime energjish, forcash dhe burimesh të mëdha më pas. Duke iu referuar këtyre shembujve Babst shtron pyetjen: “*Çfarë na tregon e gjitha kjo në lidhje me diplomacinë publike? Së pari, ajo na tregon sa rëndësi ka të jesh i qartë për synimin tënd politik. Shpesh është më mirë për një qeveri të pranojë që ajo është ende duke u përpjekur të gjejë zgjidhjen më të mirë dhe se progresi kërkon kohë. Së dyti, ajo na tregon se përpjekjet për komunikim, sado të ndërhuara me mjeshtri, ka gjasa të dështojnë nëse ngulet këmbë në portretizimin e diçkaje si histori suksesi edhe kur ajo nuk është e tillë.*”¹⁰
3. **Për të qenë efektive Diplomacia Publike duhet të jetë e besueshme.** Babst e zbërthen këtë parim duke theksuar se: “*Ajo që ka vlerë për marrëdhëniet me mediat ka vlerë edhe për të gjithë partnerët publik: nëse përpiqesh të manipulosh apo mashtrosh, shumë shpejt do të humbasësh besueshmërinë, sepse përveç mjedisit mediatik që operon 24 orë pa ndërprerje, kujtesa e publikut ende punon dhe mashtrimi apo gënjeshttrat nuk tolerohen lehtë.*”¹¹
4. **Diplomacia Publike jo gjithmonë lidhet me ty.** Ky parim lidhet me rolin e drejtuesve kryesorë, me mentalitetin dhe kuptimin që ata duhet të kenë për kontributin në diplomacinë publike. Sipas Babst: “*Ka raste kur diplomacia publike më efektive kryhet duke u vënë në qendër të vëmendjes së mediave, por në raste të tjera, çështjet politike komunikohen më mirë nga palë të treta, si studiuesit dhe akademikët, se sa nga deklaratat zyrtare. Krijimi i kushteve lehtësuese dhe mbështetja e diskutimeve mes grupeve dhe rrjeteve politike të politikës së jashtme mund të jetë një strategji e shkëlqyer e diplomacisë publike, nëse qëllimi është të prezantohet dhe silltet në vëmendjen e publikut një çështje specifike politike.*”¹²
5. **Diplomacia Publike duhet t’u përgjigjet sfidave të botës së Web 2-it.** Që të jetë efektive diplomacia publike duhet të përdorë të gjithë arsenalin e mjeteve të komunikimit duke filluar nga komunikimi i gjallë deri tek pjesëmarrja në rrjetet sociale online.
6. **Diplomacia Publike kërkon planifikimin, trajnimin dhe burimet e duhura.** Ky parim kërkon një mentalitet të ri. Kjo sepse, sipas Babst, “*...për*

⁸ Ibid. p.4

⁹ Ibid. p.5

¹⁰ Ibid. pp. 5-6

¹¹ Ibid. p.6.

¹² Ibid. pp.6-7

një kohë të gjatë, diplomacia publike nuk konsiderohej si një çështje thelbësore dhe ekspertëve të saj u duhej të rrinin në periferi, larg nga qendra ku prodhohej dhe zbatohej politika. Një gjë e tillë lipset të ndryshohet. Diplomacia publike duhet të bëhet pjesë integrale e planifikimit të politikës kombëtare dhe e vendimmarrjes. Të kuptosh diplomacinë publike si një instrument serioz politik do të thotë gjithashtu të garantosh burimet e nevojshme financiare. Meqë hartimi dhe zbatimi i një fushate të diplomacisë publike nuk mund të bëhet pa para, qeveritë lipset të mobilizojnë fondet e nevojshme që ta bëjnë diplomacinë publike të funksionojë.”¹³

Këto parime dhe e gjithë strategjia dhe politika e NATO-s për Komunikimin Strategjik ka nevojë të kuptohen mirë nga të gjitha hallkat e zinxhirit të komandimit në FA. Kjo është e domosdoshme me qëllim që të realizohet ajo që ekspertët e quajnë ‘unifikim i mesazhit brenda Aleancës. Në këtë kuadër kanë detyrime të gjitha komandat e forcave dhe njësite, por në mënyrë të veçantë, Akademia e Forcave të Armatosura, sidomos Departamenti i Strategjisë. Në kurset e ndryshme, duke filluar nga Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe deri tek kursi themelor, sipas nivelit, mund të përfshihen tema ku të qartësohet koncepti i komunikimit strategjik dhe i diplomacisë publike si pjesë e tij. Madje KLSM-ja mund të ketë një modul të titulluar “Komunikimi Strategjik”, i cili të përfshijë diplomacinë publike, çështjet publike, çështjet ushtarake me publikun, operacionet e informimit, operacionet psikologjike dhe luftën kibernetike. AFA-ja aktualisht i ka kapacitetet njerëzore dhe materiale për të organizuar konferenca, seminare dhe debate mbi diplomacinë publike, duke ftuar ekspertë edhe nga institucionet jashtë forcave të armatosura. Në kurset e OMLT-së apo në kurse të tjera para dislokimit në misionet jashtë vendit ka nevojë të përfshihen disa njohuri bazë mbi komunikimin strategjik në përgjithësi dhe diplomacinë publike në veçanti. Në këto kurse është e nevojshme të trajtohen më shumë disa udhëzime praktike se si mund të shtohen kontributet e forcave tona në misionet, në kuadrin e Aleancës.

Së dyti, Forcat tona të Armatosura kanë krijuar një imazh të mirë me pjesëmarrjen e tyre në operacionet paqeruajtëse në kuadrin e NATO-s. Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm kanë bërë një punë të mirë nëpërmjet faqeve të tyre të Internetit për pasqyrimin e këtij imazhi. Artikuj e reportazhe në shtypin ushtarak dhe më gjerë kanë trajtuar këtë kontribut të forcave tona të armatosura në misionet jashtë vendit. Megjithatë, hapësirat për një pasqyrim më të mirë të këtij imazhi janë të mëdha. Si kontribut në kuadrin e diplomacisë publike në FA mund të ishin botimet në revistat e NATO-s apo të vendeve anëtare, të artikujve të shkruar nga oficerë të rangjeve të ndryshme, të reportazheve nga vend dislokimit e forcave tona në misionet, portrete ushtarakësh që shquhen për profesionalizëm dhe integritet të lartë në misionet. Për këtë, edhe atashetë ushtarakë të vendit tonë mund të luajnë një rol nxitës dhe koordinues. Në FA ka aktualisht ushtarakë të përgatitur dhe vizionarë që njohin mirë gjuhët e NATO-s, ndaj ata duhet të marrin pjesë në diskutimet dhe blogjet e ndryshme që organizohen nga rrjete të rëndësishme sociale në Facebook, Twitter, Google+,

¹³ Ibid. pp.7-8.

YouTube dhe Flickr., të cilat shfrytëzohen edhe nga NATO. FA-të i kanë gjithashtu mundësitë të jenë më aktiv në televizionin e NATO-s, NATO Channel.tv, në websitin zyrtar të NATO-s dhe në platformën më të re interaktive në Web WE-NATO. Duke trajtuar këtë çështje në artikullin e saj “Rikonceptimi i Diplomacisë Publike të NATO-s, Stephanie Babst (2008:5) shkruan:

“Transmetimi i mesazheve të NATO-s për politikën dhe operacionet e saj përmes videove në Internet dhe mjeteve të tjera audiovizuale apo të mediave të reja do të jetë me shumë rëndësi për të shkuar te grupet e reja demografike. Po kaq i rëndësishëm është komunikimi me brezin poshtë të dyzetave përmes teknologjive të Web 2.0., p.sh. përmes blogjeve apo dhomave të chatt-it.”¹⁴

Me rëndësi gjithashtu është harmonizimi i punës përgatitore të trupave tona për në misione apo stërvitje të përbashkëta, përsa i përket diplomacisë publike, me ato të vendeve të tjera aleate. Kjo kërkon që para dislokimit, komandat duhet të njihen me prioritet e diplomacisë publike p.sh. në misionin ISAF, me qëllim që temat për diplomacinë publike që do zhvillohen me këto kontingjente të jenë të harmonizuara me kushtet specifike të Afganistanit dhe me prioritet e ISAF-it. Çdo ushtar dhe oficer që shkon në mision në një vend të caktuar shikohet nga popullata e atij vendi, së pari, si përfaqësues i Aleancës dhe së dyti, si përfaqësues i vendit tonë. Nga kjo pikëpamje ai me qëndrimet, sjelljet dhe komunikimin e tij krijon imazhin për Aleancën dhe vendin. Kjo është njëra nga arsytet që pjesëmarrja në misione duhet konsideruar si një përgjegjësi mjaft e madhe.

Ne kemi sot një numër oficerësh që punojnë në shtabet e ndryshme të NATO-s apo që trajnohen në qendra të ndryshme jashtë vendit. Këta oficerë janë një burim i mirë edhe për veprimtaritë e diplomacisë publike të FA-ve. Ata, krahas rolit të tyre si ushtarak në këto shtabe, janë pika kontakti me publikun e vendeve ku punojnë. Duke qenë të tillë ata mund dhe duhet të japin kontribut me anën e botimeve, me anën e pjesëmarrjes në diskutime në rrjetet sociale online apo në blogjet e ndryshme të NATO-s. Kontributi i tyre do të ishte i mirëpritur edhe në fushën e instalimit të bashkëpunimit midis komandave të forcave tona, me komandat e forcave të vendeve aleate edhe në fushën e diplomacisë publike.

Së fundi, rritja e efektivitetit të diplomacisë publike në FA shtron nevojën e bashkëpunimit më të mirë me mjaft aktorë të tjerë si me Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrinë e Arsimit, Policinë e Shtetit, Organizatat joqeveritare, ambasadat e shteteve të NATO-s të akredituara në vendin tonë, me mediat e ndryshme të shkruara dhe audio-vizive, sidomos ato kombëtare, dhe pse jo, edhe me media të tilla prestigjioze si: CNN, BBC, Rojter, CBS etj., si dhe me të gjithë ekspertët e fushave të ndryshme të jetës që mund të sjellin kontribute për rritjen e efektivitetit të diplomacisë publike të FA-ve.

¹⁴ Babst, S. (2008). “Reinventing NATO’s Public Diplomacy”. Research Paper, Research Division,-NATO Defense College, Rome, No.41, p.5.

Përfundime

Në kuadrin e punës për realizimin në terren konkret të Konceptit të Ri Strategjik të NATO-s, një aspekt i rëndësishëm në veprimtarinë e FA-ve është njohja me politikat e Aleancës për Komunikimin Strategjik në përgjithësi dhe diplomacinë publike në veçanti. Për kushtet e vendit tonë, që nuk pati trashëgimi në fushën e diplomacisë publike, kjo është jo vetëm një risi, por edhe nevojë që buron nga dinamikat e integritetit të mëtejshëm në NATO. Edhe pse në kushtet e krizës globale mundësitë financiare nuk lejojnë për t'i dhënë prioritetin që kërkon punës në diplomacinë publike, janë mundësitë që, duke shfrytëzuar burimet ekzistuese, ajo të fitojë dinamizëm.

Ka ardhur koha që puna për përfshirjen e FA-ve në veprimtaritë e diplomacisë publike të mos mbetet një dëshirë subjektive. Ajo lipset të kthehet në komponent të rëndësishëm në gjithë zinxhirin komandues në FA. Mbi të gjitha duhet të krijohet bindja se në kuadrin e luftës asimetrike, në këtë fillim të shekullit të 21-të, në betejën për “fitimin e mendjeve dhe zemrave”, diplomacia publike është një ndër instrumentet më efektive.

Për këtë arsye është e nevojshme që, së pari, të dendësohen veprimtaritë për qartësimin e kërkesave të NATO-s, për një diplomaci publike efektive. Kjo kërkon që, të gjitha komandat dhe shtabet e forcave, por sidomos Akademia e Forcave të Armatosura, të shtojnë veprimtaritë në këtë drejtim. Kërkesë tjetër është reflektimi i standardeve të NATO-s për Komunikimin Strategjik, në dokumentet e strategjisë të FA-ve, në programet mësimore në AFA dhe kurset e niveleve të ndryshme; organizimi i veprimtarive të tilla si: konferenca shkencore, seminare, debate e diskutime me temën e diplomacisë publike dhe; bashkërendimi më i mirë i punës me të gjithë aktorët e tjerë relevant dhe të interesuar për një diplomaci publike efektive. Kjo do të ndihmonte që ne, si anëtar i NATO-s, në mesazhet që adresojmë për audiencat e huaja të jemi gjithmonë në një ‘gjatësi vale’ me mesazhet e Aleancës.

Së dyti, burimet njerëzore brenda FA-ve lipset të orientohen më mirë në dobi të diplomacisë publike duke dhënë kontribute për imazhin e FA-ve dhe të vendit në përgjithësi me botimet në mediat e shkruara apo elektronike jashtë vendit, sidomos në vendet anëtare të NATO-s; me shembullin e tyre si profesionist dhe njerëz me integritet; me pjesëmarrjen aktive në rrjetet sociale në internet, që shfrytëzohen nga NATO dhe; me qenien më shumë të pranishëm në faqen zyrtare të Web-it të NATO-s dhe kanalin e saj televiziv.

Së fundmi, diplomacia publike duhet konsideruar si një armë që fiton beteja, pa marrë jetë njerëzish, por duke fituar zemra njerëzish. Sot, në epokën e shoqërisë së informacionit kjo armë mund të përdoret efektivisht nëse ia njeh sekretet dhe rëndësinë.

Bibliografia:

- ACO, Directive (ad) 95-2, Strategic Communications (2012). www.carlisle.army.mil
- ACO, Public Affairs, Directive Number 95-1, (2008). <http://info.publicintelligence.net/NATO-PA-Directive.pdf>
- Akçada”, E. (2012). “Public Diplomacy: a remedy for NATO’s image problem”, *Bilge Strateji, Cilt 4, Sayı 6*.
- Babst, S. (2009). “Public Diplomacy - the art of engaging and influencing”. Speech delivered at the NATO PFP Symposium. <http://www.atlantic-community.org>

- Babst, S. (2008). “Reinventing NATO’s Public Diplomacy”. Research Paper, Research Division,-NATO Defense College, Rome, No.41.
- Gregory, B. (2005). “Public Diplomacy and Strategic Communication: Cultures, Firewalls, and Imported Norms”, paper presented at American Political Science Association Conference on International Communication and Conflict. <http://www.georgetown.edu>
- Helbig, H. (2011). “Defining its future, engaging its public: NATO’s new Strategic Concept as a tool for survival”, ISU Conference Paper. <http://lilt.ilstu.edu>

Shkenca dhe Strategjia Ushtarake

Nënkolonel ® MSc. Kanan Himaj,
Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe Mbrojtjes

Trajtesë e shkurtuar. *Shkenca, në kuptimin e gjerë të fjalës, i referohet një sistemi njohurish dhe të dhënash të rëndësishme. Fushat e shkencës janë përgjithësisht të klasifikuara në dy drejtime kryesore: shkencat e natyrës, të cilat studiojnë fenomenet e natyrës dhe shkencat sociale, të cilat studiojnë sjelljet njerëzore dhe shoqërore.*

Shkenca është argument, themeli dhe pjesa bashkuese e strukturës rezistente të çdo sistemi dhe procesit, të nxitur nga e njohura. Asgjë nuk është e mundur, asgjë nuk mund të qëndrojë pa shkencë. Pra, duke e bërë objekt të konceptit tonë dhe më shumë se kaq, strategjia ushtarake, e cila qëndron si teoria dhe praktika e artit strategjik, lidhet me fenomenet më të gjera si: paqja, kriza dhe lufta.

Duke u nisur sa më lart, për të arritur synimin e këtij shkrimi reflektues, dua të sjell në vëmendjen e lexuesve se edhe shkenca ushtarake ka vendin e saj si shkencat e aplikuara të kërkimeve shkencore specifike të fushës së mbrojtjes dhe sigurisë.

Shkencat në tërësi dhe objekti i shkencës ushtarake

Shkenca është sistemi i vlerave, njohurive, informacionit, logjikës dhe metodës në veprimtarinë njerëzore. Argumentet ose teoritë përherë fillojnë me disa premisa, “elemente arbitrare”, të cilat në këtë rast janë quajtur “hamendje”. Qenia njerëzore është gjithnjë e më shumë një zbulim shkencor. Shoqëria e së ardhmes do të jetë më shumë se një shoqëri e informacionit, ajo do të jetë një shoqëri e dijes, më saktësisht, një shoqëri e njohurive shkencore, një shoqëri epistemologjike¹, pra një shoqëri e diturisë dhe besimit.

Shkenca e të menduarit të njeriut është logjika. Shkenca e shpirtit njerëzor është psikologjia. Shkenca e jetës është biologjia. Shkencat e ekzistencës dhe qenies njerëzore janë shkencat e njohurive: matematika, fizika, kimia, biologjia, historia, psikologjia etj. dhe njohuritë e shkencat e natyrës, gjeografia, gjeomorfologjia²,

¹ Epistemologjia (besim, dituri dhe fjalë, kuptim, shpjegim) ose teoria e diturisë është degë e filozofisë perëndimore që studion natyrën dhe qëllimin e diturisë dhe besimit.

² Gjeomorfologjia është disipline që merret me studimin e relievit. Gjeomorfologët mundohen të mësojnë historinë, dinamikën e relievit, mandej parashikimin e ndryshimeve të ardhshme.

meteorologjia³, kozmologjia⁴, astronomia etj., por të gjitha këto kanë rëndësi në procesin e dijes dhe veprimit njerëzor. Për më tepër, veprimi njerëzor kërkon të paktën katër komponentë, të cilat ndikojnë te njëri-tjetri përmes një filozofie të lidhjes dhe fizionomisë: konceptimi, planifikimi, organizimi dhe zhvillimi. Këto katër elementë rrjedhin jo vetëm nga reagimet, por në bazë kanë procedurat e sistemeve, jetën dhe dinamikat e saj.

Të gjitha shkencat e gjejnë veten, në një mënyrë apo në një tjetër, në shkencën ushtarake, e cila humbet cilësinë e të qenit një shkencë e veçantë dhe bëhet një shkencë e integruar dhe e veprimit, pasi ajo përdor masivisht shkencat e tjera.

Shoqëria e së ardhmes do të jetë një shoqëri njëqind për qind e varur nga shkenca. Gjithçka në këtë hapësirë të dijes, brenda njohurive të shkencës, përfshihen edhe njohuritë e brendshme apo sipërfaqësore të shkencës ushtarake.

Shkenca është rezultat i dijes dhe stimul i njohurive,- kanë thënë dijetarët. Shoqëria njerëzore është e bazuar në shkencë, ajo është e varur nga shkenca. Qenia njerëzore nuk mund të jetojë jashtë shkencës. Çdo gjë që bëjmë, nga ndërtimi në shkatërrim, nga bashkëpunimi apo konfrontimi e deri në luftë është e bazuar në shkencë. Çdo aktivitet ka shkencën e vet, domethënë, parimet, rregullat, konceptet dhe metodologjinë e saj, e cila i përdor për të dhënë efektin e integruar të shkencave të tjera. Çdo strategji ka dhe duhet të ketë një mbështetje shkencore, një burim shkencor. Nisur sa më lartë duhet thënë se: strategjia pa shkencë është improvizim dhe aventurë.

Nuk janë të shumta shkencat e paqes, por as shkencat e luftës. Lufta, pa marrë parasysh sa irracionale mund të jetë, për sa i përket rezultateve shkatërruese dhe implikimeve të vështira për të kontrolluar dhe menaxhuar problematikën, nuk mund të vendoset jashtë shkencës. Lufta është ajo që stimulon kërkimin shkencor në fushën ushtarake. Ajo sjell gjithmonë ngjarje të vështira për njerëzimin, për sot dhe për të ardhmen, e cila bëhet gjithnjë e më shumë një biznes, merr konotacione dhe përcaktime të reja. Ajo merr kuptimin e saj jo vetëm nga shkenca ushtarake, por edhe nga elementë të tjerë të teknologjisë që nuk janë shkencë e drejtpërdrejtë ushtarake, por që ndikojnë në fushën ushtarake dhe madje, kanë tendencë për të zëvendësuar atë, që ne e quajmë shkencë ushtarake.

Në fakt, lufta nuk e mban shkencën e saj të paprekur, por kjo lloj shkence nuk mbështetet në parimet e drejtpërdrejta të forcave ushtarake, mjeteve dhe veprimeve për zhvillimin e tyre, por dukshëm del se, çdo gjë që ekziston sot në planet mund të përdoret në luftë. Lufta ka zgjeruar gamën e saj të mbulimit jashtë konfrontimit ushtarak si në fushat e ekonomisë, diplomacisë, etj. që përdoren për qëllimet e vërteta dhe dimensionet e luftës.

Prandaj, shkenca ushtarake nuk mund të mbetet e ndarë, por bëhet dhe më shumë një shkencë e integruar, e cila monopolizon dhe organizon një sistem; tërheq, stimulon

³Meteorologjia është shkenca, e cila studion të gjitha dukuritë fizike respektivisht në atmosferë .Përveç kësaj, metereologjia studion edhe disa dukuri fizike, të cilat zhvillohen në vet sipërfaqen e tokës, e po ashtu edhe në shtresat e sipërme të tokës.

⁴Kozmologjia merret me prejardhjen dhe zhvillimin e gjithësisë në tërësi dhe vendin e njeriut në veçanti. Ajo është degë e fizikës dhe filozofisë.

dhe përdor një gamë të gjerë shkencash, veprimesh, eksperimentesh dhe mjetesh.

Ajo bëhet gjithnjë e më shumë një lloj i një “të panjohure”, pasi ajo ka rëndësi dhe efekte të dukshme. Lufta gjithmonë ka qenë në bazën e efekteve të parashikueshme, por edhe të efekteve të papritura. Sot, efektet e luftës tentojnë të bëhen të pakufizuara dhe madje, edhe për të marrë jashtë sferës së kontrollit të tyre.

Kjo është arsyeja pse në ditët e sotme ajo duhet të vendoset nën kontroll për të rritur parandalimin dhe zbutur efektet negative. Shkenca ushtarake, edhe nëse ajo është vetëm një “kuti e zezë” (në kuptimin që jo gjithkush mund të fitojë qasje në konceptet e saj), duhet të gjejë përgjigje për pyetjet e mprehta, të cilat janë kërkuar në lidhje me menaxhimin e efektit të luftës. Dhënia e përgjigjeve siguron fleksibilitetin e sistemit të ligjeve, parimeve, normave, rregulloreve dhe teorive që qëndrojnë në bazën e një arkitekture efektive, mbi të cilat ndërtohen strategjitë e nevojshme për qëllimin që kanë. Shkenca ushtarake nuk mbetet një kullë e fildishtë, por është e lidhur me veprimin, me jetën njerëzore në këtë botë.

Shkenca ushtarake është një shkencë vepruese, pasi ajo jep rrugën për të gjeneruar veprimtarinë dhe forcën për të ndryshuar pozitivisht apo negativisht. Karakteristikat themelore të shkencës aktuale ushtarake përfshijnë disa aspekte, si: zhvendosja nga kategori standarde të luftës; tërësia e veprimtarisë ushtarake; zhvendosja drejt teknologjisë së re, pra, drejt efektivitetit të çdo elementi shkencor ushtarak. Aktualisht, shkenca ushtarake ka pasur dhe ka ende objektin e vet të studimit: komponentin e veprimit ushtarak dhe njerëzor, kryesisht të luftës, dhe veprimet në kohe paqeje, krize dhe lufte.

Megjithatë, duke studiuar luftën si një sistem kompleks social, ajo mbetet elementi më i rëndësishëm i shkencës ushtarake që kërkon të studiohet jo vetëm brenda ushtrisë, por edhe nga autoritetet civile. Gjatë studimit duhet të merret parasysh arkitektura e re e luftës, që kushtëzohet nga: përcaktimet komplekse të saj; kufizimet dhe limitet që ndikojnë drejtpërdrejt si fenomen kompleks social me koordinata të panjohura; zbulimet e reja që bëhen në lidhje me zhvillimin e forcave dhe mjeteve; ndryshimet që ndodhin në kohë dhe hapësirë; efektet që vijnë të lidhura me proceset sociale dhe ushtarake; veprimtaria dhe dinamika e hipotezave, përvojave dhe mësimave të nxjerra nga fazat e zhvillimit të veprimeve luftarake etj. Sot kemi të bëjmë me një fazë të re në artin ushtarak, që vjen si rezultat i disa fenomeneve të pashfaqura më parë dhe që kërkojnë kundërvënie dhe metoda të reja për t’i zgjidhur.

Megjithatë, lufta bëhet një nocion gjithnjë e më kompleks. Ajo nuk mund të reduktohet me dimensionin e dhunës e të konfrontimit në një konflikt të armatosur, që ndodh jo rrallë në ditët e sotme. Lufta gjithmonë ka qenë një zgjidhje politike apo opsion, me fjalë të tjera një mjet i politikës, domethënë, mjet i forcës e i dhunës . Kur të gjitha mjetet e tjera: dialogu, diplomacia, presioni, dekurajimi, paralajmërimi, kërcënimi etj janë venitur, atëherë kalohet në luftë⁵. Megjithatë, edhe pse ajo është parë si një mjet ose si një instrument i vështirë i politikës, dhe përkatësisht i politikës së forcës, lufta është shumë më tepër.

⁵ Përkufizimi i nocionit të Luftës: Lufta është një konflikt i organizuar dhe shpesh i zgjatur që kryhet nga shtetet dhe /ose aktorët joshitetërorë. Ajo karakterizohet nga dhuna ekstreme, përçarje sociale dhe shkatërrim ekonomik.

Lufta është një fenomen shumë kompleks, e cila nuk mund të reduktohet në një betejë, fushatë dhe as në një interval të mbyllur apo të përcaktuar mbi një mori veprimesh të dhunshme e të konfrontueshme. Lufta është pjesë e jetës së qenieve njerëzore. Ajo nuk duhet të merret si një fatalitet sepse ajo ka shumë objektiva, disa prej tyre, të vendosur në të mirë të njerëzimit, po kështu, ajo ka dhe shumë anë negative.

Marrëdhëniet e krijuara në mes individëve dhe veçanërisht ndërmjet njerëzve, në thelbin e tyre janë politike (në kuptimin që ato janë të lidhura me një ansambël të interesave), dinamike dhe komplekse. Po kështu, duhet pranuar se ato janë marrëdhënie bashkëpunimi, si: aleancat, partneritetet, koalicionet, por edhe marrëdhënie konkurrence, si: konfrontimi për interesa të mëdha ose të vogla, ku disa prej tyre zgjidhen me dialogun politik, ekonomik, financiar etj, ndërsa të tjerat mund të karakterizohen nga konflikti deri në ekstrem. Këto raporte nuk janë të pandryshueshme dhe përfundimtare, ato shpesh kalojnë nga një periudhë “mjalti”, në një periudhë divorcesh dhe hendeqesh të mëdha midis individësh, grupesh apo shtetesh.

Nga historia njohim shumë ngjarje që lidhen me aleanca të fuqishme dhe jo të fuqishme. Koha ka treguar që nuk ka as partneritete, as bashkëpunime të përherëshme, por dhe konfrontimet nuk janë të përherëshme. Në disa raste partneritetet janë për qëllimet e konkurrencës, ndërsa konfrontimi mund të jetë për interesa të fshehura brenda çdo partneriteti dhe marrëdhënieje të caktuara, në një kohë të shkurtër apo afatgjatë.

Këto realitete, si dhe statistikat e caktuara, janë lidhur me raportin mes kohës së paqes dhe luftës, ku në disa shtete, luftërat janë relativisht të përherëshme, me tranzicione të shkurtra nga fazat e pritjes (qetë, aktive ose alarmante) drejt një qëndrimi të tensionuar, dhe, në fazën e fundit, drejt një konfrontimi të dhunshëm. Pra, në këto vende të pastabilizuara, paqja është relative, e përcaktuar në intervalin e pritjes. Krahas qëndrimit të tensionuar, shtetet me paqe të kufizuar bëhen të dyshimta dhe me veprime regresive që kthehen në konflikt. Kjo nuk është thjesht një metaforë, por një realitet i konfirmuar nga historia e njerëzimit, ku ende ka periudha të zëvendësimit të paqes me ato të dhunës, konfrontim deri në luftë.

Në fakt, konfrontimi i dhunshëm dhe i armatosur përfundon gjithmonë me humbje njerëzore dhe dëme të mëdha ekonomike. Luftërat nuk janë veprime lineare dhe të parashikueshme, por më shumë se kaq. Të gjithë e dimë se lufta është pjesë e jetës së njerëzimit bashkë me shkaqet që e lindin atë, filozofinë, fizionominë, probabilitetin e saj, trajektoren dhe mjaft elemente të tjerë që nuk mund të njihen. Ajo që ne dimë t’i referohemi nga luftërat e shkuara është strategjia, taktika, koha, mënyrat dhe metodat që janë përdorur, shkaqet dhe arsyet pse ajo ka filluar, dëmet që ka sjellë në jetën njerëzore dhe materiale etj.

Analiza e luftës zakonisht bëhet pas saj, pas përfundimit. Qëllimi është për të kuptuar atë çfarë ka ndodhur dhe çfarë mësimesh dhe detyrash dalin për të ardhmen, domethënë cila është pjesa më dinamike dhe dramatike në konfrontim (konfrontimi i armatosur me forca dhe mjete).

Shkenca ushtarake është teori, metodë dhe praktikë e prodhimit të aftësive ushtarake, në mënyrë të qëndrueshme me politikën e mbrojtjes kombëtare. Shkenca Ushtarake shërben për të identifikuar elementet strategjik, politik, ekonomik, psikologjik, social,

operacional, teknologjik dhe taktik, të nevojshëm për të mbështetur forcën ushtarake dhe për të arritur fitoren e paqes ose të luftës. Në përbërje të shkencëtarëve ushtarakë përfshihen teoricienë, studiues, shkencëtarë, inxhinierë, teknikë dhe personeli ushtarak me të dhëna të mira për të menduar për paqen, krizën dhe luftën.

Shkenca ushtarake është shkenca që merret me identifikimin, gjetjen dhe përcaktimin e trajektoreve të luftës, domethënë, shkaqet dhe ligjet e dukurive të luftës, rrethanat që e favorizojnë, kushtet që e krijojnë, momentet dhe kohën që ajo shpërthen, efektet dhe ndikimet e saj.

Shkenca ushtarake dhe aleancat

Shkenca ushtarake është ndërtuar si mbështetje e komponentëve të artit ushtarak, si: historia e artit ushtarak; gjeografia ushtarake; gjeostrategjia; mjekësia ushtarake; logjistika ushtarake; teknologjia ushtarake, strategjitë e tjera; sferat e operacioneve, taktikat dhe veprimtaria ushtarake; veprimi i përbashkët civilo-ushtarak etj. Pra, shkenca ushtarake është e pranishme në të gjitha nivelet e artit ushtarak: strategjik, operativ, taktik.

Me fjalë të tjera, shkenca ushtarake nuk është vetëm teori ushtarake, por është më shumë se një sistem, domethënë një sistem që integron brenda hapësirës së saj tre komponentët e sistemeve dinamike ushtarake: teorinë ushtarake, praktikën ushtarake dhe artin e luftës.

Shkenca ushtarake jo vetëm në tërësi, por edhe për sa i përket komponentëve të saj është ndërdisiplinore. Ne gjejmë në të, në të njëjtën kohë, shkencat e tjera si: fizikën, kiminë, biologjinë, biofizikën etj., si edhe shkencat e mikro-sistemeve, makro-sistemeve dhe proceset e tyre. Kjo tregon thelbin e shkencës së luftës si një instrument jo vetëm i thjeshtë, por edhe si një shërbyes i gjithëfuqishëm. Eksperienca ka treguar se drejtuesit dhe strategët ushtarakë i janë drejtuar shkencës për të zgjidhur problemet e vështira, si psh, parandalimin e konfrontimit deri në ndërtimin e paqes.

A nuk është një vlerësim dhe analizë shkencore procesi i planifikimit dhe i vlerësimit të situatës dhe mjedisit të sigurisë deri në marrjen e vendimit? Praktika e saj lidhet me udhëzime strategjike⁶ të planifikimit, duke përfshirë: të kuptuarit e mjedisit operacional; përcaktimin e fakteve të njohura të cilat zhvillojnë supozimet e planifikimit; përcaktimin dhe analizën e kufizimeve; përcaktimin e detyrave të specifikuar, të nënkuptuara dhe thelbësore; deklarimin e misionit; alokuimin e forcave; vlerësimin e rrezikut; zhvillimin e kriterëve të suksesit të misionit; zhvillimin e kërkesave të informacionit kritik; përgatitjen e vlerësimeve të stafit të analizës së shkurtër të misionit deri tek shpallja e vendimit etj. Brenda këtij konteksti duhet pranuar se ata veprojnë në mënyrë efektive dhe jo vetëm, pasi veprimi në zonën e ballafaqimit dikton punën e përbashkët të strukturave ushtarake, por edhe civile.

Për të arritur rezultatin pozitiv në të gjitha rastet synohet të merren masa të besueshme për mbrojtje. Në ditët e sotme është kuptimplote qenia në organizma të përbashkëta,

⁶Joint Publication (JP) 5-0, *Joint Operation Planning*, pasqyron udhëzime për planifikimin e operacioneve të tanishme ushtarake dhe është një botim bazë që formon thelbin e doktrinës së planifikimit të përbashkët për operacion në të gjithë gamën e operacioneve ushtarake.

në strukturat dhe aleancat e ndryshme siç është ajo e NATO-s, pasi ato kanë qëllime të përbashkëta. Parimet e funksionimit kanë thelb politik, por strukturimi, organizimi dhe përcaktimi i normave kërkojnë një dimension të gjerë shkencor që krijon forcë dhe energji.

Koncepti i ri strategjik⁷i NATO-s, në parathënien e tij, vërteton edhe njëherë angazhimin e vendeve anëtare të Aleancës në lidhjen mes kombeve, për të mbrojtur njëri-tjetrin kundër rreziqeve të reja të sigurisë e paqes. Ai shpreh qartë angazhimin e Aleancës në parandalimin e krizave, menaxhimin e konflikteve dhe bashkëpunimin e ngushtë me partnerët OKB dhe BE. Në mënyrë që të garantohet siguria e territorit dhe popullsisë së vendeve të NATO-s, Aleanca do të vazhdojë të përmbushë me cilësi të lartë detyrat themelore të saj, gjithmonë në përputhje me ligjin ndërkombëtar, Mbrojtjen Kolektive; Menaxhimin e Krizave dhe Bashkëpunimin për Sigurinë.

Shkenca e themelimit të aleancave dhe koalicioneve, konsolidimi dhe funksionimi i tyre është një sintezë me referenca të rëndësishme për politologjinë⁸, sociologjinë, ekonominë, financën, shkencat ekzakte, teknologjinë dhe artin ushtarak, sidomos në dimensionin e mësimave të nxjerra në vite.

Një aleancë është shumë më tepër se një partneritet, ajo është një entitet, një arkitekturë e komplikuar dhe një gjeografi dhe gjeopolitikë e gjerë. Për të qenë një aleancë e qëndrueshme dhe efektive, ka nevojë për një aleancë të një strukture shumë solide dhe kjo strukturë politike, në thelbin e saj, është bazuar në interesat për një koncept integruar politik dhe brenda sistemit të shkencës dhe metodës (strategjisë). Rasti konkret është Aleanca e NATO-s, që shpreh në fakt rezultatin e shkencës moderne ushtarake. Pa përjashtuar këtë klasifikim tradicional, në vijimësi do të jetë objekt studimi shkencor, ligjshmëria ushtarake dhe parimet e luftës. Karakteristikë e përgjithshme e luftërave bashkëkohore është integrimi i veprimeve të përbashkëta ushtarake dhe burimeve jo ushtarake të palëve ndërluftuese. Lufta është shpesh asimetrike. Studimi lidhet me këto luftëra, pasi karakterizohen nga shifra të larta të viktimave nga të dyja palët e përfshira në një konflikt. Studimi i hollësishëm i krizës si një proces në sistemin e sigurisë kombëtare të jep mundësinë të përcaktosh parimet e përbashkëta, procedurat, mekanizmat dhe masat për një përgjigje të koordinuar dhe efektive.

Aleanca përcakton sistemin e menaxhimit të krizave. Ajo parashikon: angazhimin e forcave të parandalimit dhe të mbrojtjes kolektive, operacionet në përgjigje të krizave, sanksionet detare e ajrore, zbatimin e embargos, kundërveprimet terroriste, mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë etj.

Të gjitha vendet anëtare të NATO-s, si dhe ato që nuk janë pjesë e Aleancës studiojnë historinë e artit ushtarak, gjeografinë ushtarake, gjeostrategjinë, strategjinë, operativitetin, artin taktik, logjistikën etj.

⁷Nga *Koncepti Strategjik i NATO, Samitin i NATO-s, Lisbonë 2010*

⁸Shkenca politike është një disiplinë në shkencat sociale që merret me studimin e shtetit, kombit, qeveritë dhe politikën. Aristoteli e ka përkufizuar atë si studimin e shtetit. Ajo merret gjerësisht me teorinë dhe praktikën e politikës dhe sistemet e analizës së politikës, sjelljen politike dhe kulturën.

Për sa i përket ndikimit të teknologjisë në artin ushtarak, ne besojmë në dallimin mes ndryshimit të parimeve dhe përshtatjes së shpejtë të strukturave (strategjia e forcave dhe strategjia e mjeteve) dhe veprimeve operacionale (doktrina dhe strategjia) për mundësitë e reja që duhet të krijohen. Për shembull, gjatë Luftës së Dytë Botërore, Gjermania është mbështetur në një strategji të reagimeve të shpejta, bazuar në një përgatitje shumë të mirë në sistemin e komunikimit. Rasti tregoi se ajo arriti të imponohet në frontin e Forcave të Armatosura Franceze⁹, të cilat ishin për filozofinë e luftës pozicionale, duke neglizhuar rolin e lëvizjes, domethënë automjetet e blinduara dhe aeroplanët, madje edhe pse ata kishin mjaft lloje të automjeteve për të neutralizuar veprimin e forcave naziste.

Amerikanët janë ndër të parët që kanë mësuar nga përvoja e shpejtësisë së veprimtarisë në ballafaqimet ushtarake, sidomos pas luftës në Vietnam. Ata kanë kuptuar se teknologjitë e reja krijojnë mundësinë e goditjes në kohë e në distancë, dhe kjo ka çuar në konfigurimin e disa mënyrave të reja të angazhimit të forcave. Kështu dallohen disa lloje luftërash, në të cilat janë përfshirë: lufta me intensitet të ulët; lufta me intensiteti të mesëm; lufta me intensitet të lartë dhe në vitet e fundit, lufta kundër terrorizmit.

Proceset komplekse sociale, sidomos krizat dhe luftërat, janë analizuar shpesh nga përdorimi i teorisë së kaosit. Ky konkluzion i parë ka lidhje me karakterin e proceseve sociale, në përgjithësi nuk janë tërësisht të kontrollueshme informatat ekonomike, sociale, politike, proceset ushtarake etj. Të rëndësishme janë teoria e luftës, krizës dhe konfliktit të armatosur. Ajo rezulton kalimin nga normaliteti drejt anormalitetit, nga anomalitë drejt krizës dhe nga krizat drejt luftës së armatosur. Kjo është arsyeja pse analiza të çon tek logjika se anormaliteti krijon tensione dhe mosfunksionim normal të shtetit.

Në teorinë e krizës, konflikti i armatosur dhe lufta, fazat e zhvillimit të tyre janë të rëndësishme, pasi parasheh mundësitë, shkaqet dhe efektet e krizës. Pra, studimi tërheq vëmendjen e shumë shkencëtarëve për të parë modelin e tyre të ndryshëm nga rasti në rast, për të kuptuar dhe menaxhuar realitetin e sotëm të paraqitjes së rreziqeve dhe sfidave që dalin përpara strategjive ushtarake.

Zbatimi i shkencës dhe strategjia ushtarake

Strategjia në thelbin e saj është një metodë shkencore (teorike), praktike (operacionale) dhe madje edhe artistike (krijuese, intuitive, zgjuarsie), në të njëjtën kohë e vënë në praktikë nga një vendim politik. Kjo është arsyeja që Koncepti Strategjik i Aleancës është një koncept me referencë për kompetenca të reja dhe mënyra të reja të veprimit të NATO-s. Ai është udhëzues dhe gjenerues i forcës nga shtetet anëtare të NATO-s. Duke pasur parasysh këto rrethana, filozofia e NATO-s është që të lëvizin drejt së ardhmes, por nga një funksionim i reagimit politik dhe ushtarak (masiv, gradual, fleksibël, nuklear, klasik, informues etj.), i sigurimit strategjik të mjedisit, të zonës së parandalimit të konflikteve dhe të kontrollit, i dekurajimit të çdo lloj konflikti, i konsolidimit të demokracisë dhe marrëdhënieve ndërmjet shteteve aleate. Prandaj

⁹Historia e Luftës së Dytë Botërore, vol. 1, Larousse, Paris-Match, f. 47.

kërkohet evolucion i një koncepti të gjerë strategjik, në të gjitha fushat, në lidhje me një kontroll dhe shfrytëzim të burimeve sipas konceptit të NATO-s, “Smart Defence”.

Koncepti strategjik i NATO-s është shprehje e filozofisë së re dhe meriton një analizë të përgjithshme dhe të zgjeruar, pasi ai është rezultati më bindës dhe forma më e drejtpërdrejtë e NATO-s se çfarë ajo do të jetë për zonën euroatlantike. Nga ky koncept burojnë të gjitha vendimet e mëtejshme, ndër më të rëndësishmet është rishikimi i strategjive, doktrinave, planifikimi i strukturave efektive etj.

Brenda këtij koncepti shohim që të përfshihen shumë ridimensionime e menaxhime të buxheteve të mbrojtjes, për shembull, në kushtet e FA Shqiptare, nëse është e nevojshme, niveli i forcave do të reduktohet dhe resurset do të jenë të orientuara drejt modernizimit të forcës. Aty do të gjejnë zbatim koncepti i kapaciteteve të përbashkëta ushtarake, “Joint force” apo “Task force”, të përshtatshme për shumë role, pajisja me materiale të ndryshme nëpërmjet bashkëpunimit (sistemet e armëve) dhe financimit të përbashkët, me shkallë të rritjes së ndërveprimit të roleve të specializimit dhe integritit, veprimit të shpejtë dhe sistemet e integruara të komandës dhe kontrollit.

Përfundime

Shkenca ushtarake nuk duhet të qëndrojë në konceptin e të qenit vetëm një projektion skolasik dhe një justifikim analitik i koncepteve dhe teorive të caktuara, apo për t’u bërë e mbyllur në kuti, ajo duhet të jetë një mbështetje e veprimeve të sofistikuar ushtarake për veprime efektive në plotësimin e misioneve dhe detyrave.

Efekti i parë të jetë ndikimi në mendimin strategjik i rolit të forcës, i cili përbëhet nga koncepti i qartë për ndërtimin e strukturave, misioneve, modernizimit të forcës, krijimit të hapësirave për veprim, harmonizimi dhe vendosja për kapërcimin e vështirësive në situatë krize apo konflikti. Megjithatë, shkenca ushtarake nuk është në duart e të gjithëve, por, duke parë se ajo përfshin shumë teori, sisteme, procese komplekse dhe dinamike, bëhet pjesë e shtresave (grupeve me bazë të gjerë intelektuale dhe shkencore) dhe merr një përmbajtje integruese dhe parashikuese me vlerë reale, që lidh njohuritë dhe informacionin, me kërkesat e sistemit të sigurisë dhe të mbrojtjes.

Ky proces do të vazhdojë dhe do të jetë më i përparuar edhe në FA në periudhën e ardhshme, sepse, pa asnjë dyshim, ne jemi duke përjetuar një nga momentet vendimtare të rindërtimit të botës, atë të zhvillimit të teknologjisë dhe të elektronikës që do të ketë ndikim të rëndësishëm në mjediset e sigurisë kombëtare.

Bibliografia:

- Historia e Luftës së Dytë Botërore, “World War II”. The Columbia Encyclopedia (6th). (2007).
- Hakim, Joy (1995). Një Histori e Jona: Luftë, Paqe dhe Xhaz) New York: Oxford University Press. ISBN 0-19-509514-6.
- Koncepti Strategjik i NATO-s, Samiti i NATO-s, Lisbonë 2010
- Strategjia Ushtarake, botim i vitit 2007,
- Joint Publication (JP) 5-0, Joint Operation Planning, 11 August 2011

Lidershipi dhe përgjegjshmëria e tij shoqërore

Dr. Fatmir Zanaj,
Zëvendësrektor dhe Dekan i Fakultetit të Diplomacisë,
Universiteti “Justiniani I”, Tiranë

Trajtesë e shkurtuar. *Jo vetëm për personalitete të shquara të historisë, por sot edhe në jetën e përditshme dëgjon të thuren lëvdata për individë apo grupe të caktuara njerëzish, në fusha të ndryshme veprimtarie. Dëgjon të thuhet, për shembull, për një grup studentësh të rinj të talentuar se “këta do të jenë liderët e së ardhmes”, për një sërë ushtarakësh të sprovuar në misione të vështira se “ata janë liderët e ardhshëm të Forcave të Armatosura”. Kjo ndodh edhe në sektorë të tjerë të jetës, në politikë, në ekonomi, në shkencë, në art, etj.*

Shtrohet pyetja: a ka disa elementë themelorë që janë të pranishëm në lidership në të gjitha periudhat historike, pavarësisht se shfaqja e tyre në secilën periudhë mbart modifikimet e kohës? Domethënë, a mund të shpjegohet dukuria e lidershipit vetëm brenda diadës veberiane prijës-dishepull, apo lidershipi është një dukuri shoqërore, përmbajtja e të cilit është rezultante e veprimit të shumë faktorëve e forcave shoqërore, historike, të cilët lideri i vërtetë i mban parasys, si pjellë e epokës historike kur vepron, pra edhe e të ashtuquajturit proces të socializmit?

Studimet sociologjike theksojnë se në përbërje të dukurisë së lidershipit duhet të dallojmë: a) procesin e udhëheqjes e të drejtimit, b) personin e liderit apo të drejtuesit, si edhe c) funksionin apo rolin e drejtimit, produktet e tij. Siç theksohet me të drejtë, lidershipi është një kombinim delikat i procesit, i teknikave të drejtimit, me aftësitë talentet specifike e cilësitë e shquara të personalitetit të liderit, si edhe me kërkesat e përgjithshme shoqërore për realizimin e atij funksioni.¹ Nga ky këndvështrim kuptohet se koncepti i lidershipit mundet dhe duhet dalluar nga gjykimet tona subjektive se ç’është lidershipi dhe kush është ai në një moment të dhënë, ndonëse fenomeni i lidershipit studiohet më mirë në lidhje të ngushtë me realizimin në kohën e dhënë të detyrave e të funksionit të drejtimit prej personave të veçantë.

¹ Al Gini, Moral Leadership: An Overview, Journal of Business Ethics, Vol. 16, No. 3 (Feb., 1997), f. 323-330 (323).

Në këtë artikull tentohet të studiohet dukuria e lidërshiptit pavarësisht nga fushat e ndryshme të veprimtarisë ku ai drejton, duke u fokusuar te tipi shoqëror i liderit, te një nga tiparet më të qenësishme që ai duhet të mishërojë për të plotësuar e arritur pritshmëritë që ka shoqëria aktuale shqiptare për rolin e arritet si dhe përgjegjshmërinë e tij shoqërore.

Mbi elementët përcaktues shoqërorë të lidërshiptit

Dukuria e lidërshiptit ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e studiuesve dhe në këtë fushë janë të panumërta studimet sociologjike, politike, psikologjike dhe menaxheriale. Me të drejtë mund të thuhet se për sqarimin më të thellë të problemit të lidërshiptit çështjen nuk e vështirëson mungesa e kërkimeve dhe e studimeve në këtë fushë, por më tepër mungesa e aprovimit të përgjithshëm se cilat janë elementët themelorë të qenësishëm që duhet të jenë të pranishëm te secili lider, se cilët janë funksionet bazë më thelbësore të drejtimit pre tij, etj. Megjithatë, në studimet sociologjike mbi lidërshiptin në fushat më të ndryshme të veprimtarisë njerëzore mund të dallohen disa elementë shoqërorë që i ndesh te të gjithë liderët e në të gjithë kohët e historisë moderne, në marrëdhëniet e tyre me masat e njerëzve të tjerë. Në kuadrin e marrëdhënieve të liderit me masat që e ndjekin atë, liderët i klasifikojnë në katër tipe: së pari, janë liderët që i shtyjnë masat për veprim; së dyti, janë ata që cilësohen eksponentë në gjirin e masave, të cilët me influencën e tyre dhe me simpatinë që gëzojnë për ta masat, personifikojnë dhe kristalizojnë përjetimet, dëshirat, ambiciet e synimet e tyre për një periudhë të caktuar kohore; së treti, janë të ashtuquajturit përfaqësuesit e masave, të zgjedhur prej tyre me metoda ligjore si përfaqësues të një grupi të caktuar shoqëror; dhe së fundi, janë liderët që e ndërtojnë vetë masën, liderët konstruktivë, që i grupojnë, organizojnë, frymëzojnë dhe i prijnë ndjekësit e tyre për realizimin e objektivave të caktuara shoqërore.²

Tipi i katërt i liderit plotëson më së miri tiparet që duhet të mishërojë për shoqërinë aktuale shqiptare lidërshipti i sotëm në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore, politike, në fushën e shkencës dhe të biznesit, si dhe të menaxhimit të proceseve e të organizatave civile dhe atyre ushtarake. Ky lloj lideri, paraqitet si një produkt shoqëror, i vetëdijshëm se nuk është një entitet me qendër vetveten, apo i caktuar nga vetvetja për atë rol, por me tepër ai është një mohim i egos së tij. Për të është e huaj ideja e autoritetit autokratik e të centralizuar.

Në ditët tona dhe për shoqëritë tona demokratike, shfaqja e një lideri që ndërton personalitetin e vet jo vetëm në fushën politike, por edhe në fusha të tjera, përmes teknikave të shtypjes e të detyrimit, të imponimit të mendimit e të vullnetit të vet jolegjitim, ka efekte tronditëse. Hedhja në qarkullim në dekadat e fundit të vlerësimeve të tilla si “lider karizmatik”, apo “prijës i të gjithë kombit” etj., - tipike për shoqëritë tradicionale të një të shkuare të largët, - janë reminishenca primitive e autoritariste, të papajteshme me frymën e procesit të pandalshëm të racionalizimit të shoqërisë bashkëkohore kapitaliste, thelbin e të cilave e ka shtjelluar gjerësisht që në vitet 20^{-të} të shekullit të kaluar sociologu gjerman Maks Veber. Ndërsa quante tipike për shoqërinë

² Shih F. Stuart Chapin, Socialized Leadership, The Journal of Social Forces, Vol. 3, No. 1 (Nov., 1924), published by Oxford University Press 2013, f. 57.

bashkëkohore kapitaliste llojin racional të legjitimitetit të çdo lloj autoriteti, ai i konsideronte shprehje të shoqërive të prapambetura patriarkale e tradicionale llojet legjitimitetit tradicional e karizmatik, përligjja e të cilëve bëhet nga nënshtrimi i verbër ndaj zakoneve e traditave të vjetra, apo ndaj cilësive të pandehura të jashtëzakonshme e pothuaj mistike të një lideri autokrat. Nisur nga koncepti veberian i racionalizimit si një proces botëror i zhvillimit të jetës në të gjithë sektorët e saj, në fushën politike racionalizimi substancial ravijëzon dallimin midis autokracisë dhe demokracisë, sepse e para, mbështetet me prezumimin e pranisë së vullnetit hyjnor apo mistik të mishëruar te një sundimtar, ndërsa e dyta, në shprehjen e vullnetit popullor të kombit. Në nivelin e racionalizimit formal, autokracia dhe demokracia dallohen midis tyre respektivisht, nga fakti se e para mbështetet në pandehmën e pranisë së karizmës së liderit, e dyta në ligjshmërinë, pra në procedurat demokratike të legjitimitetit të zgjedhjeve, si në fushën politike, edhe në fusha të tjera të veprimtarisë shoqërore.³

Lideri karizmatik i së shkuarës jodemokratike gjallonte në një mjedis shoqëror që nuk i impononte atij asnjë lloj ndjenje përgjegjshmërie ndaj pasuesve të vet apo ndaj shoqërisë në përgjithësi. Ai lloj lideri nuk i drejtohej kryesisht arsyes së turmës që e ndiqte nga pas, por instinkteve dhe pasioneve përgjithësisht të verbuar të tyre nga efekti i karizmës së tij. Në shoqërinë e sotme demokratike një tipar i qenësishëm i liderit dhe lidershipit konstruktiv është përgjegjësia, e kuptuar kjo si përgjegjshmëri përballë pasuesve për drejtimin e ndershëm të tyre për mbrojtjen e interesave dhe realizimin e objektivave madhore të komunitetit e të shoqërisë, por edhe si përgjegjësi përballë detyrave të kohës, kërkesave të saj, që shkojnë përtej interesave të komuniteteve të veçantë.

Përvoja e 22 viteve të pluralizmit në vendin tonë dëshmon për rastet e shumta të arritjeve pozitive që janë siguruar falë rolit të lidershipit shqiptar, pa dallim partiak. Të gjithë janë të vetëdijshëm se Shqipëria e vitit 2013 dallon shumë nga Shqipëria e vitit 1990. Por, nga ana tjetër, dështimet e përsëritura të lidershipit politik shqiptar për të realizuar reformat e kërkuara për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian, refuzimi i tretë nga ana e institucioneve përgjegjëse evropiane për t'i dhënë brenda vitit 2012 Shqipërisë statusin e vendit kandidat për anëtar në BE,⁴ hedhin dritë për mungesën e një aspekti shumë të rëndësishëm në veprimtarinë e lidershipit shqiptar dhe në konstitucionin e brendshëm të tij, - në aspektin e përgjegjësisë. Të gjitha studimet e anketimet sociologjike në këto dy dekadat e fundit kanë vërtetuar se shumica dërrmuese e popullsisë së Shqipërisë, pavarësisht nga orientimi politik dhe përkatësia politike, kanë kërkuar anëtarësimin e vendit në strukturat Euroatlantike dhe në BE. Nga kjo pikëpamje, duket se përgjegjësia e lidershipit shqiptar për të realizuar në një kohë sa më të shpejtë përmes plotësimit të reformave të kërkuara,

³ Fatmir Zana, Sociologjia e së Drejtës, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë 2010, f. 70, 74.

⁴ Shih COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL, Enlargement Strategy and Main Challenges 2012-2013, Brussels, 10.10. 2012, COM(2012) 600, ku i tërhiqet vëmendja lidershipit politik shqiptar për bllokimin e reformave të kërkuara prej marrëdhënieve të tensionuara mes palëve dhe thuhet shprehimisht se për të ardhmen "do të jetë thelbësore ruajtja e ritmit të reformave, me përqendrim të veçantë në zbatimin e legjislacionit dhe të politikave në fushat e sundimit të ligjit"(f. 15)

këtë objektiv madhor dhe këtë dëshirë të popullit shqiptar, duhet të ishte shumë më e madhe. Duket sikur ndodhemi në një situatë paradoksale, - kuajt duhet të tërheqin përpara karrocën, apo karroca duhet t'i shtyjë përpara kuajt?!

Mungesa në nivelin e kërkuar të kësaj përgjegjësie të lidhshme në nivelet që e ndjen faktikisht atë njeriu i thjeshtë shqiptar, meriton të studiohet më thellë. Por a nuk duhet konsideruar vetë kjo mungesë edhe si deficit lidhshmërie racionale në shoqërinë shqiptare? Sepse lideri i vërtetë dhe konstruktiv politik nuk përgjigjet vetëm përballë grupit të ngushtë të besnikëve të vet, të cilët nuk i ngajnë pasuesve të liderit karizmatik autokrat, të pushtuar nga ethet e pasioneve të verbër, nga urrejtja për kundërshtarin politik, dhe nga lakmia e përfitimit të drejtpërdrejtë me metodat e korrupsionit, të nepotizmit dhe klientelizmit. Kur flitet për liderin konstruktiv e racional, lidhshmi nuk duhet ngatërruar me praktikën e ndërtimit dhe të shfrytëzimit të klientelizmit. Lideri politik konstruktiv përgjigjet jo thjesht përpara pasuesve të rrethit të tij më të ngushtë politik, por ai duhet të përgjigjet përballë kombit për realizimin apo mosrealizimin e objektivave që koha që jeton i ka vënë përballë kombit të tij. Në këtë kuptim lideri politik nuk duhet të vlerësojë si pasues të vet vetëm fraksione të veçantë në gjirin e masave të popullit, por brenda mandatit të dhënë kohor të fituar në mënyrë demokratike, ai duhet të drejtojë tërë masat e kombit, të përgjigjet para tyre, ai duhet të shprehë dhe të mbrojë interesat e tyre themelore, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre themelore.

Lideri i sotëm konstruktiv i shoqërisë demokratike nuk është i imunizuar nga infeksionet e mundshme të shfaqjes së asaj që politologu francez Alexis de Tocqueville e quante "tiraninë e shumicës", që manifestohen nëpërmjet përpjekjeve të bëra nga liderë apo forca të caktuara politike "për të rritur në mënyrë artificiale forcën natyrore të shumicës".⁵ Në ditët tona, siç tregojnë përvoja politike e mjaft vendeve të rajonit tonë, klientelizmi dhe nepotizmi në drejtimin politik e administrativ janë dy instrumente të rritjes artificiale të fuqisë së shumicave politike të dalë nga zgjedhje të kontestuara. Dëshmi e kësaj është shqetësimi i shprehur në progresraportin e Komisionit Evropian të tetorit 2012 mbi Shqipërinë, ku evidentohen dukuritë e mos implementimit të plotë të ligjeve e vendimeve të Këshillit të Ministrave mbi strukturën e organizimit institucionel të administratës publike, dukuritë dhe refuzimit nga institucionet qendrore qeveritare të kërkesave të Departamentit të administratës publike, rastet e shumta të punësimit në këto institucione të militantëve partiakë më kontrata të përkohshme pune, në kundërshtim me ligjet e kriteret profesionale të punësimit, apo edhe dukuria e përçarjes politiko-partiake të shoqatës së autoriteteve lokale, e shoqëruar kjo edhe me mungesën e transparencës dhe të praktikës së konsultimeve të organeve të pushtetit lokal me shoqërinë civile dhe grupe të tjerë të rëndësishëm të interesit (stakeholders) etj.⁶

Përgjegjshmëria e lidhshmit ndaj pasuesve të tyre është një aspekt i rëndësishëm moral i ndershmerisë së tij në realizimin e funksionit të vet drejtues. Studimet tregojnë se ky tipar është i pranishëm në të gjitha organizimet shoqërore, politike, ekonomike

⁵ Alexis de Tocqueville, *Democracy in America: Historical-Critical Edition*, 4 Vols., Vol. 2, Chapter 7: Of the Omnipotence of the Majority in the United States and its Effects. <http://oll.libertyfund.org/>

⁶ Albania 2012 Progress Report, European Commission. Brussels 10. 10. 2012 SED (2012) 334, f. 9, 10.

etj. Studiuesit argumentojnë se lidershipi konstruktiv dhe i përgjegjshëm kontribuon në ndërtimin e shtimin e kapitalit shoqëror,⁷ se në fushën e biznesit kontributi i tij i shërben të mirës së përbashkët jo vetëm të të ashtuquajturve “shareholder” (siç quhen ata që zotërojnë një pjesë të pasurisë së një kompanie biznesi në formën e aksioneve), por edhe të ashtuquajturve stakeholder (personat që nuk zotërojnë në fakt një pjesë të kapitalit të asaj kompanie, por janë të interesuar për suksesin e saj). Në se në mënyrë figurative pasuesit e rrethit më të ngushtë e klientelist të liderit autoritarist do t’i quanim “shareholder” të biznesit të tij politik, vështrimi i tij prej autokrati e pengon të shohë e të mbrojë edhe interesat e shtresave e grupeve të tjerë të interesit në mbarë shoqërinë, që do t’i quanim grupet “stakeholder” në kuadrin e realizimit të objektivave strategjike të politikës kombëtare.

Nisur nga trajtimi i lidershipit si dukuri shoqërore, teoricienët e menaxhimit të biznesit në kushtet e krizës aktuale globale të kapitalizmit, janë orientuar për njohjen më të mirë të rrugëve, mjeteve e të metodave të ndikimit shoqëror për rritjen e përgjegjshësisë së lidershipit në një shoqëri globale pluraliste, që e quajnë edhe “shoqëria e grupeve të interesuar për mbarëvajtjen e suksesin e saj”, ose ndryshe, - “global stakeholder society”. Kjo lloj shoqërie u bën thirrje të gjitha palëve të interesuara për një angazhim proaktiv në mbarëvajtjen e saj, u kërkon liderëve që të edukojnë angazhimin gjithëpërfshirës dhe dialogun, që ata të lehtësojnë e zhvillojnë debatin legjitimues dhe të ndihmojnë në arritjen e balancës midis interesave të ndryshme në procesin e marrjes së vendimeve të shëndoshë nga pikëpamja morale.⁸

Prej këtej kuptohet se organizimet shoqërore të çdo lloji, si edhe liderët e tyre, përballen me sfidën e krijimit të një rrjeti marrëdhëniesh të qëndrueshme e komplekse, dhe duke vepruar në gjirin e tyre, tërheqin në veprimtarinë krijuese tërësinë e grupeve të interesuar, pra stakeholder, në një dialog që krijon rezonancë, besim dhe në fund të fundit, kapital shoqëror bashkëpunues. Nisur nga ky konceptim, po t’i kthehemi dështimit të përsëritur të lidershipit shqiptar për të integruar sa më shpejt vendin në Bashkimin Evropian, kuptojmë se simetria e refuzimit për të marrë parasysh edhe interesat e palës tjetër, kur është e domosdoshme përgjegjshmëria për të bërë lëshime reciproke në emër të interesave mbarë kombëtare, është shprehja më e dukshme e deficitit të lidershipit në elitën politike të shoqërisë së sotme shqiptare. Kjo situatë ka krijuar përshtypjen në segmente të gjera të shoqërisë sonë se ajo simetri refuzimi mund të përsëritet edhe nëse do të kemi rotacion në pushtetin politik, duke i forcuar sentimentet e skeptikëve në vend dhe në Evropë, nëse do apo nuk do klasa politike aktuale shqiptare që vendi të integrohet në Bashkimin Evropian.

Sigurisht, edhe në kushtet e shoqërisë demokratike të përparuar, kur flitet për lidershipin nënkuptohen tërësia e marrëdhëniesh midis liderit dhe ndjekësve të tij në nivele të ndryshme të organizimeve shoqërore. Por në këto kushte, kur lideri i organizon pasuesit e tij, ai duhet të mbajë parasysh interesat, angazhimet dhe pritshmëritë edhe të grupeve të tjera të organizuara shoqërore, që në një shoqëri pak

⁷ Thomas Maak, Responsible Leadership, Stakeholder Engagement, and the Emergence of Social Capital, Journal of Business Ethics, Vol. 74, No. 4, Ethics in and of Global Organizations: The EBEN 19th Annual Conference in Vienna (Sep., 2007), f. 329-343

⁸ Shih Thomas Maak, po aty, f. 330.

a shumë demokratike nuk konsiderohen grupe armiqësore e që duhen shtypur e asgjësuar. Një lider me formim demokratik zgjon në radhë të parë në grupin e udhëhequr prej tij dëshirën e secilit për shprehjen vetë të vullnetit dhe opinionit të tij, dhe nuk ushtron forcë apo manipulim për shtypjen e prirjeve individuale të pasuesve të tij. Fjala e tij është e larmishme dhe stimulon shprehjen e elementeve të ndryshme impulsivë dhe instiktivë në natyrën origjinale të pasuesve të tij, në interesa të mobilizimit të tyre për arritjen e objektivave të rëndësishme shoqërore të komunitetit që ai drejton.

Pasuria e jetës komunitare dhe uniteti i veprimit të tij mund të shkojnë kështu përmes përforcimit të tendencave impulsive për ndryshim te secili individ. Nën këtë lloj udhëheqjeje, pasuesit e nxitur në impulset drejt ndërtimit të jetës komunitare, si shprehje e pjesëmarrjes në ndërtimin e grupit, ka të ngjarë të gëzojnë stimulimin e kënaqësinë edhe të disa tendencave të tjera, ndikimin e grupeve konkurruese, në rrugën e vetafirmimit të idealeve dhe interesave të komunitetit. Me pak fjalë, ngacmimi reciprok i tendencave impulsive të individëve brenda grupit, por edhe të atyre midis grupeve konkurruese, merr drejtimin e kërkuar dhe fiton vetëdijen për ndryshim. Në këtë rast thuhet se anëtarët e grupit lejohen “të mësojnë duke bërë”, dhe për këtë arsye gjykimi i shëndoshë i tyre mëson edhe nga gabimet, të cilat një lider vizionar shoqëror e i përgjegjshëm i vë në dukje, i shpjegon dhe i udhëheq pasuesit e tij për t’i shmangur ato në të ardhmen.

Një lider i tillë, së dyti, organizon emocionet e vullnetin e pasuesve të tij rreth planit ose programit të lëvizjes që ai drejton, dhe jo rreth dëshirave e interesave të veta të ngushta egoiste subjektive. Ai është i bindur se besnikëria ndaj çështjes ka vlerë më të madhe se thjesht besnikëria ndaj personit të tij. Rezultat i natyrshëm të këtij lloji lidërshtipi është se anëtarët e grupit provojnë pasurimin e ndjenjës së grupit dhe vetëdijen e përkatësisë në të për shkak të identifikimit të tyre me programin që shpallot lideri, ku secili anëtar i komunitetit që ai drejton ka dhënë një lloj të caktuar kontributi dhe jo thjesht me tiparet e personalitetit të tij. Vetëvlerësimi, respekti për veten kontrollonhet e disiplinonhet nga vetëvlerësimi e respekti i grupit për vetveten dhe ngrihet kështu në nivelin më të lartë të vetërespektit, si individual dhe kolektiv. Nëse këtë e bëjnë të gjithë liderët e organizimeve e të grupeve të ndryshme konkurruese në një shoqëri demokratike, atëherë do të kemi si rezultat shtimin e kapitalit shoqëror bashkëpunues, i cili është kusht për arritjen e objektivave strategjike politike, ekonomike, kulturore e të tjera, të përbashkëta për të gjitha grupet konkurruese në shoqërinë demokratike.

Deficiti i lidërshtipit në shoqërinë aktuale shqiptare ka sjellë mungesën e një bashkëpunimi e dialogu konstruktiv mes të gjitha forcave konkurruese politiko-shoqërore. Ky deficit nuk është më sekret, i panjohur. Dëshmi të këtij deficiti lidërshtipi i gjejmë të pasqyruar në gjithë progres-raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë në periudhën 2006-2012: “Periudhat e bllokimit politik në pranverën e verën e vitit 2006 penguan përpjekjet e parlamentit për t’u marrë vesh për çështje të rëndësishme të reformave, veçanërisht ato që kërkonin konsensus të gjerë politik”⁹; “Kultura e

⁹ Albania 2006 Progress Report, Brussels, 08.11.2006, SEC (2006) 1383, {COM (2006) 649 final}

dialogut midis partive kryesore politike u përkeqësua përpara zgjedhjeve; ... në tërësi, dialogu politik, një prioritet kyç i Partneritetit Evropian, duhet të rivihet në binarë”¹⁰; “... pavarësisht nga dispozitat kushtetuese, dëshmohet mungesë e mbikëqyrjes parlamentare mbi ekzekutivin (qeverinë) dhe parlamenti nuk funksionon si një institucion i pavarur...Puna parlamentare si për miratimin e ligjeve edhe për funksionet e mbikëqyrjes mban vulën e fuqishme të dialogut politik të vështirë dhe shpesh jo konstruktiv. Që nga qershori i vitit 2009, puna parlamentare është eklipsuar dhe penguar nga ngërçi politik”¹¹; “Incidentet e dhunshme të 21 janarit 2011 që çuan në vrasjen e katër demonstruesve, e shtuan me tej klimën e mosbesimit jo vetëm midis forcave politike, por edhe midis institucioneve shtetërore...; Gjithë kjo situatë largoi vëmendjen nga reformat e shumëkërkuara politike të integritimit në Bashkimin Evropian”¹².

Lideri modern, ekspertiza dhe struktura drejtuese

Çdo lloj organizimi, qoftë ai ekonomik, politik, shkencor, administrativ etj, ka strukturën e vet. Në krye të çdo strukture, edhe të hallkave të saj përbërëse, normalisht sheh persona të caktuar. Por nuk është e thënë që personi i caktuar në krye të këtyre strukturave të ketë cilësitë e një lideri që kërkohet sot. Siç thotë me të drejtë John Gardner, “leadershipi nuk duhet të ngatërrohet kurrë me statusin, pushtetin, pozitën, rangun apo titullin. Madje në korporatat e mëdha dhe agjencitë qeveritare personi i rangut më të lartë mund të jetë thjesht burokrati numër një”¹³.

Shtrohet pyetja: lideri shfaqet spontanisht dhe si person i izoluar e merr drejtimin e një organizimi të dhënë apo në formim e sipër, apo lideri mbruhet, kalitet e formohet, si një dukuri shoqërore? Lidhur me sqarimin e kësaj pyetje ka dy qasje, ajo deterministe dhe ajo indeterministe. Nëse sipas qasjes indeterministe, shfaqja e liderit është krejtësisht spontane, sipas asaj deterministe, në një moment të dhënë të zhvillimit shoqëror, kur përpara një shoqërie apo një organizate qëndrojnë sfida të mëdha për t’u përballuar, kur ajo shoqëri apo organizatë janë ngritur e rrëzuar disa herë në përpjekjet e luftën për t’i kapërcyer pengesat që kanë përpara, kur gradualisht janë krijuar kushtet dhe mjetet për atë kapërcim, atëherë shfaqen edhe liderët që prijnë masat e pasuesve të tyre në një shoqëri apo organizatë të dhënë për arritjen e suksesit dhe plotësimin e objektivave strategjike të tyre.

Por ata nuk shfaqen të plotë në një çast të dhënë, ata përgatiten e rriten gradualisht. Kjo rritje nënkupton jo thjesht grumbullimin e përvojës e të aftësive drejtuese, por edhe të ekspertizës në fusha të ndryshme veprimtarie. Lideri i organizimeve të përmasave të mëdha duhet të shquhet e të bëhet më parë publik, në organizime më të vogla. Janë këto që e mbrujnë liderin e ardhshëm të organizimeve të mëdha. Leadershipi në këto organizata profesionale, ekonomike, ushtarake etj., është më shumë i lidhur me ekspertizën në fushat kryesore të veprimit të atyre organizatave. Por, ekspertiza

¹⁰ Albania 2009 Progress Report, Brussels, 14.10.2009, SEC(2009) 1337.

¹¹ Commission Opinion on Albania ‘s application for membership of the European Union, Brussels, 09 November 2010, SEC(2010) 1335.

¹² Albania 2011 Progress Report, Brussels, 12.10.2011, SEC(2011) 1205 final.

¹³ J. W. Gardner, On Leadership , The Free Press, New York 1990, f. 2.

është njëra anë e medaljes, ajo duhet të plotësohet pa tjetër me disa cilësi të qenësishme të liderit. Në Forcat e Armatosura, për shembull, lidershipi kërkon krahas ekspertizës, edhe besnikërinë ndaj profesionit, vizionin, integritetin dhe respektin për kolegët e vartësit, karakterin, aftësinë për të marrë vendime nën stres dhe kushte të vështira, ashtu si për profesionin e juristit, brenda organizimeve të cilëve janë vendimtare ndershmëria skrupuloze, - qetësia e drejtpeshimi në marrjen e vendimeve, bashkëpunimi me kolegët e njerëzit e tjerë. Juristët e dinë se që të jenë liderë në profesionin ligjor, ata duhet të jenë profesionalisht juristë të mirë, të aftë, të ndershëm dhe të pavarur në mendime e vendime.

Ekspertiza e duhur e bën liderin e një organizate profesionale të evidentojë e të verë në lëvizje energjite e aftësitë më të mira të vartësve të tij. Kjo është një nga përgjegjësitë e rëndësishme të liderit. Ai duhet të bazohet te kjo njohje për të ndërtuar prioritetet e shfrytëzimit me efektivitet të atyre energjive, sidomos në kushtet kur burimet e tyre janë të kufizuara. Lidershipi manifestohet si aftësi për të ofruar drejtimin dhe shembullin se “çfarë duhet bërë”, ndërsa administrimi apo menaxhimi më shumë shfaqet si aftësi për të dëshmuar se “si duhet ta bësh atë”. Kombinimi i ekspertizës, i vizionit dhe aftësive menaxhuese janë jetike për një lidership të ditëve tona, jo vetëm në struktura të vogla, të pjesshme, profesionale, por edhe në kuadrin e partive politike dhe në mbarë shoqërinë. Nëse nuk bëhet kjo, nëse ky kombinim çalon, atëherë shfaqen mungesa në lidership, siç vërehet edhe nga zhvillimet politike shoqërore të Shqipërisë e të rajonit tonë.

Lidershipi në jetën politiko-shoqërore nuk është një dukuri individualiste e izoluar. Siç thekson me të drejtë Brian J. Cook, megjithëse lidershipi është teorikisht një gjë që ushtrohet vetëm nga individët, nuk duhet lejuar që orientimi individualist apo i një aktori të vetëm të dominojë tërësisht gjithë vizionin tonë shpjegues mbi këtë dukuri. Sepse ndërtimi i një regjimi të caktuar shoqëror “është në fund të fundit një proces kolektiv... institucionet dhe organizatat e mëdha formale ushtrojnë ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë mbi karakterin e regjimit. Ato përbëjnë një masë të madhe të vet substancës së atij regjimi shoqëror”.¹⁴

Udhëheqësi apo lideri i një shoqërie demokratike nuk personalizon organizatën në fushat më të ndryshme të veprimtarive shoqërore, nuk i jep “fytyrën” e vet secilit anëtar të saj, por përpiket ta institucionalizojë atë duke i inkurajuar ndjekësit e tij për të shprehur veten brenda saj. Ai i hap rrugën shpirtit krijues e novator të secilit anëtar të thjeshtë të saj për të dhënë kontributet e tyre në jetën e komunitetit, që ata të shohin sesi idetë e tyre përfshihen në ndërtimin e jetën e organizatës. Përgjithësisht, forma më e përshtatshme e drejtimit është krijimi i organeve drejtuese, - si i një komiteti ekzekutiv apo i një bordi drejtues, i një asambleje apo komiteti drejtues etj., si shembuj të këtij lloji organizimi, të përbërë nga individë të cilët përfaqësojnë interesat elementare ose funksionale e pjesëve të ndryshme të një grupi më të gjerë shoqëror. Në këtë mënyrë mund të përfaqësohen lokaliteti i origjinës, profesionet, bindjet fetare, përkatësia gjinore etj, duke u dhënë mundësi të tërë elementëve të ndryshëm të grupit të madh përfshirës për të dhënë kontributin e tyre përkatës në favor të tij.

¹⁴ Brian J. Cook, Politics, Political Leadership, and Public Management, Public Administration Review, Vol. 58, No. 3 (May - Jun., 1998), f. 225-230 (226).

Lideri apo drejtuesi i sotëm përshtat strukturat apo makinerinë e vjetër organizative me nevojat e reja, dhe përpiqet të shmangë krijimin e strukturave të reja si përgjigje ndaj lindjes së çdo nevoje të re. Kjo teknikë e organizimit ka vlerë të madhe sepse të lejon të shfrytëzosh në mënyrën më të plotë vlerat shoqërore dhe forcat motivuese lëvizëse, të qenësishme në format ekzistuese dhe shprehitë e punës ekipore. Lideri apo drejtuesi modern nuk sheh andej-këndeje që të shpikë projekte të reja organizative, që do t'i përshtateshin ndjenjave, shijeve e kënaqësive të tij, apo të dizajnuara për të krijuar vende pune për miqtë dhe për të ndërtuar rreth vetes një klientelë mbështetëse. Ai përshtat format e strukturat organizative e agjencitë ekzistuese ndaj problemeve të reja. Pjesa më e madhe e atij padurimi dhe nxitimi për të krijuar struktura të reja duket se buron nga reagimi i atyre që kërkojnë largimin nga nevoja e përballimit me realitetin dhe nga angazhimi i ndershëm për t'u përballur me çështjet më themelore. Ky është motivi i fshehtë që shpesh qëndron në themel të aktivitetit organizativ të të ashtuquajturve liderë. Rendja pas strukturave të reja, retorika demagogjike e zhurmuese rreth dobisë dhe efektivitetit të tyre, tërheq vëmendjen nga nevojat më themelore që shpesh kërkojnë zgjidhje drastike dhe mund të kenë pasoja të pakëndshme, nëse jo pasoja katastrofike për miqtë. Kështu energjitë për progresin real të organizatës apo komunitetit shmangen e orientohen drejt kryerjes së akteve e reformave sipërfaqësore.

Mirëpo, siç vënë në dukje studiuesit, “lidershipi është një nga ato cilësi që më mirë shihet, sesa dëgjohej. Ata që drejtojnë nuk flasin shumë, ndërsa ata që flasin më shumë, drejtojnë më pak. Siç shkruante Shekspiri: *“Anija pa mall, bën zhurmën më të madhe”*. Shqiptarët janë ngopur me deklaratimet e politikanëve se vendi i tyre po kthehet në një “superfuqi rajonale” në atë apo këtë sektor, se kontrata e filan partie me elektoratin është plotësuar e tejkaluar disa herë, ndërsa në realitet Shqipëria vazhdon të mbetet vendi më i varfër i rajonit, vendi i fundit në proceset e integritimit në Bashkimin Evropian, vendi në nivelet më të ulëta të hierarkisë evropiane të prestigjit, vendi ndër më të papëlqyerit për t’iu bashkuar familjes evropiane prej atyre që i përgjigjen pyetjeve të Eurobarometrit!

Shembuj të fundit nga vendi e rajoni ynë dëshmojnë se shpesh janë shfaqur e shfaqen në fusha të ndryshme veprimtarie liderë që nxisojnë të shpikin struktura të reja organizative për të shmangur riorganizimin e jetës së tyre të brendshme, zakonet e tyre të mendimit dhe përvojat e tyre sentimentale zakonore, duke i zëvendësuar me organizimin e jashtëm të strukturave të reja. Persona të tillë që pandehin se janë “liderë” thjesht nga fakti se janë ngjitur fort pas karriges së pushtetit dhe të strukturave drejtuese partiake, janë kthyer në forcën më konservatore e penguese për progresin e forcës së tyre politike e të mbarë shoqërisë. Nëse kjo analizë është e saktë, të tillë individë arrijnë të mashtrojnë veten dhe ta përcjellin këtë ide mashtruese edhe te pasuesit e tij. Edhe kur pasuesit e tyre reagojnë, ata e mbysin me mjete e metoda antidemokratike zërin kundërshtar.

“Ka një arsye për çdo gjë”, predikonte mbreti Solomon, ka një kohë që duhet të drejtosh, ka edhe një kohë që duhet të ndjekësh pas një tjetër. Kjo ka vlerë si për drejtuesin e një organizate, edhe të një biznesi, të një partie, të një qeverie etj. Kur arrihet sukcesi, fuqia e lavdia janë si të tij, por edhe të të gjithë organizatës në tërësi. “Ka gjithashtu edhe një kohë kur duhet përdorur shprehja që injorohet më shpesh,

pra të thuhet “nuk e di”.¹⁵

Trajtimi i përmbytjes së lidërshipt si dukuri shoqërore është i pandarë nga parimi i nxitjes së edukimit të pasuesve besnikë dhe inteligjentë për pozicionet që realizojnë në përgjithësi atë funksion. Për këtë arsye, lidërshipi modern duhet të përdorë një teknikë të tillë që, bazohet në politikën e trajnimit e të edukimit të vartësve e të pasuesve. Parimet themelore të veprimtarisë organizuese të liderit të sotëm duhet të përfshijnë realizimin e vetëshprehjes së pasuesve të tij, organizimin e emocioneve të anëtarëve të grupit rreth planit apo kauzës në një rast të dhënë, në interes të zhvillimit të ndjenjës së besnikërisë, institucionalizimin e organizimit sesa personalizimin e tij, përdorimin e metodave inteligjente edukative të krijimit të kapaciteteve njerëzore, si konferenca, workshope e forma të tjera të punës edukative në grup. Aktivitetet e organizuara në grup mund të shkaktojnë më lehtë shtrirjen dhe rritjen në madhësi të grupit. Në këto kushte, mjaft organizata bëhen joefektive. Në çdo rast, këtu kemi të bëjmë me rritje të konsiderueshme të rolit të pjesëve brenda këtyre grupeve apo strukturave të mëdha. Drejtimi efektiv i grupit të madh nuk mund të mbështetet në kontaktin personal të liderit me secilin anëtar të tij. Lideri i aftë e modern e quan të domosdoshme, në faza të ndryshme të zhvillimit të aktiviteteve të grupit, të delegojë kompetenca drejtuese te vartësit e tij. Është domosdoshmëri që lideri të mbështetet në mendimet e specialistëve dhe në vartësit përgjegjës para tij. Parimi më i vlefshëm këtu është respektimi i mendimit të specialistit, i cili nga ana tjetër nuk duhet të besuar e mbivlerësuar jashtë fushës së specialitetit të tij. Përtej perimetrit të dijës së tij të veçantë profesionale, mendimi i tij rrallë është më i besueshëm se ai i çdo personi tjetër painformuar, sepse është i paorganizuar. Nevoja e madhe sot në vendet demokratike të rajonit tonë është zhvillimi i lidërshipt në të gjitha fushat e jetës, - dhe jo i një lidërshipi i përqendruar në pak njerëz, por i një udhëheqje shpërndarë dhe spontane midis masave të gjera të popujve tanë.

Në literaturën shkencore mbi dukurinë e lidërshipt bëhet dallimi midis lidërshipt formal dhe atij informal. Me lidërshipt formal kuptohet veprimtaria e drejtuese e personave të veshur me pushtet, me autoritet zyrtar, ndërsa me lidërshipt informal kuptohet fuqia e akumuluar e ndikimit dhe e aftësive bindëse-frymëzuese të individëve të ndryshëm në gjirin e komuniteteve shoqërore.¹⁶ Njohja dhe evidentimi i këtyre individëve nuk është thjesht çështje e karrierës së tyre personale, por një nevojë shoqërore e kultivimit të lidërshipt vizionar. Nevojat e zhvillimit shoqëror në periudha kthesash të mëdha historike, siç ka përjetuar rajoni ynë në këto dy tre dekadat e fundit, nxitin shfaqjen e liderëve që drejojnë masat në plotësimin e tyre. Këta janë liderët vizionarë, që kur mungojnë, duhet të krijohen nga forcat që mbështesin zhvillimet demokratike në shoqëritë në tranzicion. Rekomandimet për krijimin e edukimin e liderëve të tillë vizionarë të aftë, pastaj për të mobilizuar e drejtuar masat e popullsisë për të marrë pjesë në proceset demokratike, duke nxitur te ato frymëzimin

¹⁵ Brian D. Farrow, *Lawyers and Leadership*, The Business Lawyer, Vol. 44, No. 4 1989, f. 1699-1705 (1703)

¹⁶ Robert L. Peabody, “Leadership in Legislatures: Evolution, Selection, Functions”, *Legislative Studies Quarterly*, Vol. 9, No. 3 (Aug., 1984), f. 441-473 (443).

e kërkuar për ndryshim, janë të vlefshme sidomos për shoqëri si ato të Ballkanit perëndimor, i cili ka njohur dhe ende po përjeton periudha krize të lidershipit vizionar.

Presioni dhe asistenca e vazhdueshme e faktorëve ndërkombëtarë si BE dhe SHBA mbi drejtuesit e shteteve dhe të shoqërive të këtij rajoni i kanë shërbyer dhe i shërbejnë këtij qëllimi, ndërtimit dhe kultivimit të liderëve vizionarë. Në ditët tona shumica e vendeve duhet të angazhohen në veprimtaritë e përpjekjet për ndërtimin e kultivimin e liderëve të tillë, që i kërkon tejkalimi i situatave që ka krijuar dhe ka rënduar në mjaft drejtime si ekonomike e politike, kriza e përgjithshme e kapitalizmit. Aq më shumë kur është e domosdoshme kjo në kushtet e konkurrencës midis shoqërive demokratike dhe formave të ndryshme të regjimeve hibride e jodemokratike. Këto të fundit përcjellin mesazhe që përmbajnë rrezikun potencial të deformimit të demokracisë, për shkak të mungesës së vullnetit dhe të autoritetit që duhet të manifestojnë liderët e vërtetë vizionarë. Kjo është edhe mungesë e përgjegjshmërisë së tyre. Prandaj, siç vërejnë studiues të ndryshëm, rekomandimi për kultivimin e forcimin e lidershipit shoqëror e politik vizionar është mjaft i rëndësishëm aktualisht.¹⁷

Disa përfundime:

Së pari, në shoqëritë tona demokratike në ndryshim, nevoja për kultivimin e lidershipit shoqëror vizionar dhe të përgjegjshëm është e pranishme në të gjitha fushat e jetës. Këto nevoja bëhen më urgjente në kushtet e krizës së kapitalizmit, që duket se do të vazhdojë gjatë dhe vështirëson procesin e ndryshimeve demokratike që po zhvillohen në shoqëritë e rajonit tonë e më gjerë.

Së dyti, shoqëritë tona po kalojnë nga faza e kultivimit paraprak të lidershipit strategjik, në atë të ndërtimit të liderëve në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore, ekonomike, politike, administrative, të biznesit, të shkencës etj., për të garantuar pathyeshmërinë e procesit demokratik dhe përshpejtuar ritmet e ndryshimit në procesin e integritetit të vendit tonë në familjen evropiane, në Bashkimin Evropian, pas pranimit në NATO. Kjo do të thotë se është e domosdoshme shtimi i kapitalit shoqëror të drejtimit, institucionalizimi i procesit të rotacionit në drejtim në organizata e struktura që ndikojnë në fatet e njerëzve e të vendit. Pra, kapërcimi i deficitit në lidership e bën të domosdoshme që të ndërtohen mekanizmat që garantojnë qarkullimin e lirë, pa tensione, pra qarkullimin demokratik të elitave në pushtet, duke garantuar edhe qëndrueshmërinë e sistemit shoqëror politik si dhe kultivimin e promovimin e elitave profesionale të pavarura në të gjitha fushat e jetës ekonomike, administrative, shkencore, ushtarake etj.

Së treti, zhvillimi i qytetërimit, shtimi i pafund i vëllimit të dijes dhe ekspertizës dhe demokratizimi i procesit të edukimit, kërkojnë vizione të reja në fushën e lidershipit konstruktiv e racional në planin politiko-shoqëror. Sepse institucionet politike janë institucione të një lloji të veçantë. Ato janë instrumente të ndërtimit të sistemit, por edhe pjesë përbërëse të tij. Ato janë mjete kryesor, me anë të të cilëve një komunitet shoqëror mund të arrijë të plotësojë qëllimet e përbashkëta. Për arsye të përbërjes së

¹⁷ Yehezkel Dror, Visionary Political Leadership: On Improving a Risky Requisite, International Political Science Review / Revue internationale de science politique, Vol.9, No. 1, Visionary Realism and Political Leadership/ Dirigeants, grands desseins, et réalités politiques (Jan., 1988), f. 7-22 (9).

tyre, të strukturës dhe të funksionimit të tyre, të qëllimeve që zgjedhin dhe të ligjeve që miratojnë në emër të shoqërisë (në kuadrin e institucioneve përfaqësuese), ato kanë një ndikim të përhershëm mbi vetë karakterin e shoqërisë e të shtetit, mbi mënyrën se si ato do të zhvillohen edhe në të ardhmen.

Së katërti, në balancën e fuqisë midis liderit vizionar dhe masave që shkojnë pas tij në një shoqëri demokratike, vërehen herë pas here ndërrim të vendeve, të cilat e bëjnë edhe një herë të ditës shtrimin e pyetjes “kuajt tërheqin përpara karrocën, apo karroca duhet t’i shtyjë përpara kuajt?” Aktualisht, kur flitet për valën e katërt të demokratizimit botëror, kërkohet një leadership vizionar, që nënkupton drejtimin që përcakton qartë rolin e secilit nga dy faktorët e lartpërmendur në zhvillimin e shoqërisë. Mbi vlerësimin e rolit të liderit dhe vënienë në dyshim e rolit të masave që shkojnë pas tij, të cilat janë rezervuari i përgatitjes së liderëve të rinj, mund të vlerësohen si dështim i përcaktimit të misionit të leadershipit dhe shprehje e mungesës të tij.

Bibliografia

- Albania 2012 Progress Report, European Commission. Brussels 10. 10. 2012 SWD(2012)
- Albania 2006 Progress Report, Brussels, 08.11.2006, SEC (2006) 1383, {COM (2006) 649 final}
- Albania 2009 Progress Report, Brussels, 14.10.2009, SEC (2009) 1337.
- Albania 2011 Progress Report, Brussels, 12.10.201, SEC (2011) 1205 final.
- Al Gini, Moral Leadership: An Overview, Journal of Business Ethics, Vol. 16, No. 3 (Feb., 1997).
- Chapin F. Stuart, Socialized Leadership, The Journal of Social Forces, Vol. 3, No. 1 (Nov. 1924), published by Oxford University Press 2013.
- Commission Opinion on Albania’s application for membership of the European Union, Brussels, 09 November 2010, SEC (2010) 1335.
- COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL, Enlargement Strategy and Main Challenges 2012-2013, Brussels, 10.10. 2012, COM (2012) 600
- Cook Brian J., Politics, Political Leadership, and Public Management, Public Administration Review, Vol. 58, No. 3 (May - Jun., 1998).
- Dror Yehezkel, Visionary Political Leadership: On Improving a Risky Requisite, International Political Science Review / Revue internationale de science politique, Vol.9, No. 1, Visionary Realism and Political Leadership/Dirigeants, grands desseins, et réalités politiques (Jan., 1988).
- Forrow Brian D., Laëyers and Leadership, The Business Lawyer, Vol. 44, No. 4 1989, f. 1699-1705 (1703)
- Gardner J. W., On Leadership, The Free Press, New York 1990.
- Maak Thomas, Responsible Leadership, Stakeholder Engagement, and the Emergence of Social Capital, Journal of Business Ethics, Vol. 74, No. 4, Ethics in and of Global Organizations: The EBEN 19th Annual Conference in Vienna (Sep., 2007).
- Tocqueville Alexis de, Democracy in America: Historical-Critical Edition, 4 Vols. , Vol. 2, Chapter 7: Of the Omnipotence of the Majority in the United States and its Effects. <http://oll.libertyfund.org/>

Menaxhimi i stresit në misionet paqeruajtëse

Nënkolonele Dr. Edlira Kukeli,
Shefe e Edukimit Shëndetësor dhe Doktrinës, SUQU

Trajtesë e shkurtuar. *Stresi është reagimi i organizmit të njeriut ndaj ndryshimit. Paqeruajtësit përgjithësisht janë të aftë të përballojnë efektet e stresit. Eksperiencat traumatike, të kombinuara me presionin e vazhdueshëm dhe përgjegjësitë e vështira, si, të qenit larg, në një kulturë të huaj mund të shkaktojnë një nivel të stresit¹ që është i vështirë të kontrollohet dhe të kuptohet. Paqeruajtësit kanë një shkallë stresi, i cili lind nevojën për t'iu përshtatur ndryshimeve në misionet e tyre. Personeli paqeruajtës duhet të njohë simptomat e stresit dhe të jetë i aftë të përballlet me efektet e situatave traumatike. Monitorimi i procesit të trajtimit të stresit dhe parandalimi i komplikacioneve, nëpërmjet një ndihme profesionale mjekësore, është i domosdoshëm.*

Të gjithë individët që kanë vuajtur nga stresi i dëmshëm në të kaluarën, por që tani janë çliruar, dhe ata të cilëve u duhet ende të përballojnë cilësitë e tij të pakëndshme duhet të jenë në gjendje të kuptojnë vlerën e frazës “parandalimi është më i mirë se mjekimi”. E rëndësishme është që paqeruajtësit të ruajnë ekuilibrin midis veprimtarisë dhe pushimit, lidhjeve shoqërore dhe mbylljeve në vetmi, emocioneve dhe intelektit, zhurmës dhe qetësisë, si dhe shumë forcave të tjera të kundërta në jetën njerëzore.²

Paqeruajtësit i ndiejnë simptomat e stresit dhe janë në gjendje të gjykojnë për efektet e tij duke përdorur veten e tyre si parametër. Është e domosdoshme të theksohet që personeli paqeruajtës duhet të njohë simptomat e stresit, i cili është një proces fiziologjik e fizik i reagimit dhe përballjes me ngjarjet dhe situatat që shkaktojnë presion mbi qeniet njerëzore.

Stresi është një reaksion normal në një situatë jonormale dhe i shërben funksionit të parandalimit të një situatë kërcënuese, duke lejuar përqendrimin e vëmendjes mbi një kërcënim të veçantë. Paqeruajtësit janë të ekspozuar rregullisht ndaj incidenteve

¹ Stress Management Booklet UN Department of Operations , faqe 19-20

² Peter Tyrer “Si ta përballojmë stresin”, faqe 31-34.

të ndryshme, të cilat mund të shkaktojnë shpërthime të stresit. Ekzistojnë disa përkufizime për stresin:

- Stresi është reagimi i organizmit ndaj ndryshimit.
- Stresi është një pjesë e të mbijetuarit.
- Stresi është i natyrshëm për zhvillimin njerëzor.
- Stresi është kryesisht pozitiv, por dhe i pashëndetshëm.
- Stresi është i kontrollueshëm dhe i ndërruar.

Në këtë studim do të paraqesim tre tipe të stresit:

Stresi Bazë

Çdo eksperiencë individuale, në situatat e përditshme, mund të prodhojë tension, çrregullim, irritim, dridhje dhe mërzitje. Vulnerabiliteti i një personi është gjerësisht i përcaktuar nga fuqia, zhvillimi fizik, gatishmëria për të reaguar me një intensitet të lartë ndaj situatave të krijuara.³

Një rol të rëndësishëm ka arsimimi, aftësitë personale, eksperiencia e kaluar, moshja, niveli i intensitetit fizik, vetëvlerësimi personal etj.

Një paqeruajtësi i duhet të vuajë stresin e të qenit larg nga shtëpia, familja dhe shoqëria e tij. Vazhdueshmëria e stresit mund të shkaktojë shpërthim, acarim personal dhe profesional. Në këtë rast shohim se një person, i cili vuan nga një gjendje e tillë, ose vazhdon të punojë, ose në të shumtën e rasteve, dëmton shëndetin dhe e përjashton veten nga të gjitha aspektet e jetës. Karakteristikë është depresioni, humbja e besueshmërisë dhe e vetëvlerësimit, ndjenja e fajit, hidhërimi etj.

Si të menaxhojmë stresin bazë?

Drejtimit që vijnë kanë bërë të mundur zhvillimin e një strategjie efektive për menaxhimin e stresit. Hapat që duhet të ndiqen janë:

- Identifikimi i burimeve të stresit, njohja e kufizimeve personale.
- Menaxhimi i mirë i kohës.
- Pranimi i sfidave kryesore, njohja e kufizimeve personale.
- Gjumë i mjaftueshëm, pushim dhe ushtrime fizike.
- Kontroll në marrjen e duhanit dhe alkoolit.
- Zhvillim i marrëdhënieve dhe miqësisë së kënaqshme, sensi i humorit.

Stresi i akumuluar

Stresi i akumuluar është rezultat i një tensioni që shfaqet shpesh, zgjat për një kohë të gjatë dhe ka intensitet të lartë. Karakteristikë e stresit të akumuluar është rraskapitja. Individu është i paaftë të përballet me sasinë e stresit. Disa nga simptomat kryesore janë: lodhje e vazhdueshme e shoqëruar me hiperaktivitet të acaruar, ndjenja e mërzitjes, dekurajimi, depresioni dhe mungesa e shpresës. Karakteristikë është gjendja psikologjike e rënduar, mohimi i humbjes së efektivitetit dhe paftësi të performanca

³ Terry Pettijohn "Psikologjia, shkaqet e stresit", ShB Lilo, Tirane: 1996, fq 422-427, 430-433.

profesionale. Shenjat fizike janë: lodhje, dhimbje koke, dhimbje kurrizi, ulçer stresi etj.⁴

Si të menaxhojmë stresin e akumuluar?

Është e vështirë të zbulohen shenjat e stresit të akumuluar, pasi ato bëhen pjesë e jetës së përditshme dhe kjo duket natyrale. Për të menaxhuar stresin akumulativ duhet të ndiqni këto hapa:

- Merrni përgjegjësi personale, identifikoni zonat e stresit dhe veproni për të ndryshuar atë ose reaksionin tuaj.
- Kuptoni limitet e objektivave si paqeruajtës, mësoni të delegoni detyrat.
- Duhet të jeni realist ndaj vendimeve dhe arritjeve. Kujdesuni për veten tuaj dhe efektivisht për të tjerët
- Kryeni ushtrime të vetëdisiplinimit në situatat jashtë kontrollit.

Stresi traumatik

Stresi traumatik është rezultat i një veprimi të shpejtë e të dhunshëm, i cili do të kërcënojë një individ fizikisht dhe psikologjikisht.⁵ Ndodh në raste të tilla si: të qenit spektator i pafuqishëm në një vrasje, epidemi, shkatërrim natyror, bombardim, minim i rrugëve, sulm mbi mjetet e transportit, sulm i armatosur, shkatërrime materiale etj.

Si rezultat i situatave të përshkruara më lart, paqeruajtësit mund të vuajnë pasoja serioze, si: shok, hiperaktivitet i theksuar, shpërthime mërzitjesh etj. Reaksionet emocionale mund të shfaqen menjëherë, ose pas pak orësh, ose pas pak ditësh. Ky është stresi i çrregullimit akut. Nëse reaksionet emocionale shfaqen pas disa muajsh ose pas pak vitesh, atëherë kemi të bëjmë me stresin post traumatik.⁶ Karakteristikë është përjetimi i vazhdueshëm i eksperiencës së ngjarjes traumatike.

Në këto raste rekomandohet një ndihmë profesionale nga një specialist, si psikoterapist, i cili është trajnuar në përdorimin e teknikave të veçanta.⁷

Si të menaxhojmë stresin traumatik?

- Nuk duhet të jeni kritik me veten tuaj.
- Nuk duhet të imagjinoni që të tjerët kanë një mendim të gabuar për ju.
- Mos vuani në heshtje, por shprehini emocionet tuaja për të parandaluar efektet serioze.
- Kërkoni ndihmë për veten tuaj ose për dikë tjetër që njihni.

⁴ Stress Management for Health Course Signs and Symptoms of Stress, www.stresshelp.tripod.com.

⁵ Theodhori Karaj "Psikologjia e stresit", ShB Mokra, Tirane, fq 21.

⁶ Erika Braley "Stress relief", ShB "Shandelor Stress", 2004, fq 13.

⁷ Stress Management for Health Care Biochemical and Physiological Changes, www.stresshelp.tripod.com.

- Bisedoni për eksperiencën tuaj menjëherë me një infermier, koordinator mjekësor të trajnuar në këtë drejtim. Pranoni një ambient mbrojtës, të përfshirë nga një kujdes mjekësor.
- Bëni pushim dhe shfrytëzoni kohën për të përmirësuar veten tuaj.

Përfundime

Paqeruajtësit në misionet e tyre janë të ekspozuar ndaj situatave të vështira, deri në kërcënimin e jetës së tyre. Këto eksperiencia traumatike mund të shkaktojnë një nivel të stresit që është i vështirë të kontrollohet e të kuptohet. Është e rëndësishme që paqeruajtësit të zbulojnë simptomat e stresit dhe të jenë të aftë të përballojnë efektet e situatave traumatike. Skenari më i mirë është që personaliteti i tyre të fuqizohet dhe të përmirësohet.

Emocionet e ndryshme gjatë një incidenti traumatik, reaksioni depresiv ose fatkeqësie, janë përgjigje normale, nga një ngjarje jonormale. Këto reaksione emocionale duhet të kuptohen si plagë psikologjike. Paqeruajtësit duhet të sigurojnë trajtimin e menjëhershëm, duke mos pritur një specialist, por të kenë iniciativën personale për të reduktuar nivelin e stresit. Monitorimi i procesit të trajtimit të stresit dhe parandalimi i komplikacioneve, nëpërmjet një ndihme profesionale, është i nevojshëm.

Të dëgjuarit për rreth dy orë mund të parandalojë problemet e një eksperiencie traumatike. Ky është tipi më i rëndësishëm i asistencës për një plagë psikologjike. Një person, i cili ka një eksperiencë traumatike, duhet të bisedojë rreth ngjarjes apo emocioneve, me një person të trajnuar profesionalisht. Asistenca, të dëgjuarit, kujdesi, keqardhja, teknikat e relaksimit janë pjesë përbërëse e të punuarit me paqeruajtësit⁷.

Bibliografia:

- Stress Management Booklet UN Department of Operations.
- Peter Tyrer “Si ta përballojmë stresin”, London: Sheldon 2003.
- Terry Pettijohn “Psikologjia, shkaqet e stresit” SHB LILO, Tiranë, 1996.
- Stress Management for Health Course Signs and Sypptoms of Stress, www.stresshelp.tripod.com.
- Theothori Karaj “Psikologjia e stresit” Mokra 2005.
- Erica Braley “Stress relief” SHB “Shandelor Stress” 2004.
- Stress Management for Health Care Biochemical and Physiological Changes, www.stresshelp.tripod.com.

RUBRIKA E DYTË

Punime nga Akademia e Forcave të Armatosura

Revista Ushtarake vazhdon t'i kushtojë vëmendje punës që bën Akademia e Forcave të Armatosura dhe kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit si dhe të Kursit të Lartë të Shtabit të Përgjithshëm dhe i falënderon ata për prurjet e vazhdueshme.

Rubrika e dytë paraqet disa nga punimet e dy veprimtarive kryesore dhe të rëndësishme, të organizuara nga Akademia. Ndër to, 55-vjetori i AFA, trajtohet nëpërmjet shkrimit "Ruga 55-vjeçare e Akademisë së Forcave të Armatosura, arritjet dhe vizioni për të ardhmen", nga një grup autorësh, ndërsa veprimtaria e dytë, e organizuar nga kursantët e Kursit të Lartë të Oficerëve, në bashkëpunim me Departamentin e Operacioneve të Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes konsiston në zhvillimin e diskutimit shkencor mbi refleksionet e strategjeve të mëdhenj ushtarakë, në përjasje me doktrinën kryesore të Aleancës, të ratifikuara nga FA të RSH. Në këtë diskutim shkencor, vend të rëndësishëm zë një nga studiuesit kryesorë të teorisë së luftës, Karl fon Klauzeviç.

E veçanta e trajtesave të këtij diskutimi është se kursantët e KLO, vijnë në RU, përkrah me drejtuesit e tyre pedagogë të AFA. Shkrimet janë përpjekje serioze të kursantëve dhe pedagogëve të tyre për të sjellë në vëmendje të lexuesve pasqyrimin e problematikave të ndryshme të veprimtarisë së FA-ve, të tilla si roli i komandantit, përqendrimi i forcës, rëndësia dhe roli i rezervës, ekonomizimi i forcave, përmbytja e strategjisë, arti dhe shkenca ushtarake, marrëdhëniet civilo-ushtarake, etj. Kjo tematikë është analizuar e trajtuar ashtu si pasqyrohet në doktrinën ushtarake të Forcave tona të Armatosura dhe në ato të Aleancës.

Në vijim, rubrika e dytë sjell shkrime të stafit akademik të AFA, në trajtimin e temave që kanë të bëjnë me drejtimin e planifikimin e kohës, punën kërkimore dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë evropian.

AFA qëndron në pararojë të institucioneve të arsimit ushtarak për përgatitjen dhe arsimimin e kuadrit oficer, për të qenë të aftë për t'iu përgjigjur dhe për të përballuar sfidat e shumta me të cilat po përballen Forcat tona të Armatosura.

Rruga 55-vjeçare e Akademisë së Forcave të Armatosura, arritjet dhe vizioni për të ardhmen

Kolonel Dr. Agim Q. Sula,
Komandant/Rektor i Akademisë së Forcave të Armatosura

Gjeneralmajor ® Prof. Dr. Ruzhdi Gjatoja,
Pedagog në Departamentin e Strategjisë dhe Historisë

Kolonel ® Selim Shiroka,
Pedagog në Departamentin e Operacioneve

Trajtesë e shkurtuar. *Ndonëse ideja për krijimin e një Akademie Ushtarake ndeshet që në vitin 1936, është 10 Maji i vitit 1958 që shënon krijimin e të parit Institucion të Lartë Arsimor të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ngritja e kësaj shkolle ishte kurorëzimi i shumë përpjekjeve, si dhe një dëshmi se tashmë në Shqipëri ishte krijuar baza për një mendim ushtarak të përparuar e cilësor. Është kuptimplotë fakti që ajo u krijua vetëm një vit pas Universitetit Shtetëror të Tiranës.*

Akademia, sot e emërtuar Akademia e Forcave të Armatosura, u krijua si një institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, me status të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Akademia është institucion i lartë mësimor–edukativ e shkencor, që shërben për kualifikimin e kuadrove të lartë të Forcave të Armatosura.

Një Akademi me moshë 55-vjeçare është vështirë të përfshihet brenda pak radhësh. Është kjo arsyeja që unë do të përmend vetëm disa ndër momentet kryesore të zhvillimit dhe veprimtarisë së saj.

Pas një pune përgatitore intensive, duke kombinuar përvojën ekzistuese me atë që u mor prej akademive ushtarake lindore nëpërmjet kualifikimeve të ndryshme, më 3 janar të vitit 1959 filloi kursi i parë mësimor 3-vjeçar. Programi 3-vjeçar, në të cilin viti i parë ishte përgatitor, vazhdoi deri në 12 Janar 1966, dhe me VKM nr. 5, filloi aplikimi i programit 2-vjeçar, i cili i jepte më shumë rëndësi përgatitjes profesionale.

Gjatë viteve 70-të, Akademia njehtë përmasa të reja zhvillimi në pikëpamje sasiore dhe cilësore. Krahas përmirësimeve strukturore të procesit e të programeve mësimore, rritet edhe cilësia e dhënies dhe e kontrollit të dijeve, nëpërmjet kualifikimit të

pedagogëve, si dhe e kritereve të pranimit të kontingjenteve të oficerëve në këtë shkollë. Tashmë, në programet mësimore përfshihen tema të reja të nivelit të Brigadës, të gërshetuara këto me stërvitje shtabi e komando-shtabi, në klasë e terren, si dhe me pjesëmarrjen në stërvitje me trupa.

Në vitet 70-të, Akademia pësoi transformime të mëtejshme cilësore në organizim dhe në përmbajtje, gjë që u pasqyrua në rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe sidomos, në forcimin profesional të akademistëve. Në të vërtetë, që në këto vite u bënë përpjekje të ndjeshme për t'i dhënë një natyrë tipike prej oficeri drejtues akademistëve gjitharmësh, ku përfshiheshin dhe oficerë të Flotës Luftarake Detare, të Aviacionit dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Por kjo dukuri do të fitonte prirje të dukshme parësore në vitet 90-të.

Gjatë rrugës së saj të rritjes, përveç misionit të përgatitjes së oficerëve për të gjitha nivelet e shtabit, drejtimit e të komandimit, Akademia arriti që gradualisht të shndërrohet edhe në një institucion të mirëfilltë kërkimor-shkencor.

Ndonëse angazhimi i Akademisë në punën shkencore ka qenë i hershëm, trajtën më të organizuar e mori pas vitit 1975, kur u krijua dega shkencore e saj. Në vitet 80-të, mbi këtë bazë, u krijua Sektori i Studimeve Shkencore. Rezultatet e punës kërkimore e shkencore të Akademisë pasqyrohen në morinë e punimeve dhe leksioneve të ndryshme, në fusha të ndryshme të Artit e të Historisë Ushtarake. Gjithashtu, efektet e angazhimit shkencor të personelit të Akademisë janë ndjerë nga e gjithë ushtria, nëpërmjet rregulloreve, manualeve, doktrinave, fjalorëve të terminologjisë dhe të enciklopedisë ushtarake e shumë materialeve të tjera, në hartimin e të cilave, Akademia është angazhuar vazhdimisht.

Tregues tjetër i aktivitetit shkencor të Akademisë është dhe angazhimi i hallkave të caktuara të saj në udhëheqjen dhe vlerësimin e mjaft temave studimore, dhënia mbi këtë bazë e shumë gradave shkencore pedagogëve e punonjësve shkencorë të kësaj Akademie dhe kuadrove të njësisve e reparteve të ushtrisë.

Fakti që deri më sot janë mbi 6 mijë kuadro ushtarak që janë kualifikuar, tregon për punën e madhe që kanë bërë pedagogët dhe gjithë drejtuesit në Akademinë e Mbrojtjes. Akademia e Mbrojtjes, e cila, prej tetorit të vitit 1973 ka marrë të drejtën e dhënies së gradave shkencore, ka graduar deri më sot 147 ushtarakë e civilë me grada shkencore. Këtu fjala është për gradat dhe titujt “Doktor i Shkencave”, “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”.

Tranzicioni në shoqërinë shqiptare dhe ndikimi në arsimin ushtarak

Ndryshimet e sistemit politik të viteve 90-të nxorën më mirë në pah natyrën e një mjedisi të ri për sigurinë globale. Kjo frymë e vështrimit të së ardhmes Evropiane të Shqipërisë u reflektua natyrshëm edhe në konceptin e sigurisë, mbrojtjes dhe rolit të Forcave të Armatosura Shqiptare. Vendi ynë ishte nga të parët që shpalli si qëllim strategjik integrimin në strukturat Euroatlantike. Patjetër që kjo frymë do të ndikonte natyrshëm në sistemin arsimor ushtarak në përgjithësi dhe në institucionin e Akademisë së Forcave të Armatosura në veçanti, e cila përfaqëson nivelin më të lartë të tij.

Në përpjekje për t'iu përgjigjur ndryshimeve transformuese që po përjetonte gjithë

vendi, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm ndërmorën një nismë reformuese edhe për sistemin ushtarak. Në këtë kuadër, ata vendosën të ndërpresin kursin institucional 2-vjeçar që ishte zhvilluar deri në vitin 1993, për përgatitjen e oficerëve madhorë dhe oficerëve të shtabit. Në vitet që pasuan, Forcat e Armatosura dhe institucionet arsimore ishin pjesë aktive e nismës për PFP dhe detyrimeve transformuese që rridhnin nga planet për anëtarësim në NATO e BE. Në këtë kuadër, Akademia e Forcave të Armatosura nisi kontakte të shumta me institucionet homologe të vendeve të NATO-s e atyre partnere. Po kështu, trupa pedagogjike e drejtuese filloi të merrte prurjet e para nga trajnimet e kurset që iu ofruan oficerëve të Forcave të Armatosura në disa vende të NATO-s. Këto përpjekje u reflektuan në Akademinë e Forcave të Armatosura me hapjen e disa kurseve të reja me programe të ndryshuara. Këtu mund të veçohen hapja e Kolegjit të Mbrojtjes në vitin 1995, sipas modelit të Qendrës *Marshall* dhe e Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit, sipas modelit gjerman të arsimimit të oficerëve të shtabit. Ndërsa në vitin 1998, gjithnjë në përpjekje për të përshtatur modelin gjerman, më konkretisht atë të Akademisë së Drejtimit në Hamburg, Akademia filloi Kursin e ri të Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm, që do të përgatiste udhëheqësit ushtarakë madhorë. Këto ishin arritje për t'u përshëndetur dhe mjaft të rëndësishme për transformimet që do të sillnin në sistemin e arsimit të lartë ushtarak shqiptar.

Akademia e Forcave të Armatosura është institucioni më i lartë arsimor ushtarak dhe shkencor për Forcat e Armatosura, ku bëhet kualifikimi i gjithë personelit ushtarak, por edhe civil për fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Kolegji Rajonal (KLSM-R), që u hap për herë të parë në vitin 2007, ishte ndërkohë edhe një simbolikë kuptimplote në kuadrin e integritimit në NATO. Siç dihet, në këtë kolegji, përveç ushtarakëve e drejtuesve civil shqiptarë, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues ushtarak nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Italia, Greqia, Turqia, Serbia etj.

Marrja e ftesës për anëtarësim dhe më vonë, anëtarësimi në NATO, ishte dhe është një detyrim i madh për të gjithë ne, ushtarakët e Forcave të Armatosura Shqiptare. Ne, së pari duhet të kemi koncepte të njëjta në çdo fushë, njëlloj si kolegët tanë perëndimorë, me të cilët bashkëveprojmë dhe marrim pjesë në misione të përbashkëta. Është detyrë e arsimit ushtarak, profesion që zhvillohet në Akademinë e Forcave të Armatosura, të trajtojë konceptet, doktrinën dhe standardet përkatëse, për të përgatitur ushtarakë që të jenë të aftë të ndërveprojnë me ushtritë e tjera anëtare të NATO-s, në çdo nivel.

Kalimi nga një program 2-vjeçar, në sistemin "1+1" (përkatësisht, Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursi i Lartë i Oficerit) kërkoi një punë të kujdesshme dhe voluminoze për përgatitjen e programeve të reja arsimore. Ato u ndanë veç për Kursin e Komandës e Shtabit të Përgjithshëm dhe veç për Kursin e Lartë të Oficerit (KKSHP u çel për herë të parë në vitin 2006-2007 dhe KLO 2009-2010).

Disa piketa kryesore për Akademinë e Forcave të Armatosura për të ardhmen ***Epoka e integritimit***

Mjedisi i sigurisë në Evropë dhe Rajonin e Ballkanit ka ndryshuar thuajse në mënyrë

radikale. Vendi ynë është anëtar i Aleancës së Atlantikut të Veriut, NATO, dhe rajonit i është shtuar Republika e Kosovës si një shtet i ri. Shqipëria dhe Forcat e Armatosura po i përgjigjen këtij realiteti të ndryshuar rrënjësisht me politika e strategji të reja, për të shpejtuar bashkimin e plotë me familjen e madhe Evropiane. Këto strategji të reja kërkojnë përgjigje kompetente nga arsimit ushtarak në tërësi dhe Akademia e Forcave të Armatosura në veçanti, që ka për detyrë të përgatisë udhëheqësit ushtarak të së nesërme. Është pikërisht koha që të shtrojmë pyetjet:

Çfarë lloj oficeri, në përgjithësi, dhe oficeri madhor, në veçanti, u duhet Forcave tona të Armatosura dhe vendit, për të drejtuar në këtë mjedis të ri, dhe për më tepër, si pjesëtare e NATO-s? Fatmirësisht, tiparet e domosdoshme të trupës së oficerëve në një shtet demokratik, në veçanti të atyre madhorë, janë zgjidhur ndërkaq prej kohësh nga vendet e NATO-s, aleatët tanë. Ecja në një kah me zhvillimet që ndodhin në këto vende të Aleancës është detyrë dhe aspiratë e jona e kahershme. Të ecësh në një hap me ta, në analizë të fundit, do të thotë të ndash të paktën të njëjtën filozofi arsimimi për oficerët madhorë të shtabit.

Forcat e Armatosura Shqiptare, si një pasqyrë e shoqërisë shqiptare dhe proceseve reformuese politike që kalon vendi, kanë nevojë për udhëheqës ushtarak që kuptojnë marrëdhëniet e qeverisjes demokratike nga njëra anë dhe sigurinë e stabilitetin kombëtar nga ana tjetër. Akademia e Forcave të Armatosura, si përgjegjëse për arsimimin e udhëheqësve të lartë ushtarak, duhet të synojë përshtatjen e një filozofie arsimimi që rrënjos shprehitë e të menduarit për çështjet e sigurisë, në kuptimin e strategjisë. Ajo duhet të nxitë studentët që të vlerësojnë me kujdes dinamikën e mjedisit të sotëm të sigurisë, duke vënë në punë mjete dhe teknika të mendimit kritik, aq të domosdoshme për një udhëheqës të nivelit të lartë ushtarak.

Një thënie e hershme dhe e njohur thekson: “Dija është fuqi”, por për të qenë e tillë, në radhë të parë duhet të ekzistojë fuqia për të arritur dijen, domethënë duhet të ekzistojë vullneti individual dhe institucional, duhet të krijohen kushtet dhe mbështetja gjithëpërfshirëse institucionale për të fituar dije dhe për ta përdorur atë si fuqi.

Është e qartë se arsimit është një komponent kritik për menaxhimin dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve në çdo organizëm dhe fushë veprimi. Ndërsa mjedisi dhe kërkesat që shtrohen ndryshojnë, ushtarakët duhet të mësojnë fakte dhe rrugë të reja dhe, ndoshta më e rëndësishmja, mënyra të reja mendimi, të cilat do t'i ndihmojnë ata të përgatiten për të përballuar sfidat e ndryshimeve të shpejta dhe të vazhdueshme.

Ndërsa bota po kalon me shpejtësi drejt një të ardhmeje që karakterizohet nga pasiguri të mëdha, aftësia e ushtarakëve për të menduar në mënyrë novatore, për të zbatuar aftësitë e mendimit kritik dhe njohuritë e fituara përbën një nga faktorët më të rëndësishëm për rritjen e kapacitetit të forcave. Kjo merr rëndësi sidomos në kushtet e sotme të buxheteve të kufizuara, të përdorimit të fuqisë së butë dhe të konceptit “*Smart Defense*”.

Në qoftë se forcat tona ushtarake nuk kuptojnë drejt natyrën e mjedisit kombëtar të sigurisë, si dhe çështjet themelore dhe implikimet e prireje kryesore të këtij mjedisi dhe të fushës së luftës, pasojat mund të jenë të rënda. Në nivel individual një moskuptim i tillë ka të bëjë me jetën e individëve, ndërsa në nivel kombëtar ka të bëjë me vetë mbijetesën kombëtare.

Sfida e arsimimit profesional ushtarak është të shohë vetveten nga pikëpamja e së ardhmes dhe të përcaktojë si të plotësojë kërkesat, të cilat mund të mos jenë akoma të përcaktuara qartë.

Edukimi profesional ushtarak është shumë më tepër se transmetimi i fakteve; ai ka të bëjë me zhvillimin e aftësive analitike, mendimit kritik dhe gjykimit

Përqasja pedagogjike tradicionale mund të mos jetë më e vlefshme për edukimin profesional ushtarak, ashtu si edhe për çdo formë tjetër të arsimimit të lartë. Metoda që përqendrohet te mësuesi dhe mësimdhënia, domethënë që karakterizohet nga transmetimi relativisht pasiv i informacionit në formë leksioni, duhet të zhvendoset drejt metodës që përqendrohet te studenti dhe mësimnxënia. Pra, ky është një proces, në të cilin informacioni shkëmbehet në një dialog të dyanshëm midis kërkuesve dhe studiuesve. Arsimimi duhet të evoluojë nga ky transmetim dhe absorbim pasiv i informacionit drejt angazhimit aktiv në zhvillimin e njohurive, nga mësimi në klasë te shkrirja reale e teorisë me praktikën, nga tekstet dhe orientimet gojore në paraqitjen e ideve dhe mendimeve të larmishme, nga mësimi si një akt individual i izoluar në një akt ndërveprues në kontekstin e ideve të tjera.

Institucionet e arsimimit profesional ushtarak janë vendi kryesor ku njerëzit mund të sfidojnë praktikat dhe teoritë e pranuar, pa dëmtuar veprimtaritë e përditshme. Këto institucione duhet të jenë vatra të mendimit të pavarur ku të përpunohen ide të tilla dhe të vihen në shërbim të ushtrisë. Kurrikula ndërdisiplinore, liria akademike për trupën pedagogjike dhe marrja në konsideratë e një sërë idesh nga burime të ndryshme intelektuale duhet të karakterizojnë arsimimin profesional ushtarak, në mënyrë që të sigurohet edukimi i nevojshëm për përballjen me sfidat e ndryshimit.

Edukimi formal është një kontribut i rëndësishëm për zhvillimin e cilësive dhe attributeve të lidërsipit, që janë themelore për zhvillimin e profesionit ushtarak.

Edukimi, i cili përfshin studimet akademike ushtarake dhe civile, siguron një tërësi njohurish, që kur kombinohen me përvojën personale dhe profesionale krijojnë një mjedis që mbështet dhe inkurajon potencialet drejtuese ushtarake.

Akademia duhet të konsiderohet si një laborator ku njerëzit mësojnë nga përvojat dhe rezultatet e të tjerëve. Kjo është një thënie e vjetër që, në qoftë se nuk i kushtohet vëmendje e duhur, përbën paralajmërim për dështim. Kjo është e rëndësishme sidomos për profesionistët dhe drejtuesit ushtarak.

Përfundime

Në qendër të filozofisë së arsimimit në Akademinë e Forcave të Armatosura do të jetë motoja që vendos theksin e mësimi tek mënyra se “si të mendosh dhe jo çfarë të mendosh”.

Akademia e Forcave të Armatosura do të synojë në vendosjen dhe përforcimin e standardeve më të larta akademike, duke e vënë theksin: te vlerësimi i studentëve sipas shembujve më të mirë të institucioneve të ngjashme pasuniversitare; te përpjekjet për dhënien e gradave shkencore të shoqëruara e reflektuara në programet tona institucionale, ku do të spikatë grada shkencore “Master”; te liria akademike; te lufta pa kompromis kundër plagjiaturës, e reflektuar në sistemin e vlerësimit.

Konceptimi dhe ndarja më e qartë e niveleve të kurseve në Akademinë e Forcave të Armatosura, duke mbajtur parasysh faktin se në disa institucione homologe në Vendet e Aleancës, ato qëndrojnë si institucione të mirëfillta më vete. Në këtë logjikë do të reflektojnë edhe programet, struktura mësimore dhe ajo mbështetëse, si dhe metodat dhe standardet e vlerësimit. Theksi do të vihet në marrëdhëniet e reja mes pedagogut dhe studentit. Kjo e fundit pasqyrohet edhe në metodologjinë e mësimdhënies dhe të përgatitjes së materialeve mësimore. Hapja e Akademisë së Forcave të Armatosura ndaj shoqërisë shqiptare në përgjithësi dhe institucioneve që lidhen drejtpërsëdrejti me sektorin e sigurisë në veçanti, duke përfshirë nëpunës civilë të administratës së këtyre të fundit në kurset tona institucionale, është një kërkesë që bën të nevojshme edhe “hapjen” dhe deklasifikimin e programeve, si dhe përmirësimin rrënjësor të tyre, duke ngjasuar gjithnjë e më tepër me institucionet simotra të vendeve të NATO-s.

Shfrytëzimi dhe diskutimi mbi literaturën e rekomanduar për temat që zhvillohen në kurset tona lidhet ngushtë edhe me përdorimin e gjuhëve të huaja (kryesisht asaj angleze). Në këtë aspekt është e domosdoshme të kuptohet mirë fakti që jetojmë në kohën e internetit, ku prodhuesit më të fuqishëm të informacionit që lidhet me fushat tona përdorin kryesisht gjuhën angleze. Në të njëjtën kohë, kjo është gjuha operacionale e NATO-s, ku sot e në vazhdim do të jemi pjesë integrale dhe kontribuese.

Një fushë tjetër e rëndësishme që do të përbëjë prioritet në zhvillimet e ardhme të Akademisë së Mbrojtjes do të jetë dhe bashkëpunimi institucional me institucionet e tjera të ngjashme, brenda dhe jashtë vendit, duke shkëmbyer ekspertizën në fushën e ndërtimit të programeve, të lektorëve, të moderatorëve, të metodave të mësimdhënies, të literaturës apo të shkëmbimit të studentëve.

Në ndjekje të prioriteteve të mësipërme, programet tona akademike do të vazhdojnë të përmirësojnë dhe saktësojnë ndërtimin e modeleve dhe do të përfshijnë një fushë të gjerë temash, lidhur me sfidat e reja ndaj sigurisë kombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Ato duhet të ndjekin rrugën e kurseve të ngjashme që zhvillohen nga institucione të mirënjohura e të sprovuara në këtë fushë studimesh dhe do të ndajnë me ta, së paku, të njëjtën përjasje përsa i takon filozofisë së arsimimit.

Programet tona do të bazohen në modelin e studimeve pasuniversitare si një arsimim për të rriturit, duke u mbështetur kryesisht tek modeli i të mësuarit në seminar. Me përkushtim ndaj parimeve të rëndësishme, si: liria akademike dhe politika e mosreferimit, Institucioni i Akademisë së Forcave të Armatosura do të inkurajojë fort krijimtarinë, novacionin, eksperimentimin, rritjen intelektuale dhe jokonformizmin si në teori, ashtu edhe në praktikë.

“Produkti” përfundimtar i Kurseve në Akademinë e Mbrojtjes, e veçanërisht i atyre të larta, duhet të jetë drejtuesi i ardhshëm ushtarak apo civil që do të mund të mendojë jo vetëm në mënyrë realiste, por edhe në mënyrë kritike dhe origjinale, me një imagjinatë e një kërkësi të ushqyer nga një periudhë e gjatë leximi, kërkimi e shkrimi.

Me rastin e 55-vjetorit të Akademisë së Mbrojtjes, bazuar në gjithë punën që është bërë ndër vite, dua të bëj një homazh për gjithë ish-komandantët e ish-pedagogët që nuk jetojnë më. Po ashtu dua të shpreh respekt e mirënjohje për gjithë ish-komandantët

e ish-pedagogët që janë në lirim apo pension, të cilët janë pjesë e veprimtarisë 55-vjeçare të kësaj Akademie, ku ata kanë kontributin e tyre të padiskutueshëm për emrin e madh që ka Akademia si institucioni më i lartë i arsimimit ushtarak shqiptar. Me këtë rast dua të përshëndes dhe të gjithë stafin pedagogjik të Akademisë së Forcave të Armatosura, duke ju uruar atyre efektivitet dhe efikasitet më të lartë në përgatitjen e drejtuesve ushtarak, për arritjen e objektivave që përcaktohen nga Strategjia e Sigurisë Kombëtare dhe ajo ushtarake, në interes të plotësimit të misionit kushtetues të Forcave të Armatosura.

Mendimi i Klauzeviçit për rolin dhe karakteristikat e komandantit

Nënkolonel Behar Mara,
Kursant KLO

Nënkolonel MSc. Enrik Ago,
Pedagog i DO, AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Lideri, lidershipi, drejtuesi ushtarak dhe drejtimi në tërësi ka më shumë se një shekull që mbeten problemi dhe linja e hapur e studimeve. Përpara nesh nuk ka dhe nuk mund të ketë përcaktime përfundimtare, në lidhje me udhëheqësin e përsosur dhe tipin e drejtuesit ushtarak të pakontestueshëm. Drejtuesi mbetet objekt studimi në etapa të ndryshme të zhvillimit, në lidhje me hapësirën e fushëveprimit, kohën në ndryshim, hapësirën e operacionalitetit asimetrik të luftës. “Që të jesh komandant i çfarëdo lloj grade,- thoshte Montgomeri-së pari duhet të kesh cilësitë e udhëheqësit: për ta duhet të jetë karakteristike iniciativa; ata duhet të kenë një karakter të fortë dhe një aftësi për t’i afruar sa më tepër marrëdhëniet e tyre me vartësit “¹.*

Nga drejtuesit sot kërkohet që të krijojnë një kulturë pune dhe stërvitjeje me standarde, të cilat mbeten si gurë kilometrikë në rrugën e integritit, të përballjes me sfidat, rreziqet dhe frikën e së nesërme. Kjo vjen në një pikë takimi me atë që thoshte Epikuri se, “të diturit është një mjet që të bën të mposhtësh frikën dhe të krijosh një ekuilibër shpirtëror”. Dituria e drejtuesit ushtarak nuk është e dhënë njëherë e përgjithmonë dhe as mund të jetë nga “mendja e karriges”. Vetëm leximi universal dhe, veçanërisht ai profesional, e mban drejtuesin aktiv e veprues, sepse, siç thoshte filozofi i shquar francez Didëro, “njerëzit kur pushojnë së lexuari, pushojnë së menduari”.

Është mjaft domethënëse për drejtuesin këshilla e Xhorxh Uashingtonit: “Puno të mbash gjallë në shpirtin tënd atë shkëndijë të vogël të zjarrit, që quhet ndërgjegje”. Drejtuesi nuk mund të konceptohet pa profesionalizmin, pa aftësinë, përgjegjësinë dhe angazhimin. Duke studiuar me vëmendje karakteristikat e një lideri ushtarak, do të citoja një thënie të Karl von Klauzeviç, në veprën e tij “Mbi luftën”; “Karakterit tregon ruajtjen e bindjeve me këmbëngulje, pavarësisht

¹ Bernard Montgomeri, “Fushëbeteja” (kujttime), Tiranë, 1994, f. 69.

nëse mbështeten mbi parime, opinione, frymëzime të përkohëshme. Ky qëndrim nuk mund të vërtetohet kur vetë bindjet ndryshojnë shpesh, ndryshime të cilat nuk iu detyrohen patjetër ndikimeve të jashtme. Ato mund të jenë përfundimi i veprimtarisë së pandërprerë të mendjes sonë, gjë që, pa dyshim, tregon një paqëndrueshmëri të veçantë të saj. Është e qartë se një njeri që ndryshon mendim në çdo çast, nuk mund të merret për një njeri me karakter edhe në qoftë se shkaqet e këtyre ndryshimeve gjenden brënda tij”².

Disa nga karakteristikat dhe cilësitë e një komandanti, sipas Klauzeviçit

Po të hedhim një vështrim të përgjithshëm mbi elementet që përbëjnë atmosferën e luftës, si: rreziku, lodhja fizike, pasiguria dhe rastësia, kuptohet me lehtësi se duhet një forcë e madhe morale dhe fizike për të ecur përpara, me një garanci dhe siguri në këto elemente kaq të vështirë, në atë që përbëjnë mjegullën e pafund të luftës. Sipas Klauzeviçit, kjo forcë, sipas ndryshimeve të shkaktuara nga rrethanat, cilësohet nga udhëheqësit ushtarakë me emrat: energji, qëndresë, këmbëngulje, forcë karakteri dhe forcë shpirtërore.

Duke personifikuar rolin e komandantit me atë të një “gjeniu”, është e vështirë të dallohet se ku është thelbi i tij, por duke u mbështetur në kuptimin e zakonshëm, fjala “gjeni” tregon një aftësi shpirtërore të madhe në disa degë të veprimtarisë njerëzore, ku çdo drejtues apo komandant duhet të udhëhiqet në procesin e tij të komandimit.

Në këtë koncept ne do të tregojmë kombinimin e aftësive shpirtërore me veprimtarinë ushtarake, që, së bashku, përbëjnë thelbin e “gjenit” dhe tërësinë e cilësive, prej të cilave duhet të udhëhiqet një komandant operacional, gjatë kryerjes së detyrave.

Gjeniu i luftës, sipas tij, shfaqet jo në një cilësi të vetme luftarake siç është guximi, por edhe në aftësi mendore dhe shpirtërore të cilat përbëjnë një kombinim të harmonishëm ku mund të mbizotërojë njëra ose tjetra.

Te një popull luftarak dalin shumë më tepër individë luftarakë sesa te një popull i qytetëruar, sepse tek i pari, të gjithë luftëtarët janë të pajisur me këtë frymë, ndërsa tek i dyti, ata shkojnë në luftë nga nevoja dhe jo nga nxitja e brendshme. Popujt me një nivel qytetërimi më të lartë mund të japin gjenitë më të shkëlqyer të luftës, si për shembull romakët dhe francezët.

Duke u nisur nga rëndësia që ka niveli i përgjithshëm intelektual i gjenit të madh të luftës dhe studimi i virtyteve si cilësi të rëndësishme të luftëtarit, guximi është një virtyt shumë i rëndësishëm e i dyllorshëm:

- Guxim fizik para rrezikut personal, ndaj eprorit ose ndërgjegjes tënde.
- Guximi kundrejt rrezikut personal si një cilësi e përhershme që mund të dalë në pah nga shkaqe pozitive si ambicia, atdhetarizmi, entuziazmi i të gjitha llojeve.

Kombinimi i të dy llojeve shpreh shkallën më të lartë të guximit.

² Karl von Clausevic, “ Mbi Luftën” vëll. I -rë , fq-124.

Lufta është plot me rreziqe, lodhje dhe vuajtje fizike, prandaj njeriu, për t'i përballuar ato, duhet të ketë forcë fizike dhe shpirtërore. “Lufta është bota e pasigurisë dhe, nga të gjithë elementët mbi të cilët mbështeten veprimet, vendin e parë e zë forca mendore”³. Për të dalë fitimtarë në luftë kundër të gjitha dukurive të paparashikuara, udhëheqësi ushtarak duhet të ketë dy cilësi:

Së pari, të ketë një mendje të tillë që, edhe në mes të errësirës së madhe që e rrethon, të ruajë një dritë të brendshme të mjaftueshme për ta çuar drejt së vërtetës .

Së dyti, të ketë guximin për ta ndjekur këtë dritë të dobët. Shumë profesorë të artit të luftës i kanë dhënë rëndësi hapësirës dhe kohës, duke dhënë konceptin e një vendimi të shpejtë dhe të frytshëm. Zgjuarsia duhet të mbajë ndjenjën e guximit dhe ta udhëheqë atë në çaste shumë të vështira, kur njeriu iu bindet më shumë ndjenjave se mendimeve të tij.

“Guximi dhe zgjuarsia janë dy cilësi të cilat nuk shkrihen së bashku për të krijuar cilësinë e tretë, “vendosmërinë”, e cila sundon mbi çdo frikë tjetër në shpirtin e njeriut”⁴. Vendosmëria i detyrohet një drejtimi të veçantë të zgjuarsisë, drejtim që i përket më shumë mendjeve të forta, sesa atyre që shkëlqejnë. Kur flasim për vendosmërinë si një drejtim i veçantë i zgjuarsisë, e cila iu përket më shumë mendjeve të forta, nuk rrimë dot pa përmendur gatishmërinë si një cilësi që luan një rol të rëndësishëm për të dalë fitimtarë mbi të papriturat.

Po të shohim elementet që përbëjnë atmosferën e luftës si: pasiguria, rreziku, lodhja mendore e fizike, si dhe rastësia kuptohet lehtë se duhet një forcë e madhe morale dhe fizike për të ecur përpara, duke i cilësuar ato me emrat: qëndresë, energji, këmbëngulje, forcë karakteri dhe forcë shpirtërore.

Të gjitha ndjenjat e mëdha që mbushin zemrën e njeriut në zjarrin e luftës nuk janë më të fuqishme se aspirata për nder e lavdi.

Lind pyetja a ka patur udhëheqës të mëdhenj ushtarakë pa ambicie?

Ndjenja për të kryer vepra më të mëdha se shokët është kusht i domosdoshëm për një udhëheqës, nëse ai do të arrijë në këtë pozicion, përfundime të mëdha.

Me termin qëndresë shprehet vullneti për t'i rezistuar fuqisë së një goditjeje të vetmuar, ndërsa këmbëngulja lidhet me sasinë e kohës së zgjatjes së qëndresës.

Qëndresa e armikut ka një efekt të drejtpërdrejtë mbi komandantin, për arsye të humbjes së mjeteve që shkakton një qëndresë e zgjatur dhe përgjegjësisë që rrjedh nga kjo. Këtu fillojnë mendimet e para plot shqetësim, që nisin të vënë në provë, për herë të parë, vullnetin e tij. Megjithëse të dy termat janë shumë të përafërt me njëri-tjetrin, këmbëngulja kërkon më shumë përkrahjen e arsyes sepse, sa më shumë të zgjatet një veprim, ajo bëhet më sistematike dhe del në pah forca e saj.

Karakterit vetjak i zgjuarsisë së udhëheqësit, si dhe veçoritë e botës së tij shpirtërore ushtrojnë një ndikim të madh, në një mendje të ftohtë dhe të fuqishme.

³ Karl von Klauzeviç, *Ibid*, fq-107.

⁴ *Ibid.*, fq-111.

Forca e karakterit është aftësia për t'ju nënshtruar kontrollit të mendjes, edhe gjatë emocioneve më të forta. Pra mund të themi se “karakteri i fortë është ai që ruan ekuilibrin edhe gjatë emocioneve më të fuqishme”⁵. Përsa i përket ndikimit të fitores mbi ngjarjet e mëtejshme të luftës, kjo varet pjesërisht nga karakteri dhe talenti i prijësit ushtarak fitimtar, për më tepër, nga rrethanat që i kanë dhënë jetë fitores, si dhe nga ato që do të mund të krijojë vetë fitorja.

Forca e karakterit kthehet në kokëfortësi atëherë kur qëndresa ndaj pikëpamjeve të jashtme nuk vjen nga një bindje më e mirë dhe as nga besimi tek një parim më i lartë por nga një ndjenjë kundërshtimi.

Aftësia për të zotëruar veten është një ndjenjë e re që vendos ekuilibrin dhe siguron mbisundimin e arsyes. Kjo nuk është gjë tjetër veçse ndjenja e dinjitetit njerëzor, sedra më fisnike për të vepruar në çdo rrethanë si një qenie e pajisur me mend dhe arsye.

Mund të themi se njerëzit me temperament të ekuilibruar ndihmojnë forcën e karakterit dhe njerëzit me forcë të madhe morale kanë përgjithësisht karakter të fortë. “Shpirti i fortë nuk i përket atij që vetëm është në gjendje të përballojë emocione të forta, por edhe atij që ruan ekuilibrin gjatë tyre, në mënyrë që, megjithë furtunën që shpërthen në zemrën e tij, aftësia e gjykimit dhe bindjet e tij të ruajnë tërë hollësitë e tyre, si gjilpëra e një busulle në anijen e rrahur nga valët e detit në shtrëngatë”⁶. Pra, kjo thënie, mjaft domethënëse personifikon atë që, një komandant në luftë nuk duhet të lëkundet nga asnjë e papritur dhe rrethanë, por ai me mendje të mprehtë, me gjakftohtësi dhe intuitë, me guxim dhe trimëri të drejtojë këtë anije që mos të mbytet dhe të marrë vendimet e duhura për të kapërcyer çdo dallgë që i del përpara.

Forca morale kryesore është talenti i drejtuesit, virtytet luftarake të ushtrisë dhe ndjenja e saj kombëtare. Asnjëri nga këto tre elemente nuk mund të merret dhe të shqyrtohet veç nga të tjerët. Por talenti i udhëheqësit gjen fushë më të madhe veprimi në komandimin dhe drejtimin e trupave gjatë zhvillimit të betejave.

Pasi trajtuam cilësitë e udhëheqësit të madh ushtarak që rrjedhin nga vetitë e kombinuara të zgjuarsisë dhe temperamentit, trajtojmë tani një karakteristikë, e cila kërkon vetëm aftësi shpirtërore, pa hyrë në veprim cilësitë e temperamentit.

Kjo është intuita e lidhjes që ekziston ndërmjet luftës dhe terrenit, e cila është e përhershme dhe mund të shprehet si një veprim luftarak i kryer nga një ushtri e organizuar, në një hapësirë të përcaktuar. Për të kapërcyer vështirësitë e terrenit, duhet një veti mendore e veçantë e cila shprehet në “aftësi për t'u orientuar”, pra është fjala për një veprim të imagjinatës.

“Aftësia për të konceptuar me shpejtësi formën gjeometrike dhe të saktë të cilitdo terren dhe, si rrjedhim, të të menduarit lehtësisht gjatë veprimeve”⁷. Është e vërtetë se perceptimi i shpejtë dhe i qartë i aspekteve të terrenit është talent që i jep veprimin të tij lehtësi dhe siguri më të madhe, duke e çliruar nga disa pendesa të brendshme e

⁵ Karl von Klauzeviç, *Ibid.*, fq. 119.

⁶ Karl von Klauzeviç, *Ibid.*, fq. 123.

⁷ Karl von Klauzeviç, *Ibid.*, fq. 129.

duke e bërë më të pavarur. Historia dhe mendimi i brezave të mëvonshëm cilësojnë gjeni të vërtetë vetëm njerëzit që kanë shkëlqyer si kryekomandantë, pasi posti i tyre i lartë kërkon shumë më tepër cilësi morale dhe intelektuale.

Ajo që kërkohet është aftësia e sintezës dhe e gjykimit të lartë në nivelin e një shqyrtimi të mendjes. Kjo punë e lartë e mendjes, ky vizion prej gjeniu nuk do të jepte rezultatet e dëshiruara, pa plotësuar cilësitë e temperamentit dhe të karakterit që trajtuam më lart. Për të konkretizuar këto veti që thamë më lart, po japim disa shembuj: “Napoleoni ka thënë se shumë vendime që duhet t’i marrë udhëheqësi ushtarak, mund të përbënin problem matematike, zgjidhja e të cilave do të ishte e denjë për energjinë mendore të një personi të tipit të Njutonit, ose të një Euleri”⁸. Mirëpo kjo punë e lartë e mendjes, ky vizion prej gjeniu nuk do ta arrinin qëllimin, në rast se nuk do të plotësoheshin nga cilësitë e temperamentit dhe karakterit për të cilat kemi folur më parë. Napoleoni, në betejën e Drezdenit, kishte 120.000 trupa kundër 220.000 trupave të aleatëve dhe i kishte shpëtuar jetën Filipit disa herë. Vetëm bindja është thelbi i drejtimit. E thënë ndryshe, po t’i referohemi Karl Fon Klauzeviçit: “Funksioni i parë i komandantit është të frymëzojë e të nxitë ushtarët për të bërë gjëra të vështira, në rrethana të vështira”. Është kjo arsyeja që teoricienë të shumtë ushtarakë e kanë cilësuar oficerin, “inxhinier të shpirtave njerëzorë”.

Drejtuesi i sheh vartësit si objektin dhe subjektin e punës së vet. Ai duhet të jetë pikësëpari i armatosur psikologjikisht dhe pedagogjikisht, për përpunimin shpirtëror e moral të trupës që komandon. Shpirti dhe ana morale nuk kanë kufij midis tyre dhe nuk mund të urdhërohen. Etja e drejtuesit për karrierë nuk mund të ngrihet duke shfrytëzuar vartësit, as punën e djersën, pse jo, edhe gjakun e tyre. Pa ndershmëri, pa bindje, pa personalitet, pa kërkesë, nuk mund të pretendojmë sukses në drejtim. Është mjaft domethënëse për drejtuesin këshilla e Xhorxh Uashingtonit “...Puno të mbash gjallë në shpirtin tënd atë shkëndijë të vogël të zjarrit, që quhet ndërgjegje”. Drejtuesi nuk mund të konceptohet pa profesionalizmin, aftësinë, përgjegjësinë dhe angazhimin. Komandantit nuk duhet t’i shteren kurrë forca fizike, guximi, qëndresa, fleksibiliteti dhe parimi i ndërmarrjes së rrezikut dhe përballjes me sfidat. Drejtuesi që drejton dhe depërton me forma e metoda shpirtërore e psikologjike, që di ta shplodhë e zbavitë trupën, që di të shpërblejë dhe justifikojë aktivitetin në funksion të qëllimit, sigurisht është dhe mund të konsiderohet i suksesshëm. Eksperiencat luftarake të betejave të mëdha të historisë kanë treguar se besimi te vartësit dhe të prirurit nga parimi, “secili përgjegjës në detyrën funksionale të tij, por përgjegjësia kryesore i takon komandantit”, është kyç i suksesit.

Refleksione të karakteristikave dhe cilësive të një komandanti

Karakteristikat dhe cilësitë e një lideri ushtarak të lartpërmendura, referuar librit të Klauzeviçit, “Mbi Luftën”, janë të pasqyruara gjerësisht në doktrinën tona ushtarake. Në Doktrinën ushtarake AJP-1, ku flitet mbi natyrën e komandimit në nivel operativ, shprehen qartë këto cilësi të komandantit:

⁸ Karl von Klauzeviç, *Ibid.*, fq.135-136.

Dimensioni personal i komandimit merr rëndësi të veçantë. Komandimi në nivelin operativ, ku rreziqet janë të mëdha, kërkon një kombinim të cilësive mendore, morale dhe fizike. Komandimi është tipar personal dhe, për rrethana të ndryshme, kërkohen tipa të ndryshëm komandantësh. Nuk ka një formulë unike apo kombinim të drejtë të cilësive të një komandanti. Sado të rëndësishme mund të jenë cilësitë personale të një komandanti, ai gjithmonë do të gjykohet për veprimet e tij. Prandaj është e rëndësishme që komandantët e nivelit strategjik të kenë alternativa kur ata zgjedhin komandantët e nivelit operativ për t'iu përshtatur rrethanave. Për të qenë efektiv, një komandant, në nivelin operativ, duhet të ketë të paktën besimin e eprorëve dhe të vartësve të tij, si dhe të partnerëve për të bërë detyrën. Në rrethana të tjera besimi, aftësia për të ndërtuar apo për të kontribuar në një koalicion të ndryshëm, mund të jetë më e rëndësishme. Ideale do të ishte një kombinim i besimit të tjerët dhe vetëbesimit.

Këto konsiderata të vështira mund të ndikojnë edhe në detyrat që një komandant i nivelit operativ i jep vartësve të tij dhe janë veçanërisht të ndjeshme në një kontekst shumëkombësh. Komandimi është një aktivitet njerëzor thelbësisht i fuqishëm, që përfshin *autoritetin, përgjegjësinë dhe llogaridhënien* personale. Filozofia e komandimit ka katër tipare: kuptimin e qartë të synimit të komandantit epror; përgjegjësinë e vartësve për të përmbushur atë synim; rëndësinë e marrjes së një vendimi në kohë dhe vendosmërinë e komandantit për të parë planin, nëpërmjet një përfundimi të suksesshëm. Kjo filozofi kërkon një stil komandimi që promovon komandimin e decentralizuar, lirinë dhe shpejtësinë e veprimit, si dhe iniciativën, por gjithsesi, një stil që mbetet përgjegjës para drejtuesve eprorë. Pra, janë këto cilësi të përmendura edhe nga Klauzeviç, siç janë cilësitë mendore, morale dhe fizike, iniciativa dhe vendosmëria e tij, që kanë të bëjnë në marrjen në kohë të vendimeve.

Një komandant, i cili përpigjet ta mundë me zgjuarsia kundërshtarin e tij, ka më shumë gjasa për të patur sukses në operacione, duke kujtuar gjithmonë se ai është duke kërkuar të befasojë dhe të hutojë kundërshtarin, jo komandën e vet. Përdorimi i imagjinatës dhe novacionit për t'u bërë i paparashikueshëm, mund të sjellë përfitime të mëdha, por kjo përqsasje është plotësisht e varur nga njohja e plotë e kundërshtarit. Komandanti duhet të jetë i qetë dhe i përmbajtur edhe kur situata është e turbullt dhe efektet janë në nivelin e tyre më të lartë. “Moral i lartë personal dhe një shpirt që triumfon përballë vështirësive janë cilësi me vlerë”⁹.

Aftësia për të menduar shpejt dhe për të marrë vendime të vështira është tregues i një komandanti të zotë, që mbështetet në aftësinë për t'u përqendruar në gjërat më thelbësore dhe në identifikimin, në kohën e duhur, të rrethanave dhe momentit që kërkon një vendim të ri. Edhe pse gjykimi kur duhet marrë një vendim i shpejtë është mjaft i rëndësishëm, po aq i rëndësishëm është edhe të kuptuarit kur nuk duhet marrë një vendim i tillë.

Përqsasja kërkon komandantë që përdorin iniciativën e që veprojnë me guxim, duke identifikuar dhe shfrytëzuar mundësitë që iu krijohen, ndërkohë që balancojnë fitoren e mundshme me rrezikun përkatës.

⁹ AJP-1 fq.110.

Menjëherë pas emërimit, fokusi i komandantit duhet të jetë, në çdo rast, në arritjen e objektivit të tij. “Në një situatë konfuze dhe shumë të ngarkuar, dëshira për të fituar kërkon vendosmëri dhe këmbëngulje; një aftësi për të çarë përmes vështirësive; një vullnet të fortë, por jo kokëfortësi”¹⁰. Sado të rëndësishme të jenë procedurat operacionale efikase, sado të qarta të jenë doktrinat, gjenerimi dhe nxitja e shpirtit luftarak mbeten themelore.

Po t’i referohemi doktrinës AJP-3-2, ku bëhet fjalë për rolin e komandantit e të cilësive të tij në procesin e drejtimit dhe komandimit, në të pasqyrohen këto karakteristika të një drejtuesi:

Një komandant ka ndikim të konsiderueshëm mbi gjendjen morale, sensin e drejtimit dhe performancën e shtabit të vet dhe të komandantëve vartës në sajë të autoritetit, personalitetit, udhëheqjes, stilit të komandimit dhe sjelljes së tij në përgjithësi”¹¹. Kjo gjen zbatim si në stërvitje edhe gjatë kryerjes së operacioneve. Prandaj, është përgjegjësi e komandantit të krijojë dhe të ruajë një klimë të efektshme brenda njësisë së tij. Komandimi i suksesshëm në mision varet nga një kulturë komandimi që nxit komandantët vartës, në të gjitha nivelet, të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe të veprojnë me nismë. Vartësit gjithashtu duhet të kuptojnë arsyen e vendimeve të eprorëve të tyre. Një komandant i mençur e vlerëson këtë. Prandaj ai duhet t’ua shpjegojë synimet e tij vartësve, me qëllim që të ushqejë një ndjenjë përfshirjeje në vendimmarrje dhe të zhvillojë angazhimin e përbashkët.

Komandimi në operacion. Një komandant duhet ta udhëheqë njësinë e vet për ta mundur armikun shpejt dhe me kosto minimale për forcat e veta, duke ruajtur ndërkohë gjendjen morale dhe mirëqenien materiale të trupave të veta. Kjo mund të ndodhë në një rast frike e pasigurie gjatë operacioneve. Kompleksiteti i operacioneve rrallë do të kërkojë vënien në jetë pikë për pikë të një plani të provuar me kujdes. Komandimi kërkon zbatimin e vendosur të doktrinës, të udhëhequr nga parimet e operacioneve të përbashkëta e shumëkombëshe aleate. Për të qenë i suksesshëm, një komandant duhet të jetë në gjendje, mbi të gjitha, të përcaktojë qëllimin dhe pastaj t’i përmbahet qëllimit të tij vendosmërisht, duke shfaqur ndërkohë elasticitet në qasjen për ta arritur atë. Funkzioni i një komandanti ndryshon bashkë me nivelin e komandimit dhe me përgjegjësinë e tij.

Në nivelet më të larta, komandantët më të vjetër ushtrojnë ‘komandim të lartë’ nëpërmjet komandantëve vartës. Në nivelet më të ulëta, komandantët më të rinj përfshihen kryesisht në udhëheqjen e drejtpërdrejtë të njerëzve në luftim. Ndërmjet këtyre 2 niveleve, komandantët vartës zbërthejnë synimet e tyre që janë në komandimin e lartë dhe komandojnë formacionet e repartet e tyre. Sa më i lartë të jetë rangi i një komandanti, aq më shumë përgjegjësi ka ai për organizimin, stërvitjen dhe ndarjen e burimeve brenda njësisë së vet. Kjo kërkon zhdërvjelltësi në planëzimin e forcës, në menaxhimin e burimeve dhe në përdorimin e teknologjisë për të arritur synimet operative. Komandantët më të vjetër duhet të dinë kur t’i përdorin njohuritë dhe përvojën e tyre drejtpërdrejt për një problem, pa u përpjekur të bëjnë punën e

¹⁰ AJP-1, fq.110.

¹¹ AJP -3-2, Kap. 6 , fq. 9.

vartësve të vet. Zotësia në komandimin e lartë kërkon gjithnjë e më shumë mirëkuptim dhe bashkëpunim të ngushtë me shërbimet e tjera, me forcat e shteteve të tjera dhe me agjencitë e organizatat jo ushtarake që mund të jenë të pranishme në një teatër operativ. Ajo kërkon aftësinë për t'u përballuar me ato trysni politike, ligjore e të medias, që karakterizojnë zakonisht nivelet strategjike e operative të konfliktit, por që tashmë kanë efekt edhe në nivelin taktik.

Komandimi i luftimit. Kur duhet të përdoret forcë ushtarake, arritja e objektivave strategjike e operative varet, në një shkallë të madhe, nga suksesi taktik. Prandaj, në nivelin taktik një komandant është i interesuar që të fitojë betejat e luftimet në përputhje me planin e përgjithshëm të fushatës ose të operacionit kryesor përkatës. Ndonëse fati i mirë ose fati i keq mund të luajë rol në përfundimin e betejës, mjeshtëria taktike e një komandanti zakonisht buron nga udhëheqja e mirë, e bazuar në aftësinë për të motivuar repartin e tij dhe nga kompetenca profesionale. “Komandimi i suksesshëm në betejë kërkon njohje dhe kuptim të taktikave të armikut dhe të forcave të veta, procedura të zhdërvjellëta të komandimit e të punës së shtabit dhe, jo më pak, vendosmëri vetjake dhe elasticitet”¹². Synimi i një komandanti taktik duhet të jetë në mposhtjen me zhdërvjellësi të armikut ose të kundërshtarëve të tjerë, nëpërmjet një gjykimi të mirë për vendimmarrje të bazuar, të efektshme e në kohën e duhur dhe nëpërmjet bashkërendimit të armëve të kombinuara e zjarreve të përbashkëta në fushëbetejë. Mundësitë që krijohen nëpërmjet sistemeve të dixhitalizuara të komandimit të fushëbetejës, duhet të shfrytëzohen fuqishëm. Në mënyrë të veçantë, një komandant duhet të shfrytëzojë lirinë e lëvizjes që ka për ta pozicionuar vetveten në mënyrë të tillë që të arrijë efekt maksimal, pa u shkëputur për asnjë çast nga njohja e situatës.

Duke analizuar këto cilësi të komandantit, duke u mbështetur dhe duke iu referuar doktrinave tona ushtarake, arrijmë në përfundimin se thëniet e Klauzeviçit në veprat e tij janë të pasqyruara saktë, duke qenë praktike e aktuale. Ato gjejnë zbatim në procesin e drejtim-komandimit dhe përbëjnë çelësin e suksesit për çdo komandant, të çdo niveli komandimi.

Përfundime

- Ndër cilësitë dhe karakteristikat e një drejtuesi ushtarak, sipas Klauzeviçit, energjia, qëndresa, guximi, këmbëngulja, forca e karakterit dhe forca shpirtërore janë çelësi i suksesit të tij, ato janë të pasqyruara në doktrinën tona ushtarake.
- Asnjë komandant nuk mund të arrijë sukses gjatë betejës në qoftë se ai nuk arrin të krijojë lidhjet e tij me ndjenjën dhe forcën shpirtërore të luftëtarëve që ai komandon. Lufta, pikësëpari, fitohet në zemrat dhe mendjet e njerëzve, duke mbajtur gjithmonë lart moralin e tyre.
- Standardi për lider është kur përmbushen cilësitë morale përmes vlerave të besueshmërisë, guximit, ndershmërisë, përmes profesionalizmit, sigurimit të menaxhimit të dhunës, ushtrimit të autoritet brenda ligjit ndaj vartësve dhe bindjes ndaj eporëve, si dhe përgjegjshmërisë maksimale për detyrën.

¹² AJP-3-2, Kap. 6, fq.10.

- Mjedisi i sotëm shumëdimensional dhe natyra e luftës, kërkojnë që komandanti të jetë i qetë dhe i përmbajtur edhe kur situata është e turbullt dhe efektet janë në nivelin e tyre më të lartë. Morali i lartë personal dhe një shpirt që triumfon përballë vështirësive janë cilësi me vlerë.
- Aftësia për të menduar shpejt dhe për të marrë vendime të vështira është tregues i një komandanti të zotë, që mbështetet në aftësinë për t'u përqendruar në gjërat më thelbësore, identifikimin, në kohën e duhur, të rrethanave dhe të momentit që kërkon një vendim.
- Përqasja kërkon komandantë që përdorin iniciativën e që veprojnë me guxim, duke identifikuar dhe shfrytëzuar mundësitë që iu krijohen, ndërkohë që balancojnë fitoren e mundshme me rrezikun përkatës.

Bibliografia:

- Karl von Klauzevic, “ Mbi Luftën”.
- Doktrina e Përbashkët AJP-1.
- Doktrina e Përbashkët AJP-3-2.
- Bernard Montgomeri, “Fushëbeteja” (kujtime), Tiranë, 1994.

Përqendrimi i forcës dhe kundërveprimi i saj

Nënkolonel Arben Hoxha,
Kursant KLO

Kolonel Selim Troci,
Shef i Degës së Operacioneve dhe stërvitjes në BrMR

Trajtesë e shkurtuar. *Përqendrimi i forcës nënkupton bashkërendimin e të gjithë elementeve të fuqisë luftarake për të arritur efektin vendimtar mbi forcat e armikut në një kohë sa më të shkurtër. Në operacionet mësymëse, përqendrimi është një ndër elementet bazë për të arritur suksesin. Për të pasur sukses në përqendrimin e shpejtë të trupave, është e domosdoshme që të merren vendime të shpejta, të organizohet bashkëveprimi, të kryhen lëvizje të menjëhershme e të organizuara dhe të zbatohen masa të ruajtjes së trupave. Përqendrimi më i madh i fuqisë luftarake bëhet në drejtimin kryesor të mësymjes. Njëkohësisht mbahet në dorë një fuqi luftarake e mjaftueshme që, nëse ka sukses në një drejtim ndihmues të mësymjes, ai të fuqizohet e të kthehet në drejtim kryesor. Forcat pjesëmarrëse në operacionin mësymës duhet të ruhen nga veprimet që demaskojnë drejtimet e mësymjes dhe kohën e fillimit të saj. Në përqendrimin e fuqisë luftarake për mësymje kryesore janë: shpejtësia, ruajtja e trupave dhe mashtrimi.*

Epërsia numerike, pra përqendrimi me shpejtësi i forcave më të shumta në pikën vendimtare, ka ndodhur shpesh kur është bërë një vlerësim i pikave të tilla në drejtimin më të përshtatshëm. Ky përqendrim është përdorur gjerësisht nga Epaminonda, Frederiku i dytë dhe Napoleoni gjatë zhvillimit të betejave me kundërshtarët.

Përqendrimi i forcave është një veprim kompleks që takohet pak a shumë në të gjitha luftërat, mishëron plotësisht idenë e dhënies së goditjes përcaktuese me anë të kësaj mase, spontanisht si sulmuese e relativisht si mbrojtëse.

Përcaktimet sipas Klauçeviçit për përqendrimin e forcave dhe të mjeteve

Strategjia është përdorimi i luftimit (betejës) për arritjen e qëllimit të luftës. Kështu që strategu duhet të përcaktojë synimin për gjithë anën operacionale të luftës që do të jetë në përshtatje me qëllimin e saj. Me fjalë të tjera, ai do të hartojë planin dhe qëllimin e luftës, do të përcaktojë serinë e veprimeve të nevojshme

që synojnë arritjen e tyre. Në të vërtetë, ai do të caktojë fushatat e veçanta dhe, brenda tyre, vendos për luftimet (betejat) e veçanta.

Taktika e madhe është arti i nxjerrjes dhe vendosjes së trupave në fushën e betejës, në përputhje me rrethanat në terren, i futjes së tyre në veprim dhe arti i luftimit në terren, në përputhje me planëzimin në hartë. Veprimet e saj mund të shtrihen në një fushë (rajon) prej dhjetë deri dymbëdhjetë miljesh të gjerë.

Klauzeviçi, në përgjithësi, është më i dobishëm për mendimet e tij filozofike në lidhje me natyrën e luftës sesa për këshillën e tij strategjike “si të”. Në këtë fushë, shumë nga mendimet e tij ose ishin gjerësisht të njohura ose ishin çështje specifike të shekullit të 19-të. Këtu mund të përmendim tre përjashtime:

Së pari, ai ishte mbështetës i kërkimit të betejës.

Së dyti, Klauzeviçi krijoi konceptin e goditjes së asaj që ai e quante “qendër e rëndësës”. Qendra e rëndësës caktohet bazuar në karakteristikat e palëve ndërluftuese dhe ajo “është qendra e të gjithë fuqisë dhe lëvizjes, në të cilën varet gjithçka. Kjo është pika kundër së cilës duhet të drejtohen të gjitha energjitë tona”. Ai ofronte disa mundësi, por përcaktonte që goditja e ushtrisë së armikut ishte mënyra më e mirë për të filluar një fushatë. Forcat ushtarake të SHBA-së, në shkallë taktike, gjithnjë kanë identifikuar dhe goditur pikat e dobëta-ndërkohë që Klauzeviçi thotë se, në shkallë strategjike, duhet të godasim pikat e forta (fuqinë) të armikut (dhe kjo është e qartë pasi qendra e rëndësës është fuqia dhe jo dobësia). Ne tani shohim përpjekjet për të kombinuar të dy këto koncepte dhe, në thelb, ato zbatohen të dy bashkë. Zakonisht, kjo përshkruhet si goditje e anëve të forta nëpërmjet goditjes së anëve të dobëta.

Së treti, ideja e fundit e rëndësishme e Klauzeviçit në lidhje me “si të”, është koncepti i pikës kulmore. “Ka mësymje strategjike që kanë çuar drejtpërdrejt në arritjen e paqes, por këto përbëjnë vetëm një numër të vogël rastesh. Shumë nga këto goditje strategjike çojnë në atë pikë ku fuqia e tyre e mbetur është e mjaftueshme vetëm sa për të organizuar (mbështetur) zhvillimin veprimeve të mbrojtjes dhe për të pritur për vendosjen e paqes.

Niveli i lartë i strategjisë qëndron në të *qënit gjithmonë mjaft i fortë*, para së gjithash në tërësi e pastaj në pikën vendimtare të veprimeve luftarake. Prandaj, përveç predispozicionit për krijimin e forcave të armatosura, që jo gjithmonë varet nga drejtuesi ushtarak, nuk ekziston ligj më i thjeshtë në strategji se *ai i mbajtjes së bashkuar të forcave të tua*.

Asgjë nuk duhet shkelur nga masa kryesore, me përjashtim të rasteve dhe *qëllimeve urgjente*. Le të quajmë aksiomatik këtë rast dhe ta vlerësojmë si një drejtim të sigurtë. Do të shohim më vonë cilët mund të jenë motivet e arsyeshme të një përçarjeje forcash. Atëherë do të shohim se ky *parim* nuk ka të njëjtat pasoja të përgjithshme në çdo kohë, pasi ato ndryshohen sipas qëllimit dhe mjeteve.

Një fakt që duket i pabesueshëm dhe, mbi të gjitha, që është verifikuar qindra herë, është se disa gjeneralë, drejtues të njëjësive e reparteve i kanë copëzuar e shpërndarë forcat e tyre vetëm për të zbatuar, në mënyrë të paqartë, metoda të rëndomta e tradicionale, pa llogaritur saktë përse.

Nëse do të shihej si *parim fiks* përqendrimi i të gjitha forcave dhe si *përjashtim* çdo ndarje e copëzimit që ka nevojë të motivohet, atëherë çmenduria që theksuam më parë do të mënjanohet tërësisht, bashkë me shumë shkaqe të pajustificuara të copëzimit.

Është fjala për një *koncept* që, kur zbatohet në realitetin praktik, shkakton hera-herës pamje të tilla sa të duken të pabesueshme. Prandaj, është e nevojshme ta përkufizojmë e zhvillojmë atë tërësisht dhe për këtë qëllim do t'i lejojmë vetes të bëjmë një analizë të vogël.

Lufta është përplasja e dy forcave të kundërta. Prej këtej del, në mënyrë të qartë, se më e forta jo vetëm mund tjetrën, por e prek si ortek në lëvizjen e saj. Sidoqoftë, kjo do të përshejtohej, në fund të fundit, një *ndikim të mëpastajmë* të forcave, duke e paraqitur si ligj të dorës së parë të luftës, *përdorimin e njëkohshëm* të të gjitha forcave të parapërgatitura për goditje.

Në realitet ndodh kështu vetëm kur lufta ngjan me të vërtetë me një përplasje titanike. Përkundrazi, kur ajo konsiston në një veprim të matur e të ndërsjelltë forcash shkatërruese, mund të konceptohet shumë mirë si një efekt i përfutur nga forca të njëpasnjëshme.

Ky rast i fundit përdoret në taktikë kryesisht sepse ajo ka për bazë *luftimin* me zjarr, por edhe për motive të tjera. Nëse *njëmijë* njerëz veprojnë në luftimin me zjarr kundër *pesëqindëve*, sasia e humbjeve të tyre do të varet nga sasia e forcave përballë, nga vetë numri i tyre. *Njëmijë* vetë hapin zjarr *dyfish* kundër *pesëqindëve* por, në krahasim me elementët e tjerë, ka më shume plumba që përshkojnë një masë prej *njëmijë* vetësh sesa *pesëqind* vetësh, pasi është e kuptueshme që masa e parë është më e dendur. Nëse do të pranohej se në këtë mënyrë numri i njerëzve të goditur është gjithashtu më i madh tek *njëmijë vetët*, humbjet do të bëheshin të barabarta tek të dy palët, p.sh. te *pesëqind* vetët do të humbasin 200 vetë, po kështu edhe tek të *njëmijët*. Tani, nëse të *pesëqindët* do të kishin patur prej tyre jashtë zjarrit te efektshëm një *rezervë* prej 500 vetash të tjerë, do të mbeteshin për të dy palët nga 800 luftëtarë të vlefshëm, por nga njëra palë kjo shumë do të përfshinte 500 njerëz të freskët me forca e municione të paprekura, ndërsa nga pala tjetër do të ishin 800 vetë, të gjithë njësoj të tronditur, pa municione të mjaftueshme dhe që e kanë harxhuar një pjesë të energjisë së tyre. Nuk është megjithatë e saktë të merret me mend se *njëmijë* vetët humbasin për shkak të numrit të madh të tyre, *dyfishin* e 500-ve që ndodheshin në pozicionet e tyre dhe do të vërehej pra, fillimisht një disavantazh në atë që ka mbajtur 500 vetë rezervë.

Kështu pra, duhet pranuar se, në të shumtën e rasteve, të 1000 njerëzit e angazhuar kundër të 500-ve do të kenë epërsinë në fillim dhe do të arrijnë po ashtu të ndjekin kundërshtarët e tyre nga pozicionet, duke i detyruar të tërhiqen në thellësi. Por a munden apo jo këto dy njësi të kompensojnë mungesën që në fund nuk do të mbeten më 800 vetë të rraskapitur nga luftimi, përballë një armiku jo shumë të dobët numerikisht, por që llogarit 500 luftëtarë të freskët? Analiza nuk mund të na shërbejë për të vendosur për një çështje të tillë.

Duhet të mbështetemi te përvoja. Tani ne themi se nuk ka oficer, me pak përvojë në luftë, që nuk do t'i japë epërsinë më të madhe atij kundërshtari që disponon 500 vetë të freskët.

Kjo që thamë më lart mjafton për të shpjeguar pse mund të jetë e dëmshme të futësh fillimisht shumë forca në luftim. Sado të mëdha të jenë në fakt përparësitë tona fillestare, ato do të shlyhen hidhshëm më pas.

Megjithatë ky rrezik është i mundshëm vetën në periudhën e *çrregullimit, hutimit dhe ligështimit*. Me një fjalë, kriza për çdo luftë shkatërron edhe përfituesin. Në periudhën në të cilën ekziston një gjendje ligështimi, shfaqja e një sasive trupash të freskëta shkakton një efekt vendimtar. Por kur efekti sulmues i luftimit ka përfunduar me fitore dhe nuk mbetet tjetër veçse epërsia morale e përshkruar nga suksesi, edhe një *forcë e freskët* nuk është më në gjendje të vendosë ekuilibrin e humbur, sepse edhe kjo forcë do të tërhiqej në vorbullën e shkaktuar nga suksesi i kundërshtarit. Një ushtri e *mundur* nuk mundet më në ditën e nesërme të udhëhiqet për një fitore nga mbërritja e një rezerve të re.

Këtu ndodhemi në origjinën e një ndryshimi themelor midis taktikës dhe strategjisë. Në fakt, rezultatet e tashme, gjatë zhvillimit të luftimit dhe para çastit vendimtar, arrihen zakonisht, në pjesën më të madhe, gjatë fazës të hutimit dhe ligështimit.

Por në rezultatet strategjike, d.m.th në ato të kompleksivitetit të luftimeve, fitoret e realizuara, të mëdha apo të vogla, arrihen pas kësaj faze. Vetëm kur rezultatet e luftimeve të pjesshme janë grumbulluar në një kompleks me vete, shfaqet rezultati strategjik, por atëherë gjendja e krizës ka përfunduar së vepruari, forcat rimarrin formën fillestare duke mbetur e dobët vetëm ajo pjesë, të cilën e ka shkatërruar realisht *luftimi*.

Si pasojë e një ndryshimi të tillë, *taktika* mund të shfrytëzojë veprimin e njëpasnjëshëm të forcave, ndërsa *strategjia* duhet t'i bëjë forcat të veprojnë njëkohësisht. Në qoftë se *suksesi taktik* nuk mund të arrihet në suksesin e parë dhe i druhet asaj që mund të ndodhë në çastin menjëherë pas suksesit, është e natyrshme që dhe për të ruajtur rezultatet fillestare, duhen të përdoren vetëm forca që janë të nevojshme për këtë qëllim.

Forcat e tjera duhet të mbeten jashtë sferës së ndikimit, qoftë të zjarrit, qoftë të armëve të ftohta për të patur mundësinë t'ia kundërvësh ato forcave të reja të freskëta, ose për të arritur me to të mundësh kundërshtarin tashmë të dobësuar. Por nuk është e njëjta gjë në strategji. Nga njëra anë, siç thamë pak më parë, kur është arritur një prej rezultateve të saj, strategjia nuk duhet t'i trembet shumë një përmbysjeje, *pasi kriza përfundon pikërisht në arritjen e këtij rezultati*, nga ana tjetër, jo të gjitha forcat e shkallës strategjike janë doemos të goditura nga kriza. Janë të dobësuar vetëm trupat e impenjuara drejtpërdrejt me armikun në luftimet e pjesshme. Pra, nëse taktika nuk i ka harxhuar kot së koti forcat, në realitet janë dobësuar vetëm ato që ishin të domosdoshme dhe jo të gjitha ato që strategjia kishte në dispozicionin e saj.

Trupat që për shkak të epërsisë numerike mbi armikun, nuk kanë luftuar dhe pritja e tyre ka mjaftuar thjesht për të kontribuar në suksesin, ashtu siç ishin më parë, mund të përdoren për qëllime të reja, sikur të mos kenë bërë asgjë. Përveç kësaj, kuptohet lehtë se këto trupa që japin epërsi numerike, mund të kontribuojnë shumë në rezultatin përfundimtar. Po kështu mund të shkaktojnë një pakësim të humbjeve të trupave të tjera të përfshira në *konfliktin taktik*.

Nëse në fushën strategjike, humbjet nuk rriten përpjestimshmërisht me madhësinë e trupave të përdorura, por përkundrazi një masë e tillë vlen për t'i pakësuar humbjet

dhe, nëse rezultati, siç është e natyrshme, sigurohet më shumë nga kjo gjë, është e qartë që forcat e drejtpërdrejta pjesëmarrëse nuk do të jenë kurrë tepër të mëdha në numër dhe se ato, që janë në dorë të komandës për t'u përdorur, duhet të përdoren njëkohësisht në operacionet e planifikuara.

Duam ta shqyrtojmë këtë *parim* në një aspekt tjetër. Deri tani kemi folur vetëm për ndeshje në vetvete që përbën veprimtarinë përkatëse, por nuk duhet të humbasim nga vëmendja njerëzit, kohën dhe hapësirën, që janë elementet mbi të cilët bazohet një veprimtari e tillë, si dhe rezultatet e ndikimit të ndërsjellë të tyre që duhet të kenë pjesën e vet në *vlerësimin tona*.

Lodhjet, mundimet, privacionet përbëjnë në luftë elemente rrënues që nuk i përkasin saktësisht ndeshjes, por që janë të pandashëm prej saj. Efektet e tyre shfaqen mbi të, disa prej tyre në fushën e strategjisë. Është e vërtetë se ato ndeshen edhe në taktikë, ndoshta në masë mjaft të madhe, por kohëzgjatja e veprimeve taktike është e vogël dhe ndërkaq efektet e vogla të lodhjeve e privacioneve, në veprime të tilla mund të kenë rëndësi të pakët. Por në strategji, në të cilën koha dhe hapësira janë më të mëdha, efekti i tyre jo vetëm është gjithmonë i ndjeshëm, por, hera herës, është vendimtar. Jo rrallë është parë që një ushtri *fitimtare* të pësojë humbje më të mëdha prej *sëmundjeve*, se prej luftimeve.

Nëse shqyrtojmë këtë sferë dëmtuese në *strategji*, siç shqyrtoam në *taktikë* atë që iu përkiste armëve të zjarrit dhe atyre të ftohta, mund të konceptojmë që të gjitha forcat e armatosura, mbi të cilat ajo vepron, gjenden, në fund të një fushate ose të një *faze strategjike* e një gjendjeje të tillë dobësie, në të cilën merr rëndësi vendimtare *përdorimi i një force* të përtërirë për ndërhyrje. Pra, do të ishte me vend, ashtu si në *taktikë*, të përdoret vetëm sasia më e vogël e mundshme e forcave për arritjen e rezultateve fillestare dhe ruajtja e pjesës tjetër të forcave e paprekur për në fund të detyrës. Për të vlerësuar drejt këtë koncept, që në shumë raste të përdorimit të tij do të përbëjnë një vlerësim të madh për të vërtetën, le të përqendrojmë vëmendjen tonë mbi idetë në të cilat bazohet.

Para së gjithash nuk duhet të ngatërrojmë idenë e një përforcimi të thjeshtë me atë të një *force të re* të paprekur. Janë të pakta fushatat që në fund të tyre një shtim forcash, si fituesit edhe të munduarit i duket shumë i dëshirueshëm. Por tani nuk e kemi fjalën për këtë, pasi një shtim i tillë forcash nuk do të ishte i nevojshëm, nëse ato do të kishin qenë shtuar po aq, qysh në fillim.

Përsa i përket një ushtrie të freskët që hyn në fushatë, kjo do të ishte në kundërshtim me përvojën ku paramendohet se ajo ka vlerë morale më të madhe se ajo e ushtrisë që është tashmë në fushën e betejës, siç ndodh, nga ana tjetër, për një rezervë taktike përballë një trupe tashmë pjesëmarrëse në luftime dhe që ka vuajtur.

Duke u nisur nga kjo kuptojmë pyetjen: mos vallë humbjet nga mundimet dhe privacionet rriten në përpjesëtim të drejtë me madhësinë e forcave siç ndodh me luftimin? Kësaj pyetje duhet t'i përgjigjemi "JO", pa u lëkundur.

Mundimet rrjedhin, në pjesën më të madhe, nga rreziqet e vazhdueshme të cilave, pak a shumë, iu qëndron përballë, në çdo aspekt, veprimi luftarak. Për t'i përballuar gjithandej të tilla rreziqe, për të çuar operacionin përpara me siguri, nevojitet një

sasi veprimesh të veçanta, tërësia e të cilave përbën *detyrën taktike dhe strategjike* të ushtrisë. Ajo bëhet më tepër e vështirë dhe e rëndë, sa më e dobët është ushtria, e sa më e lehtë e sa më e madhe është epërsia numerike ndaj armikut. Kush mund të dyshojë për këtë? Një fushatë ndaj një kundërshtari shumë më të dobët, do të kushtojë shumë më pak mundime se sa ndaj një kundërshtari të barabartë dhe aq më keq me epërsi në forca.

Përsa iu përket privacioneve, çështja ndërron mjaft pamjen, në pamjaftueshmërinë e ushqimeve dhe në pamjaftueshmërinë e pushimit, qoftë për trupat në fushën e betejës, qoftë për ato në rezervë.

Nëse Napoleoni, në fushatën e tij në Rusi, në vitin 1812, mbajti trupat e veta të bashkuara në një masë tejet të madhe vetëm mbi të njëjtin dëmtim dhe i shkaktoi kështu asaj ushtrie privacione të skajshme, kjo duhet t'i njihet vetëm parimit të tij: "Nuk je kurrë i fortë në pikën vendimtare".

A i ka çuar ai, në këtë rast, në skaj pasojat e një parimi të tillë? Nuk është vendi këtu për të shqyrtuar këtë problem, por është e sigurtë se po të kishte dashur të shmangte privacionet që rridhnin nga mënyra e tij, e vendosjes së forcave, ai nuk do të kishte bërë tjetër veçse do të kishte përparuar në një front më të gjerë.

Hapësirat në Rusi nuk mungojnë, siç nuk i munguan, në pjesën më të madhe të rasteve të tjera. Nga ky shembull pra nuk mund të nxjerrim një argument për të provuar se përdorimi i njëkohshëm i forcave mjaft të tepërta duhet të jetë shkaku i një dobësimi më të madh të forcave. Por pranojmë sidoqoftë se vështirësitë dhe mundimet në luftë shkaktojnë rënie edhe në atë tepricë forcash që do të mund të duhen për përdorim të mëtejshëm, pavarësisht nga pakësimi që prania e saj i ka dhënë pjesës tjetër të ushtrisë. Para së gjithash, duhet analizuar gjithmonë tërësia e gjërave, duke i bërë pyetje vetes nëse ky zvogëlim trupash do të ketë aq rëndësi sa edhe fitimi i energjive që mund të përfitojmë nëpërmjet epërsisë sonë në forca, në më shumë se një drejtim.

Na mbetet akoma një pjesë e rëndësishme për t'u shqyrtuar. Në luftimin e pjesshëm, pa shumë vështirësi mund të vlerësohet përkohësisht forca e nevojshme për të arritur një rezultat të madh, të llogaritur qysh më parë dhe për pasojë të vlerësohet ajo çka do të ishte e tepërt. Në strategji përkundrazi, një vlerësim i ngjashëm është i pamundur, sepse realiteti strategjik nuk përbën një objekt aq të përcaktuar e të përkufizuar sa ai taktik. Ajo çka mund të quhet në taktikë si një tepricë forcash, në strategji duhet të shihet një mjet i caktuar për të zgjeruar rezultatin, nëse parashtrohet rasti. Në madhësinë e rezultatit rritet përpjesëtimi i epërsisë dhe epërsia në forca mund të arrijë menjëherë me këtë progresion në rritje në një pikë të atillë ku nuk do të arrihej kurrë me një përdorim ekonomik të tejskajshëm forcash.

Pikërisht falë epërsisë së tij tepër të madhe, Napoleoni arriti, në vitin 1812, të përparonte deri në Moskë dhe ta pushtonte atë kryeqytet. Nëse kjo epërsi do të kishte qenë edhe e tillë që t'i lejonte atij të shkatërronte gjithashtu ushtrinë ruse, ai do të kishte përfunduar mundësisht në Moskë një paqe që, në çdo mënyrë tjetër, dukej më pak e arritshme. Ky shembull synon veçse të qartësojë mendimin, jo ta vërtetojë atë, sepse për ta vërtetuar do të nevojiteshin shtjellime të hollësishme, për të cilat nuk është rasti t'i paraqesim këtu.

Të gjitha këto vlerësime i referohen vetëm konceptit të një përdorimi të njëpasnjëshëm të forcave dhe nuk kanë asgjë të përbashkët me idenë e një rezerve të vërtetë. Ato e prekin shpesh këtë ide, por ajo lidhet me vlerësime të tjera që do t'i shqyrtojmë më poshtë.

Ajo që kemi dashur të paraqesim këtu është se, nëse në taktikë forcat pësojnë vërtet një pakësim për efektin e thjeshtë të kohëzgjatjes së përdorimit real të tyre, në strategji kjo nuk është, në thelb, po aq e vërtetë.

Duhet të përdoren njëkohësisht të gjitha forcat e caktuara për një vlerësim strategjik. Ky përdorim do të jetë më i përsosur kur më shumë aksione do të përqendrohen në një vlerësim dhe në një moment të vetëm.

Së fundi, strategjia ka dhe një mjet tjetër për të siguruar rezultatet me këtë veprim të përsëritur: me përpjekje të përsëritura. Dhe për këtë nevojitet të flitet më shumë sepse ato përbëjnë një faktor thelbësor për rezultatin përfundimtar. Ky faktor është krijimi i pandërprerë i forcave të tilla.

Si pasqyrohet përqendrimi i forcës në AJP-01(D), AJP-03(B), AJP-3,2, AJP-05

Komandanti i Forcës së Bashkuar dhe shtabi i tij përdorin artin operativ për të mbajtur në konsideratë jo vetëm vendosjen e forcave ushtarake, por edhe mbështetjen dhe kryerjen e veprimeve të tyre në kohë, hapësirë dhe qëllim. Kjo përfshin metodat themelore, të shoqëruara me sinkronizimin dhe integrimin e forcave dhe kapaciteteve ushtarake. Arti operativ udhëheq vendosjen e forcave, angazhimin në një operacion të bashkuar ose tërheqjen nga ai, kryerjen e operacioneve të mëdha, betejave ose vendosjen taktike për arritjen e objektivave operacionale e atyre strategjike ushtarake.

Vendosja dhe mbështetja e efektshme e forcave ushtarake varet shumë nga masat e marra për komandim- kontrollin, nga niveli më i lartë deri te niveli më i ulët i autoritetit. Për të ushtruar autoritetin e komandim -kontrollit në operacionet e bashkuara, komandanti i Forcës së Bashkuar dhe shtabi i tij, duhet të përdorin procedura standarde dhe sistemin e komunikimit e informimit (CIS) të Aleancës.

Këto procedura dhe sistemi i komunikimit e informimit formojnë sistemin e komandim- kontrollit (C2), i cili duhet planëzuar nga komandanti i Forcës së Bashkuar, shtabi i tij e agjencitë e tjera të NATO-s, për të arritur përshtatshmërinë me mjedisin operacional dhe në të njëjtën kohë efektshmërinë optimale. Për të ruajtur efektshmërinë operacionale të forcave, funksioni i ruajtjes së tyre (FP) duhet të jetë i integruar plotësisht dhe i bashkërenduar, që nga fillimi, në procesin e planëzimit operacional (OPP), duke përfshirë edhe procesin e planëzimit operacional në nivel operativ (OLPP). Kërkesat për ruajtjen e forcave duhet të njëjtësohen qartësisht, përfshirë masat në përgjigje të krizës që kanë lidhje me ruajtjen e forcave dhe veprimeve që duhen ndërmarrë ndaj kategorive të ndryshme të rreziqeve. Ruajtja e forcave përfshin një numër disiplinash dhe kapacitetesh: *sigurinë e ruajtjes, veprimet xheniere në mbështetje të ruajtjes së forcave, mbrojtjen ajrore, ruajtjen e shëndetit, menaxhimin ose likuidimin e pasojave dhe mbrojtjen nga armët e dëmimit në masë.*

Përqendrimi i forcave në kohë e në hapësirë ka të bëjë me shpejtësinë relative me të

cilën forcat mund të njohin terrenin, ta kapin e ta mbajnë atë, ta stabilizojnë ose të kontrollojnë një zonë të caktuar. Komandanti i Forcës së Bashkuar (JFC) dhe shtabi i tij duhet të vlerësojnë zonën e operacionit në pikëpamje të hapësirës dhe kohës së nevojshme për të realizuar objektivat e caktuara brenda kësaj zone.

Objektivi për një sulmues është zënia e hapësirës, sa më shpejt të jetë e mundur, ndërkohë që mbrojtësi përpiqet të mbajë kontrollin e kësaj hapësire e të vonojë ose pengojë arritjen e objektivit nga sulmuesi. Në lidhje me kohën, çdo fitim kohe është avantazh për një aktor që dëshiron të ruajë *statu quo*-në.




Figura 1. Faktorët operacionale, sfera e informacionit dhe lidhja e tyre

Përqendrimi *Kohë+forca*, ka të bëjë me gatishmërinë relative dhe predispozicionin e forcave e të mbështetjes logjistike në kohë, përfshirë implikimet në lidhje me statusin e përgatitjes së tyre dhe zhvillimin e kapaciteteve në kohë. Koha është një element kryesor mes vlerës absolute dhe efektivitetit luftarak të një force. Shpejtësia shumëfishon fuqinë goditëse të një force. Faktorët që ndikojnë në disponueshmërinë në kohë të forcave janë: lloji, madhësia dhe organizimi i forcës, distanca për në rajonin e dislokimit, mënyra e transportit dhe infrastruktura në vendin e dislokimit.

Përqendrimi i forcave *Hapësirë+forcë*, ka të bëjë me aftësinë relative për të kontrolluar ose dominuar, në mënyrë operacionale, një zonë të caktuar, me përqendrimin dhe përhapjen e forcave brenda zonës së operacionit, përfshirë pasojat e tejzgjatjes, dislokimit dhe ekspozimit si dhe aftësinë për të lëshuar hapësirë me qëllim shmangien e betejave vendimtare.

Përqendrimi i forcave *Kohë+hapësirë+forcë*, ka të bëjë me kapacitetet relative për

planëzimin e kompozimit të një force në zonë dhe me shpejtësinë krahasuese me të cilën ato mund të ndërtojnë kapacitetet vendimtare të forcave. Kjo është edhe lidhja ose raporti më kompleks për t'u vlerësuar dhe luan një rol përcaktues në të gjitha nivelet e komandimit. Në përgjithësi, sa më larg të jetë distanca e lëvizjes dhe dislokimit të një force, aq më shumë i rëndësishëm bëhet faktori kohë. Për më tepër, sa më i madh të jetë teatri i veprimeve, aq më shumë forca kërkohen për të arritur objektivat e caktuara. Dendësia e popullsisë në teatër mund të rritë ose ulë vlefshmërinë e këtij rregulli të përgjithshëm.

Në nivel operativ, gjykimi i shëndoshë në balancimin e këtyre tre faktorëve është i rëndësishëm për shkak të pasojave serioze që mund të sjellë mospasja e një gjykimi të tillë. Disa konsiderata bazë janë: hapësira dhe forcat janë relativisht të përcaktuara në nivel operativ sepse komandanti i Forcës së Bashkuar mund të ndikojë fare pak për t'i ndryshuar ato.

Përqendrimi i forcave duke marrë parasysh informacionin dhe faktorin hapësirë. Përparimet teknologjike kanë dy impakte të ndryshme për komandantin e Forcës së Bashkuar, në lidhje me informacionin dhe raportin e tij me hapësirën. Nga njëra anë, komandanti i Forcës së Bashkuar dhe shtabi i tij, në ditët e sotme, kanë mundësi komunikimi të vazhdueshme dhe, nëse është e nevojshme, edhe mes forcave të përhapura në distanca të mëdha. Aftësia e tyre për të komunikuar me bazat e tyre të prapavijës dhe komandën e tyre eprore, për të kërkuar burime, mund të karakterizohet si një arritje globale. Për më tepër, teknologjia aktuale e informacionit e lejon komandantin e Forcës së Bashkuar dhe planëzuesit e tij operacionale të kenë më shumë informacion të saktë e të hollësishëm sesa kishin në të kaluarën, në të gjitha aspektet e hapësirës fizike.

Mjedisi i informacionit global ka tashmë ndikim, jo gjithmonë pozitiv, në gjeopolitikën, ekonominë, veprimet ushtarake në përgjithësi dhe operacionet në veçanti. Aspektet jo ushtarake të hapësirës, politika e brendshme dhe e jashtme, diplomacia, aktivitetet ekonomike, shoqëria e aspekte të tjera të veprimtarisë njerëzore ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në planëzimin dhe kryerjen e fushatave e operacioneve të mëdha.

Përqendrimi i forcave, duke patur përparësi *manovrën*, skicimi i operacionit ose kuadri operacionel duhet të shfrytëzojë mundësitë për manovër nga forcat e bashkuara. Qëllimi i manovrës është kapja e pozicioneve që sigurojnë epërsi, në raport me kundërshtarit dhe nga ku mund të kërcënohet ose ushtrohet forcë mbi të. Manovra mund të përdoret për të krijuar efektet e dëshiruara për arritjen e kushteve vendimtare ose për të ndikuar drejtpërdrejt në qendrën e rëndësës së kundërshtarit. Manovra shfrytëzon mundësitë për sulm ndaj kundërshtarit nga ai drejtim që ai nuk e pret, duke e kërcënuar fizikisht dhe në pikëpamje të moralit, duke marrë rezultate disproporcionalisht më të mëdha se forcat e mjetet e përdorura. Sekretet është gjetja e mënyrave që forcat të dominojnë në kohë dhe hapësirë.

Përqendrimi i forcave, duke mbajtur në konsideratë përqendrimin strategjik të forcave në teatrin e veprimeve luftarake dhe marshimi fillestar brenda zonës së operacionit të bashkuar, përbën manovrën operacionale më të rëndësishme, e cila duhet planëzuar duke shfrytëzuar ekspertët planëzues të operacioneve, transportit, logjistikës dhe

mjekësisë. Planëzimi mbulon gjithë sekuencën e veprimeve që nga imbarkimi, zbarrimi, përqendrimi e organizimi në stacionim si dhe lëvizja drejt destinacionit final në zonën e operacionit të bashkuar. Kjo kërkon koordinim të ngushtë me qendrën e koordinimit të lëvizjes të Aleancës (AMCC), shtetet kontribuuese me trupa dhe shtetin pritës (HN), me strukturat portuale/ aeroportuale dhe komandat përkatëse. Masat ligjore duhet të jenë të plota në lidhje me statusin e forcave dhe marrëveshjeve me shtetin pritës, si dhe me masat e kalimit tranzit ose mbikalimit ajror.

AJP-3.2 “Doktrina e Përbashkët Aleate për Operacionet Tokësore”

Mjedisi operativ. Mjedisi operativ do të përcaktohet nga një gamë e gjerë karakteristikash dhe elementesh së bashku. Karakteristikat dhe hollësitë për secilin nga këto elemente do të ndryshojnë në secilin operacion ushtarak a fushatë. Disa elemente do të përbëhen nga ato që gjenden në një teatër të operacioneve si për shembull popullata dhe kultura e tyre, ndërsa disa të tjerë do të jenë të importuar si për shembull kapacitetet e informacionit të një force koalicioni.

Mjedisi fizik. Mjedisi fizik është terreni në të cilin forca do të veprojë. Forca tokësore duhet të jetë në gjendje të veprojë në një shumëllojshmëri të gjerë të mjediseve fizike të tilla si mjedis arktik, malor, bregdetar, xhungël, shkretëtirë. Fushatat mund të përfshijnë një ndërthurje të terreneve fizike.

Kërcënimet dhe rreziqet. Kërcënimet me të cilat do të përballen forcat tona tokësore mund të marrin një numër formash dhe mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Ato mund të jenë një forcë ushtarake e mirë-organizuar dhe e identifikueshme, ose mund të përbëhen nga një element kryengritës që përpiqet të gërryjë qeverinë ekzistuese dhe të dëbojë forcat e huaja, nëpërmjet një ndërthurjeje të dhunës e të subversionit. Për shembull, forcat e parregullta mund të ndihmojnë forca konvencionale, ose shpartallimi i një force ushtarake konvencionale mund të çojë në një kryengritje të sponsorizuar nga jashtë, sipas AJP-3.2.

Përfshirja e agjencive, forcave e organizatave të tjera. Operacionet tokësore mund të përfshijnë forca që punojnë në harmoni, në mbështetje, madje edhe të mbështetura nga agjenci e organizata të tjera.

Një qasje gjithëpërfshirëse. Në një mjedis kompleks ekziston nevoja për të bashkërenduar paraprakisht veprimtaritë nga një gamë e gjerë aktorësh. Sa herë që është e mundur, një qasje gjithëpërfshirëse synon të nxitë një kulturë bashkëpunimi brenda një mjedisi bashkëveprues, duke mundësuar ndërkohë një kuptim të njëjtë të situatës.

AJP-3.2

Efkti i qasjes gjithëpërfshirëse mbi komponentin tokësor. Një kuptim i gjerë i qasjes gjithëpërfshirëse kërkohet në nivelin taktik për t’iu dhënë mundësi komandantëve të komponentit të zbatojnë planin e fushatës së komandantit operativ.

Angazhimi ushtarak në kohë paqeje (PME). Ky angazhim përmbledh të gjitha veprimtaritë ushtarake që përfshijnë shtete të tjera dhe që janë të paracaktuara për të formësuar mjedisin e sigurisë në kohë paqeje.

Mbështetja e paqes (PS). Operacionet që lidhen me temën e fushatës PS zakonisht janë reagime ndaj kushteve në fundin e poshtëm të spektrit të konfliktit. Në shumicën e rasteve, ato mandatohen e bashkërendohen nga Kombet e Bashkuara ose organizata të tjera ndërkombëtare. Nëse një situatë përkeqësohet dhe kërkon forcë, ajo mund t'i delegohet një aleance a koalicioni ushtarak.

Kundërkryengritja (COIN). Megjithëse secila kryengritje është unike, ekzistojnë dhe ngjashmëri. Ka më shumë gjasa që kryengritjet të ndodhin në shtete ku ka ndarje racore, kulturore, fetare a ideologjike të qenësishme, të cilat çojnë në mungesën e kohezionit kombëtar dhe në qeveri të dobëta, të paefektshme, të paqëndrueshme e jopopullore.

AJP-3.2

Veprimet luftarake madhore. Veprime luftarake madhore ndërmerren në rrethana që zakonisht karakterizohen si luftë. Kur shtete ose forca shumëkombëshe nisin fushata me veprime luftarake madhore, kjo zakonisht ndodh sepse kërcënohen interesa të rëndësishme.

Përqendrimi i Forcës. Fuqia luftarake duhet të përqendrohet në kohën dhe vendin e përzgjedhur, me synimin e arritjes së rezultateve vendimtare. Forca eprore nuk nënkupton vetëm një forcë të bazuar në numrat e saj, por edhe një forcë të bazuar në aftësitë luftarake, në kohezionin, moralin, shfrytëzimin e kohës, si dhe në përzgjedhjen e objektivave dhe shfrytëzimin e avantazheve të teknologjisë.

Ekonomizimi i përpjekjeve. Në kushtet e burimeve të kufizuara, do të jetë e nevojshme që në disa drejtime të operacionit të merren përsipër edhe rreziqe. Parimi i ekonomizimit të përpjekjeve pranon që, ndërsa fuqia e përqendruar duhet të ushtrohet në rajonet ku duhet të prodhohen efekte vendimtare, mund të bëhet kompromis në rajone të tjera me përparësi më të ulët. Ekonomizimi i përpjekjeve nënkupton përdorimin e balancuar të burimeve në dispozicion, duke marrë përsipër edhe rreziqe të caktuara, në interes të përmbushjes së objektivit parësor të komandantit.

Zhdërvjelltësia. Planet duhet të jenë mjaft të zhdërvjelltëta për t'iu përgjigjur situatave të papritura, si dhe për t'iu siguruar komandantit liri veprimi maksimale. Ky parim kërkon një kuptim të plotë të qëllimeve të komandantit epror, zhdërvjelltësi të mendimit, vendimmarrje të shpejtë, si dhe organizim dhe sistem komunikimi të mirë.

Nisma. Nisma mund të konsolidohet nëpërmjet besimit dhe mirëkuptimit reciprok, si dhe mund të zhvillohet nëpërmjet trajnimit të përbashkët. Iniciativa ka të bëjë me njohjen dhe shfrytëzimin e mundësive që i jepen çdo komandanti për të zgjidhur problemet e tij në një mënyrë origjinale. Në mënyrë që çdo komandant të ketë një mjedis të dominuar nga iniciativa e lirë, atij duhet t'iu jepet liria e përdorimit të iniciativës, duke inkurajuar edhe ai vetë komandantët e tij vartës të bëjnë një gjë të tillë, pa patur frikë nga pasojat e dështimit të operacionit. Kjo kërkon që çdo komandant të kultivojë një kulturë operationale dhe të trajnimit, në interes të promovimit të qëndrimit të marrjes përsipër të një rreziku të caktuar, në mënyrë që çdo komandant vartës të mendojë në mënyrë origjinale si të fitojë dhe jo si të evitohet dështimin. Parimi i iniciativës kërkon zakonisht që autoriteti i komandimit të delegohet në nivelin më të ulët të mundshëm.

Mbajtja e moralit. Komandantët duhet t'i japin komandës së tyre një identitet të veçantë. Ata duhet të inkurajojnë sedrën profesionale të njësisë, ta zhvillojnë atë në interes të qëllimit dhe të unitetit të përpjekjeve të përbashkëta të njësisë, duke promovuar objektiva të arritshëm. Morali i lartë varet shumë nga lidershipi i spikatur, i cili inspiron guxim, energji, vendosmëri dhe përkujdesje ndaj personelit vartës.

Befasia. Befasia ndërtohet e bazuar në shpejtësinë, fshehtësinë dhe mashtrimin dhe, nëse bëhet e suksesshme, arrin rezultate të cilat janë me efekte tepër të mëdha, krahasuar me përpjekjet e shpenzuara.

Siguria. Siguria jonë rrit lirinë e veprimit, duke kufizuar njëkohësisht brishtësinë ndaj veprimeve dhe kërcënimeve të kundërshtarit. Masat e sigurisë aktive dhe pasive ndihmojnë që kundërshtarit t'i mohohet marrja e informacionit kritik. Këto masa mbështesin mashtrimin dhe ndihmojnë në veprimet kundërmësymëse.

Thjeshtësia. Zhvillimi i planeve sa më të thjeshta dhe urdhrave sa më të qarta shman në maksimum keqkuptimet dhe konfuzionin në planëzimin dhe zbatimin e operacionit.

Shumëkombësia. Në përmbajtjen e saj, NATO është një aleancë e shteteve. Forcat dhe strukturat e komandimit të saj do të jenë gjithmonë shumëkombëshe. Forcat e NATO-s mund të zhvillojnë gjithashtu operacione të koalicionit, në bashkëveprim me forca të tjera jashtë Aleancës. Komandimi i forcave shumëkombëshe kërkon jo vetëm një përfaqëse shumëkombëshe, por edhe aftësinë për të kuptuar pozicionet e ndryshme kombëtare, si dhe kombinimin e tyre për arritjen e qëllimit të përbashkët.

Konsiderata të tjera

Përveç parimeve të shprehura, të cilat kanë vlera universale për të gjitha llojet e operacioneve, ka edhe çështje të tjera të fushatave të veçanta (si p.sh. Operacionet e Mbështetjes së Paqes)¹, për të cilat kërkohet të mbahen parasysh një numër konsideratash të tjera, të cilat shprehen në vijim:²

- a. **Paanshmëria.** Një Operacion i Mbështetjes së Paqes (PSO)³ duhet të kryhet në mënyrë të paanshme, në përputhje me mandatin e tij dhe pa asnjë favorizim apo paragjykim për mbështetjen e ndonjë pale të përfshirë në të.
- b. **Marrja e pëlqimit.** Niveli i marrjes së pëlqimit (arritjes së një marrëveshjeje) për praninë e një force të caktuar në një Operacion të Mbështetjes së Paqes (PSO) ose në një operacion të stabilizimit, do të ketë ndryshime në kohë dhe hapësirë. Këto ndryshime mund të jenë horizontale, përgjatë të gjithë

¹ Kjo është e vërtetë për çështje të tjera themelore si operacionet kundër kryengritësve. Këto parime, nëse do të jenë të ndryshme, do të përfshihen në edicionet e ardhshme të këtij dokumenti kur doktrina përkatëse e NATO-s të shpallet.

² Për më shumë shpjegime të hollësishme shih: Publikimi i AJP 3.4.1, Operacionet e Mbështetjes së Paqes.

³ Një operacion që parimi i paanshmërisë përdor mjetet diplomatike, civile dhe ushtarake, zakonisht në ndjekje të parimeve dhe qëllimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, për vendosjen dhe ruajtjen e paqes. Këto operacione mund të përfshijnë parandalimin e konflikteve, bërjen e paqes, imponimin e paqes, ruajtjen e paqes, ndërtimin e paqes dhe/ose operacionet humanitare (AAP-6).

elementëve të popullsisë, si dhe vertikale, brenda hierarkive të palëve në konflikt. Çdo komandant do të synojë ta shndërrojë marrjen e pëlqimit pasiv në një mbështetje aktive, nëpërmjet rritjes së legjitimitetit dhe besueshmërisë.

- c. **Kufizimi në përdorimin e forcës.** Për të arritur një objektiv të caktuar, komandantët dhe forcat e tyre duhet ta përdorin forcën mbi bazën e parimeve të matshmërisë dhe të proporcionalitetit të mjaftueshëm të saj. Kufizimet për përdorimin apo mospërdorimin e forcës mund të vendosen në mandatin përkatës, bazuar në ligjin ndërkombëtar, ligjet kombëtare të vendeve që kontribuojnë në forcën përkatëse, në rrethana të veçanta, si dhe në ligjin e vendit pritës të operacionit.
- d. **Vendosmëria/Këndvështrim afatgjatë.** Arritja e gjendjes përfundimtare politike do të kërkojë një këmbëngulje të komandantëve për ndjekjen me maturi, vendosmëri dhe vazhdueshmëri të arritjes së objektivave. Në kontekstin e fushatës afatgjatë, mund të kërkohej edhe identifikimi dhe arritja e objektivave afatshkurtër.
- e. **Legjitimiteti.** Legjitimiteti i operacionit dhe perceptimi i gjerë i këtij legjitimiteti do të përbëjë një bazë themelore për mbështetje nga komuniteti ndërkombëtar, nga vendet kontribuuese, palët e angazhuara, përfshirë dhe komunitetin civil vendas.
- f. **Besueshmëria.** Që një operacion të jetë efektiv, ai duhet të jetë i besueshëm dhe të zbatohet si i tillë nga të gjitha palët. Besueshmëria e operacionit është pjesërisht pasqyrim i vlerësimit të aftësive të forcës së palëve për përmbushjen e misionit.
- g. **Respekti i ndërsjellë.** Respekti me të cilin përcillet kryerja e një operacioni, si dhe marrëdhëniet ndërmjet forcave të Aleancës dhe popullsisë vendase, do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në suksesin e tij afatgjatë.
- h. **Transparenca.** Misioni dhe koncepti i operacioneve duhet të kuptohet lehtësisht dhe të jetë i qartë për të gjitha palët. Pamundësia për të arritur perceptim të përbashkët mund të shkaktojë fërkime dhe të çojë në dyshime, mosbesim ose madje armiqësi.
- i. **Liria e lëvizjes.** Liria e lëvizjes është thelbësore për përmbushjen e suksesshme të çdo operacioni. Kur liria e lëvizjes është e kufizuar, objektivat bëhen më të vështira për t'u arritur, në të gjitha nivelet.

Komponentët e Fuqisë Luftarake

Në kontekstin e Aleancës, fuqia luftarake përbëhet nga tre komponentë, të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin: komponenti fizik, komponenti moral dhe komponenti konceptual.⁴

Asnjë nga të tre komponentët nuk konsiderohet si më i rëndësishëm se të tjerët. Për shembull, në përcaktimin e fuqisë luftarake ka pak rëndësi sa të përparuaru janë

⁴ Këto komponentë lidhen me koordinimin e veprimtarive të Operacioneve të Informimit që synojnë të krijojnë efektet e dëshiruara mbi vullnetin e kundërshtarit dhe kapacitetet.

platformat, armatimet apo sensorët e njësisve aleate, nëse njerëzit që i drejtojnë ato janë të pamotivuar, janë të patrajnuar apo iu mungon lidershipi i duhur. Nga ana tjetër, të tre komponentët nuk janë të pavarur nga njëri-tjetri. Secili prej tyre integrohet me të tjerët.




Figura 2. Komponentët e Fuqisë Luftarake

Komponenti Fizik. Komponenti fizik i fuqisë luftarake përbëhet nga grupi i elementëve që kryejnë luftimin. Komponenti fizik përbëhet nga pesë elementë: burimet njerëzore, pajisjet, performanca kolektive, gatishmëria dhe mbështetjet. Ai është kombinimi i mjeteve detare, tokësore, ajrore, i armatimeve dhe sensorëve të tyre, si dhe i pajisjeve të tjera që personeli përdor, trajnimin që ata kryejnë, atij individual dhe kolektiv, si dhe dislokimit, mbështetjes dhe rigjenerimit efektiv të tyre.

Komponenti Moral. Bazuar në logjikën racionale, njerëzit janë ata që gjenerojnë fuqinë luftarake. Forcave të Aleancës iu nevojiten kohë, përpjekje dhe burime për të zhvilluar, përgatitur dhe përdorur aftësitë e tyre për shfrytëzimin e avantazheve të Aleancës. Komponenti moral i fuqisë luftarake ka të bëjë me krijimin e bindjeve të thella tek forcat aleate për të luftuar dhe për të arritur fitoren. Ai është i matshëm dhe synon arritjen e një niveli të lartë të moralit, duke u bazuar në bindjen se qëllimet e Aleancës janë moralisht dhe etikisht të drejta, duke prodhuar si rrjedhojë një shpirt luftarak dhe vendosmëri të lartë për arritjen e qëllimit. Rritja e nivelit të komponentit moral realizohet nëpërmjet motivimit, lidërshipit dhe menaxhimit të kujdesshëm të njerëzve.

Komponenti Konceptual⁵. Ky komponent ka të bëjë kryesisht me vëzhgimin dhe perceptimin e mjedisit operacional ku do të ushtrohet veprimtaria e një individi, një komandanti apo një organizate. Vendimmarrjet e bazuara mbi informacionin e gabuar apo të manipuluar, krijimi i një perceptimi jo të saktë mbi realitetin, si dhe informacioni jo i plotë mbi kapacitetet dhe forcat tona, mund të çojnë në përdorimin e gabuar të komponentëve të tjerë të fuqisë luftarake. Prandaj, edhe në rastet kur vullneti dhe aftësia për të luftuar janë zhvilluar në nivel të lartë, mangësitë në komponentin konceptual mund të na çojnë në përdorimin jo efektiv ose kundër-produktiv të fuqisë luftarake.

Integrimi, koordinimi dhe sinkronizimi i Operacioneve

0557. Klauzeviçi ka thënë se “Lufta ka gramatikën e vet, por ajo nuk ka logjikë”. Kuptimi i kësaj gramatike nuk është i njëjtë me imponimin e një veprimi të

⁵ Disa vende e emërtojnë edhe si Komponenti Psikologjik.

gabuar, në një situatë të ndërlikuar dhe në evoluim të vazhdueshëm. Përkundrazi, Komandanti duhet të kërkojë ta kthejë këtë kaos në avantazhin e tij, duke patur një kuptim të qartë të ndikimit të veprimtarisë taktike, te plani i fushatës dhe, në fund të fundit, tek objektivat politike. Një kuptim i tillë do të krijojë një përparësi ndaj një kundërshtari që nuk është në gjendje, apo nuk ka dëshirë të njohë këtë lidhje thelbësore. Kështu që ai (komandanti) duhet të jetë shumë i përfshirë në matjen e progresit të fushatës, në mënyrë që të vlerësojë suksesin - për të ditur nëse ai është “*duke fituar*”. Menaxhimi i fushatës realizohet kryesisht nëpërmjet një seri bordesh dhe takimesh, të organizuara nën flamurin e *Ritmit të Fushatës*. Se si arrihet kjo saktësisht, kjo varet nga natyra e operacionit, veçanërisht në operacionet shumëkombëshe, por sido që të jenë rrethanat, Komandanti duhet të jetë i qartë për çfarë informacioni ka nevojë dhe se si duhet të paraqitet ai. Roli i tij është të drejtojë procesin, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Shefit të Shtabit (COS), në mënyrë që ai të mund të marrë vendime efektive dhe në kohën e duhur.

Ligji i kthimit të sukseseve taktike në suksese operative dhe strategjike

Xhon Fyler, që në vitin 1916, ka shkruar: “Është diçka e jashtëzakonshme kur sheh që, ndërsa çdo shkencë tjetër mbështetet sot mbi parime të përcaktuara, lufta mbështetet në mëshirën e fatit. Ne mund të bëjmë disa parashikime për luftën me aq siguri sa edhe Darvini për jetën, i cili drejtpërdrejt arriti të zbulojë ligjin themelor të evolucionit...”⁶.

Mundësia e kthimit të suksesit taktik në sukses operativ e strategjik është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e ligjit të kalimit të ndryshimeve sasiore në ndryshime cilësore. Shpesh ndodh që sukseset e vogla taktike, ndonjëherë dhe pak të dukshme, gradualisht të çojnë në suksese taktike dhe këto, nga ana tjetër, në suksese operative e strategjike. Suksesi (apo mossuksesi) i një batalioni, shoqëruar me atë të batalioneve të tjera, çon në suksesin (apo mossuksesin) e brigadës; suksesi (apo mossuksesi) i një brigade, shoqëruar me atë të brigadave të tjera, çon në suksesin (apo mossuksesin) e divizionit e kështu me radhë. “Çdo kombinacion strategjik mbështetet mbi rezultatet taktike dhe këto, të arritura me ose pa gjak, janë shkaku themelor dhe real i përfundimit se, në çdo rast, vetëm rezultatet e mëdha taktike mund të çojnë në rezultate të mëdha strategjike..., rezultatet taktike kanë një rëndësi të dorës së parë në zhvillimin e luftës”⁷. Pikërisht ky ligj të orienton në mënyrën e veprimit ndaj armikut. Në rast se armiku ka epërsi në forca dhe mjete, është shumë e logjikshme që kësaj t’i përgjigjesh me veprimtari mbrojtëse. Nëpërmjet kësaj veprimtarie ta ndalosh mësymjen e kundërshtarit, ta gjakosësh e konsumosh atë dhe të përgatitësh kushtet për të kaluar në kundërsulm, kundërgoditje e kundërmësymje, duke u shndërruar në një cilësi të re, nga mbrojtja në mësymje. “Shfrytëzimi i suksesit është në radhë të parë një mjet për kalimin e suksesit taktik në atë operacional”⁸.

⁶ Dypon, “Kuptimi i luftës”, Tiranë 1997, faqe 35-36.

⁷ Klauzeviç, “Mbi luftën”, Tiranë 1995, Vol.II, faqe 144.

⁸ “Taktika” FM 100-40, Tiranë 2002, faqe 189.

Ligji i zhvillimit të pabarabartë të veprimeve luftarake në kohë dhe hapësirë

Lufta dhe operacionet e luftimit zhvillohen në një hapësirë dhe në një kohë të caktuar. Por asnjëherë nuk ka ndodhur që intensiteti, forcat pjesëmarrëse, armatimi dhe teknika e përdorur të jetë i njëjtë. Zhvillimi i pabarabartë i luftimeve është rrjedhojë e një logjike dhe një sërë faktorësh që e përbëjnë atë.

Lufta nuk është një fenomen statik që fillon e zhvillohet në mënyrë uniforme. Ajo është një fenomen shumë dinamik dhe në ecurinë e saj situatat ndryshojnë vazhdimisht dhe me shpejtësi. Si rrjedhojë, vazhdimisht e në mënyrë të pashmangshme, linden mundësi të reja, shpesh të kundërta me njëra-tjetrën, të favorshme dhe të disfavourshme, të cilat duhen vlerësuar drejt dhe shpejt. Ai që di të vlerësojë drejt dhe shpejt mundësitë e favorshme e të disponueshme që merr masat për shndërrimin në realitet të të parave dhe moslejimin e shndërrimit në realitet të të dytave, siguron suksesin. “Në luftë-ka thënë Napoleoni- ka gjithmonë një çast të favorshëm. Gjeniu e kap atë”.

Por në luftë gjithmonë ekziston mundësia e shndërrimit të fenomeneve në të kundërtën e tyre. Në qoftë se nuk parashikohen e nuk merren masat, mund të ndodhë që të kalohet nga i sulmuar në sulmues, nga i rrethuar në rrethues, nga i fortë në të dobët, etj, dhe kjo ka të bëjë pikërisht me atë rrjedhojë të ndryshimeve sasiore dhe cilësore.

Përfundime

Përqendrimi i forcës në kohë dhe në hapësirë duhet kuptuar drejt, nëpërmjet stërvitjes së trupave, trajnimeve të shtabeve e drejtuesve në të gjitha nivelet, për t’i vënë ato në funksion të operacioneve e, veçanërisht në funksion të veprimeve mbrojtëse e mësymëse, ku më konkretisht, siç ka thënë Zhomini: “Pathyeshmëria qëndron tek mbrojtja, ndërsa mundësia e fitores, tek sulmi.... Dikush mbrohet kur fuqia e tij është e pamjaftueshme, ndërsa ai sulmon kur ka forca të mëdha”.

Mendoj se objektivat e veprimeve luftarake mbrojtëse duhen kuptuar në :

- mposhtjen e fuqisë luftarake të armikut dhe thyerjen e mësymjes së tij;
- mbrojtjen me këmbëngulje të rajoneve të caktuara dhe moslejimin e pykëzimit të armikut;
- fitimi e kohës, duke konsumuar fuqinë luftarake të armikut;
- përqendrimin e forcave në drejtimet më të kërcënuara;
- mbajtjen me këmbëngulje të objektivave të rëndësishëm taktikë;
- detyrimin e armikut në përqendrimin e forcave dhe mjeteve në rajone e drejtime ku ato bëhen më të prekshme nga zjarri dhe veprimet tona.

Një mbrojtje e suksesshme nuk është e pandarë nga veprimet sulmuese:

- Tërheqja e kundërshtarit nga mbrojtësi në ato rajone luftimi a pozicione zjarri ku ai ka përqendruar fuqinë luftarake dhe ka organizuar një sistem të integruar zjarri.
- Përqendrimi i fuqisë luftarake mbi armikun për të marrë nismën dhe për të përcaktuar drejtimin kryesor ose qendrën e rëndësës në të cilën përqendrohen forcat dhe mjetet kryesore.

- Përputhja dhe bashkërendimi i veprimeve luftarake në kohë, në hapësirë e në funksion të qëllimit për të përqendruar fuqinë luftarake relative maksimale në një vend e në një kohë vendimtare.
- Momenti më vendimtar në operacionet mbrojtëse është dhënia e kundërsulmit.
- Mbështetja me zjarr përdoret për të vonuar, dëmtuar dhe asgjësuar forcën mësymëse dhe për të rritur efektet e zjarrit të drejtpërdrejtë e të përqendruar.
- Goditja kryesore ose drejtimi kryesor planëzohen e përdoren nga forcat e mjetet më të shumta të luftimit, të mbështetjes luftarake dhe mbështetjes logjistike të luftimit.
- Rezerva është një element i rëndësishëm për të përballuar situatat e paparashikuara dhe për t'u përdorur në çastet vendimtare të operacionit mësymës. Rezerva në mësymje duhet të ketë lëvizshmëri të lartë dhe fuqi të madhe zjarri.
- Manovra duhet të synojë kapjen në kohë dhe mbajtjen e terreneve kyçe dhe vendimtare të cilat ofrojnë më mirë vrojtim, zbulim, maskim dhe mundësi më të mira për hapjen e zjarrit. Synimi i manovrës mësymëse është të arrijë një përqendrim vendimtar (përqendrim të forcave e të mjeteve) në pikën vendimtare.
- Vendimi më i rëndësishëm e më i vështirë dhe vendimtar për komandantin, në operacionet mësymëse, lidhet me kohën, vendin dhe rrethanat e përqendrimit të forcave dhe mjeteve si dhe me futjen në luftim të rezervave.

Ndërsa për operacionet mësymëse mund të themi se drejtimi kryesor i mësymjes duhet të plotësojë disa kushte:

- së pari, të ketë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen dhe manovrën e forcave në mësymje dhe për zhvillimin e saj;
- së dyti, të ketë lidhje organike me drejtimet e tjera që takohen në objektiva të rëndësishëm;
- së treti, të mos përshkohet nga pengesa ujore paralel me frontin ose ato të jenë sa më të pakta e të lehta për kalim;
- së katërti, të sigurojë lëvizje e zhvendosje të shpejtë të trupave në mësymje dhe nga njëri drejtim në tjetrin. Në mësymje goditja kryesore jepet atje ku është përcaktuar drejtimi kryesor.

Bibliografia:

- Dypoi “Kuptimi i Luftës”;
- Taktika”FM 100-40;
- Doktrina e Forcave Tokësore të NATO- s;
- Klauzeviç, “Mbi Luftën”, Vëllimi I, Viti 1994;
- Klauzeviç, “Mbi Luftën”, Vëllimi II, Viti 1995;
- Sun Xu, “Arti i Luftës”, Viti 1994;
- Doktrina e Përbashkët e Forcave të Armatosura (DPU);
- AJP-01(D), AJP-03(B), AJP-3,2, AJP-05.

Roli dhe rëndësia e rezervës ushtarake në situatat luftarake

Nënkolonel Halil Myrteza,
Kursant KLO

Kolonel Eduart Bala,
Shef i Departamentit S&H, AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Referati ka si qëllim të paraqesë një vështrim të shkurtër mbi rolin e rezervës në tërësi dhe rezervës strategjike në veçanti si një parim i artit të luftës, trajtuar nga strategu historik ushtarak, Klauzeviç. Trajtesa nuk paraqet anën historike të rolit të rezervës, por analizon rolin e rezervës në tërësi dhe rezervës strategjike në veçanti, në mënyrë të shkurtër, në bazë të mendimit kritik dhe artit operativ të luftës, si dhe jep disa përfundime mbi rolin e saj dhe faktorët që duhen patur parasysh gjatë zbatimit të saj.*

Për më tepër, krahas artikulimit të rolit të rezervës, kjo trajtesë synon të japë konkretisht refleksionet e rolit të rezervës në tërësi dhe rezervës strategjike në veçanti, në doktrinat dhe manualët ushtarake. Në pjesën e tretë trajtesa pasqyron aplikime, shembuj konkretë të rolit të rezervës në operacione dhe luftëra të ndryshme.

Kjo trajtesë e shkurtuar, krahas çështjeve të përmendura më lart, synon t,i japë një përgjigje pyetjes qendrore, si dhe debatit mbi faktin se a është i nevojshëm studimi i parimeve të hershme të luftës, në këtë periudhë të progresit të shpejtë të teknologjisë.

Kësaj pyetjeje dhe debatit i ka dhënë përgjigje analisti T. Dupoi në librin e tij “Kuptimi i Luftës”. Në këtë libër, Dupoi citon se “...studimi i historisë së luftërave të mëparshme mbetet i rëndësishëm dhe me interes, historia krijon bazën, nga e cila mund të gjykoen efektet e parashikuara të teknologjisë së re”¹.

Roli i rezervës në tërësi dhe i rezervës strategjike në veçanti, sipas Klauzeviçit

Në veprën e mendimtarit Karl Fon Klauzeviç, hidhet dritë dhe trajtohen shumë parime dhe elemente themelore të luftës, të cilat janë aktuale edhe sot. Krahas trajtimit të parimeve të luftës, Klauzeviç ka artikuluar dhe ka vënë bazat e rolit të rezervës në tërësi dhe rezervës strategjike në veçanti. Konkretisht, në librin e tij “Mbi Luftën”, mendimtari strategjik ushtarak Klauzeviç i kushton vëmendje të posaçme edhe rezervës.

Në këtë drejtim, Klauzeviç, si një mendimtar i shquar i artit të luftës jo vetëm ka artikulluar konceptin bazë mbi rolin, përdorimin e rezervës, por edhe ka vlerësuar domosdoshmërinë dhe rëndësinë e pasjes së rezervës kur citonte se: “gjithçka në luftë është e thjeshtë, por gjëja më e thjeshtë është e vështirë”¹. Në këtë mënyrë, Klauzeviç, duke identifikuar kundërshtitë dhe paqartësinë e luftës, nxjerr në pah dhe thekson rëndësinë dhe domosdoshmërinë e rezervës.

Për më tepër, për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e rezervës, mendimtari i shquar Klauzeviç jep një arsytim të plotë dhe të qartë kur thotë se: “Në taktikë, në përgjithësi, nuk njihet rreshtimi luftarak i kundërshtarit, veçse duke u përpjekur ta llogaritësh atë vetë. Çdo pyll apo çdo thyerje e terrenit mund të fshehë një pjesë forcash dhe prandaj nevojitet të jesh gjithmonë i përgatitur për çdo të papritur, për të përforcuar, mundësisht nga shpina, pikat që do të rezultojnë tepër të dobëta dhe për të mundur, mbi të gjitha të përshtatësh më mirë, rreshtimin tënd luftarak me atë të kundërshtarit”².

Në citimin më sipër janë tre fjalë kyçe, nëpërmjet të cilave Klauzeviç nxjerr në pah parimet bazë të operacioneve luftarake. Në këtë mënyrë, kur përmend “për të përforcuar” rezervën, mundësisht nga “shpina dhe pikat më të dobëta”, nënkupton elementin e taktikës, manovrën. Në vazhdim të kontributit të tij në shërbim të luftës, mendimtari i shquar Klauzeviç nuk mjaftohet vetëm me përcaktimin e rëndësisë dhe domosdoshmërisë së rezervës, por ai ka përcaktuar saktë thelbin e rolit të rezervës.

Në këtë mënyrë, në librin e tij “Mbi Luftën”, ai përcakton detyrat e rezervës kur thotë se: “Një rezervë mund të ketë dy detyra të ndryshme: e para, është që ajo të zgjasë dhe të ripërtërijë luftën dhe e dyta, të përballojë rastet e paparashikuara. Rasti në të cilin dërgohet një sasi forcash në një drejtim ku rrezikohesh të thyhesh nga armiku hyn dukshëm në detyrën e dytë, pasi nuk ishte parashikuar sa duhet qëndresa që duhej bërë në atë pikë”³.

Për më tepër, në veprën e tij në shërbim të luftës, Klauzeviç hedh dritë edhe mbi konceptin e përdorimit të rezervës në nivelin taktik. Ai thotë se, “Një sasi forcash, e caktuar për të zgjatur luftën dhe e mbajtur në rezervë për një qëllim të tillë, nëse është jashtë rrezes së veprimit të armëve të zjarrit, por e mbajtur në vartësi të atij që drejton luftimin, të cilit i është caktuar në mënyrë të përhershme, do të ishte një rezervë taktike dhe jo strategjike”⁴.

Pra, në taktikë, rezervat japin mjetin jo vetëm për të përballuar efektet e rendimeve të paparashikuara armike, por edhe për të rivendosur, në rast nevojë, rezultatin, (gjithnjë të paparashikuar të luftimit), kur ai hyn në një rrugë të pafavorshme. Por strategjia duhet të heqë dorë nga ky mjet, të paktën për sa i përket zgjidhjes kryesore. Si rregull, ajo nuk mund të riparojë një përmbysje të pësuar në një pikë, veçse me suksese të arritura në pika të tjera. Dhe, në ndonjë rast të rrallë, duke lëvizur forca nga një pikë në tjetrën, nuk duhet të tërhiqemi kurrë nga koncepti për të mbajtur paraprakisht forca rezervë për të ndrequr mossukseset e mundshme⁵.

¹ T. N Dupoi, Ibid. faqe 47.

² Karl Fon Klauseviç, “Mbi Luftën”, faqe 107.

³ Karl Fon Klauseviç, Ibid.

⁴ Ibid, faqe 107.

⁵ Ibid, faqe 110.

Mendimtari strategjik Klauzevic jo vetëm që pasqyroi rëndësinë dhe rolin e rezervës, por ai kontribuoi dhe në konceptin e përdorimit të saj në nivelin strategjik. Këtë ka pasur parasysh kur thotë: “Dikush dallon tek rezerva strategjike faktin e mençurisë dhe të parashikimeve të sakta strategjike, të tjerë, përkundrazi, e mohojnë e së bashku me të mohojnë çdo koncept për rezervën, pra edhe për rezervën taktike”⁶.

Në paragrafin më lart, Klauzevic tërheq vëmendjen për kujdesin që duhet treguar mbi përdorimin dhe futjen në luftim të rezervës. Kjo kërkon një planëzim, zgjuarsia dhe intuitë të madhe të komandës e të shtabit, për përdorimin me kujdes dhe largpamësi të rezervës në kohën e duhur dhe në vendin e duhur.

Trajtimin të rolit të rezervës i ka bërë jehonë edhe mendimtari tjetër i shquar Dupoi në librin e tij “Kuptimi i Luftës” kur thotë se: “Kur shihet me këtë sy (dhe jo thjeshtë si përdorim me nikoqirllëk i rezervave apo përkujdesje për të shmangur humbjet),⁷ ekonomizimi i forcave harmonizohet mjaft qartë me parimet e tjera të Fuller-it, si dhe është plotësisht në përputhje me lëvizshmërinë (ose manovrën), ashtu si dhe me shpejtësinë në luftë”.

Ekonomizimi i forcave, i praktikuar nga Napoleoni (nga shembujt e të cilit Fuller-i formuloi konceptet e tij), ishte shumë larg nga forma e përkujdesjes; ishte një guxim i paramenduar, por i llogaritur me kujdes, që i lejonte atij edhe kohë, edhe mundësi për të mundur forca numerikisht më të mëdha. Ajo arrihej duke përdorur lëvizshmërinë dhe manovrën, si dhe duke shfrytëzuar shpejtësinë për të arritur një fuqi luftarake më të madhe në rajonin vendimtar, përpara se armiku të mundësonte përdorimin e ekonomizimit të forcave në një vend tjetër. Edhe Napoleoni, në citimin më lart, në mënyrë të tërthortë bazohet në rolin e rezervës të artikuluar nga Klauzeviç kur shprehet për përdorimin e forcave në një vend tjetër (rezervë).

Për më tepër, jo vetëm mendimtari i madh Klauzeviç, por edhe Fuller-i përcakton rëndësinë e rezervës kur thotë: Vlerësimi cilësor i faktorëve që shumëzojnë forcën për mbrojtësit jepet kur krahasohet me palën mësymëse, mbrojtësi ka zakonisht përparësinë e fortifikimit dhe vlefshmërinë e rezervës⁸. Megjithatë, këto zakonisht janë të mjaftueshme për të përmbysur faktorët që shumëzojnë forcën e mësymësit. Përveç kësaj, lidershipi i ulët i mbrojtësve ka qenë një dukuri historike, që kontribuon pa dyshim në suksesin e mësymësve.

Reflektimi i rolit të rezervës në tërësi dhe i rezervës strategjike në dokumentet dhe manualët bazë

Konceptet e mendimtarit strategjik Klauzeviç për rolin e rezervës në tërësi dhe të rezervës strategjike në veçanti, reflektohen dhe kanë gjetur pasqyrim të gjerë në dokumentet dhe manualët kryesore, në shërbim të Forcave të Armatosura. Në këtë mënyrë, edhe Doktrina e Përbashkët DPU 10 artikulon rëndësinë dhe domosdoshmërinë e rezervës. Në të shkruhet se: “Mbajtja e një rezerve është e domosdoshme

⁶ Ibid, faqe 111.

⁷ T. N Dupoi, Ibid, faqe 47.

⁸ Ibid, faqe 305.

për t'u përgjigjur situatave të paparashikuara, zhvillimeve të papritura dhe nevojave për furnizim të vazhdueshëm në çdo lloj operacioni”⁹.

Në vazhdim, në doktrinën DPU 10 shkruhet se: “Nëpërmjet rezervave sigurohet zhdërvjelltësia dhe ekuilibri i operacioneve. Parim bazë është që, çdo komandant të krijojë një rezervë të fuqishme dhe, pas futjes në luftim të saj, menjëherë të krijojë ose të sigurojë një rezervë të re”¹⁰.

Rëndësi vendimtare për çdo komandant ka fakti që rezervën ta përdorë në kohën dhe në vendin e duhur. Përbërja dhe detyrat që do të kryejë rezerva do të varen nga: misioni, lloji i operacionit, terreni, përbërja dhe gjendja e forcave të armikut, mundësitë luftarake dhe koha në dispozicion.

Për më tepër, në doktrinën dhe manualin në përdorim në Forcat e Armatosura, përcaktohen pak a shumë të njëjtat detyra dhe i njëjti rol i rezervës në tërësi dhe i rezervës strategjike në veçanti, të përcaktuara më parë nga Klauzeviç. Konkretisht, sipas doktrinës DPU 10, detyrat kryesore të rezervës janë:

a. *Në mësymje*. Në operacionin mësymës rezerva është një element i rëndësishëm për të përballuar situatat e paparashikuara dhe për t'u përdorur në momentet vendimtare të operacionit. Rezerva në mësymje duhet të ketë lëvizshmëri të lartë dhe fuqi të madhe zjarri¹¹.

Në operacionin mësymës rezerva, zakonisht, zhvillon suksesin e arritur drejt objektivave të largëta; merr pjesë në asgjësimin e armikut të rrethuar; përforcon objektet e kapura; përdoret për asgjësimin e desantit ajror e të grupeve zbuluese e diversioniste; zgjidh detyra të tjera të paparashikuara, që mund të dalin në ecurinë e zhvillimit të operacionit¹².

b. *Në mbrojtje*. Po sipas kësaj doktrine përcaktohen dhe detyrat e rezervës në mbrojtje: Rezerva operative në operacionet mbrojtëse konsiderohet element i rëndësishëm që siguron mundësinë e marrjes së nismës. Ajo mbahet në thellësinë operative të mbrojtjes dhe siguron dhënien e kundërgoditjes ndaj pykëzimeve të armikut, duke rivendosur gjendjen në brezin kryesor të mbrojtjes ose atje ku është e nevojshme dhe e mundshme. Rezerva operative mund të përdoret edhe për asgjësimin e desantit ajror¹³.

Për më tepër, doktrinën dhe manualin në përdorim në Forcat e Armatosura, jo vetëm që trajtojnë në thelb rezervën, por ato japin dhe konceptet moderne dhe bashkëkohore të rezervës, nëpërmjet konceptit të rezervës materiale (logjistike) si më poshtë: Vijimësia e operacioneve është e lidhur me sigurimin e rezervave materiale, vendosjen e tyre në përshtatje me idenë e operacionit dhe furnizimin e pandërprerë të trupave. Rezerva është një pjesë forcash, që mbahet në prapavijë ose që nuk futet në veprim që në fillim të operacionit, për të qenë në dispozicion për një lëvizje vendimtare.¹⁴

⁹ DPU-10, faqe 218.

¹⁰ Ibid.

¹¹ Ibid, faqe 229.

¹² Ibid.

¹³ Ibid.

¹⁴ Ibid.

Mbajtja e një rezerve është e domosdoshme për të siguruar aktivitetin e mbrojtjes dhe për t'iu përgjigjur situatave të paparashikuara dhe të papritura. Nëpërmjet rezervës sigurohet zhdërvjelltësia dhe ekuilibri i mbrojtjes. Funkcioni bazë i rezervës në mbrojtje është të përforcojë e të bllokojë drejtime a rajone më të kërcënuara, të kundërsulmojë kur është e domosdoshme, të zëvendësojë njësi a reparte që humbasin përkohësisht fuqinë luftarake, si dhe të mbrojë krahët e shpinën e forcave kryesore të luftimit.

Edhe taktika FM 100-40 pasqyron në mënyrë të plotë rezervën, si dhe jep, në detaje, elemente thelbësore të saj si madhësinë e forcave të vendosura në formacion rezervë, qëllimin e tyre strategjik, etj.

Gjatë ndeshjes me armikun, rezerva i siguron komandantit fleksibilitetin për të kundërvepruar në rrethana të paparashikuara dhe lejon formacionin të rifillojë me shpejtësi lëvizjen¹⁵. Për më tepër, çdo komandant, menjëherë pas futjes në përdorim të rezervës së tij, duhet të krijojë ose të sigurojë një rezervë të re.

Koncepti i rezervës është trajtuar gjerësisht edhe në dokumentet dhe manualët e NATO-s. Në këtë mënyrë AJP 3-2 thekson me forcë domosdoshmërinë e rezervës kur thotë “Shtetet dhe NATO duhet të sigurojnë, individualisht dhe kolektivisht, rezerva me burime² logjistike të standardizuara/të miratuara, për të mbështetur forcat që i caktohen NATO-s për spektrin e plotë të operacioneve të saj. Operacionet e udhëhequra nga NATO duhet të kenë akses në logjistikën e mjaftueshme në çdo fazë të operacionit. Gjithashtu, operacionet duhet të jenë të mbështetura për gjithë kohëzgjatjen e misionit”¹⁶.

Në vazhdim, AJP 3-B pasqyron edhe rrugët për sigurimin e rezervës logjistike. Ekziston një larmi mekanizmash, nëpërmjet të cilëve mund të sigurohet mbështetja, duke përfshirë marrëveshjet/kontratat shumëkombëshe e dypalëshe. Në të njëjtën kohë, burimet logjistike të nivelit kombëtar duhet të jenë të mjaftueshme për të arritur standardet e përcaktuara të gatishmërisë, të mbështetjes afatgjatë dhe të lëvizshmërisë, që të garantohet kapaciteti ushtarak i kërkuar në kohë paqeje, krize e konflikti¹⁷.

AJP 3-2 jo vetëm që jep konceptet bazë të rezervës, por në të njëjtën kohë, manuali artikulon edhe konceptin e rezervës strategjike dhe si mund të krijohet dhe mbahet ajo në kushtet aktuale të vendit tonë, pas anëtarësisë në aleancën më të fortë ushtarake, në NATO.

Në vazhdim të idesë së paraqitur më lart, AJP 3-2 artikulon në mënyrë të plotë dhe të saktë katër nivelet e rezervës: strategjik, operativ, taktik dhe individual. Secili nivel shfrytëzon disa ose të gjitha funksionet e mbështetjes logjistike të luftimit (CSS), zbaton parimet e logjistikës dhe përpiqet të shfrytëzojë efektin sinergjik të tyre në sigurimin e mbështetjes afatgjatë¹⁸.

Duke u futur në thelbin e konceptit të rezervës strategjike, AJP 3-2 jep rrugët të cilat kontribuojnë në sigurimin e saj, gjë e cila është një proces i ndërlikuar dhe kërkon

¹⁵ FM 100-40 faqe 137.

¹⁶ AJP 3.2 faqe 5-3.

¹⁷ Ibid.

¹⁸ AJP 3.2 faqe 5-8.

përfshirjen e gjithë aktorëve me qëllim jo vetëm mbështetjen e një operacioni, por edhe realizimin me sukses të tij. Mbështetja strategjike lidh bazën industriale kombëtare me një forcë të dislokuar, duke siguruar burimet e nevojshme për të kryer operacione. Ajo synon të krijojë forca në gatishmërinë e duhur për operacione dhe përqendrohet në gjetjen e bazës materiale, në krijimin e rezervave dhe në sigurimin e lëvizshmërisë strategjike. Gjithashtu, vlerëson balancën ndërmjet pajisjeve civile e ushtarake, strukturës e bazës industriale kombëtare të mbrojtjes dhe kohën që kërkohet për të gjetur bazën materiale. Ajo arrihet nëpërmjet një ndërthurjeje të kapaciteteve industriale dhe organizmave logjistike të mbrojtjes. Ndikohet nga shumë faktorë, duke përfshirë koston, por përpjekja për rendiment, në kohë paqeje, duhet të drejtpeshohet me nevojën për rezultate në operacione¹⁹.

Shembuj nga zbatimi i rolit të rezervës në operacione luftarake dhe beteja të ndryshme

Të dy palët kundërshtarë që ballafaqojnë forcat në luftë, synojnë të arrijnë fitoren, por vetëm njëri palë do t'i buzëqeshë ajo. Fitorja përfundimtare nuk mund të varet nga suksesi i një sulmi të vetëm, sado i shkëlqyer të jetë ky sulm, por ky sulm duhet të lidhet me një numër sulmesh të tjera.

Eksperiencia e luftërave në të shkuarën ka provuar se për ta paguar me çdo çmim fitoren, forcat sulmuese të përgatitura, të udhëhequra nga komandantë të zotë dhe të ndërgjegjshëm kanë shpërthyer gjithmonë edhe mbrojtjet më të fuqishme, të cilat konsideroheshin fillimisht të papushtueshme nga forcat që ndodheshin të vendosura në mbrojtje.

Në këtë kuadër, sidomos futja sidomos në luftim e forcave rezervë, në momentin më të përshtatshëm, pasi kundërshtari kishte konsumuar çdo gjë, edhe për pushtimin e vijave mbrojtëse të fortifikuara, ka shpejtuar arritjen e fitores. Mjafton të përmendim veprimet luftarake të Napoleonit, i cili në fazën vendimtare të luftimeve fuste në veprim rezervat, duke u nisur nga parimi: “Fuqia më e madhe luftarake gjithmonë fiton kur drejtohet nga takticienë e strategë të shquar, kur është e vendosur për të kryer detyrën e ngarkuar dhe kur nuk i mungojnë furnizimet e duhura me mjete lufte dhe mbijetese.”

Operacioni i Kursk-Obojanit është një mësim, por edhe një aplikim i suksesshëm i rolit të rezervës në veçanti. Ky operacion u planëzua si operacion shpërthimi, por nuk përfundoi me shpërthimin e mbrojtjes dhe me fitoren vendimtare për mësymësin. Në këtë rast, gjermanët sulmuan rusët. Gjermanët e kishin përparësinë e efektivitetit luftarak relativ dhe epërsinë në lëvizshmëri në fushën e betejës, por këto qenë të pamjaftueshme për të përmbysur përparësinë vendimtare të rusëve, të cilët kishin rezerva të mëdha dhe pozicione të parapërgatitura²⁰. Në këtë mënyrë, në paragrafin më sipër, jepet shembulli konkret në përdorimin e rezervës së përdorur nga Gjenerali Zhukov në Luftën e Dytë Botërore, gjatë një operacioni rezervë e cila shkatërroi sulmin gjerman.

¹⁹ Ibid.

²⁰ T. N Dupoi, Ibid, faqe 305.

Në paragrafin në vijim paraqitet rëndësia e rezervës së përdorur në operacion, në një rol tjetër të rëndësishëm të saj, atë të ruajtjes së tempit të sulmit dhe futjes së energjisë së freskët dhe ripërtëritjen e trupave për vazhdimin e sulmit. “Pavarësisht nga përparimet e shpejta në fillim të operacionit, gjermanët nuk bënë gjë tjetër, veçse konsumuan trupat efektivë dhe u detyruan të ndaleshin, për shkak të mungesës së përforcimeve” (rezervës)²¹.

Në vazhdim të analizës së përlshjes në Kursk, Dupoi shton se: “Rusët, nga ana tjetër, ishin në gjendje të fusnin në betejë, pa asnjë vështirësi, trupa të freskëta (rezervë). Gjermanët patën mundësi të përdornin koeficientët shumëzues të forcës, për të rritur raportin e forcave prej 0,69, në një raport të fuqive luftarake prej 1,31, por kjo nuk mjaftoi për të siguruar shpërthimin dhe fitoren”.

Zbarkimi në *Inchon* (lufta në Kore shtator 1950) ishte një tjetër shembull i suksesshëm i zbatimit të rolit të rezervës në tërësi, dhe i rezervës strategjike në veçanti. Pas tërheqjes së forcave koreane dhe atyre amerikane, në perimetrin *Pusan*, Komanda e Paqësorit drejtuar nga Gjenerali *Mac Arthur* përgatiti kundërsulmin nga deti në *Inchon*. Zbarkimi i 40.000 trupave të divizionit të parë të marinës së SHBA-së siguroi goditjen e trupave të Koresë së Veriut nga një drejtim tjetër në shpinë.

Futja në luftim e rezervës, zbarkimi në *Inchon* ishte vendimtar në kundërmësymjen mbi trupat e Koresë së Veriut, si dhe shënoi thyerjen përfundimtare. Futja e trupave të SHBA-së dhe trupave koreano-jugore në luftim, në bregdetin e *Inchon* ishte një vendim i drejtë, pasi siguroi befasinë, sulmoi armikun në shpinë, ishte rruga më e shkurtër për në kryeqytetin Seul dhe në këtë mënyrë, një shembull i suksesshëm i përdorimit të rezervës.

Por historia nuk na afron gjithmonë shembuj të suksesshëm betejash si ajo në *Kursk*, *Inchon*. Nga ushtritë që përplasen, vetëm njërës do t’i buzëqeshë fati i fitores. Shembulli në vazhdim na kujton edhe humbje që krahas dobësive të tjera, pasqyrojnë, para së gjithash, mungesën e vizionit strategjik të komandantit në përdorimin e forcave (rezervës).

“Kush dëshiron një shembull të dukshëm për këtë mund të kujtojë se në vitin 1806 Prusia mbajti mënjane në Marka, nën komandën e princit të Vyttembergut, një rezervë prej 20.000 vetësh, e cila nuk mundi të arrinte Salen në kohën e duhur, përveç kësaj 25.000 prusianë të tjerë, duke u mbajtur rezervë, mbetën jo aktivë në Prusinë lindore, për t’u vënë në gjendje lufte më vonë”²².

Përfundime dhe perspektiva e rolit të rezervës në të ardhmen

Për sa më sipër, mund të themi se teoritë mbi rolin e rezervës në tërësi dhe rezervës strategjike në veçanti, sipas Klauzeviç, dhe vepra e tij mbeten aktuale edhe në ditët e sotme. Roli i rezervës në tërësi, i artikuluar nga mendimtari strategjik Klauzeviç, ka gjetur përdorim dhe është pasqyruar tërësisht në dokumentet doktrinare dhe manualet e Forcave të Armatosura, si dhe në ato të ushtrive të tjera anëtare dhe jo anëtare të NATO-s.

²¹ Ibid.

²² Karl Fon Klausevic, Ibid. faqe 107.

Megjithëse në këtë shkrim, shembujt dhe analizat e paraqitura janë të pakta, në një farë mënyrë jep dhe mbështet idenë qendrore se Klauzeviç ka qenë jo vetëm një mendimtar i shquar, por edhe një strateg i ndritur i artit të luftës.

Për më tepër, teoria e luftës mbi rolin e rezervës në tërësi dhe rezervës strategjike në veçanti, sipas Klauzeviç, është zbatuar në një formë apo në një tjetër në operacionet, luftërat e ndryshme (si në *Kurks*, *Inchon*). Në kushtet aktuale të vendit tonë, pas anëtarësisë në aleancën më të fortë ushtarake, NATO, rezerva strategjike nuk e zbeh rolin e saj, ajo duhet të sigurohet individualisht dhe kolektivisht, rezerva me burime³ logjistike të standardizuara/të miratuara, për të mbështetur forcat që i caktohen vendeve anëtare në spektrin e plotë të operacioneve të NATO-s²³.

Analisti i shquar i strategjisë moderne Kolins S. Grey ka të drejtë kur citon në veprën e tij *“Modern Strategy”* se: “Perspektiva klauzeviçiane në këtë shekull të 20^{te} mbetet autoritare”²⁴. Si rrjedhim, me gjithë zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, bazuar në analizën e mësipërme, roli i rezervës në tërësi dhe i rezervës strategjike, në veçanti, do të jetë i rëndësishëm edhe në të ardhmen.

Sidoqoftë, duhet shtuar fakti se, me futjen e vendit në NATO dhe duke pasur parasysh se luftërat e kohëve të fundit po i largohen operacioneve tokësore dhe po marrin një karakter të operacioneve në ajër, luftimit në ajër (në hapësirë), parimet dhe teoritë e lëna nga mendimtarët e luftës dhe sidomos teoritë mbi rezervën mbeten thelbësore. Njohja e parimeve, ligjeve të luftës dhe në mënyrë të veçantë, i rezervës në tërësi dhe rezervës strategjike, në veçanti, nga ushtarakët, mbetet e një rëndësie të madhe.

Së fundmi, nisur nga largpamësia dhe trajtimi me vërtetësi i parimeve të lëna në veprën e mendimtarit dhe strategut të shquar të luftës, Klauzeviç dhe sidomos i rezervës, mund të themi se edhe analistë të ndritur të luftës si Dupoi kanë patur të drejtë të thonë se: “Unë nuk e konsideroj veten jo vetëm një dishepull të Klauzeviç, por edhe një shkruar të tij”²⁵.

Bibliografi:

- T. N Dupoi, “Kuptimi i Luftës”.
- AJP 3.2.
- Colins S, Gray “Modern Strategy” Oxford University Press.
- Karl Fon Klauzeviç, “Mbi Luftën”.
- FM 100-40.
- DPU 10.

²³ AJP 3.2, faqe 5-3.

²⁴ Colins S. Gray, “Modern Strategy” Oxford University Press, faqe 271.

²⁵ T. N Dupoi, “Kuptimi i Luftës”, faqe 7.

Përmbajtja dhe kuptimi i ekonomizimit të forcave

N/Kolonel Arben Kingji,
Kursant KLO

Kolonel MSc. Fatmir Lokaj,
Shefi sektorit të operacioneve, AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Klauzeviçi është një nga studiuesit kryesorë të luftës e, në mënyrë të veçantë, i teorisë së luftës. Në studimin që i bën luftës, trashëgimia e tij është një vlerë e padiskutueshme në fushën e studimeve ushtarake. Mund të themi pa frikë se përkufizimi që ai i bën luftës, është guri themelor ose bazamenti ku mbështeten pothuajse të gjithë studiuesit pasardhës të tij.*

Ja si e përshkruan pasigurinë e konfliktit Klauzeviçi :

“Lufta lëviz në një atmosferë të përbërë nga rreziku, tendosja fizike, pasiguria dhe rasti. Çdo gjë në luftë është e thjeshtë, por edhe gjëja më e thjeshtë është e vështirë dhe këto vështirësi, në pjesën më të madhe të papritura e të paparashikuara, grumbullohen e prodhojnë fërkim, një frenë ngadalësuese mbi shtrirjen dhe shkarkimin e plotë të dhunës. Këto vështirësi përbëhen nga “rreziku”, ‘tendosja trupore’, ‘informacioni’ ose mungesa e tij dhe rrethana e pasiguri të tjera të panumërta të vogla e të pallogaritshme, që burojnë nga rasti. Këto janë disa nga gjërat e pashmangshme që e pengojnë gjithmonë luftën në realitet, qoftë edhe t’i për afrohet luftës në letër e në plane”¹.

Përgatitja dhe realizimi i operacioneve ushtarake dhe i luftës, në tërësi, bëhet duke mbajtur parasysh disa parime bazë të cilat zbatohen në përputhje me kushtet konkrete dhe me karakterin e veçantë të çdo operacioni a veprimi luftarak. Këto parime janë të zbatueshme si në operacionet luftarake, ashtu edhe në operacionet e mbështetjes së paqes.

Parimet e luftës sigurojnë një bazë të përgjithshme për planëzimin dhe drejtimin e luftës dhe të operacioneve ushtarake në nivel strategjik, operative e taktik. Ato përbëjnë themelin e doktrinës ushtarake, pasi janë rezultat i sintetizuar i përvojës së luftërave të zhvilluara.

¹ Karl fon Klauseviç, *Mbi luftën*, (London: Routledge & Kegan Paul, 1962), Libri 1, faqe 53 dhe 77.

Parimet e luftës nuk janë një listë me rregulla që garantojnë vetvetiu suksesin në operacion, por, nëse zbatohen në përshtatje me situatën e rrethanat konkrete në fushëbetejë, ato krijojnë parakushtet e domosdoshme për përdorimin me frytshmëri të forcave e mjeteve në çdo operacion ushtarak. Këto parime duhet të zbatohen gjithnjë në lidhje të ngushtë me njeri-tjetrin, duke mbajtur parasysh synimin e komandantit epror, objektivin e operacionit, veprimet e palëve të tjera të përfshira në operacion, si dhe faktorët *kohë* dhe *hapësirë*.

Kuptimi i parimeve kyçe për operacionet e përbashkëta e shumëkombëshe, që bazohen në teorinë e luftës dhe përvojën praktike, siguron një bazë për zhvillimin e doktrinës. Këto parime nuk janë absolute. Situata operative mund të kërkojë theksim më të madh të disave prej tyre, në raport me të tjerat. Ato përshkruhen më gjerë në AJP-01(D), Kreu 1: Përcaktimi i objektivave, Uniteti i përpjekjeve, Mbështetja afatgjatë, Përqendrimi i forcës, Ekonomizimi i përpjekjeve, Elasticiteti, Nisma, Ruajtja e Moralit, Befasia, Siguria, Thjeshtësia dhe Shumëkombëshmëria. Konkretisht do të shohim se si e kanë trajtuar këtë parim studiuesit e luftës dhe si trajtohet në doktrinën e përbashkët dhe dokumentet e tjera.

Kuptimi dhe përmbajtja e ekonomizimit të forcave

Ky parim nënkupton se nëse fuqia luftarake kryesore duhet të përdoret në zonat ose rajonet ku mund të ketë efekte maksimale, arritja e objektivave të operacionit nuk duhet të komprometohet duke u shmangur në rajone apo drejtime më pak prioritare. Ekonomizimi i forcave do të thotë përdorimi i burimeve, në mënyrë të tillë që të arrihet objektivi parësor i komandantit.²

Le të shikojmë se si e trajton Klauzeviçi parimin e ekonomizimit të forcave dhe mjeteve. Por, para se të shikojmë tek parimi në veçanti, të shikojmë se si i trajton ai parimet në përgjithësi, ku konkretisht thekson: “Udhëheqësi ushtarak, nga ana e vet, detyrohet shumë shpejt t’i varë shpresat te ndjesia delikate e gjykimit të tij ose të thjeshtëzojë ligjin, duke e konkretizuar atë në pika mbështetjeje, të cilat përbëjnë rregullat e tij, ose së fundi, metoda e përshtatur bëhet një udhërrëfyes tek i cili ai mbështetet”³.

Duke analizuar këtë thënie të Klauzevicit, ne kuptojmë se është tepër e rëndësishme të studiosh, të kuptosh dhe të zbatosh parimet, taktikat dhe strategjinë tonë, kundër asaj të armikut, pra t’i kundërvihesh strategjisë së armikut. Faktor tjetër i rëndësishëm është të përdorësh zgjuarsinë dhe diplomacinë, për ta mposhtur kundërshtarin, me sa më pak humbje forcash dhe mjetesh. Kjo kërkon që udhëheqësit ushtarakë të jenë më të saktë gjatë gjykimeve që bëjnë në marrjen e vendimeve.

Në artin tonë ushtarak, duke reflektuar, jo vetëm parimet e Klauzeviçit, por edhe të dijetarëve të tjerë ushtarakë, ekonomizimi i forcave është përcaktuar si një ndër parimet kryesore që duhen marrë në konsideratë gjatë zhvillimit të operacioneve.

Konkretisht, në manualin AJP-5 “Doktrina e Përbashkët e aleancës për planëzimin” theksohet: “*Natyra e larmishme e operacioneve ushtarake kërkon që komandantët*

² AJP-5, faqe 8.

³ Karl Fon Klauzeviç, *Mbi luftën*, vëllimi i II, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1995, fq 112.

të marrin parasysh variante të ndryshme për përhapje. Variantet e përzgjedhura varen nga efektet e dëshiruara dhe nga një mori faktorësh të planëzimit, të tillë si misioni, situata e sigurisë, kërkesat specifike të komponentëve, mjedisi politik, implikimet ekonomike dhe infrastruktura e transportit.

Fuqia luftarake duhet të përqendrohet në kohën dhe vendin e përzgjedhur, me synimin e arritjes së rezultateve vendimtare. Forca superiore nuk nënkupton vetëm një forcë të bazuar në numrin e saj, por edhe një forcë të bazuar në aftësitë luftarake, kohezionin, moralin, shfrytëzimin e kohës, si dhe në përzgjedhjen e objektivave dhe shfrytëzimin e avantazheve të teknologjisë. Planëzimi për ruajtjen e forcave vendos kërkesat dhe identifikon masat e nevojshme e mjetet për të minimizuar ekspozimin e personelit, objekteve, materialeve e veprimeve ndaj kërcënimeve dhe dëmtimeve, me qëllim ruajtjen e lirisë së veprimeve dhe efektivitetin e operacionit. Ruajtja e forcave duhet planëzuar me kujdes, sipas një procesi ciklik në nivel strategjik, operativ dhe taktik. Planëzimi, në nivel operativ, për ruajtjen e forcave është normalisht një funksion i grupit të planëzimit të përbashkët, me mbështetjen e specialistëve të shtabit dhe këshilltarëve”.⁴

Përbërja e forcave dhe organizimi i tyre duhet të reflektojë elementët e kërkuar dhe komponentët e ruajtjes së forcave që janë të nevojshëm në zbatimin e planit të operacionit. Kërkesat për ruajtjen e forcave duhet të identifikohen qartësisht, përfshirë masat specifike që duhen marrë në përgjigje të ruajtjes së forcave ndaj kategorive të ndryshme të kërcënimeve.

Në lidhje të qartë me parimin e ekonomizimit, Klauzeviçi shprehet: “Një prej këtyre bazave e mbështetjeje të shpirtit, sipas mendimit tonë, është mbajtja e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet të gjitha forcave ose, me fjalë të tjera, mbajtja gjithmonë parasysh se asnjë pjesë e këtyre forcave nuk duhet të mbetet e padobishme... Të kesh forca në një pikë, në të cilën nuk iu jep atyre, në mënyrë të mjaftueshme, mundësinë të tregojnë vlerat e tyre, t’i vësh trupat në marshim, d.m.th. t’i heqësh ato nga veprimi, ndërkohë që forcat armike janë në luftim, është një përdorim i keq i trupave të tua. Në këtë rast, ekziston një harxhim i kotë forcash, shumë më i dëmshëm se përdorimi i tyre i papërshtatshëm. Kur veprimi duhet të kryhet, është nevojë themelore që të gjitha forcat të ndihmojnë aty, sepse edhe aktiviteti i kryer bllokon dhe drobit të paktën një pjesë të forcave të kundërshtarit, ndërsa trupat që mbahen krejtësisht inaktive janë, për momentin, krejt të asnjënjësura.”⁵

Referuar manualit FM 100-40 “Taktika”, një ndër konceptet taktike është mbështetja e ndërsjellë, mbështetje të cilën njësitë ia japin njëra-tjetrës në veprimet kundër armikut.⁶ Forcat ushtarake e realizojnë këtë parim nëpërmjet komandimit të unifikuar që siguron kohezionin e nevojshëm për planëzimin e kryerjen e operacioneve. Komandimi i unifikuar është i vështirë për t’u realizuar kur bashkëveprohet me agjenci jo ushtarake. Në këtë rast, preferohet parimi i qëllimit të unifikuar që nënkupton vullnetin e mirë, qëllimin e përbashkët, ndarjen e qartë të përgjegjësisive dhe rënien dakord për to, kuptimin e kapaciteteve dhe kufizimeve të të tjerëve. Të gjithë këto

⁴ AJP-5 faqe 42.

⁵ Karl Klauzeviç, Ibid., faqe 112, 113.

⁶ Taktika FM-100-40 faqe 84.

elementë janë thelbësorë në arritjen e qëllimit të unifikuar dhe përpjekjeve maksimale kolektive.⁷

Duhet theksuar që Klauzeviçi, parimin e ekonomizimit të forcave dhe të mjeteve, e shikon të lidhur ngushtë me:

- përqendrimin e forcave në hapësirë;
- përqendrimin e forcave në kohë;
- rezervat strategjike.

Se si gjen zbatim në manualët e sotme parimi i përqendrimit në hapësirë dhe në kohë, kjo ka të bëjë me shpejtësinë relative me të cilën forcat mund të njohin terrenin, ta kapin e ta mbajnë atë, të stabilizojnë ose të kontrollojnë një zonë të caktuar. Komandantët, me shtabet e tyre, duhet të vlerësojnë zonën e operacionit, në pikëpamje të hapësirës dhe kohës së nevojshme, duhet të realizojnë kapacitetet e mundshme për vendosjen e forcave me qëllim realizimin e objektivave të caktuara brenda kësaj zone. Komandantët mund të harmonizojnë faktorët *kohë e hapësirë*, duke zgjedhur objektivat më të afërt nga pozicionet e tyre, shkurtimin e distancës mesatare duke vepruar nga një pozicion i mesëm ose qendror, aplikimin e ideve operacionale novatore që rritin shpejtësinë në zbatim dhe mashtrim, ndryshimin e rrugëve të lëvizjes. Objektivi për një sulmues është zënia e hapësirës, sa më shpejt të jetë e mundur, ndërkohë që mbrojtësi përpiqet të mbajë kontrollin e kësaj hapësire e të vonojë ose pengojë arritjen e objektivit nga sulmuesi. Në lidhje me kohën, çdo fitim kohe është avantazh për një aktor që dëshiron të ruajë *statu quo*-në. Nëse mbrojtësi nuk është mundur plotësisht, ai mund të mbajë hapësirë dhe kohë të caktuar për t'i rezistuar sulmit derisa forca sulmuese të arrijë pikën e vet kulmore. Faktori *kohë* është jashtëzakonisht i rëndësishëm për një sulmues. Sa më pak kohë ka mbrojtësi për mobilizim, dislokim e përqendrim forcash, aq më shumë gjasa ka sulmuesi ta kapë atë të papërgatitur.

Tejkalimi i faktorit *hapësirë* përfshin lëvizjen e forcave, impaktin ose efektin e zjarrit, transmetimin e mesazheve dhe urdhrave. Avantazhet teknologjike kanë provuar zgjidhje më të mira për lëvizjet në distanca të mëdha, por veçanërisht lëvizja fizike e forcave ende paraqet probleme, që në parim janë: kufizime në mjetet e transportit në dispozicion, kërkesa për lëvizje në sasi të mëdha të forcave dhe mjeteve, konsumim kohe për lëvizjet në distanca të mëdha. Në përgjithësi, sa më larg të jetë objektivi fizik i operacionit në hapësirë aq më shumë burime fuqie nevojiten për ta realizuar atë. Raporti *forcë-hapësirë* është një nga faktorët më kryesorë në planëzimin e fushatës ose operacioneve të mëdha. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme me zgjatjen e krizës ose periudhës kërcënuese. Në përgjithësi, sa më shumë hapësirë përfshihet, aq më shumë kufizime në burime do të ketë.

Vazhdojmë të shikojmë se si trajtohet parimi i ekonomizimit të forcave dhe mjeteve prej doktrinave dhe manualeve dhe konkretisht le të fillojmë me Doktrinën e Përbashkët Ushtarake (DPU-10).

⁷ AJP-5 Kapitulli i pare.

“Sipas këtij parimi, kërkohet që në drejtimet më pak të rëndësishme ose ndihmuese të operacioneve ushtarake, të caktohen për të vepruar forca e mjete minimale të domosdoshme.”⁸

Në librin *Çështje të Strategjisë Ushtarake*, ky parim vlerësohet në këtë mënyrë: “Mjetet që zotërojmë, qoftë ato shpirtërore apo materiale, asnjëherë nuk janë të pakufizuara. Si rrjedhojë, përqendrimi i tyre në pikat vendimtare, nënkupton nevojën për t’i kursyer ato në një vend tjetër.”

Ndërsa në *Taktika FM-100-40*, parimi i ekonomizimit trajtohet në këtë mënyrë: “Ekonomizimi i forcës do të thotë dislokimi i një minimumi mundësish esenciale luftarake ose i fuqisë luftarake në drejtimet ndihmuese, me qëllim që forcat kryesore të mund të përqendrohen në rajonin ku e kërkon vendimi.”⁹ Në këtë manual theksohet që forcat dhe mjetet duhet të ekonomizohen në mënyrë të tillë që në drejtimin kryesor të përdoret sasia më e madhe e tyre, ndërsa në drejtimet ndihmuese sasi më e pakët. Gjithashtu, në bazë të parashikimit të rreziqeve dhe kërcënimeve, është e nevojshme edhe mbajtja e një rezerve, për ta përdorur atë në momentin e volitshëm.

Parimi i ekonomizimit të forcave dhe mjeteve trajtohet shumë qartë edhe në manualin e ushtrisë amerikane ku thuhet: “Ekonomizimi i forcës është shpërndarja dhe përdorimi i mençur i forcave. Asnjë pjesë e forcave nuk duhet lënë pa detyra. Kur vjen koha për veprim, të gjitha forcat duhet të veprojnë. Përdorimi i fuqisë luftarake në dispozicion të detyrave të tilla si veprimet e kufizuara sulmuese, mbrojtëse, vonuese, mashtruese, ose edhe në operacionet tërheqëse, është i matshëm për të arritur përqendrimin në një vend tjetër, në një kohë dhe një pikë përcaktuese në fushëbetje.”¹⁰

Forca mbrojtëse duhet të përqendrojë efektet e të gjithë fuqisë luftarake të saj për të dominuar mbi armikun dhe për t’i rimarrë iniciativën. Komandantët duhet të përdorin masat e ekonomizimit të forcave në rajonet që nuk implikohen në drejtimin kryesor, në mënyrë që të mund të përqendrojë efektet e forcës në rajonin ku e kërkon vendimi.

Metodat për realizimin e ekonomizimit të forcave

Ekonomizimi i forcave dhe i mjeteve është i paraparë në të tre nivelet e luftës: në nivelin strategjik, operativ dhe atë taktik. Në *Doktrinën e Përbashkët* ky parim është përcaktuar në këtë mënyrë: “Në pikëpamje strategjike, kërkohet që, në mungesë të burimeve të pakufizuara, në rajone ku interesat kombëtare nuk rrezikohen drejtpërdrejt, të pranohet një farë rreziku”. Kjo nënkupton që parimi i përqendrimit të forcave, për të arritur objektivin kryesor, nuk mund të gjejë zbatim nëse përhapen e vendosen forca e mjete në sasi të panevojshme edhe në drejtime a rajone me përparësi më të ulët. Në pikëpamje operative e taktike, parimi i ekonomizimit të forcave kërkon që në drejtimet e rajonet më pak të rëndësishme ose ndihmuese, të përdoren forca dhe mjete minimale. Zbatimi i këtij parimi mund të kërkojë që forcat e përdorura në këto drejtime të sulmojnë, të mbrohen, të vonojnë ose të kryejnë operacione mashtrimi a në mbështetje të popullsisë civile.

⁸ Doktrina e Përbashkët e Forcave të Armatosura, Tiranë, 2009, fq.31.

⁹ Taktika FM 100-40, Tiranë, 2002, Qendra e Shtypit dhe botimeve Ushtarake, fq. 80.

¹⁰ Field Manual Headquarters 100-5 Department of the Army, p 2-6, Uashington, DC, 14 June 1993.

Zbatimi i parimit të ekonomizimit të forcave dhe mjeteve trajtohet mjaft qartë në doktrinën dhe manualin e ndryshme. Në manualin fushor të shtabeve të SHBA, zbatimi i parimit të ekonomizimit shprehet mjaft qartë dhe në lidhje me parimet e tjera të luftës në këtë mënyrë: “Në të gjitha nivelet e luftës, aplikimi i suksesshëm i manovrës kërkon shkathtësi mendimi, planesh, operacionesh dhe organizimesh. Ai kërkon projektim dhe ndryshim të pikave të përpjekjes kryesore dhe zbatim të menduar të parimeve të përqendrimit dhe ekonomizimit të forcës.

Në taktikën e forcave tona të armatosura theksohet se: “Ekonomizimi i forcave është karakteristikë për veprimet luftarake dhe jo për llojin e misionit. Sipas kësaj, një njësi mund të caktohet në çdo lloj ose formë veprimi luftarak në rolin e forcës ekonomizuese. Në nivelin taktik, ky parim kërkon që në drejtimet ndihmuese të përdoret minimum i forcave dhe mjeteve. Kjo, nga ana tjetër, kërkon pranimin e rreziqeve të arsyeshme në rajone të zgjedhura, me qëllim që të sigurohet superioriteti në rajonet ku e kërkon vendimi”.¹¹

Një studiuës që e ka trajtuar gjerësisht parimin e ekonomizimit të forcave dhe mjeteve është *Foshi*. Sipas tij, ishte parimi i ekonomizimit të forcave ai që i jepte jetë “artit të luftës”, pavarësisht rrezikut të kaosit dhe konfuzionit që shkaktohej nga rrethanat e luftës moderne.

Vete *Foshi* nuk e ka përcaktuar asnjëherë qartë këtë parim, por le të citojmë vëzhgimet më të rëndësishme të tij në lidhje me parimin në fjalë: “Ekziston një proverb që thotë: *Nuk mund të gjuash dy lepuj njëkohësisht*. Në këtë rast, mund të mos kapësh asnjërin...Përpjekjet duhet të përqendrohen...Ata që mund të thonë se ekonomizimi është kursim i forcave, thonë vetëm gjysmën e së vërtetës.

Më afër së vërtetës do të ishin ata që do ta quanin atë artin e të diturit si të harxhosh me dobi dhe me leverdi, si të shfrytëzosh sa më mirë burimet në dispozicion”. *Foshi*, origjinën e këtij parimi e sheh në luftërat e Revolucionit Francez, duke patur parasysh këtu pohimin e *Zhominis* se *Napoleoni* përdorte maksimumin e forcave kundër pikës me të dobët të armikut. Është e qartë se ky parim i gjerë nuk mund të jepte rregulla për t’u përdorur në të gjitha rrethanat e mundshme. Kështu për shembull nuk mund të thuhet se të gjitha forcat gjithmonë duhet të përqendrohen në dhënien e sulmit vendimtar.

Por megjithatë ishte e qartë se çfarë mësimi kishte parasysh ky parim: pamundësinë praktike për të qenë kudo i sigurtë se armiku mund të mos jetë më i fortë dhe rrjedhimisht nevojën e marrjes parasysh të rrezikut. “Ka shumë gjeneralë të mirë, vazhdon *Foshi*, por ata përpiqen të merren me çdo gjë: përpiqen të shikojnë, të mbajnë e të mbrojnë çdo gjë, depot, linjat e komunikacionit, prapavijën, etj. Duke përdorur metoda të tilla..., në fund të fundit, do të thotë të shpërndaresh, gjë që i pengon ata të komandojnë, të përqendrohen në një çështje të vetme, të japin goditje të forta... ata përfundojnë në pafuqishëm.

A nuk ekziston atëherë, si rezultat i këtij përqendrimi, rreziku i kapjes në befasi nga armiku në vendin që nuk e pret? Parimi i sigurimit kishte për qëllim të bënte të qartë

¹¹ Taktika FM 100-40, Tiranë 2002, faqe 80.

këtë rrezik. Në komentet e tij të mëvonshme, *Foshi* shpjegon se si epërsia në strategji i kishte dhënë atij mundësinë të mundte *Ludendorfin*. “*Ludendorfi*, thotë *Foshi*, duke komentuar mësymjen e vitit 1918, e kishte përgatitur planin e sulmit me detaje taktike në mënyrë të përsosur. Atij nuk mund t’i bëje përmirësime të tjera. Por ai nuk kishte një plan rezervë ... ai nuk kishte ide për tërësinë e bashkërenduar, nuk kishte plan të një shkalle më të madhe ... Përse ai, pas çdo sulmi masiv, pavarësisht nga rezultati i shkëlqyer i secilit prej tyre, nuk mund të arrinte një sukses vendimtar? Për këtë ka vetëm një përgjigje: Fitorja përfundimtare nuk mund të varet nga suksesi i një sulmi të vetëm, sado i shkëlqyer të jetë. Ai sulm duhet të lidhet me një numër sulmesh të tjera. Ai duhet të jetë pjesë e një të tërë dhe jo vetëm e tëra. Pikërisht këtë harronte *Ludendorfi*”.

Pra *Foshi* e vë theksin në vlerën e planëzimit të një tërësie operacionesh, që çoi në dorëzimin e gjermanëve. Ishte e nevojshme të kryheshin një sërë mësymjesh të lidhura në mënyrë të tillë në të gjithë frontin e të ndërthurura me njëra-tjetrën. *Foshi* e kishte përshkruar strategjinë e vërtetë të mësymjes, madje edhe përpara luftës, si një “marshim papagalli”-domethënë si një progres që i ngjan ngjitjes shkallë- shkallë të hekurave të kafazit nga papagalli, duke përdorur në mënyrë të alternuar sqepin dhe kthetrat dhe duke u siguruar mirë përpara kalimit nga një hap në tjetrin. Sigurisht kjo thënie përputhet me parimin e ekonomizimit të forcave.

Si gjen zbatim parimi i ekonomizimit të forcave në operacionet e sotme

Termi *Smart Defense* (Mbrotjtja e Mençur) u projektua nga NATO, ku përveç prioriteteve të tjera të NATO-s pikë prioritare ishte edhe *Smart Defence*. Mendimi ushtarak, si koncept shumëdimensional prej dhjetëvjeçarësh (që pas mbarimit të *Luftës së Ftohtë*) ka qenë në krizë. Kjo krizë është vërejtur jo vetëm tek NATO apo anëtarët e saj, por edhe tek kundërshtarët e saj dhe kishte të bënte me mënyrën e përdorimit të fuqisë luftarake përballë kërcënimeve moderne.

Analistët ushtarakë arritën në përfundimin se ekonomizimi i forcave dhe përdorja e tyre me sukses është çelësi dhe hallka kryesore në zgjidhjen e krizës. Duke e parë problemin në aspektin ekonomik, kriza e nisur që në vitin 2007, filloi të prekë menjëherë disa vende dhe rezultatet ishin menjëherë të ndjeshme. Shkurtime në buxhet u shfaqën në një numër të madh të vendeve anëtare dhe NATO, duke bërë mirë llogaritë se përballë një kërcënimi që kurrë s’i dihej origjina, koha dhe vendi i kryerjes, vendosi të krijojë *Mbrojtjen e Mençur*, që në të vërtetë nuk është, asgjë më shumë se përlllogaritje forcash, mjetesh dhe operatorësh të trajnuar, në përgjigje të kërcënimit modern. Në anën tjetër, duhet theksuar se gara e armatimit në periudhën e *Luftës së Ftohtë* kishte shtuar në maksimum *Forcat Konvencionale*, të cilave po iu humbet rëndësia gjithnjë e më shumë dhe manovrimi i tyre është tepër i kushtueshëm.

Rezultati tashmë është i matshëm. *Forcat Konvencionale* nuk i përgjigjen dot kërcënimeve në kohë dhe efekti i prodhuar prej tyre është i pakët. Ato kanë një kosto të jashtëzakonshme për t’u gjeneruar në operacione. Përballë këtyre sfidave të mëdha, ku industri dhe fabrika ushtarake të tëra do të mbyllen apo numri i punëtorëve të tyre do të reduktohet, kemi edhe personelin ushtarak që do të lërë uniformën pasi nuk i nevojitet më këtij rendi shoqëror. *Ken Both*, një autor që merret me çështjet e sigurisë, parashikon reduktime drastike në të gjitha vendet e botës, madje ai shkon deri atje sa

që reduktimi në masë i ushtrisë do të zvogëlonte konfliktet dhe se kjo lloj ushtrie që ekziston sot nuk iu përgjigjet dot sfidave të reja kërcënuese.

Por zgjidhje për këtë mbeten *Forcat e Operacioneve Speciale*. Këta operatorë të cilët kanë trajnim specifik të veçantë, janë të mirëpajisur dhe të mirëorganizuar, janë i vetmi opsion që analistët ushtarakë ofrojnë si zgjidhje. Përballë një kërcënimi modern që shfaqet në forma moderne, në vende të ndryshme të globit, duhet patjetër një forcë moderne, e aftë për t'iu përgjigjur këtij kërcënimi dhe që nuk krijon efekte anësore apo, e thënë ndryshe, që nuk krijon dëme kolaterale.

Në anën tjetër, kostoja financiare për operatorët e FS që përfshin trajnim e kompletim me pajisje, është dhjetëfish më e ulët se sa ajo e *Trupës Konvencionale*, ndërsa efekti në terren është relativisht i suksesshëm, krahasuar me *Forcat Konvencionale*. Është kjo arsyeja pse SHBA do të shkurtojnë ushtrinë konvencionale me qindra mijëra vetë. Vetëm në vitet e fundit, SHBA-të kanë rritur, me miliona dollarë, investimet tek FS e tyre dhe nuk janë të vetme. Një sërë vendesh kanë filluar të bëjnë të njëjtin gjë.

Pikërisht kjo strategji po ndiqet edhe në Afganistan ku, pas vitit 2014, vendin dhe rolin e *Forcave Konvencionale* do ta zënë FS të cilat, sipas një projekti të parë, do të qëndrojnë në Afganistan deri në vitin 2020. Si fillim, aty po ngrihet komanda e FS në Kabul dhe, më pas, nëpërmjet FS, një gjeneral me tre yje do të kontrollojë jo vetëm Afganistanin, por edhe vendet fqinje. Kontrolli i një hapësire territoriale me pak *Forca Speciale*, në vend të 140 mijë *Forcave Konvencionale* do të thotë reduktim i forcave në terren, reduktim i shpenzimeve ushtarake me miliona dollarë, duke patur një ndikim më të mirë edhe të hapësirës operacionale. Po kështu, një sërë vendesh të Afrikës Veriore, të cilat kanë kuptuar drejt rolin e FS, po tentojnë të ngrënë kapacitetet e tyre nëpërmjet kërkesave për ndihmë nga NATO.

Përfundime

- Mund të arrijmë në përfundimin se *Doktrina e Përbashkët* dhe manualët, e trajtojnë parimin e ekonomizimit të forcave dhe mjeteve thelbësisht njësoj si parim universal dhe të lidhur ngushtë me parimet e tjera të luftës.
- Shpërndarja e barabartë e fuqisë luftarake dhe e elementëve mbështetës në drejtimet kryesore dhe në ato ndihmuese, është një lloj si të mos përcaktosh fare goditje kryesore. Njohja dhe zbatimi i ekonomizimit të forcave dhe mjeteve është një domosdoshmëri që jep ndikimin e vet në realizimin e operacioneve.
- Indoktrinimi i FS në vend të *Forcave Konvencionale* krijon ekonomizimin më të saktë dhe më të drejtë për kohën në të cilën gjendemi.
- Mund të themi se Klauzeviç dhe Foshi, parimin e ekonomizimit të forcave dhe mjeteve, e shikonin edhe si parim në vetvete, por më e rëndësishmja është se ata e analizonin të lidhur ngushtë me parimet e tjera të luftës.
- Për të arritur një objektiv të caktuar, komandantët dhe forcat e tyre duhet ta përdorin forcën mbi bazën e parimeve të matshmërisë dhe të proporcionalitetit të mjaftueshëm të saj.

Bibliografia:

- Karl Fon Klauzeviç, *Mbi luftën*, vëllimi i II, Tiranë 1995 .
- Taktika FM 100-40, Tiranë 2002.
- Field Manual Headquarters 100-5 Department of the Army, Uashington, DC, 14 June 1993.
- AJP-5.
- DPU-01.
- AJP-3.2.
- AJP-3(B).

Mbi përmbajtjen e strategjisë së Aleancës sipas AJP-01(D)

Nënkolonel Leonard Çoku,
Kursant KLO

Gjeneral Brigade Ylber Dogjani,
Komandant i QPR

Trajtesë e shkurtuar. *Strategjia është kompleksiteti i bashkëpunimit dhe bashkëveprimit ndërmjet objektivit, metodave të përdorimit dhe burimeve. Në shekullin e 21, strategjia nuk është më një koncept i fushës së mbrojtjes dhe asaj të sigurisë, si në rrafshin ndërkombëtar ashtu edhe në atë kombëtar. Strategjia përfshin të gjithë elementet e fuqisë në kohë paqeje dhe në kohë lufte dhe mbështet vizionin strategjik të një shteti apo aleance në arenën rajonale apo globale.*

Nëpërmjet këtij materiali të përmbledhur do të sjellim në vëmendjen tuaj disa parime, koncepte dhe konsiderata mbi përmbajtjen e strategjisë së Aleancës sipas AJP-01(D), në përfaqësim me mendimin e Klauzeviçit mbi strategjinë.

Strategjia është ura që lidh fuqinë ushtarake me qëllimet politike; ajo nuk është as fuqia ushtarake dhe as qëllimi politik me vete. Me strategji kuptojmë përdorimin që i bëhet forcës, dhe kërcënimin për përdorimin e forcës për të përfunduar politikën. Ky është një adoptim i përkufizimit të Klauzeviçit, dhëne në librin “Mbi Luftën”, i cili thekson shkurt kur përkufizon “Strategjia është përdorimi i luftimit për qëllimet e luftës”¹. Në gjuhën e thjeshtë ai na tregon në se strategjia është përdorimi i nënkuptuar dhe i qartë i kërcënit, si dhe luftërave dhe fushatave për avancimin e qëllimeve politike.

Pavarësisht se sot kanë ndryshuar, mjetet, armët, pajisjet etj, në thelb mjaft koncepte mbeten të njëjta, por ndryshojnë mënyrat.

Klauzeviç mbi strategjinë ushtarake, këndvëndvështrim i përgjithshëm mbi aplikimin e teorive të tij në ditët e sotme

Sipas Klauzeviçit “strategjia është përdorimi i luftimit për qëllimet e luftës”. Por ajo duhet te vendosë për çdo veprim luftarak një qëllim imediat dhe një qëllim final që

¹ Karl Fon Klauzeviç “Mbi Luftën” Vëllimi II, faqe 37.

duhet te arrijë. Ajo përpunon planin e luftës, lidh me qëllimin imediat serinë e operacioneve që duhet të kryhen, pra projektton planet e betejave dhe koordinon luftimet e veçanta të tyre. Strategu harton planin e luftës, qëllimi i luftës do përcaktojë serinë e veprimeve të nevojshme që synojnë arritjen e tij.

Në teorinë e sotme (që në fakt me plus minuset e veta janë thjeshtë një interpretim i teorive të Klauzeviçit), thuhet: Strategjia siguron një plan koherent, të logjikshëm për mbushjen e boshllëkut ndërmjet realiteteve të sotme dhe të ardhmes së dëshiruar. Synimi është që të arrijmë rezultate më të favorshme në të ardhmen, krahasuar me ato që mund të rezultojnë në rast se kjo i lihet rastësisë.

Në teorinë Klauzeviçiane të luftës strategjia është para se gjithash ushtarake. Ajo konsiston në vendosjen e luftimeve për të arritur objektivin e luftës, pra për të krijuar një kontekst në të cilin të mund të imponohen ose të arrijnë me armikun një paqe korrespondente me interesat ose vlerat tona, duke mbajtur parasysh raportin e forcave që përcaktohen me konfrontimin e armatosur.

Po sipas Klauzeviçit “Në strategji gjithçka është shumë e thjeshtë, por jo se gjithçka është e lehtë”². Kur nga kushte të veçanta të shtetit, është nxjerrë përfundimi se çfarë duhet e ç’ mund të jetë lufta, rruga që do të ndiqet gjendet lehtë. Po të ngulmohet me këmbëngulje të madhe në këtë rrugë, të zbatosh planin e hartuar, pa u hutuar mijëra herë nga mijëra rrethana, kërkon, përveç se një forcë të madhe karakteri, një vizion shumë të qartë dhe siguri të madhe shpirtërore.

Strategjia nga natyra e saj është tërësore, gjithë përfshirëse; qëllimi kryesor i saj është të influencojë pozitivisht mjedisin e paqëndrueshëm e kompleks strategjik nëpërmjet sigurimit të një drejtimi që garanton përdorim racional të fuqisë për përmbushjen e objektivave të shtruar nga politika. Klauzeviç preferonte si qëllim “përmbysjen e qeverisë së armikut”, si një mënyrë (koncept) “zhvillimin e betejës vendimtare” dhe si mjet (burim) “një ushtri të madhe”.

Ndoshta kjo është ideja e Klauzeviçit në citatin e famshëm: “lufta është vazhdim i politikës më mjete të tjera” Strategjia ishte një plan-fushatë për të shkatërruar armikun. Evidentohen dy veprimtari kryesore në luftë : planëzimi dhe luftimi. Me të parin do të merrej strategjia, ndërsa me të dytin taktika. Përveç nivelit politik ka edhe dy nivele ushtarake të luftës: strategjia dhe taktika.

Klauzeviç nuk përfshinte nivelin operativ të luftës (artin operativ), ndërkohë që ky fakt ka një dallim të dukshëm me AJP 01 (D). Ku sipas Doktrinës AJP 01 (D) “Niveli Operativ është ‘niveli i luftës në të cilin planëzohen, zhvillohen dhe mbështeten fushatat dhe operacionet e mëdha ushtarake për të përmbushur objektivat strategjike brenda teatrove ose zonave të operacioneve’ Arti operativ-si arti i përdorimit me mjeshtëri të forcave ushtarake, në harmoni me kapacitetet e agjencive të tjera, për të përmbushur objektivat strategjike, nëpërmjet planëzimit, organizimit, integritetit dhe zhvillimit të fushatave ose të operacioneve të mëdha – bën lidhjen midis strategjisë ushtarake dhe taktikave”³.

² Karl Fon Klauzeviç “Mbi Luftën”, Vëllimi II, faqe 40.

³ AJP 01 (D) Seksioni II Paragrafi 0115

Sipas Klauzeviçit asgjë nuk ka më tepër rëndësi në luftë se sa beteja e madhe. Strategjia prek majat e saj më të larta të konceptimit kur shtrëngohet të sigurojë mjetet për të njëjtën gjë, të përcaktojë në mënyrë të volitshme vendin, kohën dhe drejtimin e forcave dhe të nxjerrë prej andej përfitimin më të madh.

Mendimet e Klauzeviçit në zbatimin e strategjisë

Klauzeviç në përgjithësi është më i dobishëm për mendimet e tij filozofike në lidhje me natyrën e luftës se sa për këshillën e tij strategjike “si të”. Këtu mund të përmendim tre përjashtime:

Së pari, ai ishte mbështetës i kërkimit të betejës. Së dyti, Klauzeviç krijoi konceptin e goditjes së asaj çfarë ai e quante qendër e rëndësës. Qendra e rëndësës caktohet bazuar në karakteristikat e palëve ndërluftuese dhe ajo “është qendra e gjithë fuqisë dhe lëvizjes, në të cilën varet gjithçka. Kjo është pika kundër së cilës duhet të drejtohen të gjitha energjitë tona”. Së treti, apo ideja e fundit e rëndësishme e Klauzeviçit në lidhje me “si të” është koncepti i pikës kulmore. “Ka mësymje strategjike që kanë çuar drejtpërdrejt në arritjen e paqes, por këto përbëjnë vetëm një numër të vogël rastesh. Shumë nga këto goditje strategjike çojnë në atë pikë ku fuqia e tyre e mbetur është e mjaftueshme vetëm sa për të organizuar (mbështetur) zhvillimin e veprimeve mbrojtëse dhe për të pritur për vendosjen e paqes. Përtej kësaj pike, kemi ndryshimin e balancës, dhe reagimi vijon me një forcë të vogël që zakonisht është mjaft me e fuqishme se ajo e sulmit (goditjes) fillestar. Kjo është ajo çfarë ne kuptojmë me pikë kulmore të sulmit (mësymjes). Pika kulmore për mbrojtjen – në thelb kufiri kritik i rezistencës.

Në AJP 01(D) është shprehur koncepti i pikës kulmore, ku sipas saj: “Pika Kulmore arrihet si në operacionet mësymëse dhe mbrojtëse. Në mësymje, pika kulmore është pika në kohën dhe vendin, kur fuqia luftarake e mësymësit nuk është më e madhe se e mbrojtësit dhe mësymësi duhet të kalojë në mbrojtje ose rrezikon kundër goditjen dhe të pësojë disfatën. Një forcë në mbrojtje, e arrin pikën e vet kulmore, kur ajo nuk ka më aftësinë për t’u hedhur në kundërshtim me mësymje ose për të mbrojtur më gjatë pozicionet e veta dhe është e detyruar që, ose të shkëputë kontaktin, ose të tërhiqet, ose të përballlet me disfatën.”⁴

Po sipas AJP-01(D)⁵ Qendra e Rëndësës (QR) është ai element i kapaciteteve ose i sistemeve të përgjithshme të kundërshtarit, që reziston më shumë në arritjen e gjendjes përfundimtare të Aleancës, dhe në qoftë se shkatërrohet apo neutralizohet, do të çojë në mënyrë të pashmangshme në arritjen e objektivave tona. Një Qendër e Rëndësës përkufizohet si ato “Karakteristika, aftësi, ose infrastruktura nga të cilat buron liria e veprimit, forca fizike ose vullneti për të luftuar, i një shteti, i një aleance, i një forcë ushtarake apo çdo grupimi tjetër”.⁶

Përmbajtja e strategjisë së Aleancës sipas AJP-01(D)

Strategjia e Aleancës. Politikat kanë të bëjnë me aftësinë e një vendi apo organizate për të influencuar mbi qëndrimet e të tjerëve. Përpunimi i politikave ndërkombëtare

⁴ AJP 01 (D) Aneksi 5A, pika k

⁵ Doktrina e Përbashkët e Aleancës AJP-01(D)

⁶ AAP-6.

bëhet bazuar në lidhjen e zbatimit të fuqisë kombëtare me sistemin politik ndërkombëtar, përgjithësisht të motivuar nga interesat kombëtare dhe ato kolektive, si dhe në harmoni me aleatët dhe partnerët. Objektivat që synohen së bashku me mënyrat e përmbushjes së tyre përbëjnë strategjinë e madhe të një vendi. Meqë Aleanca vepron me konsensus, Strategjia e Aleancës reflekton vullnetin politik të të gjithë anëtarëve të saj.

Thelbi i Strategjisë së Aleancës. Çështja thelbësore për zbatimin e suksesshëm të marrëdhënieve të Aleancës me vendet e tjera jashtë saj është përdorimi i kujdesshëm i grupit më të përshtatshëm të instrumenteve të fuqisë së saj, në përputhje me rrethanat konkrete. Instrumentet e secilit vend duhet të përdoren në harmoni me ato të të tjerëve, nëpërmjet një strategjie të koordinuar nga Aleanca, me qëllim që të arrihet një efektivitet maksimal i përpjekjeve. Mjetet diplomatike janë normalisht më të suksesshme kur ato mbështeten në vullnetin për të përdorur, në mënyrë të hapur ose të nënkuptueshme, edhe mjetet e tjera në mbështetje të tyre, ose për t'u vënë në përdorim në rastet kur diplomacia dështon. Në teorinë e Klauzeviçit për luftën strategjia është para se gjithash ushtarake. Sot strategjia përfshin jo vetëm elementin tradicional ushtarak të fuqisë por edhe elemente të tjerë të fuqisë si atë politik, ekonomik të informacionit etj.

Komponentët e Fuqisë Luftarake

Në kontekstin e Aleancës, fuqia luftarake përbëhet nga tre komponentë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin: komponenti fizik, komponenti moral, dhe komponenti konceptual. Për konceptin që trajtohet sot në AJP 01 (D) në kontekstin e Aleancës, Klauzeviç është shprehur “ Shkaqet që në strategji ndikojnë në përdorimin e luftimit mund të grupohen në elementë të natyrave të ndryshme : Moralë, fizikë, matematikë, gjeografikë e statistikë”.⁷

Zhvillimi i fushatës

Sipas parashikimeve, çdo fushatë do të përfshijë një balancë të ndryshme dhe të veçantë, midis operacioneve të mëdha luftarake për eliminimin e kërcënimeve, nga njëra anë dhe, operacioneve të sigurisë për të lehtësuar dhe mbështetur procesin e stabilizimit dhe të paqes së qëndrueshme afatgjatë, nga ana tjetër. Kufijtë midis rezultateve të arritura në kohë të ndryshme mund të mos jenë tërësisht të qarta dhe të palosen me njëra-tjetrën (po ashtu edhe roli i forcave të NATO-s); ato mund të ndryshojnë në mënyrë të shpejtë dhe të dukshme, ose në mënyrë më graduale dhe të padukshme.

Angazhimi për të sulmuar kohezionin dhe vullnetin e kundërshtarit

Elementi vendimtar i një fushate zakonisht do të përfshijë një formë të veprimeve sulmuese kundër vullnetit dhe kohezionit të kundërshtarit. Duke e thyer kohezionin e kundërshtarit, ai nuk do të jetë në gjendje të koordinojë dhe organizojë veprimet ushtarake dhe veprimet e tjera; për më tepër është shumë më e lehtë për ta mposhtur

⁷ Klauzeviç “Mbi Luftën”, Vëll. II faqe, 50

atë pjesë-pjesë. Duke i dobësuar vullnetin e tij, kundërshtari do të jetë më pak i aftë për të motivuar forcat e tij për të ndërmarrë veprime të rrezikshme dhe mund të jetë më i gatshëm të pranojë kompromise politike apo të tjera.

Sipas Klauzeviç “ Humbja materiale në forcën e armatosur nuk është e vetmja që të dy palët kundërshtare e provojnë gjatë luftimit; edhe forcat morale janë të tronditura, të bëra copë e çikë, të shkatërruara”⁸.

Sipas AJP 3.2 për qasjen e manovrës thuhet: Qasja e manovrës është një qasje në të cilën thyerja e kohezionit të përgjithshëm të armikut dhe e vullnetit të tij për të luftuar, është parësore. Ajo është një qasje e tërthortë, që e vë theksin te përzgjedhja si objektivi i komponentit moral të fuqisë luftarake të armikut dhe jo e atij fizik. Qasja përfshin një ndërthurje të mjeteve të dhunshme e jo të dhunshme për të arritur objektiva që formësojnë të kuptuarit e tij, gërryejnë vullnetin e tij dhe prishin kohezionin e tij⁹. Ajo synon të përdorë forcë kundër pikave të dobëta të identifikuar. Tipare të rëndësishme janë shpejtësia, ritmi dhe zhdërvjelltësia, të cilat në ndërthurje me njëra-tjetrën çojnë te tronditja (shoku) dhe befasia. Ajo kërkon një mendësi sipas së cilës kryerja e veprimeve të paparashikuara, përdorimi i nismës dhe kërkimi i origjinalitetit ndërthuren me një vendosmëri të palëkundur për t’ia dalë mbanë. Është e zbatueshme në të gjitha llojet e operacioneve ushtarake përgjatë spektrit të konfliktit.

Përfundime

Strategjia është një plan veprimi i hartuar me synimin për të arritur një qëllim të caktuar. Strategjia është një koncept për të lidhur mjetet me qëllimet.

Koncepti i kohës së sotme për strategjinë, përfshin formulimin fillestar të Klauzeviçit, zgjerimin dhe zhvillimin që i bëri Lidell Harti dhe idenë e Klauzeviçit për ngjashmërinë midis luftës dhe paqes në pikepamje politike.

Strategjia e Aleancës reflekton vullnetin politik të të gjithë anëtarëve të saj. Në qendër të saj qëndron kuptimi i trinitetit thelbësor të fuqisë së diplomacisë, të ekonomisë dhe të fuqisë ushtarake, secila prej tyre si një instrument i fuqisë kombëtare.

Koncepti i sotëm për strategjinë nuk mohon konceptet e mëparëshme, përfshirë edhe atë të Klauzeviçit. Ai është zhvillim i tyre në përshtatje me kushtet e reja shoqërore, politike, ushtarake e teknologjike.

Pavarësisht se sot kanë ndryshuar, mjetet, armët, pajisjet etj, në thelb mjaft koncepte mbeten të njëjta, por ndryshojnë mënyrat.

Bibliografia:

- Karl Fon Klauzeviç “Mbi Luftën” ,Vëllimi II,
- Doktrina e Përbashkët e Aleancës AJP-01(D)
- Doktrina e Përbashkët e Aleancës për Planëzimin në nivel operativ AJP-5
- Doktrina e Përbashkët e Aleancës AJP 3.2

⁸ Karl Fon Klauzeviç “Mbi Luftën” ,Vëllimi II, faqe 150

⁹ AJP 3.2 Seksioni II Paragrafi 0207

Arti e shkenca ushtarake dhe zbatimi i tyre në doktrinat e FA

Nënkolonel MA Ardian Lulaj,
Shef/Pedagog i Grupit të Studimeve Strategjike, AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Në këtë shkrim, synojmë të argumentojmë çështjen e shtruar prej kohësh, nëse lufta është art apo shkencë? Si pasqyrohet ajo në doktrinat ushtarake të NATO-s, të Forcave të Armatosura, por edhe si është trajtuar nga teoricienët ushtarakë prej kohësh. Pyetjet që shtrohen kanë nevojë për një trajtim dhe analizë që jemi munduar ta bëjmë në shtjellimin e mëposhtëm të temës. Për këtë na u desh të shfletonim shumë e të studionim disa nga teoricienët e mendimit strategjik ushtarak që kanë trajtuar në thellësi këtë çështje.*

Pikërisht, për këtë do t'i referohemi teoricienëve më të famshëm ushtarakë përgjatë historisë, duke filluar nga antikiteti, periudha iluministe dhe koha moderne. Gjerësisht do t'i referohemi teoricienëve më të njohur, si Klauzeviç, Jomini, Dupoi, por edhe doktrinave dhe manualeve të Aleancës dhe të Forcave tona të Armatosura, që gjithsesi, janë rrjedhojë e studimit të literaturës së shkruar e përvojës së teoricienëve të përmendur më lart dhe asaj të fituar në shumë operacione luftarake dhe joluftarake. Metodave shkencore për të arritur në përfundimin se çfarë ndodh në luftë, menaxhimi i forcës ushtarake, planifikimi, projektimi dhe armët me të cilat ajo zhvillohet, janë thelbësore në shpjegimin nëse lufta është art apo shkencë. Njohuritë dhe të kuptuarit e luftës duhet të bazohen në shkencë, por sjellja e saj aktuale është kryesisht art.¹

Shkenca e luftës

Ae ka ndryshuar teknologjia natyrën e luftës? Futja e teknologjisë së re, si: rritja e precizionit të municioneve të drejtuara, metodat e automatizuara të komandim-kontrollit, shpikjet teknologjike për zotërimin dhe përdorimin e hapësirës, sistemet e vëzhgimit jashtëzakonisht të shtrenjta, e kështu me rradhë, janë shprehje e përpjekjeve shkencore për modernizimin e luftës. Duke iu referuar historisë, vihet re se ka shumë momente që çojnë në mendimin se lufta është edhe rrjedhojë e metodave shkencore, si: shpikja e barutit, përdorimi i gazit në Luftën e Parë Botërore, armët bërthamore e atomike, etj, që gjithsesi kanë ndryshuar shumë gjëra në luftë,

¹ Në trajtimin e kësaj teme jam referuar kryesisht në studimin "War as Art or Science": A Humanist Vision të Todd Richard Sears, United States Navy, Master of Arts in National Security Affairs, from the Naval Postgraduate School, December 1991.

por jo natyrën e saj. Ideja se zhvillimi i luftës është shkencë apo art është pothuajse aq e vjetër sa vetë lufta.

Në Kohën e Lashtë. Teoricienët ushtarakë filluan të kërkojnë parime dhe rregulla të caktuara në të cilat mbështetet zhvillimi i luftës. Shumë kohë më vonë mareshalli francez *Sébastien Le Prestre de Vauban* (1633–1707)² e zhvilloi artin dhe shkencën e luftës kur përdori kuptimin e tij mbi gjeometrinë, arkitekturën dhe qitjen me artileri, për të çuar më tej fortifikimin. Në 30 vitet e aktivitetit të tij profesional, *Vauban* projektoi një sërë fortifikatash dhe realizoi afërsisht 50 fitore, të gjitha të suksesshme.

Austriaku i lindur në Itali, mareshalli *Raimondo Montecuccoli* (1609–1680)³ ishte një nga praktikuesit dhe teoricienët më me influencë i fundshekullit të 17-të. Ai ishte një nga të parët i cili u përpoq të shpjegonte luftën në pikëpamje shkencore. *Montecuccoli* vuri re që si të gjitha shkencat, shkenca e luftës tenton të reduktojë eksperiencat, në rregulla dhe baza universale.

Marshalli francez *Jacques-Francois de Chastenot*⁴ (1656–1743) ndërmori një trajtim sistematik të luftës. Ashtu si edhe *Montecuccoli*, ai vuri re se lufta ishte më e rëndësishmja ndër shkencat dhe artet, e cila nuk i ishte nënshtruar një studimi teorik, por i ishte referuar më shumë traditës dhe përvojës personale të njerëzve. Sipas pikëpamjes së tij, lufta meritonte të trajtohej në pikëpamje më shkencore, ashtu siç kishte bërë *Vauban*. Kështu, ajo duhej të studiohej e lidhur ngushtë me gjeometrinë dhe gjeografinë, si dhe me zbatimin e tyre në luftë.

Teoricieni francez *Jean-Charles de Folard* (1669–1752)⁵. *Folard* iu referua shumë Greqisë dhe Romës klasike. Ai e studioi luftën nga pikëpamja shkencore, me qëllim që të zbulonte parimet dhe rregullat universale që drejtonin zhvillimin e saj. Ai trajtoi gjithashtu dimensionet psikologjike në betejë. Vlen të theksohet se shkrimet e tij ndikuan mjaft teoricienë dhe praktikues ushtarakë të asaj kohe, siç ishte *Maurice de Saxe*, Frederiku i Madh dhe Napoleon Bonaparti I (1769–1821).

² *Sébastien Le Prestre, Seigneur de Vauban*, lindi më 15 Maj 1633, në *Saint Leger Vauban*, i njohur më vonë *Marquis de Vauban*, ishte mareshal francez, inxhinier ushtarak i kohës së tij, i famshëm për aftësitë e tij në projektimin e fortifikimeve ushtarake. Ai njihet si këshilluesi i Luisit XIV, se si të forconte kufijtë e Francës për t'i bërë ato më të mbrojtura nga armiqtë e kohës. Vdiq më 30 Mars 1707.

³ Lindur më 21 shkurt 1609 në *Castle Montecuccolo*, afër Modenas, Itali. Vdiq më 16 tetor 1680 në *Linz*, Austri. Ishte një reformator ushtarak dhe mjeshtër i luftës kryesisht i bazuar në fortifikimin dhe manovrën. Ai udhëhoqi ushtritë austriake drejt fitores kundër Habsburgëve për gjysmë shekulli. Vepra e tij më e rëndësishme “*Arti Ushtarak*”, e botuar për herë të parë më 1792, është ribotuar shumë herë të tjera.

⁴ Mareshalli *Jacques François de Chastenot de Puysegur* lindi në vitin 1656, shërbeu si këshilltar i mbretit francez. Ai u konsiderua si mareshalli më me eksperiencë i *Louis XIV*. Shquhet për përvojën në studimin e çështjeve ushtarake të konkretizuara edhe me librin e tij *Arti i Luftës (Art de la Guerre)* Vdiq në vitin-1743.

⁵ Lindi më 13 Shkurt, 1669, ushtarak dhe teoricien francez. Në analizat e tij ushtarake hulumtoi teorinë e luftës duke hedhur një sërë idesh të pavarura dhe me vlerë për kohën por edhe për ditët e sotme. Vdiq në vitin 1752.

Në kohën e Iluminizmit, 1750–1800. Revolucioni shkencor i shekullit të 17-të dhe fillimi i shkencës njutoniane në veçanti, çoi në shpërndarjen e besimit ndërmjet intelektualëve evropianë, se mendja njerëzore është e aftë të formojë realitetin. Ushtarakët, kryesisht nga rangjet e larta, u influencuan nga trendi intelektual, filozofik dhe kulturor i shekullit të 18-të. Ata dolën në përfundimin se lufta, ashtu si shkencat e tjera, duhet të studiohet në mënyrë sistematike, duke krijuar kështu një teori universale të saj. Po kështu duhet të studiohet sistematikisht edhe përvoja ushtarake dhe vetë profesioni i ushtarakut dhe jo vetëm përvoja e misioneve ushtarake. Idetë dominuese në mendimin ushtarak ishin kryesisht në Prusi dhe ato të Frederikut të Madh, sidomos ana politike në lidhje me luftën, realizimi i rolit filozofik në luftë dhe zbatimi i parimeve pseudoshkencore në studimin e saj. Teoricienët më të famshëm të kohës së iluminizmit ishin, *Paul Gideon Joly de Maizeroy* (1719–1780)⁶, Frederiku i Madh⁷, *Pierre-Joseph de Bourcet* (1700–1780)⁸, *Comte de Guibert* (1743–1790)⁹ dhe *Dietrich Heinrich Freiherr von Bülow* (1757–1807)¹⁰.

Në periudhën e vonë të iluminizmit, teoria ushtarake u dominua nga avokatët e të ashtuquajturës shkollë të gjeometrisë dhe matematikës. Këta teoricienë besonin se arti i vërtetë i luftës nuk ishte në betejat e përgjakshme, por në zhvillimin e manovrës së aftë për të surprizuar armikun, nëpërmjet llogaritjeve të lëvizjeve dhe marshimeve. Kjo i afrohet shumë idesë së të madhit *Sun Tzu* kur thoshte se “ideale është të fitosh betejën pa luftuar”.¹¹ Në këtë kohë, strategjia bazohej në bazat abstrakte matematikore. Komandanti kërkohet të ishte si një lojtar shahu, i aftë të kombinonte lëvizjet, ndërsa ushtria në fushëbetjë konsiderohej si figurat në fushën e shahut.

Gjenerali dhe teoricieni nga Uells *Henry E. Lloyd*¹² ishte një nga mendimtarët që mbështeste studimin shkencor të luftës. Ai e krahasonte ushtrinë me një mjet mekanik, e cila, “si gjithë makineritë e tjera”, është e përbërë nga pjesë të ndryshme. Perfeksioni i saj varet së pari, te pjesët e saj, dhe së dyti, në mënyra me të cilën këto pjesë kombinohen.

⁶ *Paul Joly Maizeroy Gideon* lindi në vitin 1719 në Metz të Francës. Ai ishte një oficer dhe teoricieni ushtarak i shekullit XVIII. E nisi shërbimin ushtarak në moshën 15 vjeçare, shumë i ri mori pjesë në betejën e Bohemisë dhe Flandër dhe në mënyrë të shkëlqyer udhëhoqi fitoren e *Namur-it*. *Paul Joly Maizeroy Gideon* vdiq më 7 Shkurt 1780.

⁷ *Frederick II (Friedrich II)* lindi më 24 Janar 1712. Ishte mbreti i Prusisë në periudhën 1740-1786, në Dinastinë *Hohenzollern*. Është i mirënjohur për shkëlqimin e tij në organizimin e betejave ushtarake të ushtrisë prusiane. Vdiq më 17 gusht 1786.

⁸ *Pierre-Joseph Bourcet* lindi më 1 mars 1700. Ishte takticieni francez, gjeneral, shef shtabi, topograf dhe instruktor ushtarak. Vdiq më 14 Tetor 1780.

⁹ *Jacques-Antoine-Hippolyte, Comte de Guibert* (12 November 1743 – 6 May 1790) ishte gjeneral francez dhe shkrimtar ushtarak. Ka lindur në *Montabaun*, Ai shoqëroi babanë e tij në luftë përpara se të bëhej vetë gjeneral. Në vitin 1770 publikoi një ese për taktikën në Londër e cila ndikoi shumë taktikën e luftës në atë kohë.

¹⁰ *Dietrich Heinrich Freiherr von Bülow* lindi në vitin 1757. Ushtarak prusian dhe shkrimtar ushtarak. Hyri në ushtrinë prusiane në vitin 1773. Vdiq në vitin 1807.

¹¹ *Sun Tzu*, “Art i Luftës”.

¹² *Henry Humphrey Evans Lloyd* lindi në vitin 1718. Ishte oficer nga Uells dhe shkrimtar ushtarak. Luftoi për Francën kundër Austrisë. Kreu gjithashtu edhe shumë misione diplomatike për Anglinë. Shkrimet e tij ushtarake u studiuuan edhe nga të famshmit *Xhorxh Washington*, *Xhorxh Paton* dhe *Fuller*, për të kuptuar shkencën e luftës. Vdiq më 19 qershor 1783.

Oficeri prusian *Freiherr von Bülow*¹³, një nga teoricienët më me përvojë, shkroi "*Shpirti i Sistemit të ri të Luftës*" (1799). Ai përforcoi këndvështrimin shkencor të Lloydit ose shkencën gjeometrike të strategjisë. Në pikëpamjen e tij, zhvillimi modern i luftës bazohej në linjat e operacionit dhe prezantimin e armëve të zjarrit. Bülow siguroi teori të sakta matematikore. Ai besonte se teoritë e tij mund të siguronin çelësin e fitores nëpërmjet mundësimit të saktësisë shkencore të rezultateve, përpara se forcat të angazhohen në luftë. Ai u përpoq të zbulonte sekretet matematikore të strategjisë dhe zbatimin e tyre si shkencë.

Periudha ushtarake postiluministe. Gjenerali zvicerano-francez *Antoine-Henri Jomini*¹⁴, shmangu tendencat e zhvillimit të sistemit gjeometrik të luftës. Ai ndërtoi teoritë e tij në bazat e iluministëve. Kjo, e çoi atë në një këndvështrim reduktues dhe paragjykses. Jomini shkroi që: "*lufta në ansamblin e saj nuk është shkencë, por art dhe strategjia në veçanti mund të rregullohet nga ligje fikse, duke i ngjarë shkencave pozitive, por kjo nuk është e vërtetë në se lufta shihet si një e tërë.*"¹⁵ Ai argumentoi se taktika është pjesa e vetme e luftës e cila mund të mbështetet në rregulla fikse.

Archduka Charles, djali i Perandorit *Leopold II*, ishte një nga teoricienët më të njohur ushtarakë të kohës së tij. Në "*Parimet e Strategjisë*" (1814), *Archduka Charles* mbështeste pothuajse plotësisht teorinë e *Bülow-it*, teorinë e përgjithshme të luftës dhe konceptin e tij gjeometrik të operacioneve, por me më pak theks në aspektin matematikor.¹⁶

Gjenerali britanik *J.F.C. Fuller* (1878–1966)¹⁷, një nga teoricienët lider të shekullit të 20-të, besonte se zhvillimi i luftës është gjerësisht shkencë. Ai u influencua shumë nga teoritë e *Lloyd-it*. Në librin e tij "*Themelet e Shkencës së Luftës*", *Fuller* theksonte se metodat shkencore janë qasje me kuptim të përbashkët në atë se si të njohësh të vërtetën rreth të shkuarës dhe si mund ta zbatojmë këtë të vërtetë në kushtet që na rrethojnë tani e do të na rrethojnë edhe në luftëra të tjera. Ai mendonte se lufta duhet të reduktohet në shkencë, përpara se ajo mund të praktikohet me korrektësi si art.

Teoritë moderne. Tradicionalisht, këndvështrimi perëndimor për zhvillimin e luftës është ndikuar nga kërkimi njutonian, për të identifikuar ligjet universale të luftës,

¹³ *Bülow* lindi në Falkenberg në Altmarm dhe ishte vëllai i madh i *Freiherr Dietrich von Bülow*. Pasi kreu studimet në mënyrë të shkëlqyer, hyri në ushtrinë prusiane në vitin 1768 dhe u bë nëntoger në vitin 1772 dhe toger në vitin 1775. Mori pjesë në "luftën e patates" në vitin 1778, dhe, më pas, ia kushtoi jetën studimeve në profesionin e tij në shkenca dhe arte.

¹⁴ Për më tepër shiko : Grup autorësh "Teori e Luftës dhe e Strategjisë," Krijuesit e mendimit ushtarak modern. *Antoine de Jomini*. Shkruar nga Ardian Lulaj. Faqe 209 – 211. Shtypshkronja. "Mirgeeralb", Tiranë 2011.

¹⁵ *Antoine-Henry de Jomini*, "Summary of the Art of War", or a New Analytical Compend of the Principle Combinations of Strategy, of Grand Tactics and of Military Policy.

¹⁶ Lieutenant *Todd Richard Sears*, United States Navy "War as Art or Science" nga thëniet e *Archduka Charles*, në librin e tij "Principet e Artit të Lartë të Luftës"

¹⁷ Gjeneralmajor *John Frederick Charles Fuller* lindi në vitin 1878. Ishte oficer britanik, historian ushtarak dhe strategjist, i shquar si teoricien në fushën e mjeteve të blinduara, përfshirë edhe kategorizimin e principeve të luftës. Ishte gjithashtu edhe shpikësi i "dritës së hënës artificiale". Vdiq në shkurt 1966.

nëpërmjet të cilave mund të zgjidhen të gjithë problemet dhe mund të parashikohen rezultatet e saj. Që nga fillimi i kohës moderne, ka pasur tentativa të shumta për zbatimin e disa elementëve të analizës sasiore, për të përcaktuar burimet e fitores. Ky është rasti që tregon këndvështrimin e atyre që e shikojnë zhvillimin e luftës si shkencë. Kërkimet kanë treguar se përdorimi i metodave sasiore është më “objektiv” sesa përdorimi i gjykimit dhe përvojës së komandantit. *Karl fon Klauzeviç* (1780–1831) paralajmëroi se i ashtuquajturit faktor matematik nuk mund të gjejë kurrë bazë të sigurt në llogaritjen ushtarake.

Rusët u mbështetën në zgjidhje të ndryshme matematikore për parashikimin e problemeve ushtarake, që nga shekulli i 19-të. Ky ishte rezultat i më shumë se 75 vjet studimesh, mendimi kritik dhe përmirësimi të vazhdueshëm. Ata përshkruan modele të luftimit, për të zgjedhur kurset e veprimit dhe përparimet e fushëbetejës. Këto masa u bazuan në rrjedhojat e operacioneve të mëdha gjatë luftës së madhe patriotike të viteve 1941–1945. Rusët e konsideruan metodologjinë e tyre dialektike dhe shkencore, duke futur edhe ideologjinë marksiste-leniniste.

Një nga avokatët më të fortë të analizës së sistemit në SHBA ishte Sekretari i Mbrojtjes *Robert McNamara*¹⁸. Gjatë mandatit të tij (1961–1968), ai përdori gjerësisht analizën e sistemeve për të marrë vendime kyçe, në përputhje me kërkesat e forcës dhe prokurimet për dizenjimin e armëve. *McNamara* është ndoshta më i mirënjohuri për përdorimin e metodave sasiore jo vetëm në vlerësimin e progresit të luftës në Vietnam, por edhe në marrjen e vendimeve bazuar në këto metoda dhe kjo është një përpjekje për të zhvilluar luftën si shkencë dhe jo si art.

Arti i luftës. Të kuptosh se zhvillimi i luftës është art, nuk është një gjë krejtësisht e lehtë. Shumë teoricienë ushtarakë, gjatë periudhës së iluminizmit, në mënyrë të theksuar *Saxe* dhe *Lloyd*, kuptuan rëndësinë e madhe të faktorit psikologjik në luftë. Ndryshimet dramatike në teorinë ushtarake, që kanë çuar në këndvështrimin më të mprehtë të luftës, ndodhën në Gjermani në shekullin e 18-të dhe në fillim të shekullit të 19-të. Tendencat e reja kulturore, që filluan si reaksion i iluminizmit, patën gjithashtu ndikim tek teoricienët ushtarakë gjermanë, sidomos tek *Georg Heinrich von Berenhorst* (1733–1814)¹⁹, *Johann Gerhard von Scharnhorst* (1755–1813)²⁰, dhe *Karl fon Klauzeviç*. Puna e parë që tronditi idetë e iluministëve ishte volumi i tretë i *Berenhorst*-it “*Refleksione mbi Artin e Luftës: Progresi i tij, kontradiktat dhe siguria*” (1796–1799). *Berenhorst*-i vëzhgoi se grekët e lashtë dhe romakët e sollën artin e luftës në majën e përsosmërisë. Për të, ata ishin më artistikë se çdokush tjetër. Ai shkroi se gjatë periudhës së iluminizmit, arti i luftës, si dhe pjesa tjetër e shkencës

¹⁸ *Robert Strange McNamara* (9 qershor 1916 – 6 korrik 2009) ishte sekretari i 8-të amerikan i mbrojtjes i SHBA që shërbeu në administratën e presidentit *John F. Kennedy* dhe *Lyndon B. Johnson* nga 1961–1968, kohë gjatë së cilës ai luajti rol kryesor në përshkallëzimin e përfshirjes së SHBA në luftën e Vietnamit.

¹⁹ *Georg Heinrich von Berenhorst* lindi në tetor 1733 në *Sandersleben*. Ishte shkrimtar ushtarak. Vdiq në më 30 tetor 1814.

²⁰ *Gerhard Johann David Waitz von Scharnhorst* (12 nëntor 1755 – 28 qershor 1813) ishte gjeneral prusian, shefi i Shtabit të Përgjithshëm prusian, i shquar për shkrimet dhe reformën në ushtrinë prusiane si dhe për lidhshimin e tij në Luftërat Napoleonike.

dhe artit, avancuan njohuritë dhe mbështetën talentin. Në pikëpamjen e tij, arti i luftës nuk është i bazuar në ligjet e pandryshueshme, por përkundrazi është i lidhur me shpirtin e panjohur dhe të pakontrolluar njerëzor. *Berenhorst* besonte se lufta, në kontrast me matematikën dhe astronominë, nuk mund të formulohej si shkencë.

Scharnhorst (12 Nëntor 1755 - 28 Qershor 1813) e shikonte sistemin e zhvillimit të operacionit si të njëanshëm. Arti i luftës ishte shkencë praktike dhe kuptimi i saj mund të bazohej vetëm në studimin e realitetit. Nëse kjo lidhje thyhet, atëherë arti i luftës çon në abstraksion. Në esenë e tij “*Përdorimi i Historisë Ushtarake, shkak i deficiteve të saj*” (1806), *Scharnhorst* shkruante se gjeneralët e mëdhenj gjatë historisë studiuan parimet e artit të luftës.

Pasqyrimi i artit dhe shkencës së luftës në doktrinat ushtarake të NATO-s dhe FA-së

Doktrina e Përbashkët e Aleancës AJP-01(D)

Arti dhe shkenca e luftës janë pasqyruar gjerësisht edhe në doktrinat e Aleancës dhe ato të Forcave të Armatosura të RSH-së. Kështu p.sh. në Doktrinën e Përbashkët të Aleancës AJP-01 (D), pjesa për artin operativ thekson se:”Arti operativ është orkestrimi i operacionit në lidhje me agjencitë e tjera, për të konvertuar objektivat strategjike në veprime taktike, me qëllim arritjen e synimeve të dëshiruara”²¹. Kjo thënë vërteton faktin se arti operativ, jo vetëm është hallka lidhëse ndërmjet strategjisë dhe veprimeve taktike në fushëbetëje, por vërteton edhe ekzistencën e luftës si art. E thënë ndryshe, është pikërisht aftësia dhe veprimtaria krijuese dhe orkestruese e liderit ajo që bën që të gjitha “pjesët” e luftës të orientohen dhe kombinohen drejt në fushëbetëje. Për këtë, lufta është art dhe shkencë, mbështetur edhe në këtë doktrinë të Aleancës, sepse përfshin aftësinë e komandantëve për të shqyrtuar problemet shpesh komplekse dhe për të siguruar qartësi të mjaftueshme dhe logjike si dhe për të mundësuar planëzim të detajuar dhe urdhra praktikë.

Doktrina e Përbashkët e Aleancës AJP-01(D)

Po kështu në kapitullin e dytë të kësaj doktrine është cilësuar qartë se “Arti operativ është dislokimi cilësor i forcave ushtarake për të arritur objektivat operative dhe strategjike nëpërmjet një plani organizimi, integrimi dhe zhvillimi të betejës”²². E thënë më thjeshtë, arti operativ përcakton kur, ku dhe për ç’qëllim forcat do të kryejnë operacionin. Për ta bërë këtë, komandantët duhet të marrin në konsideratë mënyrën se si mund të arrihet synimi.

Arti Operativ dhe bazat e operacioneve ushtarake

Në tekstin “Arti Operativ dhe bazat e operacioneve ushtarake” të FA të RSH, shkenca dhe arti i luftës gjejnë një zbatim të gjerë. Në këtë tekst theksohet ndër të tjera se “Koncepti i artit operativ ka lindur në mendjen e teoricienëve gjermanë e sovjetikë, të cilët njohën efektet e mëdha të revolucionit industrial për zhvillimin e luftës”²³.

²¹ Doktrina e Përbashkët e Aleancës AJP-01(D), dhjetor 2010.

²² Doktrina e Përbashkët e Aleancës AJP-01 (D) Kapitulli II,

²³ Arti Operativ dhe Bazat e Operacioneve Ushtarake (tekst mësimor metodik) Tiranë 2011, publikim

Aty përmendet, me të drejtë, oficeri i ushtrisë gjermane, *Sigismund von Schlichting*, në fund të shekullit të XIX, i cili studioi punimet e *Karl fon Klauzeviç* dhe *Helmuth von Moltke*, që ndoshta ishte i pari që njohu ndryshimet sasiore e cilësore në luftë. “Kur Klauzeviç kishte përcaktuar “strategjinë si artin e betejave për qëllimet e luftës, *Schlichting* theksoi rëndësinë e përdorimit të manovrave operative për të arritur qëllimet e luftës”²⁴

Kuptimi i artit operativ

Në këtë manual ushtarak shprehet saktësisht edhe rëndësia e aftësisë që duhet të ketë lideri për të zbatuar artin e luftës në betejë. Në këtë manual theksohet se “Operacionet ushtarake kërkojnë integrimin e vizioneve krijuese përgjatë gjithë niveleve të luftës. Arti operativ parashikon operacionet në të gjitha skalionet. Megjithëse arti ushtarak shkon më tej se nivelet e luftës, arti operativ është i veçantë. Ai është zbatimi i imagjinatës krijuese nga komandantët dhe shtabet, i mbështetur nga njohuritë e tyre dhe përvoja, në përpilimin e strategjive, fushatave dhe operacioneve kryesore, si dhe në organizimin e angazhimit të forcave ushtarake”²⁵

Për të përcaktuar kushtet për sukses, arti operativ duhet të pasqyrojë intuitë mbi ambientin operacional. Komandantët operacionalë përpunojnë planet të cilat duhet të përputhen me udhëzimet e udhëheqjes strategjike. Kjo kërkon mendim krijues të drejtuesve të operacioneve ushtarake dhe zbatim të teknologjisë së luftës, çka do të thotë që kërkon aplikim me efektivitet të shkencës dhe artit të luftës. “Për të kryer këtë veprim, komandantët operacionalë veprojnë bazuar në përvojë, njohuri, arsimim, intelekt, intuitë dhe krijimtari”²⁶

Është momenti të shprehemi se Gjenerali *Tommy Franks*²⁷ i cili ishte planëzuesi dhe zbatuesi i operacioneve “Liria e Qëndrueshme” në Afganistan, si dhe “Liria e Irakut”, të përfshira në kuadrin e “Luftës Globale kundër Terrorizmit” mbas ngjarjeve të 11 shtatorit, ka dhënë një kontribut të veçantë në zbatimin me efektivitet të shkencës dhe artit të luftës në nivel operativ. Përvoja e tij si ajo në Luftën e Vietnamit dhe në luftën e parë kundër Irakut në “Stuhia e Shkretëtirës”, gjatë së cilës ai ushtronte detyrën e Zëvendëskomandantit të Divizionit për Operacionet dhe Manovrën me gradën e Gjeneralit të Brigadës, e ndihmoi atë për të bërë analiza dhe për të nxjerrë mësim të cilat ai i zbatoi si në koncept edhe në praktikë në operacionet në Afganistan dhe në Irak, kohë në të cilin ai ushtronte funksionin e Komandantit të Komandës Qendrore (CENTCOM) të Ushtrisë Amerikane.

Gjenerali *Franks* i mbrojti konceptet e tij në kundërshtim të plotë me konceptet e operacionit të parë “Stuhia e Shkretëtirës”, në mënyrë të veçantë për përqendrimin dhe krijimin e raportit të forcave. Ai planëzoi dhe përdori forca të vogla në numër

i Akademisë së Mbrojtjes “Spiro Moisiu” Departamenti i Operacioneve, përgatitur nga: Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Agim Lala, Kolonel Dr. Gëzim Mustafaj, Nënkolonel Doc. Ismet Tola, faqe 34.

²⁴ Po aty, faqe 34.

²⁵ Po aty, faqe 34.

²⁶ Po aty, faqe 5.

²⁷ Për më tepër shiko : Nënkolonel Ardian Lulaj “Refleksione rreth librit “*American Soldier*” të Gjeneral *Tommy Franks*” Revista Ushtarake. Nr.1/2010

dhe bëri lëvizje taktike shumë më të thjeshta për të përmbushur misionin. Ja cila ishte përgjigjja e tij, lidhur me problemet që ngrinte Sekretari i Shtetit *Colin Powell* në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit Kombëtar të Amerikës, kur diskutonin për planin e sulmit në Irak. “Nëpërmjet aplikimit të sulmit ushtarak të njëkohshëm dhe nga shumë drejtime në pikat kyçe, ne arrijmë të shkatërrojmë balancën e forcave armike, në vend që të provojmë të sulmojmë në një drejtim të vetëm e në front të gjerë në mënyrë të ngadaltë konvencionale...Shpejtësia dhe momenti (kushtet) janë faktorët kyç.”²⁸ Gjeneralit *Franks* i duhej të guxonte dhe të dilte mbi konceptet doktrinare të mësuara në shkollë dhe të zbatuara e provuara në luftë. Ja si shprehet ai më tej: “Në letër dukej sikur ne do të sulmonim kundër një armiku që është superior në numër, me një forcë ofensive relativisht në numër më të vogël. A po rrezikoja unë duke sfiduar principin e mësuar në Kolegjin e Luftës që minimumi i raportit të forcave në sulm kundër një mbrojtjeje të përgatitur duhet të jetë tre me një? Aspak..., por në fushëbetejën e shekullit të njëzet e një, forca do të varet nga ushtrimi efektiv i fuqisë luftarake dhe jo thjesht nga numri i trupave apo tankeve në terren.”²⁹

Doktrina Ushtarake e FARSH

Arti dhe shkencë e luftës gjejnë pasqyrim të gjerë edhe në “Doktrinën Ushtarake të FARSH (DP-01)”. Në të, arti operativ paraqitet si teoria dhe praktika e përgatitjes, e organizimit dhe e kryerjes së operacioneve ushtarake, i cili i shndërron objektivat strategjike në projekte e plane operative që lidhin dhe integrojnë betejat e luftimet taktike, për të arritur qëllimet strategjike. “Në kuptimin më konkret, arti operativ përcakton ku, kur, dhe për çfarë qëllimi do të angazhohen forcat në operacione”.³⁰

Pikëpamjet e teoricienëve ushtarakë mbi kuptimin e “artit” dhe “shkencës” së luftës

Karl fon Klauzeviç³¹

Klauzeviçi ishte i pari teoricien që, në mënyrë sistematike, paraqiti filozofinë e luftës në të gjitha aspektet. I ndikuar nga idetë e romantizmit gjerman, ai e pa luftën ndryshe nga mendimtarët ushtarakë të iluminizmit. Ai u ndikua shumë edhe nga pragmatizmi i *Scharnhorst*-it.

Arti në luftë është manifestimi dhe zbatimi i gjenialitetit historik, në raport me atë sublim, që më vonë u bë e dukshëm edhe në shkencë. Të flasësh për artin në kontekstin e luftës do të thotë të flasësh për krijimtarinë dinamike njerëzore. Klauzeviç e fillon kapitullin e tij “Art i Luftës ose Shkencë e luftës” duke tentuar të klasifikonte luftën. Ai e specifikonte pikëpamjen e tij mbi luftën duke theksuar: “*quaj “art” gjithçka, objekti i së cilës është aftësia krijuese si p.sh. arkitektura. Termi “shkencë” duhet*

²⁸ “American Soldier” General Tommy Franks Commander in Chief United States Central Command. ReganBooks, An imprint of HarperCollinsPublishers 2005, faqe 395.

²⁹ Ibid., faqe 415.

³⁰ DP-01 Doktrina Ushtarake e FARSH (DP-01) faqe 21

³¹ Për më tepër shiko Grup autorësh “Teori e Luftës dhe Strategjisë” Krijuesit e mendimit ushtarak modern, shkruar nga Ardian Lulaj, faqe 197 – 208. Shtypshkronja. “Mürgeeralb”, Tiranë 2011.

parë për disiplinat si matematika ose astronomia, objekt i së cilës janë njohuritë e pastra”³². Ai vazhdon më tej duke mbrojtur se “lufta është më shumë art se sa shkencë, por nuk mund të konsiderohet art i pastër. Në luftë, vullneti drejtohet ndaj armikut që reagon”.

Klauzeviç e konsideron luftën si gjysmë art. Kështu për Klauzeviç lufta nuk është një art i vërtetë, për shkak se ajo përfshin “objekte armiqësore” duke iu referuar armikut. Në këtë sens, lufta është diçka e veçantë. Por ajo që Klauzeviç nuk përmend është se objekti reagues i krijimtarisë në rastin e luftës, ushtria armike, rrit nevojën për aktualizim të gjenialitetit të komandantit. Në një farë mënyre, dhuna dhe rreziku i luftës kërkojnë një talent që shkon përtej vullnetit. Për këtë arsye, Klauzeviç e konsideron luftën më shumë artistike sesa artet e tjera. Lufta është patjetër aftësi krijuese, ajo kërkon trajnim të vullnetit. Arti për Klauzeviç është kapacitet i zhvilluar. Ai duhet të ketë një qëllim, forca e mjete në dispozicion dhe për t’i vendosur këto forca në luftë, kërkohet talent. Kjo do të thotë që të kombinosh mirë objektivin me burimet, për të arritur fitoren. Pra arti ka një qëllim, ai kërkon të kesh mjete në dispozicion dhe t’i kombinosh ato, pra do të thotë të kesh talent. Edhe pse lufta nuk përmendet në këto thënie të Klauzeviçit, kjo është e kuptueshme pasi ajo ka një qëllim, kërkon mjete dhe gjenium që t’i kombinojë mirë ato, çka do të thotë të bësh art.³³

Klauzeviç besonte se lufta është domen i jetës sociale; ajo nuk është as art as shkencë. Ai shkruante se “arti i luftës lë gjithmonë hapësirë për pasiguri në gjëra më të mëdha dhe në ato të vogla. Faktori njerëzor përcakton atë që quhet “natyra” e luftës, cilësi këto konstante, universale dhe të natyrshme, që kanë karakterizuar luftën gjatë periudhave të ndryshme.

Helmuth von Moltke (26 tetor 1800-24 prill 1891)³⁴

Helmuth von Moltke, Sr, theksonte se shumica e asaj çka ligjëron operacionet ushtarake, është mbështetur kryesisht në shkencë, ndërsa arti del në pah kur shfaqet vullneti i komandantëve. Ai besonte se asgjë në luftë nuk ishte e sigurt. Prandaj në luftë, ashtu si edhe në art, nuk ekzistojnë rregulla të përgjithshme, në të talenti nuk mund të zëvendësohet nga parimet. Gjermanët e konsideronin luftën më tepër si art se sa si shkencë. Ata besonin se asnjë nuk mund t’i kontrollojë ngjarjet në luftë.

T. N. Dupoi dhe “Kuptimi i Luftës”³⁵

Nuk do të quhej e plotë kjo temë, nëse nuk do t’i referoheshim edhe *T. N. Dupoi-t* në veprën e tij “Kuptimi i Luftës”. Në këtë veper ai është përpjekur të arsyetojë nëse

³² Clausewitz, “On War”, f.148.

³³ Hilary Putnam’s “What Theories Are Not” in *Logic, Methodology, and Philosophy of Science: Proceedings of the 1960 International Congress* ndryshuar nga Ernest Nagel, Patrick Suppes dhe Alfred Tarski, (Stanford, CA: Stanford University Press, 1962), 240-251.

³⁴ *Helmuth Karl Bernhard Graf von Moltke* (26 Tetor 1800 – 24 Prill 1891) ishte Mareshall gjerman. Shefi i Shtabit të Ushtrisë prusiane për 30 vjet, vlerësohet si një nga strategjistët më të mëdhenj të shekullit të XIX-të dhe krijues i metodave të reja dhe moderne të drejtimit të ushtrisë në luftë. Njihet si *Moltke* i vjetri për ta dalluar nga nipi i tij *Helmuth Johann Ludwig von Moltke* që komandoi ushtrinë gjermane në fillim të Luftës së Parë Botërore.

³⁵ T.N.Dupoi “Historia dhe teoria e Luftës” SHBU, Tiranë 1997, faqe 5.

lufta është shkencë apo art. Duke e studiuar këtë vepër, ne gjejmë një trajtim të luftës mbi baza shkencore. Një vepër e mbushur me formula dhe llogaritje, ashtu siç është vetë shkencën, çka argumenton se lufta është vërtetë shkencë. *T. N. Dupoi* i referohet teoricienëve ushtarakë amerikanë deri në kohët e vonshme, duke theksuar faktin se edhe ata kanë treguar pak interes për shpjegimin apo argumentimin, se lufta është shkencë apo art. “*Ideja e zbatimit të shkencës në luftë*, thekson *Dupoi*, *u forcua gjatë Luftës së Dytë Botërore. Dy ishin format që ai përmend për këtë fakt: Zbatimi i teknologjisë nëpërmjet projektimit dhe realizimit të instrumenteve të luftës dhe studimi i dukurive të luftës nëpërmjet punës kërkimore shkencore në veprimet ushtarake. Në pikëpamjen e parë shkencëtarët amerikanë kanë qenë të suksesshëm, në zbatimin e teknologjisë në armatim e pajisje.*”³⁶. Gjatë studimit të tij mbi teorinë e luftës *Dupoi* theksonte se, me gjithë përparimet në këtë drejtim, ka përsëri konfuzion në përcaktimin e ligjeve dhe rregullave unike të luftës që do ta barazonin atë me shkencat e tjera ekzakte, si matematika apo gjeometria, në të cilat rregullat që zbatohen janë fikse. Por vëmendja e treguar dhe rëndësia e mbështetjes së zhvillimit të luftës në ligje dhe rregulla unike i detyroi dy shkencëtarët amerikanë, programues matematike, *Lorenç Lou* dhe *Dr. Xhejms Tailor*, profesor në shkollën e Flotës së SHBA-së, të njohin punën e bërë nga *Dupoi* për studimin e Luftës së Dytë Botërore dhe ta përshtatin atë në një program kërkimor shkencor. Ata u përpoqën të përmbushnin atë që kishin dashur të bënin prej kohësh *Zhomini* dhe *Klauzeviçi*, një shekull më parë, apo *Fuller-i* në fillim të shekullit. Për këtë qëllim u krijua *Instituti i Konfliktit Ushtarak*, qëllimi i të cilit është të zhvillojë më tej konceptin shkencor të luftës dhe përpunimin e teorive të saj.³⁷

Disa përfundime

Pas kësaj panorame të paraqitur dhe studimi i teoricienëve që kanë shkruar e folur për artin dhe shkencën e luftës, lind përsëri pyetja: Çfarë është lufta? A është ajo art apo shkencë? A është ajo diçka që në një farë mënyre i sintetizon të dyja bashkë? Teknologjia e shkencës, në sytë e publikut, është tashmë e dukshme nëpërmjet operacioneve ushtarake, veçanërisht pas operacioneve “*Stuhia e Shkretëtirës*” në *Kuvajt*, *Irak*, por edhe “*Liria e Qëndrueshme*” në *Afganistan* dhe “*Liria e Irakut*”. *Njerëzit* e quajnë luftën “shkencore” për shkak se shtetet që e zhvillojnë atë përdorin teknologji të lartë dhe armë të sofistikuar, të cilat janë rezultat i punës shkencore të njeriut. Në fakt, roli i njeriut në procesin shkencor dhe artistik të luftës, prej shumë kohësh, është injoruar. Por e vërteta është se, është pikërisht njeriu ai që zhvillon edhe shkencën edhe artin e luftës.

Nocioni i gjerë i luftës ndahet në dy komponentë: përgatitja për luftë dhe zhvillimi i luftës. Përgatitja për luftë përfshin aktivitete të tilla si: planëzimi strategjik, programim dhe buxhetim, prokurim të armatimeve, etj. Përgatitja e luftës drejtohet nga njeriu dhe mendja e tij, por ajo pasqyron një lloj të veçantë pune. Zhvillimi i luftës kërkon po ashtu një lloj të veçantë gjeniu. Pyetja nëse zhvillimi i luftës është art apo shkencë

³⁶ Ibid., faqe 75.

³⁷ T.N.Dupoi, Ibid., faqe 75-83.

është tashmë e qartë. Lufta është mjaft komplekse, kaotike dhe e paparashikueshme për t'u zhvilluar duke përdorur metodat shkencore, pavarësisht se sa të përparuara janë. Këtë nuk e themi për të nënvleftësuar rolin e teknologjisë në çështjet ushtarake. Shkenca dhe teknologjia kanë qenë dhe do të mbeten faktorë të rëndësishëm në çdo ndryshim të karakterit të luftës. Historia është e mbushur me shembuj, ku shkenca dhe teknologjia kanë bërë dallimin ndërmjet fitores dhe humbjes.

Si përfundim, ekziston një ndryshim i madh ndërmjet përdorimit të shkencës dhe teknologjisë për të rritur potencialin e luftës, dhe zbatimit të metodave shkencore në zhvillimin e luftës. Pra, njohuritë dhe kuptimi i luftës janë shkencë, por vetë zhvillimi i luftës është art. Mendojmë se kjo nuk do të ndryshojë në të ardhmen, pavarësisht përparimeve shkencore dhe teknologjike. Ashtu si edhe në të kaluarën, arti dhe shkenca e luftës mund të shkojnë përpara, të zhvillohen nëpërmjet teknologjisë dhe metodave të hartimit të planeve të saj, por kurrsesi, lufta, siç thekson edhe Karl fon Klauzeviç, nuk do të ndryshojë.

Mendojmë se është e vlefshme të ritheksojmë edhe njëherë faktet më kryesore që dalin nga trajtimi i kësaj teme:

- Arti dhe shkenca e luftës janë studiuar prej shekujsh nga studiuesit ushtarakë, megjithëse në forma dhe metoda të ndryshme.
- Ato i janë nënshtruar zhvillimit të vazhdueshëm teorik dhe praktik, si rezultat edhe i ndryshimeve teknologjike.
- Zhvillimi teknologjik ka ndikuar në zhvillimin e artit dhe shkencës së luftës, por kurrsesi nuk e ka zëvendësuar rolin e faktorit njeri.
- Ashtu siç ka thënë Karl fon Klauzeviç, është pikërisht gjeniu (njeriu)³⁸ ai që zbaton teknologjinë shkencore të luftës dhe artin e saj në betejë.
- Arti dhe shkenca e luftës zbatohen gjerësisht edhe në doktrinat e Aleancës dhe ato të FA të RSh si pjesë e saj.
- Është domosdoshmëri të studiohen nga ushtarakët tanë, teoricienët ushtarakë që kanë trajtuar artin dhe shkencën e luftës, pavarësisht periudhës së cilës i përkasin. Ata mund të shërbejnë si orientim i zhvillimit teorik të doktrinës sonë ushtarake, por edhe mund të zbatohen gjerësisht në operacionet luftarake dhe joluftarake të njëjësive të FA-së.

Bibliografia:

- Karl Fon Klauzeviç “Mbi luftën” Vëllimi I. SHBU, Tiranë 1994.
- Karl Fon Klauzeviç “Mbi luftën” Vëllimi II. SHBU, Tiranë 1995.
- Karl Fon Klauzeviç “Mbi luftën” Vëllimi III. SHBU, Tiranë 1996.
- T. N. Dupoi “Kuptimi i Luftës”. SHBU, Tiranë 1997.
- Peter Paret “Makers of Modern Strategy from Machiavelli to the Nuclear Age”, faqe 186 -213. Botuar nga Princeton University, New Jersey.
- Grup autorësh “Teori e Luftës dhe Strategjisë” Shtypshkronja. “Mirgeeralb”, Tiranë 2011.

³⁸ Perifrazim i autorit.

- DPU-10 “Doktrina e Përbashkët e FA të RSH”.
- AJP-1.0 “Doktrina e Përbashkët e Aleancës”.
- General Tommy Franks Commander in Chief of United States Central Command. “American Soldier” Regan Books, An imprint of Harper Collins Publishers 2005.
- Milan Vego “Science vs. the Art of War” “Operational Commander’s Intent”.
- Lieutenant Todd Richard Sears United States Navy “War as Art or Science”, A Humanist Vision B.A, University of South Carolina, 1986.
- Revista Ushtarake, Nr.1/2010. “Refleksione rreth librit “American Soldier” të Gjeneral Tommy Franks” shkruar nga Nënkolonel Ardian Lulaj.
- Major Jim Storr “*Neither art nor science-towards a discipline of warfare*”.
- W S Lind, “*Manoeuvre Warfare Handbook*” (London: West view Press, 1985).
- Gat, Azar. “*The Origins of Military Thought: From the Enlightenment to Clausewitz*”. New York, NY: Oxford University Press, 1989.

Marrëdhëniet civilo-ushtarake dhe pasqyrimi i tyre në doktrinën ushtarake të Aleancës

Nënkolonele Alda Sula,
Kursante KLO

Prof. Dr. Pëllumb Danaj,
Pedagog i DO, AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Mjedisi strategjik, i cili tashmë është një mjedis në ndryshim, ka sjellë edhe një dinamikë të re të operacioneve të sotme dhe të ardhme, me një spektër të gjerë, nga operacionet klasike luftarake e deri tek ato paqeruajtëse e humanitare. Teoria e Klauzeviçit mbi kontrollin e pushtetit e përdorimin e forcës, ashtu sikurse dhe “triniteti paradoksal” i tij, janë të rëndësishme në të gjithë këtë mjedis të ndryshueshëm strategjik. Kjo analizë strategjike kërkon nga operacionet ushtarake kontribuimin në një qasje gjithëpërfshirëse politiko-civilo-ushtarake, për të menaxhuar krizat nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, si dhe domosdoshmërinë e krijimit të udhëzimeve operacionale brenda fushës së operacioneve.*

Që në parathëniet e publikimeve të Aleancës gjejmë në vija të përgjithshme konceptin e zhvillimit të operacioneve në një mjedis gjithëpërfshirës, pra, atë që ne sot themi se: operacionet ushtarake nuk mund të zhvillohen pa drejtimin politik, mbështetjen dhe koordinimin e të gjithë aktorëve të tjerë civilë.

Koncepti klauzeviçian i MCU tek “Mbi luftën”

“Fjala shtet është identike me fjalën luftë” (Prince Peter Kropotkin, 1885)¹

Citati i mësipërm nënkupton që për sa kohë që ekzistojnë shtetet, do të ketë edhe luftëra. Edhe pse shtetet angazhohen në konflikte të ndryshme ku reflektohen forma dhe stile të ndryshme qeverisëse, duke filluar nga diktaturat te demokracitë, më i rëndësishëm mbetet elementi i udhëheqjes civile së një force ushtarake vartëse.

Klauzeviçi, teoricieni i madh gjerman i luftës së 1800-s, shkroi me kompetencë dhe profesionalizëm në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet liderit politik dhe komandantit

¹ Daniel B. Baker, Power Quotes.

ushtarak. Është interesante që idetë e tij zbatohen uniform, pavarësisht nga stili i qeverisjes që përcakton marrëdhëniet politiko-ushtarake.

Në temën e marrëdhënieve civilo-ushtarake, Klauzeviçi pranon se nuk ka linja të qarta të përgjegjësive midis liderit politik dhe komandantit ushtarak.² Ashtu siç përshkruhet në këtë seksion, Klauzeviçi paraqet tre koncepte, të cilat formojnë bazën e një marrëdhënieje efektive civilo-ushtarake. Së pari, gjatë fazës fillestare të planifikimit të luftës, objektivi politik duhet të vendosë në mënyrë të përcaktuar natyrën e luftës, si dhe objektivat ushtarake e mjetet.³ Së dyti, kur lufta shpalolet, përcaktohen fillimisht faktorët ku objektivi politik bëhet jashtëzakonisht dinamik dhe kërkon rishikim të vazhdueshëm. Dhe së treti, kur parashikohet një konflikt në të afërmen, fitorja (ose *end-state*) përcaktohet nga lideri politik dhe jo nga komandanti ushtarak. Rrjedhimisht, shteti dhe komandanti duhet të mbajnë një dialog të hapur dhe të ndershëm para, gjatë dhe pas konfliktit ushtarak.⁴

Ky dialog merr rëndësi të veçantë kur lideri politik fillon të mendojë për veprimet ushtarake. Një nga përgjegjësitë e para të liderit politik është që të krijojë objektivin politik që duhet të arrijë lufta. Komandanti ushtarak duhet të jetë një pjesë e këtij procesi për të siguruar atë që, “dizajni i politikës nuk duhet të jetë në kundërshtim me mjetet. Me fjalë të tjera, komandanti duhet ta informojë liderin politik, nëse objektivi politik është i arritshëm, nëpërmjet përdorimit të forcës ushtarake. Nëse jo, objektivi politik mund të ketë nevojë të modifikohet”⁵. Pasi objektivi i luftës është përcaktuar, kalohet në hapin tjetër, atë të përcaktimit të natyrës së luftës, ku sipas Klauzeviçit, ”Sa më të mëdha e të fuqishme të jenë shkaqet e luftës, sa më shumë ato prekin interesat jetike të popujve, aq më mirë përputhet qëllimi politik me atë ushtarak e aq më shumë karakteri i luftës do të duket thjesht ushtarak dhe më pak politik”⁶.

Rëndësi të madhe merr përcaktimi i objektivave dhe mjeteve ushtarake. Këto dy elemente formojnë bazën për strategjinë ushtarake dhe janë përcaktuar kryesisht nga objektivi politik. Klauzeviçi përcakton qartë se: “...në qoftë se pikësëpari shtrajmë pyetjen se drejt cilit objektiv duhet të synojë çdo luftë, në mënyrë që të përbëjë mjetin më të mirë për të realizuar qëllimin politik, gjejmë se ky qëllim politik është po aq i ndryshueshëm sa vetë objektivi politik dhe rrethanat që e karakterizojnë luftën...”⁷.

Teoria e Klauzeviçit, për karakterin politik të luftës, përforcon pikëpamjet e shprehura për natyrën e dyfishtë të luftës, që ajo nuk është një veprim i pavarur e i izoluar. “Shkatërrimi i fuqisë luftarake të armikut dhe i vullnetit të tij për ta përdorur atë nuk është një qëllim në vetvete, por një mjet për të arritur objektivin politik. Dhuna nuk duhet të zërë vendin e synimit politik apo ta injorojë këtë të fundit. Udhëheqja politike duhet, patjetër, ta kontrollojë dhe ta drejtojë luftën. Kjo nuk do të thotë që ajo do të

² Klauzevic, “Mbi luftën, v.III / kreu VI-A;B; fq 553-557.

³ Klauzevic, Ibid., kreu II; fq 80, si dhe v. I; fq. 13.

⁴ Ibid., fq. 80.

⁵ Ibid, fq.73-74.

⁶ Ibid.; fq.75-76.

⁷ Ibid; fq.80.

mënjanojë ushtarakët në planëzimin dhe kryerjen e operacioneve...”⁸. Interes të veçantë, paraqesin idetë e Klauzeviçit për funksionin dhe marrëdhëniet midis qëllimit, objektivit dhe mjeteve. Sipas tij, “qëllimi politik për të cilin luftohet, përcakton edhe mjetet që përdoren dhe llojin e shkallën e përpjekjeve që duhen bërë. Qëllimi politik duhet gjithashtu të përcaktojë edhe objektivin ushtarak. Ndonjëherë ato janë të njëjta”⁹. Gjithashtu, mund të ndodhë që objektivat politikë të ndryshojnë gjatë luftës të cilat, në të njëjtën kohë, shoqërohen me ndryshime të atyre ushtarake e strategjike. Klauzeviçi e citon thjesht këtë gjë kur shprehet se: “...janë të shumta rrugët në luftë që të çojnë drejt suksesit”¹⁰. Secila rrugë duhet ta ketë origjinën nga objektivat politikë.

Për këtë arsye, komandanti ushtarak duhet të jetë në njëfarë mënyre “*lider politik, për të kuptuar ndryshimet e situatave politike, si dhe për të kuptuar se si mund t’ia dalë në këto situata me mjetet që ka në dispozicion*”¹¹. Shembull i kësaj është edhe planëzimi parapërgatitor, ku lideri politik duhet të dijë instrumentet që i nevojiten për të përdorur në luftë. Për këtë Klauzeviçi shton se: “.. nëse politika lexon rrjedhën e ngjarjeve ushtarake saktë, ajo ka ekskluzivitetin të vendosë që këto ngjarje dhe tendenca (kurset e veprimt), janë më të mirat për objektivat e luftës.”¹². Qëllimi nuk është për të balancuar pushtetin apo autoritetin midis dy pozicioneve, por për të siguruar ekuilibrin midis objektivit politik dhe zhvillimit të luftës. Kjo shihet në dy këndvështrime: liderët politikë monitorojnë rrjedhën e luftës për t’u siguruar në vlefshmërinë e objektivave politikë dhe liderët ushtarakë ndërgjegjësohen për situatën politike, për t’u siguruar që strategjitë ushtarake mos të dalin jashtë kontureve politike. Procesi i kësaj balance duhet të vazhdojë përgjatë gjithë spektrit të operacioneve. Arritja e paqes sipas Klauzeviçit, kërkon bashkëpunimin midis liderit politik e atij ushtarak, në pikën që; “.. *strategjia dhe politika të konvertojnë, duke ritheksuar edhe njëherë atë që lideri ushtarak duhet të bëhet lider politik*”¹³. Kjo ilustron natyrën e vërtetë të Marrëdhënieve Civilo-Ushtarake Klauzeviçiiane ku, “...*lufta do të mbetet gjithmonë një zgjerim i politikës dhe kurrë diçka e huaj për qëllimin e saj. Lufta mbetet gjithmonë një mjet serioz, për një qëllim serioz*”¹⁴

Shembuj të pikëpamjes klauzeviçiiane mbi MCU

Këtë pikëpamje e gjejmë të pasqyruar shumë mirë te vepra e Sun Tzu. Ai argumenton se: “... *vendimi për të shkuar në luftë duhet të jetë një vendim politik, por që komandanti duhet të veprojë me autonomi pas marrjes së këtij vendimi*”¹⁵. Kjo pikëpamje ka mbijetuar deri në ditët e sotme moderne. Brenda eksperiencës së ushtrisë amerikane, ndoshta avokati më i famshëm ndaj këtij koncepti, është gjenerali Douglas MacArthur. Në një fjalim në Kongres, pas shkarkimit të tij nga Presidenti Truman, gjenerali MacArthur pohoi se: “... *kur lufta është e detyrueshme, për ne nuk ka asnjë*

⁸ Ibid; fq.7-8.

⁹ Ibid; fq.16-17.

¹⁰ Ibid; fq.85, 90-91.

¹¹ Ibid; fq. 135.

¹² Ibid, v. III, kreu VI/B, fq. 560-561.

¹³ Ibid v.I; fq. 135.

¹⁴ Klauzevic, Ibid; fq. 73.

¹⁵ Sun Xu, hyrje,kap.1 fq.22.

*alternativë tjetër, përveçse të aplikojmë çdo mjet që kemi në dispozicion, për të sjellë një fund të shpejtë. Objekti i luftës është fitorja e jo një pavendosmëri e zgjatur*¹⁶. Pozicionimi i *MacArthur-it* të lë të nënkuptosh atë, që ka pak hapësira veprimi për faktorët politikë për të moderuar një konflikt, pasi ai ka filluar.

Ka pasur edhe nga ata që kanë ndërmarrë veprime kundërshtuese të pikëpamjes së mësipërme, veprime që konsistojnë në sigurimin e një kontrolli të gjerë politik mbi operacionet ushtarake. Adolf Hitleri ishte lideri tipik, sjellja e të cilit e ka ilustruar këtë parim. Jo vetëm që ai pranoi këshillat strategjike të gjeneralëve të tij në fillimet e Luftës së Dytë Botërore, por u përfshi gjithnjë e më shumë në detajet e operacioneve ushtarake gjatë gjithë shtrirjes së luftës. Historia amerikane gjithashtu ofron shembuj të liderëve politikë që e kanë marrë këtë qasje për këtë çështje; disa presidentë kanë zgjedhur të jenë pjesëmarrës aktivë në bërjen e strategjive ushtarake dhe planifikimin e fushatave. Për shembull, gjatë Luftës Civile Amerikane, presidenti *Abraham Lincoln* ishte "*Commander in chief*"¹⁷ shumë aktiv. Edhe Presidenti *John F. Kennedy* ishte thellësisht i përfshirë në detajet operacionale gjatë krizës kubaneze për raketat. Ajo që është e diskutueshme jo vetëm për këto raste, por dhe më gjerë është që ky raport, ky interesim mund të quhet mbikëqyrje apo ndërhyrje shqetësuese nga pushtetarët. Diskutimet janë të shumta dhe variojnë sipas shteteve.

Po t'i referohemi periudhës së para viteve 90-të, e kryesisht në vendet e ish-bllokut komunist, shohim një keqpërdorim të konceptit të Klauzeviçit në lidhje me kontrollin e politikës dhe përdorimin e forcës. Keqpërdorimi i teorisë së Klauzeviçit, në thelb ka patur justifikimin e diktaturave politike. Shqipëria nuk bën ndonjë përjashtim në këtë proces të para viteve 1990, ku anëtarët e Byrosë Politike ishin civilë, nën komandën dhe kontrollin e forcave tona të armatosura¹⁸.

Pasqyrimi i konceptit klauzeviçian mbi MCU tek publikimet e Aleancës

Vetë struktura organizative e Aleancës flet për reflektime të ideve të Klauzeviçit, për marrëdhëniet civilo-ushtarake, reflektime të pasqyruara në publikimet e saj. Që në parathëniet e publikimeve gjejmë, në vija të përgjithshme, konceptin e zhvillimit të operacioneve në një mjedis gjithëpërfshirës, pra, atë që sot operacionet ushtarake nuk mund të zhvillohen pa drejtimin politik, mbështetjen e koordinimin e të gjithë aktorëve të tjerë civilë. Konkretisht, në AJP01(D), gjejmë: "*... Në nivelin strategjik ushtarak, forcat e armatosura dislokohen dhe përdoren mbi bazën e një kuadri të angazhimit politik, si pjesë e një strategjie kolektive për përmbushjen e objektivave strategjike të Aleancës. Në këtë nivel, Komiteti Ushtarak (MC) gjykon mbi kontributin real që mund të japin forcat ushtarake për përmbushjen e këtyre objektivave, si dhe mbi Opsionet e Përgjigjes Ushtarake të mundshme (MROs) që i jepen komitetit politik përkatës për vlerësim. Në përgatitjen e këtyre Opsioneve, Komiteti Ushtarak duhet*

¹⁶ William Manchester, *The American Caesar*, New York: Dell Publishing Company, 1978, p. 789.

¹⁷ Russell F. Weigley, "The American Military and the Principle of Civilian Control from McClellan to Powell," *The Journal of Military History Special Issue*, Vol. 57, October 1993, p. 37-38.

¹⁸ Zija Bahja, "MCU dhe bashkëpunimi ndër-agjencor në sektorin e sigurisë në Shqipëri".

të konsultohet paraprakisht me Komandantin Suprem të NATO-s për Operacionet (SACEUR). Në rastet kur Këshilli i Atlantikut të Veriut (NAC) merr vendim ndaj një kërkesë që mund t'i bëhet për ndërhyrje ushtarake, ai duhet të lëshojë një Direktivë Inicuese (Direktivë Politike e NAC-ut), duke mundësuar fillimin e një planëzimi operacional të detajuar. Më tej, SACEUR-i monitoron planëzimin e nivelit operativ dhe zbatimin e fushatës”¹⁹.

Në paragrafin “Komponenti Ushtarak i Strategjisë”, trajtohet “ 0405. Marrëdhëniet midis Objektivave Politike dhe Ushtarakë. Objektivat politikë do të normëzojnë kontributin ushtarak për zgjidhjen e një konflikti, si dhe do të specifikojnë prioritetet ushtarake”.²⁰

Ndërsa në paragrafin “Politikat Moderne dhe Konteksti Politiko-Ushtarak” gjejmë këtë përshkrim- “ 0408. Ndërtimi dhe konsolidimi i besimit reciprok midis vendimmarrësve politikë dhe komandantëve ushtarakë është me rëndësi vendimtare, veçanërisht në kohë krize apo luftime. Si politikat, ashtu dhe lufta kanë të bëjnë shumë me ndërveprimin e njerëzve, ndaj është e rëndësishme që stafet ushtarake të japin këshillim ushtarak profesional të depolitizuar dhe logjik, si dhe të marrin, sa më shumë të jetë e mundur, drejtim politik të qartë dhe të padyshimtë. Përpyekja e kërkuar për të ruajtur kohezionin e Aleancës, për të mbajtur një kurs të qëndrueshëm dhe për të plotësuar kërkesat e opinionit publik krijon tensione të konsiderueshme në nivelin politik.”²¹

Të njëjtën referencë e gjejmë edhe në AJP 3B. Në kreun II, që ka të bëjë me formimin e forcës, në Seksionin II “ arkitektura e komandim-kontrollit”, në paragrafët 0206 dhe 0207, gjejmë të reflektuar teorinë e Klauzevicit, si më poshtë: *Niveli strategjik, “ Në këtë nivel, Forcat Aleate përdoren brenda një kuadri politiko-ushtarak të rekomanduar nga Komiteti Ushtarak (MC) dhe të miratuar nga Këshilli i Atlantikut Verior (NAC), me qëllim që të arrihen objektivat strategjike të Aleancës. SACEUR merr komandimin e përgjithshëm të operacionit në nivel strategjik. SACEUR nxjerr direktivën ushtarake strategjike për komandantët vartës. Përfshirja e vendeve partnere në marrëveshjet e komandimit parashtrohet në parimet dhe modalitetet e Kuadrit Politiko-Ushtarak për operacionet e Partneritetit për Paqe, të udhëhequra nga NATO”²².*

Edhe në AJP 5, gjejmë njaft mirë të zberthyer konceptin klauzeviçian të MPU. “Marrëdhënia e planëzimit operacional me planëzimin e mbrojtjes së NATO-s”²³, pika a, rithekson : “ *Funksioni 1. Udhëzimet politike. Udhëzimet politike të NATO-*

¹⁹ AJP-01(D), nivelet operacionale; nivel strategjik ushtarak; 0019; fq.16.

²⁰ Objektivat politike nuk janë domosdoshmërisht të specifikuar ushtarakisht (megjithëse disa prej tyre edhe mund të jenë). Si të tilla, gjendja përfundimtare e NATO-s (politike), objektivat politike dhe udhëzimet e tjera mbi veprimet specifike ushtarake të përshkruara në Direktivën Inicuese të NAC-ut do të përdoren nga komandanti strategjik gjatë përcaktimit të objektivave strategjike ushtarakë.

²¹ AJP 01(D), “Politika moderne dhe konteksti politico-ushtarak”, fq.63.

²² AJP3B, kreu II, seksioni II “Arkitektura e komandim-kontrollit”; fq.2.2.

²³Cf. for the complete Section PO(2009)0042 Outline Model for a NATO Defence Planning Process, dated 01 April 2009

s (PG) sigurojnë qëllimet e përgjithshme dhe objektivat që duhen arritur nga Aleanca brenda kuadrit të planëzimit të mbrojtjes. Aty përcaktohet qartësisht se çfarë duhet të jetë e aftë të bëjë në terma cilësorë dhe sasiorë, duke kulmuar me nivelin e ambicies së Aleancës dhe prioritetet që e shoqërojnë. Komuniteti i planëzimit operacional, duke shfrytëzuar mësimet e nxjerra nga operacionet, stërvitjet dhe aktivitetet e tjera kontribuon në analizën e zbulimit dhe analizën ushtarake të udhëzimeve politike.”²⁴ Gjithashtu, në këtë publikim hasim edhe një herë kontrollin politik nëpërmjet NAC. “Kontrolli politik. NAC ushtron kontrollin politik në procesin e planëzimit operacional, dhe për pasojë, edhe në procesin e planëzimit në nivel operativ nëpërmjet: Dhënies së direktivës fillestare; Aprovimit të idesë së operacionit dhe kërkesave paraprake për planin operacional strategjik; direktivën strategjiko-politike; Aprovimit të kategorive të objektivave; Aprovimit të rregullave të angazhimit; Autorizimit të aktivizimit të forcave; Aprovimit të planit operacional strategjik; Aprovimit të dislokimit të forcave; Autorizimit të zbatimit të planit të operacionit; Aprovimit të mesazheve kryesore të informimit”.²⁵

Përfundime

Mënyra e reflektimit na ndihmoi që të kuptonim aktualitetin e mendimeve të Klauzeviçit. Çështjet që paraqet Klauzeviçi janë sfida si për liderët politikë, ashtu edhe për liderët ushtarakë. Liderët politikë duhet të mendojnë si strategët, duke qenë të qartë që në fillim në lidhje me qëllimet dhe mjetet njihëse se këto mund të ndryshojnë në rrjedhën e ngjarjeve. Liderët politikë pritët të jenë autoriteti mbi pikat e forta dhe dobësitë e brendshme, si dhe mbi mjedisin ndërkombëtar. Klauzeviçi, gjithashtu, i ngarkon liderët politikë “... me përgjegjësinë e të qenit të njohur me mjetet ushtarake, çka do të thotë që ata të jenë konsumatorët inteligjentë të këshillave ushtarakë”.²⁶ Po në të njëjtën mënyrë janë të sfiduar edhe liderët ushtarakë. Jo vetëm janë të njohur si ekspertë në “gramatikën” e luftës, por ata duhet të mbeten gjithmonë të vetëdijshëm se, qëllimet e luftës vijnë nga jashtë tyre dhe se këto qëllime, të cilat janë politike, duhet përfundimisht të qeverisen. Ajo që mbetet për t’u debatuar është se cila nga këto sfida është më e kërkuara. Çfarë është marrëdhënia ideale në mes të komandantit dhe një pushtetari në kohë lufte? Cilat janë kufizimet optimale, nëse ka ndonjë, a ekzistojnë ato te kontrolli politik mbi operacionet ushtarake? Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre pyetjeve, jepen një varg përgjigjesh si nga Klauzeviçi, ashtu edhe në botimet e ndryshme të Aleancës.

Bibliografia:

- Klauzeviç, “Mbi luftën”.
- AJP5.
- AJP-01(D).

²⁴ AJP5, Seksioni VI - Marrëdhënia e planëzimit operacional me planëzimin e mbrojtjes së NATO²⁵/ pika a. : “Funksioni 1 -Udhëzimet politike”, fq.18.

²⁶ AJP 5, 0353 Kontrolli i procesit të planëzimit operacional; fq.119.

²⁷ Klauzevic, “Mbi Luftën” ; V.III, kreu VI-ndikimi I qëllimit politik në objektivin ushtarak/pika B; fq.565, 570.

- AJP 3B.
- Daniel B. Baker, “*Power Quotes*”.
- William Manchester, “*The American Caesar*”, New York: Dell Publishing Company, 1978.
- Russell F. Weigley, “*The American Military and the Principle of Civilian Control from McClellan to Powell,*” *The Journal of Military History*, *Special Issue*; Vol. 57, October 1993.
- Zija Bahja, “MCU dhe bashkëpunimi ndër-agjencor në sektorin e sigurisë në Shqipëri”.
- Sun Xu, hyrje, kap.1.

Planifikimi i kohës dhe Drejtimi

Kolonel Dr. Edmond Braneshi,
Zëvendësrektor i AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Koha përbën një stres më vete për drejtuesin, pasi çdo detyrë e marrë ka një afat të caktuar kohor realizimi. Drejtuesi ndodhet midis direktivës (misionit) të marrë nga eprori dhe zbatimit të saj nga vartësit në kohën e duhur. Kështu, ai duhet të njohë mirë teknikat e programimit të kohës dhe njëkohësisht të zotërojë aftësi të mira organizative dhe një karakter të qëndrueshëm. Në këtë kuadër, shkrimi jep impuls domethënës veprimtarisë së pavarur drejtuese, me qëllim që ata të zotërojnë në mënyrë logjike dhe analitike faktorin “kohë”. Për këtë, drejtuesit duhet të kenë parasysh disa norma që synojnë rritjen e frytshmërisë së veprimtarisë së organizatës. Klima duhet të jetë e tillë që, si drejtuesi edhe vartësi të mendojnë dhe veprojnë në funksion të qëllimit të përbashkët apo misionit, sipas prioritetit kohor të realizimit të tij pa qenë nevoja e udhëzimeve plotësuese.*

Kompetencat metodike janë të lidhura ngushtësisht me aftësitë individuale të drejtuesit ushtarak, me aftësitë për të drejtuar e udhëhequr njerëzit, për t’u pozicionuar në çdo çast në mënyrë bindëse si personalitet shoqëror dhe juridik. Është pikërisht aftësia për të administruar suksesshëm kohën që ka në dispozicion, ajo që do t’i japë kuptim veprimtarisë së drejtuesit si një personalitet që zotëron çdo situatë.

Hyrje

Drejtimi është një nga problemet më delikate dhe me përgjegjësi. Vetë të qenurit drejtues është ngarkesë e përhershme, nën presionin e marrjes së detyrave nga eprori dhe realizimi i tyre nga vartësit. Kur emërohesh drejtues ndodhesh para një sfide të re, më të madhe e shumë më të ndryshme nga mendësia që krijohet, kur zgjidhesh për një detyrë normale shtabi. Sfida, për shumë arsye bëhet më e afërt e më e mprehtë. Drejtuesi në çdo çast do të përballet me detyra të ndryshme të planëzuara më parë ose të çastit, të cilat duhet të realizohen në kohë, në funksion të misionit të organizatës. Të gjitha planëzimet që bën drejtuesi, qofshin ditore, javore, mujore e vjetore, kanë një lidhje logjike me njëra-tjetrën dhe janë të ndërvarura, pasi mosrealizimi i njëres masë a detyrë në kohën e duhur pengon ecurinë e masës a detyrës tjetër. Koha është një resurs i çmuar; ajo nuk mund të ruhet, nuk mund të shtohet, nuk mund të kthehet prapa, por vetëm mund të shfrytëzohet, duke e

administruar sa më drejt. Në këtë kuadër, një drejtues i mirë duhet të ketë përgjegjësi absolute përsa i përket kohës, në mënyrë që ajo të planëzohet drejt dhe sipas rëndësisë së detyrave.

Të qenët drejtues, në radhë të parë, nënkupton përgjegjshmëri për realizimin e misionit të ngarkuar dhe zotërim të kompetencave drejtuese. Kjo do të thotë që e gjithë veprimtaria e tij të jetë mbi baza ligjore; po ashtu, drejtuesi duhet të ketë ndjenjën e përgjegjësisë për ecurinë e të gjitha detyrave dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në organizatë. Ai duhet të jetë ideuesi, përpunuesi, përshtatësi dhe bashkërenduesi i të gjitha “zërave” që i përkasin organizatës së tij, pavarësisht se direktiva (urdhri) vjen nga eprori, pavarësisht se drejtuesi vetë mund të delegojë kompetenca, apo një pjesë e detyrave zbatohen drejtpërsëdrejti nga vartësit. Rudolf Xhuliani, në kujtimet e tij si kryetar i Bashkisë së Nju-Jorkut rrëfen: “*Shumë udhëheqës mbajnë thënie tërheqëse mbi tryezat e tyre. Një pllakat dy-fjalësh mbi tryezën time të punës përmblihte vërtet filozofinë time: “JAM I PËRGJEGJSHËM”. Gjatë qëndrimit tim në bashki bëra më të mirën e mundshme që këto fjalë të ishin një lloj nënshkrimi i dytë për çdo punonjës, duke filluar nga vetja ime. Gjatë gjithë karrierës sime e kam pasur këtë përgjegjshmëri. Ideja se njerëzit që punojnë për mua janë përgjegjës kundrejt atyre për të cilët ne punojmë, është guri themelor. Dhe ky parim fillon me mua*”.¹ Ndjenja e përgjegjësisë bën që drejtuesi të jetë i lidhur në çdo kohë me vartësit e bashkëpunëtorët e tij për dinamikën e detyrave që ka njësia dhe së bashku të jenë partnerë për zbatimin e tyre.

Koncepti për administrimin e kohës

Admirali amerikan Arleigh A. Burke, në librin e tij “Lidershipi detar: Zëri i përvojës” (1987) thekson: “*Lidership do të thotë të kuptosh njerëzit dhe njëkohësisht t’i përfshish ata në veprimtari në mënyrë që t’ju ndihmojnë të bëni punën. Kjo kërkon angazhimin e cilësive tuaja më të mira si: ndershmërinë, përkushtimin ndaj arritjes së qëllimit, njohuritë, aftësitë, papajtueshmërinë si dhe vendosmërinë për sukses*”.² Në këtë kuadër, aftësia për të orientuar vlerat njerëzore si dhe mundësia për të vendosur marrëdhënie efektive ndërmjet resurseve dhe shpenzimeve, nuk do të evidentoheshin si elemente parësore të personalitetit të individit si drejtues rezultativ, nëse ato nuk analizohen në përputhje me elementin kohë dhe me potencialet individuale për të kuptuar e administruar kohën. Për të krijuar një ide të qartë lidhur me këtë është e nevojshme të sqarohet pozicionimi i drejtuesit ndaj kohës. Vendosja e marrëdhënieve efektive ndërmjet njësisë së kohës dhe kompetencave metodike e profesionale si pjesë përbërëse të kompetencave drejtuese jep përmbajtjen e konceptit “*menaxhimi i kohës*”. Koha është një tregues cilësor i një veprimtarie efektive dhe drejtuesi duhet të mbajë parasysh disa **norma**:

Hapësirë pa kufi. Një drejtuesi të mirë nuk i mungon koha të kontaktojë në çdo çast me bashkëpunëtorët dhe vartësit e tij. Ai duhet ta gjejë kohën për çdo problem në funksion të punës e në të mirë të vartësve dhe t’u japë zgjidhje drejtpërsëdrejti, pa ndjekur rrugën burokratike. Perri Smith në librin e tij “Përgjegjësia” u këshillon drejtuesve të njësisë rregullin e “4 orëshit”, sipas të cilit “...drejtuesit nuk duhet të harxhojnë më shumë se

¹ Rudolph Giuliani “Udhëheqja”, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë 2006, faqe 84.

² FM 6-22, “Army Leadership, Competent, Confident and Agile”, October 2006, faqe 12-2

katër orë në ditë në zyrë... dhe pjesa tjetër e kohës duhet harxhuar në takimet me njerëzit e tjerë, duke vizituar repartet vartëse në veprimtaritë e ndryshme, duke marrë pjesë në ngjarje shoqërore, duke drejtuar ose duke marrë pjesë në ceremoni të ndryshme apo duke mbajtur biseda të shkurtëra me motive e qëllime të caktuara...³. Në këtë drejtim nuk mungon edhe përvoja e shumë drejtuesve të shquar. Kështu, Montgomeri i rekomandonte çdo komandanti që rreth 1/3 e kohës t'ua kushtonte ushtarëve, oficerëve dhe gjeneralëve: "...Gjatë gjithë ditës qëndroja në front poshtë e lart vijës së saj, – shkruan ai në librin e tij me kujtime "Fushëbeteja", – duke shkuar e parë vazhdimisht dëgjoja problemet e trupës, u jepja komandantëve vendime dhe urdhra verbalë..."⁴. Edhe Ajzenhaueri gjatë përgatitjes së operacionit në Normandi "...harxhoi shumë nga koha e tij, duke vizituar trupat në terren... Në katër muaj ai vizitoi 26 divizione, 24 fusha aeroplanësh, 5 anije lufte dhe një numër të pafund objektesh të tjera..."⁵.

Takimi me vartësit jep mundësinë e njohjes sa më mirë të karakterit dhe natyrës së tyre. Drejtuesi duhet të krijojë një klimë të tillë që vartësit të ndjehen partnerë të vërtetë në realizimin e çdo detyre si dhe të jenë pjesëtarë aktivë në të gjithë veprimtarinë shumëplanëse të organizatës. Si shembull mund të përmendim komandantin e suksesshëm të Luftës së Gjirit, Gjeneralin Shvarckopf, i cili "...shrytëzonte çdo rast e kohë të lirë për të shkuar në terren dhe të fliste shtruar me njerëzit e vet. Ky veprim ishte një amplifikator i moralit të forcave dhe një terapi për vetë Shvarcin. Vizitat me njerëzit e luftës dhe eprorët e tyre të drejtpërdrejtë gjithnjë e ngrohë nga ana shpirtërore, e bindte atë çdo ditë e më tepër për aftësinë luftarake dhe shkallën profesionale të trupave nën komandë."⁶ Pra, suksesin e tij, drejtuesi duhet ta mbështesë, ndër të tjera, te besimi reciprok, nderimi, respekti dhe siguria ndaj vartësve. Në këtë kuadër, kontakti me vartësit dhe bashkëpunorët kërkon hapësirë "pa kufi".

Mendim i sistemuar (ose **qartësia në të shprehur**). Për probleme pune, drejtuesi komunikon vazhdimisht me eprorët, kolegët, vartësit e bashkëpunëtorët, zhvillon mbledhje, konsulta, analiza e trajtesa, biseda në telefon, kontakton me të huajt etj., dhe në çdo rast ai duhet të jetë mjaft lakonik dhe i saktë, duke iu përshtatur partnerit. Komunikimi është efektiv kur drejtuesi shprehet qartë dhe kuptohet plotësisht nga partneri. Në shumë raste qëllimi i komunikimit është: për të drejtuar, ndihmuar, bashkërenduar, nxitur, kontrolluar, përgatitur, mësuar dhe këshilluar vartësit. Drejtuesi duhet të jetë në gjendje të kuptojë problemin, ta mendojë mirë atë dhe ta shndërrojë në një ide të qartë, të përmbledhur dhe në formë të përshtatshme. Mesazhi i tij duhet të jetë i qartë, i thjeshtë, i kuptueshëm dhe t'i shërbejë qëllimit. Sipas R. Xhulianit, një nga përgjegjësitë e drejtuesit është "...të kuptojë nevojat e atyre që drejton. Qëllimi nuk është të ndryshosh mesazhin sipas atyre që të dëgjojnë, por ta paraqitësh atë në mënyrë të tillë që ai të kuptohet prej të gjithë atyre që u drejtohesh. Qëllimi duhet të jetë që të sigurohesh që mesazhi yt do të mbërrijë i fortë dhe i qartë te sa më shumë njerëz që të jetë i mundur"⁷.

³ Perry M. Smith, "Taking Charge, a practical guide for leaders", National Defense University Press, Washington, D.C. 1986, faqe 11.

⁴ Bernard Montgomeri, "Fushëbeteja (kujtime)", SHBU, Tiranë 1994, faqe 33.

⁵ Stefën E. Ambroz, "Duajt D. Ajzenhauer", SHBU, Tiranë 1995, faqe 95.

⁶ M. E. Morris "H. Norman Shvarckopf: Stuhia e shkretëtirës", SHBU, Tiranë, faqe 72.

⁷ Rudolph W. Giuliani, "Udhëheqja", Shtëpia Botuese "Dudaj", Tiranë 2006, faqe 211.

Një drejtues, që zotëron mendimin e sistemuar, ndikon drejtpërdrejt në fitimin e kohës, pasi në çdo situatë, pyetjet, sqarimet, replikat, hezitimet, kundërshtimet etj., do të jenë minimale ose nuk do të ketë fare të tilla, e për pasojë, mesazhi merret drejt. Në të njejtën kohë, kjo bën që edhe çdo bashkëpunëtor i drejtuesit, qoftë ai epror a vartës, koleg a ortak, të jetë gjithmonë i përgatitur kur të kontaktojë me të. Nëse drejtuesi nuk shprehet qartë, vartësi do ta perceptojë mesazhin sipas mendjes së tij dhe ky “telefon i prishur” do të vazhdojë edhe në hallkat e mëposhtme. Si rrjedhojë, efektiviteti do t’i largohet sa më shumë realizimit të objektivitetit të vërtetë. Ja si shprehet për këtë problem Gjeneral M.A. Birand: *“Zbatimi i direktivës realizohet në forma të ndryshme. Në qoftë se komandantët qëndrojnë në nivelin e detyrës së tyre dhe janë të pajisur me aftësitë e nevojshme, zbatimi i urdhrat dhe i direktivës realizohet suksesshëm. Në rast të kundërt, komandanti le të thotë ç’të dojë, direktiva do të zbatohet ashtu siç e koncepton i urdhëruari. Pra, urdhrat e instruksionet që jepen duhet të jenë të qarta si për atë që e jep dhe për atë që e merr, pra të qarta, të zbatueshëm për cilindo”*⁸. Pra, është pikërisht qartësia dhe saktësia e të shprehurit në vazhdimësi e drejtuesit që detyron cilindo person që t’i përmbahet në mënyrë të përmbledhur problemit ose çështjeve që diskutohen brenda kohës së lejuar dhe pa bezdisje.

Vendimmarrja. Drejtuesi duhet të jetë i aftë për të vlerësuar shpejt situatën dhe për të marrë vendime të qëndrueshme. Një vendim i marrë shpejt dhe drejt siguron suksesin e betejës apo të veprimtarisë. Në një situatë luftarake ose në stërvitje, një drejtuesi do t’i duhet të përballet me probleme të ndërlikuara të cilat kërkojnë zgjidhje të menjëhershme dhe, në varësi të situatës, informacioni mund të jetë i plotë ose i pjesshëm. Për të marrë një vendim sa më të saktë dhe funksional, që t’i shërbejë kapërcimit të vështirësive, nga drejtuesi kërkohet:

- të njohë dhe të përcaktojë qartë problemin;
- të grumbullojë informacionin e nevojshëm dhe të supozojë rreth tij;
- të zhvillojë me vetveten zgjidhjet më të mundshme;
- të analizojë dhe të krahasojë këto zgjidhje duke marrë për bazë variantin më të mirë.

Ky proces është i vazhdueshëm. Koha e parashikuar, shpejtësia për zgjidhjen e situatës, gjykimi i drejtuesit dhe profesionalizmi i tij do të ndikojnë pozitivisht në procesin e vendimmarrjes. Megjithatë, drejtuesi asnjëherë nuk duhet të bëhet “pre” e nxitimit në dëm të cilësisë së vendimit. *“Nxitimi në marrjen e vendimit prej komandantit - theksonte gjenerali Zhukov, - pa kontrollin dhe rikontrollin e detyrave, të të dhënave të marra dhe vlerësimin e aftësive të atyre që kanë raportuar situatën, si të njohurive ushtarake, të përvojës, të vetëpërmbytjes dhe të gjakftohëtisë, ndikon negativisht në ecurinë e operacionit ose të luftimit”*⁹.

Vendimet e nxituara e të vrullshme kthehen gjithmonë në veprime që më pas na bëjnë të pendo kemi që i kemi kryer. Prandaj drejtuesi duhet të dëgjojë të gjithë vartësit përkatës para se të vendosë. Ai duhet të marrë vendime të prera, por me urtësi e durim. Në raste të veçanta ai mund ta shtyjë marrjen e një vendimi të rëndësishëm vetëm me qëllimin për të

⁸ Mehmet Ali Birand, “Urdhëroni komandant”, SHBU, Tiranë 1994, faqe 143.

⁹ G.K. Zhukov, “Kujtime dhe meditime”, vëllimi I, SHBU, Tiranë 1995, faqe 344-345.

mblethur informacionin dhe argumentet e nevojshme. Gjithashtu, ai duhet të bisedojë me vartësit që nuk janë pro vendimit të paraqitur, për të marrë vesh pikëpamjen e tyre të kundërt, sepse në fund të fundit, edhe një *vendim i pamarrë është në vetvete një lloj vendimi*.

Aftësia vendimmarrëse e një drejtuesi do të ishte gjysmake nëse nuk shoqërohet me masat e duhura për zbatimin e tij. Ai duhet të ketë qartësinë për të zhvilluar drejt strategjinë e zbatimit të vendimit deri te hallka e fundit. Ajo që i ngriti vlerat Ajzenhauerit si drejtues i suksesshëm “*ishte, - siç pati theksuar ai, - ... arti i drejtimit, mbi të gjitha i marrjes së vendimeve të drejta, të cilat arritën të kuptohen e të zbatohet nga njerëzit*”¹⁰.

Drejtuesi që i shtyn pa fund vendimet krijon një atmosferë që e çorienton organizatën, krijon konfuzion dhe humbet besimin te vartësit. Prandaj *një vendim i drejtë, i marrë në kohë, është më i mirë se një vendim shumë i mirë, por i marrë me vonë*.¹¹ Kjo është filozofia që duhet të udhëheqë drejtuesin në vendimmarrje.

Fryma kohezive. Deril Henderson në librin e tij “Kohezioni” përcakton qartë thelbin e kësaj dukurie. Ai shkruan se “...kohezioni ushtarak është lidhja e pjesëtarëve të një njësie në një formë të tillë që çdo pjesëtar i saj t’ia nënshtrojë vullnetin dhe angazhimin e vet shokut të tij, njësisë ku bën pjesë dhe misionit të ngarkuar”¹². Pra, siç shihet, kohezioni është produkt i lidhjes së ushtarakëve me njëri-tjetrin ose e thënë ndryshe i lidhjes drejtues-vartës. Kohezioni kërkon një respekt të vazhdueshëm, një detyrim të fortë si dhe besim, koefidencë e mirëkuptim brenda organizatës.

Të dhënat nga betejat e zhvilluara gjatë Luftës së Dytë Botërore tregojnë se përqindja e dështimeve ishte shumë më e vogël në njësitë kompakte se sa në ato jo kompakte. Sipas veteranëve amerikanë, *40-50 përqind e humbjeve janë shkaktuar më shumë nga lodhjet se sa nga veprimet në beteja*.¹³ Përfundimi është i qartë: është e nevojshme që drejtuesi të zhvillojë frymën e kohezionit sidomos përpara se të shkojë për të luftuar a vepruar dhe ta ruajë atë gjatë luftës ose veprimtarisë. *Në qoftë se ushtarët jetojnë në atmosferën e së panjohurës, në qoftë se ata i trembin dhe i persekutojnë, në qoftë se disiplina ruhet kryesisht me dhunë, në një situatë të tillë, instikti i frikës merr përmasa kërcënuese dhe i shkakton dëme serioze aftësisë luftarake të trupave*,¹⁴ prandaj një drejtues i mirë duhet të jetë tepër i vëmendshëm ndaj këtyre dukurive. Ai gjithmonë duhet të qëndrojë pranë vartësve duke mbajtur një qëndrim të kujdesshëm ndaj tyre dhe në këtë mënyrë ata do ta ndejnë veten të bashkuar si një kolektiv unik dhe atëherë nuk do të ketë vështirësi që të mos jenë në gjendje t’i kalojnë. Fryma kohezive duhet të jetë dyplanëshe: horizontale dhe vertikale.

Fryma kohezive horizontale nënkupton që drejtuesi me shtabin e tij (vartësit e drejtpërdrejtë) me të cilët këshillohet e debaton për ciklin e procesit të drejtimit (përcaktimin e objektivave, planëzimin, përgatitjen e urdhrave dhe kontrollin) karakterizohen nga bashkëpunimi i frytshëm dhe të gjithë në mënyrë solide janë në funksion të misionit të njësisë.

¹⁰ Stefën E. Ambroz, “Duajt D. Ajzenhauer”, SHBU, Tiranë 1995, faqe 59.

¹¹ “Udhëheqja Ushtarake”, SHBU, Tiranë 1995, faqe 122.

¹² Deril Henderson, “Kohezioni (elementi njeri në luftim)”, SHBU, Tiranë 1995, faqe 14.

¹³ “Udhëheqja Ushtarake”, SHBU, Tiranë 1995, faqe 113.

¹⁴ Norman Kouplend, “Psikologjia dhe ushtari”, SHBU, Tiranë 1993, faqe 31.

Fryma kohezive vertikale do të thotë se gjithçka e planëzuar merr vlerë vetëm kur zbatohet në kohën dhe vendin e duhur dhe nga personeli përkatës. Sidoqoftë, sado të përkryera të jenë planet, në fund të fundit, ata që do t'i zbatojnë janë ushtarët e organizuar në grupe, skuadra, toga e kompani dhe secila prej këtyre hallkave ka nga një drejtues. Pikërisht drejtuesi i njësisë, nëpërmjet “*zinxhirit komandues*”, duhet të ndikojë fuqishëm te drejtuesit e hallkave poshtë tij në mënyrë që ata:

- të përcjellin synimet e objektivat që duhen arritur;
- të drejtojnë repartet, nënrepartet e njësitë e vogla në arritjen e këtyre synimeve e objektivave;
- të ruajnë normat e dëshiruara të sjelljes brenda grupit, duke siguruar mbështetjen e hallkës eprore;
- të krijojnë e të ruajnë një “trupë të shëndoshë” nëpërmjet shembullit vetjak.

Qëllimi i frymës kohezive vertikale është “çimentimi” i masës së individëve në një kolektiv të organizuar, veprimi i tyre si një tërësi e vetme që drejtohet për arritjen e një qëllimi të përbashkët.¹⁵ Drejtuesi i njësisë nëpërmjet bashkërendimit të detyrave dhe stilit të tij të drejtimit duhet të çojë në kompaktësimin e trupës. Rëndësia e frymës kohezive del qartë në thënien e mëposhtme të Uellingtonit: “*Nuk është e vështirë të hedhësh një armatë britanike në një aksion të përgjithshëm dhe t’i bësh ushtarët dhe oficerët të kryejnë detyrën. E vështirë është t’i sjellësh ata si një trupë kompakte deri në pikën ose në çastin kur do të fillojë beteja*”¹⁶.

Natyrshëm lind pyetja: “A ka lidhje fryma kohezive me moralin e trupës që vepron për arritjen e objektivit ?” ose, “A ndikon kohezioni te morali i trupës ?” Mendoj se po. Suksesi i frymës kohezive kërkon një moral të lartë, i cili duhet të pasqyrohet nga trupa, si para dhe gjatë realizimit të objektivave. Shpesh, kohezioni duhet kuptuar si sinonim i moralit. Nuk mund të kuptohet një trupë me frymë kohezive dhe pa moral të lartë apo anasjelltas. Kjo lidhje e dyanshme duket më së miri në *faktorët*¹⁷ që ndikojnë në mbajtjen lart të moralit, të cilët janë:

- së pari, një trupë me moral të lartë, gjithmonë ka një synim të përbashkët. Ky objektiv është i qartë për secilin;
- së dyti, trupa funksionon si njësi e vetme. Të qenit në një mendje me natyrën e objektivit përfundimtar, shkakton ndjenjën e bashkësisë dhe të shpirtit të repartit.
- së treti, morali i lartë shoqëron njohjen e rrezikut të përbashkët;
- së katërti, prirja në rritje me moralin ushtarak vjen kur secili ndjen se ai mund të përballojë rrezikun nëpërmjet veprimit vetjak dhe bashkëveprimit;
- së pesti, njohja në vijimësi e efektivit me faktin se po bëhen përparime në arritjen e objektivit të përbashkët.

Fryma kohezive nuk është çështje ditësh, por është problem i përhershëm i drejtuesit.

¹⁵ Norman Kouplend, “Psikologjia dhe ushtari”, SHBU, Tiranë 1993, faqe 42.

¹⁶ Xhon Kigan, “Maska e komandimit”, SHBU, Tiranë 1994, faqe 187-188.

¹⁷ L.A. Pennington, Rameyn, B. Hought, H.W. Case, “Psikologjia e drejtimit në ushtri”, SHBU, Tiranë 1995, faqe 258.

Në këtë kuptim “koha” është një kapital ndaj të cilit duhet të tregohet largpamësi dhe ndjenjë e lartë përgjegjësie për një shfrytëzim efektiv. Debatimi me vetveten për çështjet e fushës së përgjegjësisë si drejtues, është mënyra më e mirë për të kuptuar mundësitë që të ofrohen, me qëllim që situatat, qofshin ato të favorshme apo jo të favorshme, t’i orientosh drejt qëllimit të caktuar, duke i zgjidhur me sukses dhe në afat. Nga ky këndvështrim mund të veçohen dy aspekte: **së pari**, ndryshimi dhe përmirësimi i aftësive drejtuese do të bëhet nëpërmjet zotërimit të vetvetes dhe vendosmërisë për të ndikuar e drejtuar në mënyrë aktive rrjedhën e punës drejtuese, duke mënjanuar ndikimet negative në këtë rrjedhë; **së dyti**, nëpërmjet zbatimit konsequent të metodave dhe teknikave të përshtatshme të miradministrimit të kohës, përmirësohen mënyrat e drejtimit në kuadrin e procesit të drejtimit. Këto aspekte të veçanta, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me elementin kohë, nxjerrin edhe disa synime thelbësore të veprimtarisë së drejtuesit, duke i dhënë një kuptim përcaktues konceptit “*menaxhim kohe*”, synime të tilla si:

Përmirësimi dhe rritja e produktivitetit të punës në njësinë e kohës.

Kjo do të thotë që për të njëjtin shpenzim kohe, rezultati të jetë më i mirë. Për këtë, si drejtuesi edhe vartësi duhet të mendojnë dhe të veprojnë në funksion të qëllimit të përbashkët (misionit), sipas prioritetit kohor të realizimit të tij pa qenë nevoja e udhëzimeve plotësuese. Kur Ajzenhaueri punonte në Drejtorinë e Planifikimit, gjenerali Xhorxh Marshall (ish-shefi i shtabeve të përbashkëta të SHBA-së) iu drejtua: “*Ajzenhauer, departamenti ka plot njerëz të zotë, që analizojnë mirë problemet, por m’i lënë mua që të gjej zgjidhjen finale. Unë duhet të kem asistentë që t’i zgjidhin vetë problemet dhe më pas të më thonë çfarë kanë bërë*”¹⁸. Produktiviteti në punë është pjesë e stilit të drejtimit dhe drejtuesi duhet të ndikojë që vartësit të mos sjellin vetëm “probleme”, por të sjellin rrugët e zgjidhjes së tyre, gjë që ndikon ndjeshëm në ecurinë e arritjes së objektivave dhe në motivimin e tyre. Te libri “Elementet e Lidërshiptit” theksohet: “*Motivimi është më shumë se inkurajim. Ju keni mundësi të motivoni anëtarët e organizatës tuaj, duke i ndihmuar ata që të jenë pjesë e zgjidhjes së problemeve, që të arrijnë rezultatet e pritshme. Në këtë kuadër, ju i jepni një shtysë më të gjerë motivimit, duke hequr barrierat (komplekset frenuese) të performancës dhe kështu, vartësit mund të realizojnë më lehtësisht detyrat e tyre*”¹⁹. Ky është një element i rëndësishëm drejtimi që ka një ndikim të madh në frytshmërinë e përditshme të veprimtarisë së vartësve dhe është i lidhur drejtpërsëdrejti me “klimën” që sjell drejtuesi.

Zgjerimi i hapësirës informative e kualifikuese në fushën profesionale dhe zhvillimi i personalitetit si individ.

Kjo arrihet me studim të vazhdueshëm, duke u njohur me të renë, bashkëkohoren, duke qenë gjithnjë në korent të problemeve si dhe duke debatuar me vartësit prej të cilëve ke se ç’ mëson. Duke iu referuar librit “Udhëheqja”, Rudolf Xhuliani, në kohën që ishte kryetar i Bashkisë së Nju Jorkut shprehet si më poshtë: “*Unë i shikoj debatet jashtëzakonisht të dobishme dhe ndonjëherë i nxisja vetë, me qëllim që të dëgjoja më shumë pikëpamje për diçka. Gjithnjë marr vendimin më të mirë, nëse dëgjoj më parë*

¹⁸ Stefan E. Ambroz, “Duajt D. Ajzenhauer”, SHBU, Tiranë 1995, faqe 46.

¹⁹ Mike Mears, “Leadership Elements, a guide to building trust”, Universe, Inc. New York Bloomington 2009, faqe 75.

*tri apo katër pikëpamje të ndryshme... Nuk mund të krijosh një debat të përzemërt, nëse pjesëmarrësit besojnë që përfundimi është i paravendosur*²⁰.

Po kështu, informimi duhet të konsiderohet nga drejtuesi, si një element përcaktues në moralin e vartësve dhe besueshmëri në veprimtarinë e tij drejtuese. Është e provuar katërciprisht se vetëm ai që është i informuar në kohë dhe që mund të dallojë rolin e rëndësishëm të tij në veprimin luftarak e merr seriozisht detyrën, është i gatshëm dhe ka besim në drejtësinë e vendimit të eprorit për suksesin. Kjo do të thotë se në veprimtarinë drejtuese, çështja e informimit nuk është një problem që u takon “disave”, të cilët, duke monopolizuar informacionin vendosin me dashje ose padashje tutelën, kultivojnë frikën dhe veprimin në të panjohurën, dukuri këto, që sjellin dështimin apo mospjesëmarrjen. Është pikërisht drejtuesi ai, që administron drejt informacionin, duke e dhënë në vendin dhe kohën e duhur drejtëpërsëdrejti ose jo, së bashku me udhëzimet përkatëse. Kështu drejtuesi, duke mbushur këtë boshllëk të vartësve, ndikon sa më mirë në arritjen e suksesit prej tyre në veprimtarinë e tyre.

Shmangia e ndërhyrjeve nga jashtë

Kjo arrihet kur secili i del zot detyrës së tij, duke i hequr mundësinë e ndërhyrjes së tjetrit në vendimet brenda kompetencave e fushës së përgjegjësisë. Kur Kolin Pauell u emërua komandant i Korpusit të pestë në Gjermani, në takimin e parë që organizoi me vartësve, ndër të tjerë tha: “...nuk duhet të përplasat marrja e çdo vendimi deri tek unë. Unë kam një zonë të gjerë indiference. Nuk dua t’ia di nëse ju e bëni zgjedhjen në orën 5.30 apo në 5.45 dhe mos më pyesni mua për të vendosur...”²¹. Drejtuesi i çfardo niveli qoftë e përcakton vetë kohën e kryerjes së çdo detyre, duke shmangur mundësinë e ndërhyrjeve nga jashtë.

Në këtë kuadër ndërhyrjet nga jashtë shmangen kur drejtuesi:

- njeh me saktësi fushën e përgjegjësisë së tij dhe të vartësve e bashkëpunëtorëve;
- përcakton vetë kohën e kryerjes së detyrave kryesore;
- shmang përplasjet e panevojshme, duke sinkronizuar bashkëveprimin dhe përgjegjësitë;
- krijon një mjedis të këndshëm për punën dhe shfaq kurdoherë prirje për të ndryshuar qëndrimin për mirë;
- nxit krijimtarinë dhe aplikimin e teknikave të reja në punë, duke administruar drejt resurset dhe kohën.

Mosdikimi nga komplekset vetjake dhe kontrolli i vetvetes

Për të siguruar kurdoherë si duhet rolin e tij në organizatë, drejtuesi duhet të njohë së pari vetveten, dobësitë, pikat e forta dhe të dobëta të tij. Ai përpiqet gjithmonë për një vetëvlerësim kritik, duke qenë i vetëdijshëm që sjellja e tij në mjedisin civil apo ushtarak nuk kalon pa u vëzhguar në mënyrë kritike. Në analizën e vetvetes është i nevojshëm vetëbesimi dhe vetëvlerësimi, por gjithmonë të kombinuara me gatishmërinë për të dëgjuar, për të pranuar kritikën, për të mësuar nga gabimet. Drejtuesi vazhdimisht duhet të jetë i hapur me veten, duke larguar mburrjen dhe

²⁰ Rudolf W. Giuliani, “Udhëheqja”, Shtëpia botuese “Dudaj”, Tiranë 2006, faqe 156.

duke pranuar me sinqeritet gabimin. Sipas H. Boks, *njeriu inteligjent i vë re gabimet, i pranon dhe i korrigjon, njeriu teveqel i vë re, i pranon dhe i vazhdon*²². Drejtuesi nuk humbet asgjë nëse vartësve u kërkon këshilla dhe pranon gabimet e tij. Kjo rrit autoritetin e tij dhe njëkohësisht ul ngarkesat e panevojshme vetjake. Që drejtuesi të administrojë sa më mirë ngarkesat, duhet që vazhdimisht të zotërojë vetveten. Kontrolli i vetvetes është një virtut që ka një rëndësi të dyfishtë, praktike dhe morale. Si virtut praktik e shpëton nga veprime të pamenduara e nga nisma të padobishme e të qortueshme; si virtut moral e mëson të veprojë sipas parimeve që i ka vendosur vetes. Njeriu që nuk kontrollon veten me rreptësi bie në një sërë gabimesh. Ai duhet të ushtrojë një kontroll të vazhdueshëm mbi veprimet e veta, mbi idetë e veta. Harri Boks te “Arti i imponimit” këshillon: “...Pa një kontroll të përpiktë, jeta bie nën pushtetin e ngjarjeve të papritura. Mbrohu nga e papritura. Paralizojë rastin... Duhet të dominosh përmes një kontrolli sistematik e vigjilent të gjithë elementet që hyjnë në jetën tënde. Ti duhet ta mbikqyrësh veten: bëhu një mendje e kthjellët, një vetëdije aktive, një vullnet gjithmonë e në rritje, të dish se çfarë do të bësh e cilin qëllim do të arrish; ngjarjet nuk do të befasojnë më”²³. Drejtuesi duhet të veçojë situatat e tensionuara psikologjike e morale si rezultat i fatkeqësive të ndryshme nga ato të vështirësisë së detyrës. Te të parat duhet drejtuar me shpirt e zemër, ndërsa te të dytat me vendosmëri dhe urdhër.

Kënaqësia në punë

Kënaqësia në kohën e punës është elementi më frytdhënës me karakter moral që ndikon bindshëm në rezultatet e veprimtarisë drejtuese, prandaj ajo duhet realizuar, duke u çliuar nga veprimtaritë e panevojshme dhe streset nëpërmjet përputhjes së kohës me qëndrimin e sjelljen drejtuese. Drejtimi është më shumë një përvojë dhënëse se sa marrëse. Qëndrimi i drejtuesit në veprimtarinë e përditshme është shumë i rëndësishëm dhe ka një ndikim të madh në moralin e njësisë. Nëse drejtuesi është njeri me karakter të dobët, ndikimi do të jetë negativ. Nga ana tjetër, *nëse drejtuesi është i gëzueshëm dhe i gjallë, gëzimi dhe gjallërimi do të përhapet anembanë njësisë. Njerëzit duan të dëgjojnë fjalë të mira dhe të ndjejnë kënaqësi për veten, për njësitë e tyre dhe për punën që bëjnë*²⁴. Për këtë arsye, një kulturë e shëndetshme është një mjet i fuqishëm motivues. Qëllimi i drejtuesit është që të udhëheqë dhe frymëzojë vartësit. Ata përdorin kulturën e organizatës (institutonale) për të mbështetur vizionin, për të realizuar misionin dhe njëkohësisht për të përmirësuar performancën e organizatës së tyre. Një kulturë kohezive modelon dhe përsos moralin e vartësve, duke fuqizuar klimën etike në mënyrë të qëndrueshme brenda vetë vlerave të ushtrisë²⁵.

Koha është gjëja më e çmuar, përdoreni atë me zgjuarsë. Përcaktoni dhe ndani drejt detyrat. Kjo do të forcojë sistemin e komandimit, duke nxjerrë në dukje edhe besimin

²¹ Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikan”, SHBU, Tiranë 1999, faqe 238.

²² Harry Box “Arti i imponimit”, Volumi i gjashtë, Shtëpia Botuese “Shkolla e jetës” Tiranë 1999, faqe 153.

²³ Po aty, faqe 97-98

²⁴ Perry M. Smith, “Taking Charge, a practical guide for leaders”, National Defense University Press, Washington, D.C. 1986, faqe 153.

²⁵ FM 6-22, “Army Leadership, Competent, Confident and Agile”, October 2006, faqe 12-9.

tuaj për vartësit. Prandaj, receta e suksesit për një drejtues kërkon: së pari, të krijojë reputacionin e njeriut krijues; së dyti, të rrethojë veten me bashkëpunorë që janë më të mirë se ai; së treti, t'i lërë ata të bëjnë punën. Prirja drejt përputhjes së teknikave menaxhuese të kohës dhe stileve të drejtimit me sjelljen e qëndrimin drejtues duhet të jetë objekt i arsimimit dhe i zhvillimit të aftësive drejtuese. Janë pikërisht këto elemente, të cilat përcaktojnë edhe mënyrën e ndryshimit të qëndrimit e të sjelljes në përputhje me kushtet e situatat e reja.

Bibliografia:

- Stefen Ambroz, “Duajt Ajzenhauer”, SHBU, Tiranë 1994.
- Mehmet Ali Birand, “Urdhëroni komandant”, SHBU, Tiranë 1994.
- Harry Box, “Arti i imponimit”, Volumi VI, SHB “Shkolla e jetës”, Tiranë 1999.
- Rudolph W. Giuliani, “Udhëheqja”, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë 2006.
- Deril Henderson, “Kohezioni-elementi njeri në luftim”, SHBU.
- Xhon Kigan, “Maska e komandimit”, SHBU, Tiranë 1995.
- Norman Kouplend, “Psikologjia dhe ushtari”, SHBU, Tiranë 1993.
- Mike Mears, “Leadership Elements, a guide to building trust”, i Universe, Inc. New York Bloomington 2009.
- Bernard Montgomeri, “Fushëbetejat” (Kujtime), SHBU, Tiranë 1994.
- M. E. Morris, “H. Norman Shvarckopf: Stuhia e shkretëtirës”, SHBU, Tiranë 1992.
- Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikan”, SHBU, Tiranë 1999.
- L.A. Pennington, Rameyn, B. Hought, H.W. Case, “Psikologjia e drejtimit në ushtri”, SHBU, Tiranë 1995.
- Perry M. Smith, “Taking Charge, a practical guide for leaders”, National Defense University Press, Washington, D.C. 1986.
- George Zhukov, “Kujtime dhe meditime”, Volumi I, SHBU, Tiranë 1995.
- “Army Leadership, Competent, Confident and Agile”, FM 6-22, October 2006.
- “Udhëheqja Ushtarake”, SHBU, Tiranë 1995.

Puna kërkimore, pjesë e misionit të Akademisë së Forcave të Armatosura

Nënkolonel® Prof. As. Dr. Agron Agolli,
Koordinator i Punës Kërkimore-Shkencore në AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Në harkun kohor të mbi 54 viteve të veprimtarisë së Akademisë, puna shkencore vjen dhe shfaqet përmes përvojës dhe eksperiencës së brezave, herë me shkëlqimin e veprimtarisë së tyre krijuese nëpër vite dhe herë përhumur nëpër mjegullnajën e largimit, venitjes, harrimit, shpërfilljes e anashkalimit që u bëri vetë zhvillimi e koha. Gjithsesi ajo mbart me vete historinë e këtij institucioni ushtarak, traditën kërkimore-shkencore të tij me arritjet dhe mangësitë.*

Sot, Akademia e Forcave të Armatosura, si qendër elitare e mendimit ushtarak të Forcave të Armatosura dhe vlerë e kombit, ka një rol parësor e të çmuar lidhur me informacionin dhe nivelin e dijeve që jep për formimin dhe kualifikimin e lidershit ushtarak e të civilëve që merren me problemet e sigurisë e të mbrojtjes, në planin kombëtar, rajonal e më gjerë. Me vizion të qartë për të ardhmen, qasje kritike ndaj arritjeve të deritanishme, pa përsëritur atë që është thënë e stërthënë, veprimtaritë kërkimore-shkencore i kontribuojnë misionit, respektit të merituar, reformimit të vazhdueshëm të arsimit ushtarak, forcimit dhe ruajtjes së identitetit e dinjitetit institucional.

Vizioni i ri për Arsimin e Lartë Ushtarak Shqiptar dhe zbatimi i konceptit integruar të Forcave të Armatosura, si anëtar me të drejta të barabarta në strukturat Euroatlantike¹, kërkon thellimin e mëtejshëm të masave për reformimin e pandërprerë të punës kërkimore-shkencore dhe këndvështrimin e ri të saj për të ardhmen.

Në këtë kuadër, ajo edhe në vijimësi është dhe mbetet pjesë integrale e misionit, detyrave dhe përgjegjësive të akademisë, një dimension i rëndësishëm i këtij institucioni që planëzohet dhe zhvillohet në përputhje me filozofinë e arsimimit e të kualifikimit shkencor.

¹ Fjala e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm në KDS, datë 09.01.2013.

Akademia e Forcave të Armatosura, si Institucioni i Arsimit të Lartë², përveç arsimimit të lartë profesional, ofron edhe veprimtari kërkimore në fushat specifike të sigurisë dhe mbrojtjes.

Në Akademinë e Forcave të Armatosura, programet e studimit të ciklit të tretë, si hallka më e lartë e edukimit të studentëve dhe në masë më të vogël, programet e studimit të ciklit të dytë, konsiderohen punë kërkimore dhe i nënshtrohen planifikimit të rregullt institucional³.

Kalimi në strukturën e re të Akademisë me fakultete, rrit së tepërmi spektrin e veprimtarive kërkimore, i bën ato më institucionale, më integruese dhe bashkëpunuese si me IAL të vendit e ato jashtë, ashtu edhe me akademitë homologe të vendeve të Aleancës. Vetë Dekreti i Presidentit të Republikës Nr. 7458, datë 11.05.2012 “Struktura Organizative e Forcave të Armatosura”⁴, duke rregulluar kuadrin institucional, me dy njësi kryesore mësimore-shkencore, QGJH, degë ndihmëse e mbështetëse, nxit dukshëm përmirësimin e metodave të mësimdhënies, të të nxënit dhe format efikase të kontrollit të dijeve. Njëherazi kjo strukturë kërkon dhe hap rrugë për diskutime të gjera e debate frytdhënëse lidhur me konsolidimin e kurrikulës së programeve që zbaton Akademia e Forcave të Armatosura, përmbajtjen e lëndëve /moduleve me kredite, raporteve të drejta në auditor, alternativa zgjedhjesh e fleksibilitet në studime.

Në strukturat e Akademisë së Forcave të Armatosura realizohet punë kërkimore-shkencore bazë ose e aplikuar, duke inkurajuar punën e pavarur, të menduarit kritik, larg ndonjë tendence apo prirjeje për t’u dhënë akademistëve vetëm informacion të gatshëm dhe kërkuar prej tyre një riprodhim të thjeshtë dhe vetëm brenda kornizave të ngushta tradicionale⁵.

Performanca e punës kërkimore e të gjitha llojeve dhe niveleve rrezatohet gjerësisht në strukturat e Forcave të Armatosura dhe institucionet që merren me problemet e sigurisë dhe të mbrojtjes, pasi ato kanë përfaqësuesit e tyre në këto programe arsimimi e kualifikimi. Gjithsesi, roli i Akademisë për ecurinë dhe motivimin e kësaj veprimtarie është faktor bazë, i vazhdueshëm dhe në përputhje me standardet shtetërore të arsimit të lartë, rregullat dhe parimet e hapësirës evropiane dhe Kartës së Bolonjës⁶.

Synim kryesor i kësaj veprimtarie konkrete, esenciale dhe gjithëpërfshirëse, në tërësinë e masave për përmbylljen e procesit integruar në NATO, edhe në vazhdim mbetet *sigurimi dhe integrimi i punës kërkimore me procesin mësimor*.

Kjo veprimtari është e lirë për të gjithë personelin akademik, studentët dhe pjesëtarë të tjerë të institucioneve të Sigurisë dhe Mbrojtjes, aktiviteti dhe puna e të cilëve lidhet me Akademinë. Veprimtaritë kërkimore-shkencore në tërësi zhvillohen mbi baza shkencore, duke lidhur teorinë me praktikën, përpunuar dhe përgjithësuar në

² Ligji Nr.9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, neni 4 faqe 2.

³ Ligji Nr.9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, neni 70 faqe 27.

⁴ Dekret i Presidentit të Republikës Nr.7458, datë 11.05.2012.

⁵ VKM Nr.1509, datë 30.07.2008, “Strategjia Kombëtare e Arsimit të Lartë 2008-2013”.

⁶ Deklarata e Bolonjës, 18-19 qershor 1999.

mënyrë krijuese probleme të rëndësishme të taktikës, të artit operativ dhe të strategjisë e sigurisë kombëtare, rajonale e më gjerë.

Sfera e Historisë Ushtarake, përvoja dhe arritjet operacionale të strukturave të Forcave të Armatosura, në praktikën e përditshme dhe në misionet paqeruajtëse, në rrugën integruese, zënë një vend përësor në objektin dhe trajtesat e veprimtarive kërkimore-shkencore në departamente, fakultete dhe nivel Akademi. Oficerët pjesëmarrës në këto operacione janë moderatorët kryesorë të analizave, rasteve të studimit apo argumentimit të raporteve dhe balancave që duhet të ketë arsimimi, kualifikimi dhe trajnimi apo veprimi praktik në terren e fushëbetjë.

Veprimtaritë e përbashkëta në planin institucional, rajonal e me gjerë, kanë përparësi dhe shikohen me vëmendje të veçantë si shanse që do rritin ndjeshëm dhe në mënyrë reale jo vetëm përvojën, eksperiencën, por edhe rolin dhe ekselencën institucionale. Kjo dukuri bëhet më e ndjeshme kur shohim se arsimit ushtarak është një pasqyrim besnik i shoqërisë në përgjithësi dhe pjesë integrale e sistemit arsimor kombëtar⁷.

Puna kërkimore-shkencore mban parasysh kërkesat e Direktivës së Mbrojtjes 2013, lidhur me Arsimimin Ushtarak, *për konsolidimin e mëtejshëm të tij, lidhjen me zhvillimet e FA-së dhe me standardet bashkëkohore*. Ajo do t'i shërbejë kontributit të Akademisë për *...përmirësimin rrënjësor të sistemit arsimor të Forcave të Armatosura*⁸, *problemeve që lidhen me ...rishikimin e Strategjisë së Mbrojtjes, detyrave të Konferencës së 5-të për integrimin në NATO, angazhimeve në operacionet e saj si dhe veprimtarive që analizojnë dhe lartësojnë peshën specifike të të gjitha kontributeve tona në këtë drejtim*.

Kushtet konkrete dhe dukuritë e reja të mjedisit të sigurisë e të konceptit të mbrojtjes na bëjnë të ndjejmë më shumë jo vetëm nevojën e zhvillimit, por edhe të thellimit të mëtejshëm të punës studimore-shkencore për të shmangur përsëritjet, gjërat e përgjithshme, plagjiaturën, *“ato që janë thënë e stërthënë”*⁹, për të rritur aftësinë kërkuese, përkushtimin dhe seriozitetin krijues e analitik të problemeve si dhe për të lartësuar efektivitetin e saj. Me synimin drejt integritit të plotë në NATO e BE dhe perspektivës së zhvillimit të sistemit arsimor ushtarak, në kuadër të programit afatmesëm zbatues të Forcave të Armatosura 2013-2018 dhe atij afatgjatë 2023, domosdoshmëria e një *hopi cilësor të punës studimore-shkencore* shihet nga nevoja e përfitimit, rritjes dhe transmetimit të dijeve shkencore në procesin mësimor-edukativ, për aftësimin e pedagogëve e të punonjësve pedagogjikë-kërkimorë, me konceptet doktrinare bashkëkohore dhe zhvillimet e kohës, për hulumtime, gjetje e produkte të mirëfillta shkencore. Në këtë mënyrë do të arrihet të zhvillohet tek akademistët e studentët e tjerë mendimi analitik dhe aftësia e reflektimit, jo vetëm për të menduar në mënyrë realiste, por edhe në mënyrë kritike e origjinale me një imagjinatë e arsytim sa më realist e bashkëkohor.

Edhe në orientimet e Komandantit të Akademisë së Forcave të Armatosura, fakulteteve dhe departamenteve, puna kërkimore-shkencore vlerësohet si një problem shumë i

⁷ Përmbledhje Materialesh të Akademisë, Tiranë 2008, fq.28.

⁸ Direktiva e Mbrojtjes 2013, faqe 2-3.

⁹ Zija Xholi, Monografia Sami Frashëri, Tiranë 1978, fq.157.

rëndësishëm, i pandarë nga veprimtaria mësimore-shkencore e administrative, si një element thelbësor për të ushqyer këtë institucion me informacion të ri bashkëkohor dhe të rejtat shkencore, si një detyrim dhe përgjegjësi institucionale (*ku pas përcaktimit të fushave parësore të kërkimit, zgjidhen, përcaktohen e zbatohen prioritetet, sigurohet vazhdimësia dhe bëhen të njohura rezultatet*¹⁰), që të lidh me realitetin e Forcave të Armatosura dhe zhvillimet në Institucionet e Arsimit të Lartë të vendit.

Duke qenë viti vendimtar i realizimit të procesit të integritit të plotë në NATO, ka mundësi dhe hapësira më të gjera për të ndërmarrë studime e projekte konkrete kërkimore-shkencore në interes të sistemit të arsimit ushtarak, universitar e pasuniversitar, problemeve integruese të Mbrojtjes dhe Sigurisë, sidomos pas konsultash, ballafaqimesh dhe diskutimesh konkrete edhe me komandat e llojit të forcave dhe strukturat e tjera të MM e SHP.

Hapësira të reja dhe pozicione të avancuara përvijuese i japin këtij sektori sot, ligji i ri Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin Nr. 9832, datë 12.11.2007, i ndryshuar me ligjin Nr. 10307, datë 22.07.2010, VKM Nr. 467, datë 18.07. 2007 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik, i ndryshuar”, VKM Nr. 1509, datë 30.07.2008 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin e lartë, 2008-2013”, Urdhri Nr. 396, datë 10.08.2011 i MASH “Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu” të Tiranës, Urdhri Nr. 502, datë 07.10. 2011 i MASH për “Hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, të doktoratës në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, të Tiranës”, Urdhri i MASH Nr. 126.17.03. 2011 “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin institucional të institucioneve të arsimit të lartë “, Urdhri MASH Nr. 135, datë 21.03.2011 “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në IAL”, Urdhri i MASH Nr. 136, datë 21.03.2011 “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit të ciklit të tretë në IA”, Direktiva e Mbrojtjes 2013, Politika e Arsimit dhe Trajnimit Individual të Personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Udhëzimet e SHSHP të FA, drejtimet kryesore të punës së Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes (KDS), statutit dhe rregulloret bazë.

Këto dokumente dhe të tjera në vijimësi janë bazë e hartimit të programit vjetore të punës kërkimore-shkencore dhe tërësisht të kërkim-zhvillimit¹¹ e inovacionit në akademi.

Stadi aktual i Akademisë së Forcave të Armatosura pas Dekretit të Presidentit të Republikës Nr. 7458, datë 11.05.2012 “Struktura organizative e FA të RSH”, me fakultete, krijimi i Qendrës Kombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes (QSKM), programeve ambiciozë të kurseve profesionale (sidomos cikli i dytë dhe i tretë i studimeve Master-Doktoraturë), rolit të saj në pararojë të Forcave të Armatosura (të

¹⁰ Standardet shtetërore të cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë, 2011, fq.24-25.

¹¹ Doktrina e Mbrojtjes 2013, faqe 7.

cilat kanë projekte madhore modernizimi, tregues operacionalë të trupave tokësore në OMP, investimeve të Forcave Detare, kapaciteteve të Forcave Ajrore)¹², për promovimin e koncepteve dhe ideve të reja integruese, *theksojnë nevojën e një rrezatimi më të madh e më cilësor të përmbajtjes së punës mësimore-shkencore.*

Edhe ndryshimi i mjedisit strategjik, zhvillimi i konceptit të mbrojtjes kolektive, ndërlikimi i fushës së luftimit-betejës, natyra e shumëllojtë e detyrave operacionale të Forcave të Armatosura, e transformimit të tyre, e konsolidimit të forcës profesioniste, synojnë dimensione të reja si në përzgjedhjen e objektit të kërkimit, ashtu edhe të karakterit të veprimtarive studimore-shkencore në të gjitha nivelet e këtij Institucioni.

Konceptimi i punës kërkimore-shkencore, si pjesë integrale e tërë veprimtarisë mësimore-edukative që zhvillohet në Akademi, nuk është parë thjesht si privilegj për të bërë emër, për të zënë një qoshe të rehatshme apo fituar një gradë karriere, përkundrazi ajo është parë dhe *shihet së pari nga nevoja:*

- E përfitimit, rritjes dhe transmetimit të dijeve shkencore në procesin mësimor-edukativ për formimin dhe përgatitjen shkencore e teknike të studiuesve ushtarakë me metodologjinë e punës kërkimore të pavarur lidhur me problemet e fushës së mbrojtjes e të sigurisë.
- E aftësisë të pedagogëve e punonjësve shkencorë me koncepte doktrinare bashkëkohore, metodologjisë efektive në procesin e mësimdhënies, mësimnxënies, të formave të kontrollit të dijeve dhe ndjekjes koherente të situatës.
- E nxitjes së prirjeve të akademistëve të kurseve të niveleve të ndryshme e sidomos të ciklit të dytë e të tretë për një punë të pavarur studimore me analizë, krahasim, evidentim logjik të fakteve, statistikave, parashikimeve dhe formave induktive e deduktive, si faktor me rëndësi në krijimin e lidhshmërisë të ri ushtarak të Forcave të Armatosura që do të angazhohen në detyra të ndryshme vendimmarrëse, ku kërkohet mendim aktiv e vizionar, aftësi operuese, standarde të larta morale, gjuhë diplomatike e të tjera tipare të qenësishme. Dy cilësi janë të pazëvendësueshme thotë Klauzeviç: *“e para, një intelekt që edhe në orët më të vështira/të errëta është në gjendje të ruajë ndriçimin e asaj drite të brendshme që të prin drejt së vërtetës; dhe e dyta, kuraja për ta ndjekur këtë dritë të zbehtë kudo që të çon ajo”¹³.*
- E gjenerimit të koncepteve doktrinare në interes të integritetit afatmesëm e afatgjatë të FA si anëtarë me të drejta të plota anëtarësimi në NATO, pasi aktualisht në strukturat e saj vepron një numër i konsiderueshëm kuadrosh, për të cilët kërkohet një profil i ri lideri që të jetë në gjendje të ballafaqohet denjësisht me sfidat e shekullit.
- E zhvillimit dhe zbatimit të doktrineve të NATO-s, të stanagëve, një pjesë e të cilëve tashmë të ratifikuar e në implementim, e qëndrimit ndaj çështjeve

¹² SHSHPFA, fjala në auditoriumin e KDS-së, datë 11.02.2013.

¹³ Gjeneral Brigade Jeronim Bazo, Përmbledhje Materialesh të Akademisë së Mbrojtjes, 2008, fq.24.

të nivelit të ambicies dhe të hapit më të madh të FA, atij të integritit të plotë në NATO¹⁴.

- E transformimit dhe zhvillimit të FA-së në një forcë plotësisht profesioniste me parametra perëndimore si ato të NATO-s, sipas konceptit “*smart defence*” dhe sidomos të kërkesave të Komandës së NATO-s për Transformim (ACT), pa pretenduar shpikje e çudira jashtë filozofisë së re të arsimit dhe hapit të përbashkët kolektiv.
- E mbështetjes së realizimit të objektivave të Forcave të Armatosura, përgatitjes së skenarëve e planeve metodikë (për grup batalioni, grupit për detyrë të Forcave Speciale, SOTG) si dhe pesë objektivave “*Blue Book*”¹⁵.
- E sanksionimit të standardeve shtetërore të Arsimit të Lartë, të përçasura me IAL të vendit dhe përvojën e akademive homologe¹⁶.
- E trajnimit të personelit të FA në gjuhën angleze STANAG 6001 dhe të gjuhëve të vendeve ku forcat tona marrin pjesë në Operacionet e Mbështetjes së Paqes (OMP).

Njësitë mësimore-shkencore bazë, seksionet, çdo strukturë e fushë funksionale e kanë të kristalizuar mendimin se qëllimi i punës studimore-shkencore duhet t’i shërbejë më së miri... *realizimit të misionit të Akademisë së Forcave të Armatosura, fushës së përgjegjësive dhe të detyrave funksionale të saj*. Në këtë drejtim, departamentet me grupet e tyre kërkimore-mësimore sigurojnë ecurinë e kësaj pune të inkurajuar nga institucioni¹⁷.

Nga ky këndvështrim, është parë dhe objekti i drejtpërdrejtë i punës studimore-shkencore, i cili përgjithësisht vazhdon të *prirë nga mendimi*:

- Për të përgatitur e kualifikuar liderë ushtarakë të së ardhmes me vizion e mentalitet të ri për të kuptuar zhvillimet e kohës, situatat e mjedisit të sigurisë dhe kompleksitetin e fushës operacionale.
- Për të njohur, studiuar, përpunuar e interpretuar drejt konceptet doktrinare të zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe mendimin bashkëkohor integruar të tyre në kuadër aleance.
- I studimit dhe pasqyrimit shkencërisht të Historisë së Ushtrisë Shqiptare e të Artit Ushtarak të saj, të rrugëve e gjetjeve të reja, si një pjesë e kuadrit kombëtar të historisë dhe vlerave më të mira të kombit tonë, pasi “*historia, - thotë Sami Frashëri, - ruan për jetë emrat e atyre që çajnë rrugë të reja në dije dhe në shkencë*”¹⁸.
- Për të rritur fushat e vlerësimit dhe përcaktuar drejt rolin e AFA-së në të gjitha nivelet e prezantimit e kualifikimit, si zëdhënëse e moralit të Forcave

¹⁴ Arben Imami, Fjala në takimin për Integrimin e plotë në NATO, “Ushtria”, 25 janar 2013.

¹⁵ Doktrina e Mbrojtjes 2013, faqe 3.

¹⁶ Urdhri i MASH-it Nr.135, datë 21.03.2011, faqe 21-26.

¹⁷ Urdhri i MASH-it Nr.136, datë 21.03.2011, faqe 5-9.

¹⁸ Zija Xholi, Monografi Sami Frashëri, Tiranë 1978, fq.145.

të Armatosura e vendit dhe të një institucioni *me nivel të lartë ekspertize në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare e më gjerë (Qendër Ekselence).*

Nisur nga misioni, objekti, fushat e përgjegjësive që ka AFA, si dhe përvoja më e mirë e fituar në procesin e arsimimit, janë përcaktuar detyrat kryesore të punës kërkimore-shkencore duke i fokusuar *sipas drejtimeve të mëposhtme:*

- Në njohjen, studimin, analizën dhe përgjithësimin e dukurive të luftës së sotme pavarësisht nga niveli i saj, me qëllim që të evidentohet karakteri i saj, format dhe metodat e reja të aplikuara, ato që kanë humbur rëndësinë e përdorimit, planëzimi i fuqisë luftarake, llogaritja e vlerës së luftimit, aftësia operationale bashkëvepruese me aleatët, rritja e shanseve të fitores me një shkallë humbjesh sa më të pakta në njerëz e teknike luftarake.
- Me një vëmendje të veçantë do të shikohen e ndiqen sidomos *tendencat asimetrike të luftës së sotme, betejat aero-tokësore, lufta kundër terrorizmit, guerilja urbane si dhe “Mësimet e Nxjerra”¹⁹ nga ndryshimet e ndodhura në mjedisin e sigurisë e të konceptit të mbrojtjes etj.*

Meqenëse stërvitjet e ndryshme të njësisve e reparteve të Forcave tona të Armatosura nuk janë luftë e vërtetë, por tentojnë të paraqesin një përfytyrim sa më të ngjashëm të episodeve të saj (kërcënimeve dhe rreziqeve) në kushtet konkrete, po në të njëjtën mënyrë duhen ndjekur, vëzhguar, studiuar me kujdes dhe përgjithësuar vlerat e tyre në procesin mësimor edukativ.

Më e dukshme bëhet kjo gjë sidomos në kuadër kooperimi e bashkëveprimi me forcat aleate për menaxhimin e krizave dhe përballimin e situatave konfliktuale. Lidhur me këtë problem, ka vite që Akademia e Forcave të Armatosura, duke u angazhuar në hartimin e planeve metodikë të llojeve të ndryshme operationale dhe niveleve të caktuara të komandim-kontrollit, si dhe ndjekjen e drejtpërdrejtë të stërvitjeve të ndryshme të njësisve e reparteve të Forcave të Armatosura, jo vetëm që ka fituar përvojë dhe eksperiencë, por njëkohësisht ka rritur nivelin e saj kërkimore-shkencor si dhe anën profesionale të trupës mësimore. Në këtë drejtim do të punohet me kujdes për të ofruar dhe vjelë edhe përvojën e mjaft akademistëve, të cilët kanë qenë pjesëmarrës aktivë në Operacione të Mbështetjes së Paqes, në funksione drejtimi të strukturave të NATO-s, apo kanë shoqëruar kontingjentet tona paqeruajtëse gjatë misioneve në Bosnjë, Afganistan, Irak dhe Çad.

- Në ndihmën e dhënë gjatë Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes (RSM), Strategjisë Ushtarake, hartimit dhe publikimit të Doktrinës Ushtarake të FA-së (DP-01). Këtë rol të veçantë do të ketë bashkëpunimi ynë me Qendrën Kombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes, QD etj.
- Në njohjen dhe studimin e përvojës dhe eksperiencës së instrumentit ushtarak të ushtrive homologe bashkëvepruese, i zhvillimeve në to, kapaciteteve dhe potencialeve njerëzore e teknike, i aftësive taktike-operative dhe i arritjeve zbatuese (integruese) të koncepteve doktrinare në kushtet e mjedisit të luftimit-fushëbetjës apo OMP.

¹⁹ Doktrina e Mbrojtjes 2013.

- Në studimin, shfrytëzimin dhe përgjithësimin shkencor të vlerave më të mira, eksperiencës së pasur të luftës së popullit si dhe të historisë së luftërave të ushtrive të vendeve të tjera. Një vëmendje e veçantë në këtë drejtim do t'i kushtohet njohjes dhe pasqyrimin të dukurive të konflikteve dhe luftërave të fillimit të shekullit të ri, duke thelluar frymën e aktiviteteve të realizuara me rastin e 100-vjetorit të krijimit të Shtetit Shqiptar dhe Ushtrisë Shqiptare në bashkëveprim edhe me të tjerët.
- Në studimin e veçorive të përdorimit dhe efektivitetin operacional të llojit të forcave, trupave të luftimit, të mbështetjes në luftim, mbështetjes me shërbime, forcave speciale, komando apo *task force*, si dhe të kërkesave të sigurimit luftarak. Operacionalitetin e forcave do ta shohim të lidhur me efektivitetin që kanë sistemet e reja të komunikimit, mundësitë e mbështetjes logjistike, operacionet informative, roli i medias, vlerat moralo-profesionale të lidërshipt ushtarak etj. Me interes të veçantë do të shikohet sidomos përvoja e pjesëmarrjes së forcave tona në OMP apo humanitare, si kontribute dhe vlera të FA-së në planin kombëtar e më gjerë.
- Në studimin e dukurive esenciale dhe karakteristikave të veçanta që dalin nga format e përgatitjes së efektivave të Forcave të Armatosura për zbatimin e detyrave kushtetuese të mbrojtjes së integritetit territorial, institucioneve demokratike dhe vlerave tona kombëtare, pavarësisht nga niveli i komandim-kontrollit dhe qenies anëtar i aleancës. Më me seriozitet do të planëzohet ndjekja nga ana e departamenteve e aktiviteteve kryesore stërvitore të njësisve dhe reparteve të Forcave të Armatosura, *për të evidentuar e vjelë risitë e reja për procesin mësimor*, pasi ndodh që aplikimet e reja të formave dhe metodave të luftimit apo zhvillimet e reja konceptuale nuk gjejnë sa e si duhet vend në punën mësimore-shkencore të këtij institucioni. Këtë dukuri e shikojmë të lidhur me faktin se Akademia e Forcave të Armatosura, *është gjeneratori, që nëpërmjet arsimimit dhe kualifikimit të kuadrove, rrezaton drejtpërdrejt, në mënyrë të artikuluar e institucionale gjerësisht në ushtri*. Praktika e deritanishme tregon se ky ndikim ka qenë i dukshëm për strukturat e Forcave tona të Armatosura.
- Në analizën, studimin, pasqyrimin e karakteristikave dhe vlerave ushtarake të teatrit të veprimeve luftarake (TVL), fushëbetëjës (FB), brezave e rajoneve si dhe në ndikimin që ka tërësisht hapësira (tokësore, detare, ajrore) në integrimin e pikëpamjeve doktrinare. Natyrisht në këtë drejtim, me kujdes të veçantë do të shikohet sidomos vlera dhe rëndësia që ka konceptimi i drejtë i rolit të FA-së në sigurinë e vendit, aftësinë ndërvepruese në Aleancën e Atlantikut, kontrollit dhe sigurimit të hapësirës ajrore e detare. Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet studimit të kompleksitetit të fushës operationale, duke vlerësuar rolin e çdo fushe funksionale, kjo nëpërmjet temave studimore të përzgjedhura për zbatuesit e ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë.

Një rol të veçantë kanë edhe strukturat dhe organet që merren me punën studimore-shkencore në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Puna studimore-shkencore në AFA do të bëhet e organizuar, programuar dhe rregullisht do të drejtohet nga Komandanti i Akademisë nëpërmjet Senatit Akademik, shefit të Fakultetit të Sigurisë e Mbrojtjes, atij të Fakultetit të Arsimit të Përgjithshëm, Këshillit të Profesorëve, shefave të njësive bazë mësimore-kërkimore (departamenteve), QGJH, degëve ndihmëse e mbështetëse, strukturës drejtuese të programeve të ciklit të dytë e të tretë, si dhe ndërveprimet të tyre me qendrat e KDS, strukturave të tjera të ushtrisë e botës akademike të vendit.

Në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.5.2007, neni 12 dhe me strukturën organizative ekzistuese, *departamenti mbetet njësisia bazë mësimore-kërkimore funksionale* në Akademinë e Forcave të Armatosura, e cila administron veprimtaritë e mësimdhënies e ato kërkimore.

Departamenti përgjigjet për drejtimin e punës studimore-shkencore, integrimin e çështjeve të saj në planet vjetore e mujore, bashkërendimin me departamentet e tjera të IAL të vendit, degëve të KDS-së, komandave të llojit të forcave etj., në zhvillimin e sesioneve shkencore, konferencave shkencore, tryezave të rrumbullakëta, mësimëve të hapura, debatit e diskutimeve shkencore, reçencave, oponentëve, referateve, studimeve të ndryshme nga fusha që mbulon, artikujve problemorë në Revistën Ushtarake etj.

Tipar dallues i punës studimore-shkencore të departamenteve mbetet fakti se në këtë proces synohet që të angazhohen dhe marrin pjesë jo vetëm seksionet (grupet kërkimore), të gjithë *pedagogët e departamenteve*, por dhe *akademistët* që kanë kualifikime, prirje dhe vlera të veçanta, duke qenë pjesë e ciklit të dytë e të tretë të studimeve. Lidhur me realizimin e punës studimore-shkencore, departamenti mund të mblidhet në mënyrë periodike, *një herë në tre muaj, për të bërë analiza 6-mujore, raporte vjetore etj.*

Koordinatori për punën kërkimore-shkencor është vend organik e funksional i punës ushtarake studimore, i cili përgjigjet për organizimin, ndjekjen dhe realizimin e detyrave të vëna nga Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Dekani i FSM, gjatë vitit mësimor. Ky sektor siguron lidhjen e punës studimore-shkencore të Akademisë brenda strukturave të saj dhe me institucionet e larta arsimore të vendit, institutet dhe qendrat e ndryshme studimore. Në vëmendjen dhe kujdesin e tij është bashkëpunimi me MASH-in, APAAL, AKP, Qendrën Kombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes (QSKM), koordinatorët e programeve Master dhe të doktoratës, departamentet, bordin e ekuivalentimit si dhe Këshillin e Profesorëve, për të ndihmuar gjatë realizimit të programeve si dhe për përgatitjen e raporteve përmbledhëse për titullarin dhe MASH, lidhur me veprimtarinë e kërkim-zhvillimit institucional.

Ndjekja e *marrëveshjeve të lidhura me IAL*, brenda e jashtë vendit, është një drejtim i veçantë i punës së këtij sektori, ashtu sikundër mbetet parësore nxitja dhe bashkëpunimi me IALP jashtë vendit, akademitë homologe etj.

Gjatë hartimit të planit të punës studimore të Akademisë së Forcave të Armatosura për vitin 2013 janë mbajtur parasysh:

- Specifikat që ka institucioni në procesin e arsimim-edukimit-kualifikimit, eksperiencën e fituar dhe mundësitë e kualitetet shkencore të saj, duke mos

harruar asnjëherë se njerëzit e shkencës ushqejnë dashurinë për Forcat e Armatosura, shtytjnë e nxitin njerëzit të ecin përpara.

- Pasqyrimi me kohë në masat e saj i qëllimeve dhe synimeve të komandantit për t'u ardhur në takim nevojave të departamenteve në standardizimin e formave të mësimdhënies, rritjes cilësore të brendisë së materialeve, efektivitetit në vlerësim dhe zhvillim të koncepteve operacionale të Forcave të Armatosura sipas rëndësisë dhe prioriteteve.
- Efektiviteti i masave planëzuese të punës studimore-shkencore të lidhur me kontributin që do të japë ajo në zgjidhjen e detyrave kryesore të thellimit të procesit të reformimit të programeve, kualifikimit të mëtjejshtëm të trupës pedagogjike, interpretimit të konceptit të ri të mbrojtjes e sigurisë dhe arritjeve të FA-së për integrim.
- Kujdesi për të rritur shkallën e kërkesës dhe të qëndrimit oponent ndaj çdo punimi: (leksion, material studimor, plan metodik, dispensë, manual, tekst, temë kursori, mikrotezë, temë doktore, etj.). Kërkesat do të synojnë informacionin e ri bashkëkohor, nxitjen e mendimit të pavarur, mprehjen e gjykimit, argumentin bindës si dhe zgjidhje të pavarura e sa më të larmishme. Nga ky këndvështrim, akademisti është jo vetëm objekt, por edhe subjekt aktiv e i përgjegjshëm për të prezantuar vlerat e tij intelektuale dhe profesionale, vizionin e liderit profesionist e të aftë për menaxhimin e situatave.
- Puna e orientuar në mënyrë të tillë që departamentet, seksionet e grupet mësimore të diskutojnë me përgjegjësi dhe kompetencë për arritjet e tyre, duke dhënë vlerësimin, mendimin dhe propozimin konkret si do të integrohet puna studimore-kërkimore në procesin mësimor, brenda modulit e në çdo ligjëratë në auditor, çfarë informacioni do të prezantohet në seminare, ese apo tema kursori etj. Vendos departamenti për vlerën dhe rëndësinë e punimeve shkencore e të veprimtarive studimore, çfarë do të futet në leksion, material studimi, dispensë, në planin metodik apo tekstin mësimor. Natyrisht, ai mban parasysh edhe porosinë e dekanit dhe rektorit si titullar, i cili është kryetar i Senatit Akademik dhe tërë veprimtarisë akademike, si dhe detyrat e vëna nga KDS. Me theks të veçantë janë parë edhe temat me profil të ngushtë specialiteti për vlerësimin e të cilave departamenti mund të krijojë edhe komisione të posaçme sipas kërkesave të standardeve shtetërore dhe kritereve akademike.

Në masat planëzuese të vitit 2013, theksohet se punimet e rëndësishme të përgatitura nga autorë të veçantë ose grup autorësh, pasi janë diskutuar me reënca përkatëse në departamente, për jetëgjatësinë e mëtjejshtëm të tyre (pse jo edhe deri botimin e radhës), zakonisht shtrohen për diskutim në Departamente apo edhe Komitetet Shkencore të Programeve, deri edhe në Këshillin e Profesorëve, ku mund të ftohen edhe studiues e specialistë të jashtëm. Kur ka raste të tilla, edhe pse paraqitjen e temës, materialit e bën shefi i departamentit, së bashku me të merr pjesë edhe autori (grupi i autorëve) dhe recensuesit. Natyrisht struktura më e lartë që drejton, bën vlerësimin dhe merr vendimin për miratim apo edhe botim përmblendhës, duke theksuar të drejtat e autorit sipas ligjit.

Veprimtaria studimore-shkencore e AM-së dhe strukturave të saj zbatuese për realizimin e programit të punës shkencore vjetore do të udhëhiqet nga një *sërë kërkesash dhe kriteresh shkencore si më poshtë:*

Nga e vërteta shkencore në tërë spektrin e detyrave të saj. Për këtë, do të respektohen të gjitha standardet shtetërore të Arsimit të Lartë si dhe udhëzimet e MASH-it në këtë drejtim. E vërteta shkencore e materialit do të jetë kërkesa dhe tipari dallues i studimit të ndërmarrë. Përvojë e mirë tashmë është krijuar në zhvillimin e programeve të ciklit të dytë Master Profesional dhe Master Shkencor në “Studime në Fushën e Sigurisë e të Mbrojtjes” (temat studimore të përgatitura për mbrojtjen e diplomave), të ciklit të tretë, si dhe për promovimin e personelit akademik me tituj shkencorë. Në zgjedhjen e temave studimore krahas dy fushave bazë të sigurisë dhe mbrojtjes, vëmendje më të madhe do t’u kushtohet temave nga Fusha e Historisë Ushtarake dhe të traditës së vyer të popullit tonë në shekuj, përpjekjeve transformuese të FA-së për integrim të plotë në NATO e BE. Kështu, do të bëjmë të mundur realizimin plotësisht të Nenit 26 të ligjit të arsimit të lartë për ciklet e studimit dhe njëherazi në bashkëpunim me drejtorin e këtyre cikleve, do të krijojmë traditën e mirë të përgatitjes së ciklit të plotë të të gjitha dokumenteve mësimore për akademistët e studentët diplomatë.

Nga prirja për të mbrojtur arritjet e ushtrisë dhe interesat e sigurisë kombëtare. Për të realizuar në mënyrë sa më efektive këtë kërkesë, puna kualifikuese kërkimore-shkencore, ciklet e studimit dhe sidomos mbrojtja e temave të doktoraturës nuk do të jenë qëllim në vetvete i këtij institucioni, por me synim për të rrezatuar më gjerë në fushën e mbrojtjes e të sigurisë mendimin e kualifikuar shkencor dhe ekspertizën për zgjidhjen e problemeve të sigurisë e të mbrojtjes në planin kombëtar e më gjerë ballkanik. Zgjerimi i ciklit të tretë, fushave të përzgjedhjes së temave, kërkon padyshim rikonceptime të reja në spektrin e njohjes, studimit, vlerësimit, kërkesës dhe realizimit të projekteve kërkimore sipas kërkesave shkencore. Këtu edhe departamentet kanë një rol të rëndësishëm në drejtimin e tyre. Masat e punës shkencore në këtë drejtim do të synojnë sigurimin e informacionit për të sqaruar rreziqet asimetrike të luftës së sotme, kërcënimet dhe rreziqet e sigurisë e të mbrojtjes, analizën dhe dukuritë e kuadrit strategjik etj. Interesimi i mjaft kuadrove për të provuar aftësitë e tyre kërkimore-shkencore në tema madhore të fushës së sigurisë, na nxisin dhe shtyjnë që t’i shohim më me kujdes dhe optimizëm masat tona në këtë drejtim.

Nga liria e veprimit dhe e mësimin të saj në mënyrë krijuese gjatë procesit të arsimimit e kualifikimit, duke iu përshtatur zhvillimeve dhe synimeve për integrim të plotë në NATO. Për këtë janë bërë e bëhen përpjekje për të ndjekur hap pas hapi zhvillimet kryesore të Forcave të Armatosura si gjatë organizimit e ristrukturimit, ashtu edhe për modernizimin e ardhshëm të tyre. Një vëmendje të veçantë i kushtohet edhe pjesëmarrjes në takimet, trajnimet dhe stërvitjet që zhvillohen me ushtritë homologe të vendeve të NATO-s ku ne bëjmë pjesë. Nga këto aktivitete nëpërmjet informacioneve, synohet që të përfitohen tematikat e reja të stërvitjeve, mënyra e përdorimit të trupave, efektiviteti i tyre në kushtet e realitetit ekzistues, format dhe metodat e reja të luftimit për të përballuar kërcënimet dhe rreziqet e sigurisë kombëtare, deri te përvoja e Operacioneve të Mbështetjes së Paqes (si një obligim i padiskutueshëm për FA në kuadër integrimi të plotë) e atyre humanitare etj.

Nga domosdoshmëria e ndërthurjes së arritjeve studimore-shkencore me procesin e kualifikimit të kurseve të niveleve të ndryshme (ciklin e dytë e të tretë), që zhvillohen në AFT sipas planit të nevojave të FA-së dhe programit integruar të tyre 2013-2018 dhe 2023. Lidhur me këtë, prioritet i punës studimore-shkencore të Komandës së AFT-së dhe njësisë kryesore e atyre bazë mësimore shkencore, do të jetë lidhja me njësitë dhe repartet e ushtrisë, për të grumbulluar problemet evidente dhe mendimin më të kualifikuar për të zgjeruar tematikën dhe platformën e punës studimore-shkencore, larg skemave shabllone e pa debat. Ky veprim i AFT-së për t'u futur në jetën e ushtrisë dhe reflektuar arritjet e saj në procesin mësimor, do të ketë ndikimin e saj pozitiv në rritjen e autoritetit të Institucionit dhe strukturave të tij për përmbushjen e detyrave të tij ligjore në kuadër të programeve integruese të sistemit arsimor ushtarak të akredituar plotësisht për ciklin e dytë dhe në proces për ciklin e tretë-Doktoraturë, pas kryerjes së vlerësimit të jashtëm nga APAAL-i²⁰.

Për të rrezatuar më gjerë në zhvillimin e Forcave të Armatosura, puna studimore shkencore, edhe më mirë do të bëjë objekt të diskutimit, debatit, ballafaqimeve në departamente, *reformulimin teorik në nivele të ndryshme komandimi*, si: të llojit të forcave, trupave të luftimit, trupave mbështetëse të luftimit, të mbështetjes me shërbime, forcave speciale, komando, të Reagimit të Shpejtë, ashtu edhe të Brigadës së Stërvitjes, Shkollës së Trupës e strukturave të tjera të Forcave të Armatosura.

Nga përgjegjësia morale e kandidatëve (studiuësve) që nisin rrugën e kualifikimit shkencor për programet studimore Master dhe Doktoraturë (ciklin e tretë të studimeve). Në këtë proces po bëhet kujdes që të përzgjidhen aplikantë cilësorë si për studimet e thelluara teorike njëvjeçare që përfundojnë me një provim për realizim të 60 krediteve, ashtu edhe për ata që do të vazhdojnë përgatitjen e doktoraturës dhe detyrimeve të tjera shkencore. Dhe kjo arrihet me kandidatë të përgjegjshëm, me veprimtari botuese në organet e shtypit, arritje të mira në fushën funksionale ku shërben, prirje për të ndërmarrë studime të mirëfillta, punë të pavarur hulumtues dhe vizione të reja konceptuale që i shërbejnë të ardhmes. Udhëzimet e MASH-it, datë 21.03.2011, janë një orientim dhe ndihmesë e vyer në këtë drejtim për çdo doktorant e udhëheqës shkencor.

Efektiviteti kërkon që të organizohet më mirë puna për vazhdimin e programeve të studimit të ciklit të tretë, detyrimet shkencore të aplikantëve sipas programit të zbërthyer të përgatitjes së disertacionit në vite dhe vërejtjeve të bëra nga udhëheqësi shkencor. Ndiham duhet të konstatojë në faktin për të mos patur më individë që nuk përmbushin në kohë detyrimet studimore-shkencore të pranuar vetë e të planëzuara nga Akademia e FA, FSM, sipas kërkesave të departamenteve. E themi këtë pasi ka vend për të përmirësuar punën me studentët e ciklit të tretë lidhur me plotësimin e dosjeve, të marrëdhënieve me udhëheqësit shkencore, të realizimit të projekteve kërkimore, likuidimit të detyrimeve mësimore etj. Grupi i vlerësimit të dosjeve apo *ad-hoc* duhet të jetë edhe në vazhdim më institucional dhe shterues në drejtim të respektimit të standardeve shtetërore për përzgjedhje dhe regjistrim në këtë cikël studimi vetëm të atyre aplikantëve që përmbushin kriteret si: sigurimin e notës 8

²⁰Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë.

(tetë) e mbi tetë në diplomën e shkollës së lartë universitare, nivelin e kërkuar të gjuhës së huaj, aftësitë kërkimore-shkencore e botuese para regjistrimit etj.

Përveç nxitjes së përgjegjësisë personale të kandidatit, po punohet dhe kërkohet më shumë kujdes e vëmendje edhe nga udhëheqësit shkencor, për të qenë në pozitat orientuese e drejtuese dhe luajnë më mirë rolin e tyre shkencor, organizues, nxitës, këshillues e kontrollues të kësaj veprimtarie shkencore. Nisur nga fakti se vlera e udhëheqësit reflektohet te cilësia e punimit shkencor, ka vend që ata të rritin shkallën e përgjegjësisë ndaj kërkesave shkencore dhe qëndrimin oponent të tyre gjatë relacioneve në Këshillin e Profesorëve apo departamentin përkatës së bashku me disertantin që drejtojnë. Më mirë duhet të lidhen ata me drejtorin e ciklit të tretë, i cili menaxhon zhvillimin e programit të studimit.

Akademia e Mbrojtjes vazhdon të mbajë më mirë në vëmendjen e punës kërkimore-shkencore nevojën për rritje të cilësisë gjatë përgatitjes së temave studimore, mbrojtjen e tyre para jurive të posaçme sa më objektive e të pavarura, duke synuar sa më shumë aktivizimin dhe pjesëmarrjen në to edhe të personaliteteve shkencore nga institucionet shkencore të vendit si: MASH, MM, Universiteti i Tiranës, UET, UMT, UPT, UPT, UD “Aleksandër Moisiu”, Universiteti “Illyria”, Universiteti i Prishtinës, UNS, (me një pjesë të cilave ka edhe marrëveshje bashkëpunimi), Shtabi i Përgjithshëm, komandantët e llojit të forcave, Akademia e Diplomacisë, gjë që ka bërë të mundur shmangien e subjektivitetit, konformizmit dhe zbehjes së kritikës shkencore. Temat e mbrojtura gjatë vitit 2009-2010 e sidomos të vitit akademik 2010-2011 (për të cilat u dha për herë të parë edhe Diplomë Master, transkript e Supplement Diplome) e kanë kaluar me sukses këtë provë serioze testimi e përgjegjësie të kandidatëve pse jo edhe të pjekurisë së programeve studimore, por gjithsesi kjo nuk mjafton në raport me kërkesat e reja. Ndiqja e punës kërkimore-shkencore në këtë drejtim do të jepet për përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm në sekretarinë përkatëse. Përvoja e të dy kurseve ekzistuese të ciklit të tretë (shkollës së doktoraturës), padyshim që do të lerë gjurmë në këtë drejtim.

Bashkëpunimi dhe aktivizimi i personave pedagogjikë shkencorë e akademikë të jashtëm, jo vetëm që do të vazhdojnë të konfirmojnë seriozitetin e përmbushjes së kësaj pjese të punës shkencore që ligjërisht bëhet në Akademinë e FA, por njëherazi do t'i japin shtytje dhe impulse të reja e më domethënëse tërë spektrit dhe problematikës që mund e duhet të përfshijë puna studimore shkencore e pedagogjike.

Lidhur me mbrojtjen e temave të doktoraturave, sektori i punës shkencore të Akademisë nëpërmjet informacioneve, raporteve dhe analizave konkrete do të theksojë më me forcë faktin se krahas rritjes së seriozitetit nga strukturat përgjegjëse të AFA, përgjegjësinë direkte për cilësinë dhe efektivitetin e materialeve të përgatitura për doktoraturë e gradë shkencore, pas procedurave miratuese të Këshillit të Profesorëve, koordinatorit dhe departamentit përkatës, e kanë disertanti, udhëheqësi shkencor dhe *juria vlerësuese*²¹. Nisur nga kjo si departamentet, ashtu edhe sektori drejtues i cikleve të studimit dhe koordinatori i punës kërkimore-shkencore i Akademisë, sipas plan-miratimit të MASH, vëmendje të veçantë vazhdojnë t'u kushtojnë jo vetëm punës së

²¹ Urdhri i MASH-it Nr.136, datë 21.03.2011, faqe 2-12.

kandidatit, por edhe procedurave të organizimit e strukturimit të doktoraturave, duke kërkuar seriozitet, përkushtim, rregull e disiplinë të lartë shkencore si dhe korrektësi në plotësimin ligjor të të gjitha detyrimeve²².

Nga përshatja dhe ndryshimet e vazhdueshme të programeve të punës kualifikuese e studimore-shkencore, me akademitë homologe dhe institucionet e tjera shkencore të vendit. Në këtë drejtim, sipas planit të miratuar nga Ministria e Mbrojtjes, shqyrtuar nga KDS dhe specifikuar sipas fushave bazë të punës mësimore të Akademisë së FA-së, sektori i punës studimore përgjithëson rezultatet e bashkëpunimit duke përvijuar edhe synimet e përfitimit të përvojës bashkërenduese me akademitë ushtarake homologe dhe kolegjet e tyre mbi bazë reciprociteti e informacioni të ndërsjellë. Esenca e këtyre kontakteve i ka shërbyer transmetimit të dijeve shkencore në procesin mësimor-edukativ në tërësi si dhe në aftësimin e pedagogëve e të punonjësve shkencorë për të zgjeruar horizontin në fushat funksionale. Aspekt i veçantë do të jetë edhe certifikimi i KLSM me Komandën e NATO-s për Transformim. Do të bëhen përpjekje që kjo përvojë të materializohet nga këndvështrime të reja edhe në hartimin e planeve metodike të ndryshme e sidomos të Stërviçjeve Planëzuese të nivelit operacional në Qendrën e Simulimeve. Këtu edhe pse do të gjejnë veten e tyre të tre departamentet, i Operacioneve, i Strategjisë dhe Historisë, i Leadershipit dhe Shkencave Shoqërore, punën më të madhe e ka Departamenti i Operacioneve, pasi lidhet drejtpërdrejt me përmbajtjen e fushës që mbulon dhe modulit përkatës.

Ripunimi dhe përgatitja e tërë dokumentit bazë ligjor (Statutit, Rregullores së Brendshme, të Senatit Akademik, Këshillit të Profesorëve, Rregullores Mësimore (ose të vlerësimit institucional), të etikës etj.), mbi të cilin mbështetet aktiviteti dhe veprimtaria e AFA-së dhe e fakulteteve, departamenteve, është padyshim objekt dhe prioriteti i punës studimore-shkencore të stafit të Akademisë.

Duke bashkëpunuar me institucionet shkencore të vendit, do të bëhet kujdes që të përfitohet më mirë përvoja dhe eksperiencia e shkollës së lartë në praktikat me ciklet e dyta e të treta, promovimin e personelit akademik me qëllim pasqyrimin dhe implementimin e kërkesave ligjore të Arsimit të Lartë në kushtet e realitetit konkret të AFA-së dhe prirjeve të arsimit ushtarak drejt integritit e hopit cilësor. Sektori shkencor ka vendin e tij të veçantë gjatë ripunimit të programeve master e të doktoraturës, në përbërje të grupeve të punës për konsolidimin e kurrikulës përkatëse në të dy fushat të Mbrojtjes e Sigurisë.

Rritja cilësore e mësimdhënies dhe zbatimi i një metodologjie bashkëkohore didaktike me spektrin e niveleve të ndryshme të kurseve që kualifikohen në Akademi, përfshi edhe Kolegjin e Lartë të Sigurisë e Mbrojtjes (me theks të veçantë cikli II dhe cikli III), do të mbetet një fushë e gjerë refleksioni e punës studimore-shkencore, për të depërtuar në esencën e dukurive thelbësore që kanë ndikime në përshpejtimin e zhvillimit të FA-së drejt përmbushjes së kërkesave të planeve të integritit si dhe vetë akademisë në kuadrin e “Revolucionit Arsimor”. Në funksion të krijimit të kulturës së cilësisë së brendshme²³ dhe sipas udhëzimeve të APAAL-it, do të punohet për krijimin e Manualit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Institucionit.

²² Rregullore e Organizimit të Doktoraturës.

Këtu synohet që departamentet të planëzojnë veprimtaritë e tyre kërkimore-shkencore vetë ose në bashkëveprim me të tjerët. Në nivel akademie veprimtaritë kërkimore-shkencore trajtojnë probleme esenciale që i shërbejnë rritjes së cilësisë së veprimtarisë mësimore, konsolidimit të programeve dhe tërë aktivitetëve të saj. Botimet planëzohen së pari për të mbështetur procesin mësimor dhe ardhur në takim edhe kërkesave prioritare të FA për integrim.

Në vend të përfundimeve

Nga sa më sipër edhe njëherë duhet të theksojmë se puna kërkimore-shkencore që do të bëhet në Akademinë e Forcave të Armatosura (përkatësisht njësitë kryesore të saj e departamente), qendra e degë, asnjëherë nuk do të shikohet vetëm nga këndvështrimi i privilegjit apo si rrugë për përfitime personale të karrierës, *por si obligim e kontribut intelektual të njerëzve*, për t'i orientuar e mbështetur gjithë ata që tentojnë t'i futen rrugës së vështirë e të mundimshme të punës shkencore. Ajo është në kohën e duhur për të ndikuar dhe për të bërë institucionin e mendimit ushtarak në një qendër bazë të dijeve dhe kulturës bashkëkohore. Që thellimi i mëtejshëm i saj mbetet një nevojë imediate e kohës, e tregon edhe interesi gjithnjë e më i madh i atyre që guxojnë të konkurrojnë për t'u startuar në nivele të mëtejshme më të larta kualifikimi (Programet Master e Doktoraturë), gjë e cila jo vetëm që na inkurajon për besimin që kanë ndaj këtij institucioni, por në të njëjtën kohë, kjo gjë na bën të jemi më të ndjeshëm e më të vëmendshëm ndaj tyre. Konfirmimi në mënyrë publike (më 15 janar 2013) nga drejtori i APAAL-it Prof. Dr. Avni Meshi, se Akademia Ushtarake është i vetmi IALP i akredituar, kuptohet në ciklin e dytë të studimeve dhe njohje e vlerësim të ciklit të tretë tregon për seriozitet e përkushtim në krijimin e kulturës së brendshme të cilësisë dhe transparencën institucionale. Njëherazi ajo është edhe një mbështetje e madhe, edhe garanci tjetër në përfundimin e plotë të procesit të akreditimit për ciklin e tretë që zhvillojmë, raporti vlerësues i brendshëm i të cilit tashmë është dërguar në agjenci.

Akademia e FA, brenda kuadrit ligjor, do t'i menaxhojë më mirë fondet dhe mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën e kërkimit shkencor dhe të veprimtarive kërkimore që ajo planëzon duke inkurajuar zhvillimin e tyre nga strukturat përgjegjëse, si dhe do të thellojë fushat parësore të punës kërkimore, prioritetet e këtyre veprimtarive, vazhdimësinë, inkurajimin e kërkuesve të rinj, njohjen, vlerësimin dhe propagandimin e botimeve shkencore dhe të veprimtarive kërkimore.

Për ecurinë e punës kërkimore-shkencore, AFA i ka mundësitë që të vëzhgojë me cilësi dhe në mënyrë më eficiente fonde edhe më të mëdha nga buxheti i mbrojtjes, pasi ka potenciale intelektuale për të ndërmarrë edhe studime të mirëfillta në interes të mbrojtjes e sigurisë së vendit.

Nisur nga mendimi se *nuk ka punë kërkimore-shkencore që nuk çon në zhvillim apo në një cilësi të re*²⁴, ajo me gjithë lirinë akademike dhe paanshmërinë e shprehjes së mendimit, do të jetë objekt i vëzhgimit dhe kontrollit të brendshëm periodik apo të radhës të cilësisë nga GSBC (Grupi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë). Në vijimësi ajo do t'i

²³ APAAL, "Udhëzues për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë", 2009.

²⁴ Revista Ushtarake Nr.2/2009,fq.102.

shërbejë rritjes së autoritetit të institucionit dhe strukturave të tij për përmbushjen e detyrave ligjore në kuadër të programeve integruese të sistemit arsimor ushtarak të akredituar, ashtu edhe të botimeve të ndryshme që mbështesin procesin mësimor.

Tërë veprimtaria kërkimore-shkencore do të programohet duke iu përshtatur zhvillimeve të reja, synimeve dhe objektivave për integrim të plotë në NATO si vit vendimtar për përfundimin e këtij procesi.

Në kuadër të strategjisë së zhvillimit institucional, puna kërkimore po zë një vend më evident e më përparësor në përputhje me misionin e Akademisë së riorganizuar dhe të zgjerimit të spektrit të detyrave që kryen ajo si *zëdhënëse e mendimit më të përparuar ushtarak-shkencor të kohës*. Natyrisht kjo trajtesë teorike programore që lidhet me punën kërkimore-shkencore në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vetë specifikën që ka, shoqërohet edhe me plane konkrete të veprimtarive shkencore e botuese që janë hallka të rëndësishme në zinxhirin tërësor të këtij problemi.

Bibliografia

- Fjala e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm në KDS, datë 09.01.2013.
- Ligji Nr.9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, neni 4, 70.
- Dekret i Presidentit të Republikës Nr.7458, datë 11.05.2012.
- VKM Nr.1509, datë 30.07.2008, Strategjia Kombëtare e Arsimit të Lartë 2008-2013".
- Deklarata e Bolonjës, 18-19 qershor 1999.
- Përmbledhje Materialesh të Akademisë, Tiranë 2008.
- Direktiva e Mbrojtjes 2013.
- Zija Xholi, Monografia Sami Frashëri, Tiranë 1978.
- Standardet shtetërore të cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë, 2011.
- Doktrina e Mbrojtjes 2013.
- SHSHPFA, fjala në auditoriumin e KDS-së, datë 11.02.2013.
- Gjeneral Brigade Jeronim Bazo, Përmbledhje Materialesh të Akademisë së Mbrojtjes, 2008.
- Arben Imami, Fjala në takimin për Integrimin e plotë në NATO, "Ushtria", 25 janar 2013.
- Urdhri i MASH-it Nr.135, 136, datë 21.03.2011.
- Doktrina e Mbrojtjes 2013.
- Urdhri i MASH-it Nr.136, datë 21.03.2011.
- Rregullore e Organizimit të Doktoraturës.
- APAAL, "Udhëzues për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë", 2009.
- Revista Ushtarake Nr.2/2009.

Legjislacioni shqiptar dhe ai evropian, në fushën e sigurisë

Dr. Ardian Myslimaj,
Drejtor i Programeve Master dhe Doktoraturës në AFA
MSc Etleva Metaj

Trajtesë e shkurtuar. *Punimi bazohet mbi një analizë të realizimit të procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë. Në këtë studim analitik, rëndësi e veçantë dhe përparësi i është dhënë prioritetëve në fushën e sigurisë, ku bazohet përafrimi i legjislacionit, si dhe vlerësimit të hapave që janë ndërmarrë, deri më sot, nga ana e Shqipërisë.*

Rëndësi i është kushtuar nismave ligjore, të ndërmarra në kuadrin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (2009-2014), institucioneve dhe bazës ligjore të përfshirë në të gjitha aktivitetet që janë bërë dhe që janë planifikuar të kryen në vazhdimësi.

Përzgjedhja e fushave, legjislacioni i të cilave është analizuar, është bërë sipas rëndësisë që iu është dhënë atyre në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes, si dhe sipas Traktatit të Lisbonës, në kuadrin e prioritetëve dhe objektivave për një Politikë të Përbashkët në Politikën e Jashtme, Sigurinë dhe Mbrojtjen, konkretisht: Politika e Përbashkët për Politikën e Jashtme, Sigurisë dhe Mbrojtjes, bashkëpunimi në çështjet e brendshme, krimi i organizuar, terrorizmi dhe Forcat e Armatosura.

Në fokusin e këtij studimi qëndrojnë çështjet e sigurisë, rëndësia e tyre për një stabilitet të qëndrueshëm dhe real jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon e më gjerë.

Përveç identifikimit të fushave të sigurisë, në qendër të studimit mbetet edhe identifikimi i dokumenteve strategjike, institucioneve përkatëse dhe identifikimi i legjislacionit vendas dhe atij evropian, në fushën e sigurisë, si dhe përpjekjet e deritanishme që qeveria shqiptare ka bërë në përafrimin e legjislacionit, në përputhje me standardet dhe kriteret e përcaktuara nga vetë komuniteti evropian, si një shtet aspirant për të qenë anëtar i Bashkimit Evropian.

Angazhimet e shtetit shqiptar për përafrimin e legjislacionit ekzistues si dhe masat e marra, para anëtarësimit, për një politikë sigurie të përbashkët, synojnë moscenimin

e sovranitetit shtetëror dhe përputhshmëri me të drejtën ndërkombëtare. Vlen të theksojmë rolin e rëndësishëm që luajnë, në këtë kuadër, marrëveshjet në të cilat shteti shqiptar ka nënshkruar, me qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe aderimit në strukturat ndërkombëtare si NATO, OKB, OSBE, etj. Rëndësia e këtyre marrëveshjeve qëndron në faktin se, në momentin e ratifikimit të tyre, ato përbëjnë një “detyrim” në përmbushjen e angazhimeve të marra për shtetin shqiptar. Ky detyrim vjen nga bazat kushtetuese, që duke i dhënë epërsi marrëveshjeve ndërkombëtare, detyrojnë shtetin t’i zbatojë ato në përputhje të plotë me kushtetutën e vendit.

Synimet, objektivat dhe politikat nuk janë më të ndara sipas shteteve, por ato iu përkasin të gjitha shteteve, dhe këtu do të theksoja jo vetëm shteteve që janë pjesë, por edhe shteteve që aspirojnë të jenë pjesë e komunitetit. Siguria përbën një nga tri shtyllat e Bashkimit Evropian, konkretisht, shtyllën e dytë e cila përfshin menaxhimin e krizave civile dhe ushtarake dhe parandalimin e konflikteve.

Bazuar në dokumentin e nënshkruar nga qeveria shqiptare për përafrimin e legjislacionit, janë analizuar nismat ligjore, afatet e tyre dhe kuadri ligjor ekzistues, për disa fusha të çështjeve të sigurisë. Pas identifikimit të kuadrit ligjor aktual, janë përcaktuar përparësitë dhe afatet për realizimin e tyre dhe kuadri institucional. Nismat ligjore janë ndërmarrë për adresimin e përparësive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Mbështetja pa rezerva që Shqipëria i ofron Strategjisë Evropiane të Sigurisë 2003, shprehet qartë në dokumentet strategjike të Republikës së Shqipërisë në fushën e sigurisë, në bashkimin me deklaratat përkatëse të BE-së dhe me deklaratat politike të Republikës së Shqipërisë për këtë çështje.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare¹ e Republikës së Shqipërisë mbështet konceptin e afrimit të shpejtë të vendit tonë, nëpërmjet reformave të përshkallëzuara e shumëplanëshe, në strukturat kolektive të sigurisë evropiane, bazuar në dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara mbi sigurinë dhe mbrojtjen kolektive.

Në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare specifikohet se përafrimi i legjislacionit me standardet e Bashkimit Evropian dhe funksionimi efektiv i shtetit ligjor janë garanci afatgjata, për të mbrojtur interesat kombëtare dhe për integrimin e Shqipërisë.

Me ndryshimin e mjedisit strategjik rajonal dhe ndërkombëtar të sigurisë, Republika e Shqipërisë është aktualisht në fazën e rishikimit përkatës të Strategjisë së saj të Sigurisë Kombëtare, e cila është në harmoni dhe përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, si dhe bazohet, ndër të tjera, në vlerësimet e Strategjisë Evropiane të Sigurisë.

Në këtë kuadër, duke pasur parasysh edhe anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO)², Strategjia e Sigurisë Kombëtare mbështet konceptin e afrimit të shpejtë të vendit tonë, nëpërmjet reformave

¹Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin Nr. 9322, dt. 25.11.2004 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

² Më dt. 2 Prill 2009.

të përshkallëzuara e shumëplanëshe, në strukturat kolektive të sigurisë evropiane, si dhe pjesëmarrjen e kontributin përkatës në kuadër të OKB-së, NATO-s, OSBE-së, apo mekanizmave të tjerë rajonalë, bazuar në dispozitat e Kartës së OKB-së mbi sigurinë dhe mbrojtjen kolektive.

Bazuar në Strategjinë e Sigurisë, objektivat klasifikohen si të natyrës afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Realizimi i këtyre objektivave synon të krijojë një lidhje thelbësore ndërvepruese të interesave kombëtare, nevojave dhe mundësive të vendit.

Objektivat parësore që synohen të realizohen në planin afatshkurtër dhe afatmesëm janë:

Paqe dhe siguri në vend, me fokus stabilitetin e brendshëm të vendit, si një produkt i forcimit të shtetit ligjor për të mbrojtur qytetarët, shoqërinë civile dhe shtetin nga veprimet antiligjore.

Bashkëpunimi rajonal, duke synuar ndërtimin e marrëdhënieve rajonale, në funksion të politikave të përbashkëta të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Mbetet qëllim i përbashkët integrimi në strukturat evropiane dhe euroatlantike për të kthyer rajonin tonë në faktor paqeje, stabiliteti dhe prosperiteti.

Konsolidimi i shoqërisë demokratike dhe të drejtave të njeriut, ku forcimi i institucioneve shtetërore është një garanci për zhvillimin e shoqërisë demokratike me norma dhe standarde të larta në respektimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, si një garanci për një mjedis të sigurtë dhe raporte harmonike individ-shoqëri. Individit, shoqëria dhe shteti kanë detyrime të përbashkëta për sigurimin e vendit. Shkelja e këtyre detyrimeve, qoftë edhe nga njëra palë, dëmton rëndë sigurinë e tij. Roli aktiv i organizatave joqeveritare kontribuon në konsolidimin e standardeve demokratike të shoqërisë.

Konsolidimi i institucioneve dhe instrumenteve të sigurimit, konsiderohet një aftësi për të mbrojtur interesat kombëtare dhe si një përgjegjësi për të vepruar ndaj çdo situatë. Ato konsiderohen si faktorë vendimtarë në suksesin e demokracisë dhe ekonomisë së tregut në një shoqëri të zhvilluar.

Fuqizimi i ekonomisë në vend, në nivelet evropiane në infrastrukturë, shfrytëzimi i avantazheve krahasuese në tregjet rajonale dhe evropiane, do të mundësojnë shfrytëzimin me efektivitet të pozitës së favorshme gjeostrategjike të Shqipërisë.

Objektiva parësore që do të mbahen parasysh në planin afatmesëm dhe afatgjatë:

Integrimi në strukturat evropiane. Anëtarësimi në BE mbetet objektiv parësor në funksion dhe në dobi të sigurisë së vendit. Përafrimi i legjislacionit me standardet e Bashkimit Evropian dhe funksionimi efektiv i shtetit ligjor janë garanci afatgjata, për të mbrojtur interesat kombëtare dhe për integrimin e Shqipërisë.

Çështja kombëtare shqiptare. Stabiliteti rajonal konsiderohet si kusht drejt integritetit të vendeve të rajonit në Evropë. Shqipëria synon të jetë një partner aktiv në politikën rajonale. Në këtë kuadër, çështja kombëtare shqiptare synohet të arrihet nëpërmjet integritetit evropian dhe euroatlantik të vendeve të rajonit si edhe zgjidhjeve që sigurojnë garanci afatgjatë dhe të pranueshme për bashkësinë ndërkombëtare.

Mbrojtja e mjedisit dhe burimeve natyrore, si elementë të pashtershëm të gjenerimit të instrumenteve të sigurisë.

Konsolidimi i Forcave të Armatosura, nëpërmjet rishikimit periodik të strukturës së Forcave të Armatosura, në varësi të situatave dhe zhvillimeve në mjedisin e sigurisë. Aftësia mbrojtëse e tërësisë territoriale dhe pavarësia e vendit mbeten shprehje e vullnetit të popullit për të siguruar vetveten pa kërcënuar vendet e tjera.

Lufta kundër terrorizmit, duke angazhuar drejtpërdrejt të gjitha strukturat e specializuara të Policisë së Shtetit, Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Forcave të Armatosura. Në këtë kuadër, në bashkëpunim me organizmat e specializuara ndërkombëtare, strukturat përkatëse do të punojnë në drejtim të pasurimit dhe përmirësimit të bazës ligjore dhe në ristrukturimin e organeve të specializuara. Objektivi i tyre është efektshmëria maksimale në luftën kundër terrorizmit.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Institucionet ligjore shqiptare kanë për detyrë të ndërveprojnë mes tyre në mënyrë efikase. Zbatimi i ligjit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit përbën një element të rëndësishëm të Sigurisë së Shqipërisë.

Traktati i Lisbonës është analizuar në kuadrin e legjislacionit të BE-së, pasi është dokumenti të cilit, të gjitha shtetet anëtare të BE dhe ato që presin të bëhen anëtare, do t'i referohen për hartimin dhe zbatimin e politikave të jashtme dhe të sigurisë, në të ardhmen.

Pavarësisht faktit se ky traktat kryesisht ka të bëjë me vendet anëtare të BE-së, vlen të theksohet se është shumë e rëndësishme për Shqipërinë që t'i referohet këtij traktati, lidhur me legjislacionin për çështjet e sigurisë. Politika e Përbashkët e Jashtme dhe Sigurisë është shtylla e dytë e rëndësishme dhe një nga prioritetet në BE.

Republika e Shqipërisë, e konsideron integrimin evropian si një objektiv strategjik, i cili ofron garanci për forcimin e mëtejshëm të sigurisë në vend dhe i shërben mbrojtjes së interesave kombëtare, paqes e stabilitetit në rajon e më gjerë.

Në funksion të këtij objektivi madhor dhe duke synuar promovimin e vlerave dhe parimeve të përbashkëta evropiane, Shqipëria mbështet fuqimisht politikën e jashtme të sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së, e cila synon forcimin e rolit të BE-së, si një entitet me ndikim politik gjithnjë e në rritje në politikën ndërkombëtare.

Në këtë kontekst, Republika e Shqipërisë është seriozisht e angazhuar që, me aderimin e saj në Bashkimin Evropian, të jetë në gjendje të marrë pjesë plotësisht dhe aktivisht në Politikën e Jashtme të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Bashkimit Evropian, duke kontribuar në një frymë besnikërie dhe solidariteti reciprok, në afirmimin e rolit të BE-së, si një aktor global në sigurinë evropiane dhe atë ndërkombëtare.

Që prej janarit 2004, Shqipëria i është bashkuar rregullisht qëndrimeve të përbashkëta të BE-së në fushën e Politikës së Jashtme të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Bashkimit Evropian. Për më tepër, ajo ka kontribuar dhe kontribuon në misionet ushtarake të BE-së.

Shqipëria mbështet konceptin e një "kulture parandalimi", sikurse sugjerohet në Programin e BE-së, për Parandalimin e Konfliktit të Dhunshëm, miratuar nga Këshilli

Evropian i Göteborgut. Po kështu, bashkohet me objektivat afatgjata të “Projektimit të Stabilitetit” si dhe me objektivat afatshkurtëra për “Reagimin e shpejtë” për parandalimin e konfliktit, parashikuar në Komunikatën e Komisionit, në prill 2001. Në vëmendje të shtrirjes horizontale dhe multidimensionalitetit të kësaj politike, vlerësohet si mjaft i rëndësishëm bashkëpunimi dhe koordinimi efektiv i punës ndërmjet organizatave ndërkombëtare si OKB, OSBE, KE, etj.

Si një ndër vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria ka qenë “konsumatore” e kësaj politike, duke përfituar nga asistenca dhe ekspertiza e BE-së dhe mjaft organizatave ndërkombëtare në rrugën e saj të konsolidimit të shtetit ligjor demokratik, respektimit të të drejtave të njeriut, zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, rritjes së kapaciteteve menaxhuese, etj. Kjo përvojë dhe ekspertizë, i ka shërbyer Shqipërisë për t’u kthyer në një kontribuese të procesit të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë. Ky qëndrim konstruktiv dhe bashkëpunues rajonal, si dhe mesazhi i harmonisë dhe bashkëjetesës fetare janë një vlerë e shtuar që Shqipëria do t’i ofrojë Komunitetit.

Republika e Shqipërisë ka ndjekur me vëmendje procesin e zhvillimit të Politikës së Jashtme të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Bashkimit Evropian dhe vlerëson ndikimin e Traktatit të Lisbonës në forcimin e arkitekturës institucionale të CFSP/CSDP³, duke e konsideruar si një hap të rëndësishëm për rritjen e efektivitetit dhe koherencës në politikën e jashtme të Unionit.

Duke iu referuar në veçanti dimensionit ushtarak, Republika e Shqipërisë i bashkohet përpjekjeve të Unionit për rritjen e kapaciteteve ushtarake dhe krijimin e një bashkëpunimi strukturor të përhershëm në fushën ushtarake, i cili do t’i shërbejë forcimit të identitetit ndërkombëtar të Unionit, si një aktor me kapacitete ushtarake dhe civile të përforcuara për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave strategjike të tij. Në përputhje me kapacitetet e saj, Shqipëria do të vazhdojë të marrë të gjitha masat e nevojshme për forcimin e kapaciteteve civile-ushtarake dhe konsolidimin e të gjitha institucioneve të sigurisë në vend, në përputhje me kërkesat operacionale dhe politikat e përcaktuara nga Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA)⁴, me qëllim dhënien e kontributit përkatës në zhvillimin e dimensionit ushtarak. Në kuadër të transformimit, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë të fokusuar në arritjen e plotë të standardeve të kërkuara për njësitë ushtarake që do të kontribuojnë në të ardhmen në operacionet e drejtuara nga BE, NATO dhe OKB.

Në kuadër të kërkesave që BE i ka paraqitur Shqipërisë mbi përcaktimin e instrumenteve ligjorë në fushën e Politikës së Jashtme të Sigurisë dhe Mbrojtjes, ku një rol shumë të rëndësishëm luan Ministria e Punëve të Jashtme dhe instrumentet në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, janë përcaktuar ligjet dhe aktet ligjore përkatëse si vijon:

- Ligji Nr. 9095, datë 3.7.2003,⁵ “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

³CFSP-Common Foreign and Security Policy; CSDP-Common Security and Defense Policy.

⁴EDA- European Defense Agency, krijuar sipas Traktatit të Lisbonës.

⁵Fletorja Zyrtare: Viti 2003, Nr. 64.

- Ligji Nr. 8372, datë 9.7.1998,⁶ “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore”.
- Ligji Nr. 7164, datë 10 Tetor 1987, për ratifikimin e Konventës së Vjenës, “Për marrëdhëniet diplomatike”.
- Ligji Nr. 7507, datë 31 Korrik 1991 për ratifikimin e Konventës së Vjenës, “Për marrëdhëniet konsullore”.
- Ligji Nr. 9322, datë 25.11.2004⁷, “Për Strategjinë Kombëtare të Sigurisë”.
- Ligji Nr. 8696, datë 23 Nëntor 2000⁸, “Për ratifikim e Konventës së Vjenës për të drejtën e traktateve”.
- Ligji Nr. 8371, datë 9.7.1998,⁹ “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”.
- VKM, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim”.
- “Rregullorja e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me VKM nr. 839, datë 17.12.2004.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 9322, datë 25.11.2004, “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë” është dokument me karakter kombëtar, që mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, pasqyron zhvillimet e politikave shtetërore për sigurimin e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit demokratik shqiptar ndaj kërcënimeve e rreziqeve të brendshme dhe të jashtme. Siguria e vendit garantohet kur përmbushet me efektivitet mbrojtja e interesave kombëtare, në shtrirje kohore dhe në vështirim perspektiv.

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 9858, datë 27.12.2007, “Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë” është një dokument i rëndësishëm që përmban parimet dhe konceptet bazë për zhvillimin dhe përdorimin e Forcave të Armatosura për arritjen e objektivave të politikës së mbrojtjes. Ajo rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e Strategjia e Sigurisë Kombëtare dhe përcakton synimet, objektivat, kapacitetet e kërkuara dhe burimet për krijimin e një force të aftë për realizimin e misionit të saj kushtetues.

Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE, është një proces i vështirë dhe kompleks. Një nga kërkesat e këtij procesi është që Shqipëria jo vetëm të ndërtojë kuadrin ligjor në përputhje me kërkesat e tij, por edhe të sigurojë struktura administrative dhe kushtet e tjera të nevojshme për zbatimin e saj. Pra, procesi i përafrimit shkon përtej detyrave që kanë të bëjnë thjesht me hartim legjislacioni; ai kërkon vëmendje të veçantë për fazën e formulimit të politikave, në mënyrë të tillë që të merren vendime të menduara mirë dhe të prodhohen tekste ligjore cilësore.

⁶ Fletorja Zyrtare: Viti 1998, Nr .18.

⁷ Fletorja Zyrtare: Viti 2004, Nr. 98.

⁸ Fletorja Zyrtare, Viti 2000, Nr. 40.

⁹ Fletorja Zyrtare, Viti 1998, Nr .18.

Në fushën e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë, Shqipërisë i është kërkuar nëse është e gatshme të pranojë, në tërësinë e tyre dhe pa rezerva, objektivat e Traktatit të Lisbonës, sipas dispozitave të Kapitullit V, si dhe deklaratën e cila përfshin marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga BE dhe burime të rëndësishme në fushën e politikës së jashtme të sigurisë dhe mbrojtjes së BE.

Në këtë kuadër, Shqipëria i është bashkuar, plotësisht dhe pa asnjë rezervë, vlerave, parimeve dhe objektivave që udhëheqin veprimet në politikën e jashtme të BE-së, të përcaktuara në Kapitullin V të Traktatit të Bashkimit Evropian (TEU).

Respektimi i normave të së drejtës ndërkombëtare dhe parimeve të përcaktuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara, Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit për ruajtjen e paqes, parandalimin e konflikteve dhe forcimin e sigurisë globale, përbëjnë shtyllat ku mbështetet politika e jashtme e Shqipërisë.

Në themel të vizionit të politikës së jashtme të Shqipërisë qëndron ndërtimi i marrëdhënieve dy dhe shumëpalëshe, të karakterizuara nga fryma e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Në zbatim të këtij orientimi themelor të politikës së jashtme, Shqipëria ka adoptuar gjithnjë e më shumë një rol të dukshëm aktiv në favor të paqes dhe stabilitetit në rajon, duke zgjeruar e intensifikuar marrëdhëniet diplomatike, ekonomike, politike e kulturore me të gjitha vendet e rajonit.

Objektivi i përbashkët i rajonit për integrimin në strukturat evropiane dhe euroatlantike i ka shërbyer intensifikimit të marrëdhënieve të gjithanshme miqësore dypalëshe, duke kontribuar kështu në kthimin e rajonit në faktor paqeje, stabiliteti dhe prosperiteti. Në këtë kuadër, Shqipëria i kushton një vëmendje të veçantë dhe forcimit të marrëdhënieve shumëpalëshe rajonale, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në të gjitha nismat rajonale.

Një qëndrim gjithëpërfshirës është adoptuar përsa i përket konceptit të sigurisë, i cili ka evoluar në përputhje me zhvillimet e brendshme dhe të jashtme, për të drejtuar sfidat dhe kërcënimet e reja, me të cilat përballet sot komuniteti ndërkombëtar.

Përmes këtij procesi mbështetet zhvillimi e partneritetit strategjik të Bashkimit Evropian me NATO-n në menaxhimin e krizave, si dhe ndahet i njëjti vlerësim me atë të BE-së, për rolin primar të OKB-së në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, Shqipëria mbështet objektivat e Politikës së Fqinjësisë Evropiane për të kontribuar në stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin e vendeve të përfshira në këtë nismë.

Vlen të theksohet se, ndër angazhimet që Shqipëria ka marrë në kuadrin e integritit në Bashkimin Evropian, janë masat për rritjen e pranisë së saj në misionet paqeruajtëse dhe në dhënien e një kontributi më të madh në parandalimin e krizave ndërkombëtare.

Shqipëria ka mbështetur plotësisht të gjitha përpjekjet në luftën globale kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar. Gjithashtu, ajo është pjesë e regjimeve ndërkombëtare për mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe i është bashkuar Kodit të Sjelljes së BE-së për eksportin e armëve.

Detyrimi për të përafruar legjislacionin Shqiptar me atë të BE-së buron nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), nënshkruar më 12 qershor 2006. Përafrimi

gradual i legjislacionit shqiptar përbën gjithashtu një nga kriteret e Kopenhagenit për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Të gjitha fazat e procesit legjislativ, duke nisur nga formulimi i politikave dhe përcaktimi i instrumentit rregullues (ligj ose akt nënligjor) deri tek hartimi i tekstit të aktit, janë pjesë e procesit të adresimit të kërkesave në legjislacionin shqiptar.

Megjithatë është meritë e specialistëve ligjorë të fushës dhe e vullnetit politik të vendimmarrësve që Shqipëria, në një periudhë kaq të shkurtër kohore, pa anashkaluar këtu edhe problemet e tjera që ka hasur, të mund të hartojë dhe të përshtatë një legjislacion kaq të gjerë dhe kaq të hollësishëm duke përmbushur kërkesat e organizatave ku tashmë ajo është anëtare me të drejta të plota dhe e gatshme për t'u bërë pjesë e një komuniteti të madh shtetesh të Bashkimit Evropian.

Pavarësisht nga puna e madhe dhe e kujdesshme që është bërë në fushën e përafrimit të legjislacionit shqiptar në fushën e sigurisë me atë të Bashkimit Evropian, ende mbetet punë për të bërë. Ky konstatim nuk ka të bëjë vetëm me legjislacionin në fushën e sigurisë, por edhe më gjerë, më gjithë procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar.

Por duke u përqendruar tek fusha e sigurisë mendoj se, me gjithë përpjekjet, ende nuk ka një bashkëpunim të plotë mes ministrive përkatëse apo institucioneve dhe agjencive të përfshira në këtë proces dhe duhet një bashkëpunim edhe më i gjerë mes komiteeve ndërminstrore të ngritura, Ministrisë së Integritimit, Ministrisë së Jashtme, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë. Fakti që ka zvarritje në miratimin e ligjeve apo dhe konventa të paratifikuara, tregon nevojën për një përpjekje më serioze në këtë drejtim.

Mendoj se një drejtim tjetër ku mund të përmirësohet procesi është edhe nevoja për një transparencë më të madhe ndaj opinionit publik, për t'i dhënë atij informacion të hollësishëm në lidhje me procesin. Kjo e bën median më aktive në problematikën e fushës së sigurisë dhe rrit ndjeshëm edhe angazhimin e shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit që janë të lidhura me këtë proces.

Bibliografia:

- *Bashkëpunimi ndërkombëtar për paqe, siguri dhe përparim në Europën Juglindore*, (2004), Shoqata Shqiptare e Atlantikut.
- *Libri i Bardhë* (2005), Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake, Tiranë.
- *Manual i Hartimit të ligjeve, Guidë për procesin legjislativ në Shqipëri*, Tiranë.
- *Marrëveshjet dhe Konventat për Forcat e Armatosura* (2003), Republika e Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes, Tiranë.
- *Membership Action Plan, Annual National Programs of the Republic of Albania 1999-2005*, Tirana.
- *Politika e Sigurimit Kombëtar në Shoqërinë Demokratike* (1996); Akademia e Mbrojtjes, Ministria e Mbrojtjes, Tiranë.
- *Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë*, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin Nr. 9322, datë 25.11.2004 "Për Miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë".
- *Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë*, miratuar me Ligjin Nr. 9858, datë 27.12.2007, "Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë".

- *Doracak i NATO-s* (2001); Office of Information and Press, NATO -1110, Brussels, Belgium.
- *Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZ-MSA)*, miratuar me VKM Nr. 317, datë 13.5.2006.
- *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 (SKZH)*, miratuar me VKM Nr. 342, datë 15.05.2008.
- *Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 43, datë 16.01.2008*, Fletorja Zyrtare, Viti 2008, Nr. 8, Faqe 240, Data e botimit, 30.01.2008.
- *Ligji Nr. 2.10100, datë 26.3.2009*, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Atlantikut të Veriut”, Fletore Zyrtare, Viti 2009, Nr 33.
- *Fletore Zyrtare*, Viti 2003, Nr 64.
- *Fletore Zyrtare*, Viti 1998, Nr 18.
- *Fletore Zyrtare*, Viti 2004, Nr 98.
- *Fletore Zyrtare*, Viti 2000, Nr 40.
- *Fletore Zyrtare*, Viti 1998, Nr 18.

RUBRIKA E TRETË

Punime historike

Revista Ushtarake e ka bërë pjesë të saj trajtimin e temave historike, të lidhura me çështje të ndjeshme të historisë së popullit shqiptar dhe mendimin strategjik ushtarak, si dhe të çështje të sigurisë në zona të tjera të botës.

Në këtë numër, kjo rubrikë trajton, në një shkrim të sjellë nga Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneralmajor Viktor Bërdo, veçori të mendimit dhe strategjisë ushtarake izraelite. Autori trajton aspektin se si kultura e një populli lidhet me pasigurinë e trashëguar të luftrave, se si një vend i vogël si Izraeli posedon një kulturë të konsoliduar strategjike. Ndërsa Komandanti i Trupave Speciale, Kolonel Dritan Demiraj rivjen me prurjet e tij të mbështetura në përvojën personale, për shkak të detyrës dhe pjesëmarrjes konkrete në misione në ndihmë të vendosjes së paqes dhe sigurisë, në zona të tilla si Pakistani apo Afganistani. Shkrimi i tij trajton çështje ende të pazgjidhura të Pakistanit, të cilat autori mendon t'i trajtojë edhe në numra të tjerë të RU.

Revista mirëpret vazhdimisht shkrime nga pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Roli i UÇK-së në çlirimin e Kosovës, është sjellë nga Gjeneral Brigade Bashkim Jashari. Autori shpjegon rëndësinë gjeostrategjike dhe gjeopolitike të gadishullit të Ballkanit, si një udhëkryq që lidh Evropën, Azinë dhe Afrikën.

Shtypi ushtarak, i trajtuar në fillesat e tij, vjen nga Dr. Zaho Golemi. Autori thekson rolin e botimeve ushtarake në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare, në zgjerimin e lëvizjes çlirimtare, si dhe në masivizimin e saj. Botimet e kësaj kohe përshkruajnë heroizmin dhe trimërinë popullore, duke trajtuar e sjellë më afër traditën popullore, të pleksur me elemente të artit luftarak shqiptar të trashëguar në shekuj prej tij.

Disa veçori të mendimit dhe strategjisë ushtarake izraelite

Gjeneralmajor Viktor Bërdo,
Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të FA

Askush nuk e fillon një luftë, ose më mirë, askush nuk e dëshiron fillimin e një lufte, pa qenë plotësisht i qartë në mendjen e tij për atë që dëshiron të arrijë nga kjo luftë dhe se si duhet ta zhvillojë atë. Objektivat politikë janë të parët për nga rëndësia, objektivat operacionalë janë rrjedhojë e tyre.

Karl fon Klauzeviç

Trajtesë e shkurtuar. *Ekzistojnë elementë thelbësorë që identifikojnë njerëzit si: grupet etnike, raca, gjuha, kufijtë, fetë, ideologjitë, etj. Nëse do të rendisim elementë të tjerë, lista do të ishte e pafund. Kultura është një fenomen që na përket të gjithëve pasi ne përballemi me të kudo, në çdo moment dhe në çdo aspekt të jetës, por ajo kushtëzohet nga shumë faktorë.*

Kultura strategjike lidhet me pasigurinë e trashëguar të luftërave. Kultura strategjike është një shumë përparësish të përcaktuara nga vendimmarrësit, përparësi që lidhen me objektivat politikë të luftës dhe me mënyrën më të efekshme për t'i përmbushur ato.

Trajtesa e mëposhtme shqyrton kulturën në përgjithësi dhe shtjellon kulturën strategjike, në mënyrë më specifike, duke marrë në konsideratë si rast studimi Izraelin, një vend të vogël me kulturë të konsoliduar strategjike.

Hyrje

Koncepti i kulturës është një nocion shumë i përdorur në kohët e sotme. Në vija të përgjithshme, kultura ka kuptime të ndryshme¹. Kultura përbëhet nga vlerat që zotërojnë anëtarët e një grupi, nga normat që ata respektojnë dhe nga të mirat materiale që krijojnë. Fjalën “kulturë”, shpesh e mendojmë si vlera të

¹ Kuptimi francez lidhet me idenë e veprës së krijimit, por kuptimi ndryshon në kohë dhe në vend dhe nënkupton përkufizime të trashëgimisë dhe të dijes. Kuptimi gjerman i afërt me fjalën “civilizim”, përmbledh simbolet vlerat, përfytyrimet, historinë. Kuptimi anglo-sakson antropologjik merr parasysh mënyrën e jetesës, stilet, përvojat e përditshme, imazhet. Për me gjerë shih: Dominique Volton, Të shpëtojme komunikimin, Tiranë, 2009, f. 15.

“elementeve të larta të mendjes njerëzore, artit, shkencës, letërsisë, muzikës”.² Pra, kulturë do të thotë zhvillim, në shkallë të lartë inteligjence, në fusha të caktuara si arti, shkenca, etj. *Fernand Braudel*, në librin e tij “Gramatika e Qytetërimeve” shprehet: “Fjalori i shkencave humane nuk lejon fare përkufizime të prera. Jo se gjithçka në këtë fjalor është e pasigurt ose bëhet e tillë, por shumica e termave, jo vetëm që nuk janë të përcaktuar një herë e përgjithmonë, por ndryshojnë nga një autor te tjetri dhe nuk pushojnë së ndryshuari para syve tanë”.

Williams në “*The sociology of Culture*”³, e përkufizon kulturën në këtë mënyrë: “Vlerat kulturore janë koncepte të përgjithshme, janë kritere, në bazë të të cilave anëtarët e një kulture përcaktojnë se çfarë është e dëshirueshme apo e padëshirueshme, e mirë apo e keqe, e bukur apo e shëmtuar”. Vlera dhe normat e sjelljes ndryshojnë shumë nga njëra kulturë në tjetrën. “Çdo kulturë përmban modele unike të sjelljes që mund të duken të huaja për njerëzit që kanë prejardhje të ndryshme kulturore.”⁴

Shumëllojshmëria e besimeve fetare dhe e organizatave fetare është e pafundme. Studiuesit janë përballur me vështirësi të mëdha për arritjen e një përkufizimi të vetëm të fesë. Në shoqërinë tradicionale, zakonisht feja luan një rol të rëndësishëm në jetën sociale. Sipas sociologut *Emile Durkheim*, feja lidhet me “natyrën e përgjithshme të institucioneve të një shoqërie”.

Dy fjalë rreth kulturës strategjike

Në këtë artikull, të përqendruar sidomos te Izraeli, kultura strategjike do të përcaktohet si: besime, mendime dhe mënyra të sjelluri të përbashkëta, derivate të përvojave të përbashkëta dhe tregimeve të njohura (të shkruara dhe verbale), të cilat i japin trajtë identitetit kolektiv dhe marrëdhënieve me grupet e tjera dhe që përcaktojnë përfundimet e mjetet e përshtatshme për të arritur objektivat e sigurisë⁵.

Ky përcaktim i përshtatet më së miri vlerësimeve për çështjen e Izraelit. Izraeli ka kultivuar, disa mund të thonë edhe imponuar, një set besimesh dhe mendimesh rreth popullsisë së tij, si mjet për të ndërtuar dhe mbrojtur, në të njëjtë kohë, shtetin e ri izraelit përballë fytyrës thellësisht armiqësore të Islamit.

Ky sistem besimi është rrënjësor, pjesërisht në tekste të lashta të tilla si Bibla, por është nën presion të konsiderueshëm nga ndryshimet bashkëkohore demografike, ideologjike dhe fetare në shoqërinë izraelite. Sigurisht, struktura e kulturës strategjike mund të ofrojë një mjet të dobishëm për të parashikuar se si shteti hebre mund të përballojë sfidat ndaj sigurisë së tij, brenda dhe jashtë.

Është treguar se përvoja, mbështetur në dimensionet hapësirë-kohë, bën që popuj të ndryshëm të kenë këndvështrime të ndryshme strategjike. Shembulli më i dukshëm është rasti i mendësisë strategjike izraelite, si vepër e një vetëdije historike që zgjatet

² The Third World, Peter Worsley, London, 1967.

³ Cituar nga Zyhdi Dervishi, “Sociologji Kulture I”, f 25-31.

⁴ Sociologjia, Anthony Giddens, Polity Press Çabej, 2007, fq 49.

⁵ Gregory F. Giles.

në shekuj. Në të njëjtin drejtim, edhe paralelizmi dhe vazhdimësia mes përparësive strategjike të carizmit ortodoks rus dhe ish-Bashkimit Sovjetik ateist, është tregues i faktit se në ç' masë është e përcaktueshme nga të dhënat konstante si historia dhe gjeografia, mendësia strategjike e popujve. Përmbajtja e mendësisë strategjike merr formë të kapshme e të kuptueshme përmes planifikimit strategjik, të vendosur në një skenar racional, me anë të të dhënave potenciale ushtarake për betejë⁶.

Në auditorët e akademive kemi gjetur shpjegime për shkaqet e luftërave të tilla si: nacionalizmi, militarizimi, aleancat, faktorët ekonomikë, etj. *J. Stoessenger* thekson se në librat tradicionalë mbi luftën, dimensionit njerëzor “rrallë i jepet pesha e dëshiruar”⁷. Autori, duke analizuar në mënyrë mjeshtërore dhjetë luftërat e fundit, duke filluar nga dy luftërat botërore e deri te lufta e dytë në Irak, arrin në përfundim për rolin e liderëve apo komandantëve, për përgjegjësinë e shkuarjes në luftë apo paqe. Sipas tij, në asnjë luftë, personalitetet nuk kanë luajtur rol më të madh se sa në Vietnam. Gjatë jetës së një brezi, shkruan autori, pesë presidentë amerikanë i bazuan politikat e tyre në Indokinë, jo mbi realitetet aziatike. Historia e shpërbërjes së Jugosllavisë është historia e arrogancës shkatërruese të Millosheviçit. Në luftën gati pesëdhjetëvjeçare, që u zhvillua në shekullin XX, midis arabëve e izraelitëve, si udhëheqësit arabë dhe ata izraelitë, e kanë parë kauzën e tyre të drejtë dhe të bazuar vendosmërisht mbi vullnetin e Perëndisë, në moralin dhe arsyen.

Disa karakteristika të kulturës strategjike të Izraelit

Përkrashtimet e kulturës strategjike ushtarake

Kultura strategjike izraelite është përpunuar me kujdes gjatë gjashtë dekadave të shkuara. Mjetet parësore për realizimin e saj kanë qenë institucionet shtetërore. Ndër ta, institucioni kryesor është FMI. Ajo ka në dispozicion mjete të ndryshme për të indoktrinuar izraelitët, veçanërisht emigrantët e rinj, me kulturën dominuese të sigurisë. Kjo arrihet kryesisht me anë të rekrutimit të përgjithshëm. Meshkujt izraelitë të moshës 18-21 vjeç duhet të shërbejnë tre vjet në radhët e FMI, ndërsa femrat dy vjet, me disa përjashtime dhe veçanti.

Veç kësaj, pas rekrutimit, izraelitët duhet të qëndrojnë si rezervistë në radhët e FMI, duke u grumbulluar çdo vit për stërvitje, në disa raste deri në moshën 54 vjeç. Ky është një mjet shumë i fuqishëm, me anë të të cilit FMI ka depërtuar në shoqërinë civile dhe e ka brumosur atë me një ndjenjë kërcënimi të përhershëm dhe me nevojën për sakrificë, në emër të “sigurisë”. Duke qenë se shërbimi i FMI është i domosdoshëm për mirëqenien e shtetit dhe shërben për të hapur dyert e punëve civile të paguara mirë, shteti izraelit përdor mjetet ekonomike për të përforcuar më tej këtë indoktrinim. Ata të cilët janë të përjashtuar nga shërbimi i FMI, të quajtur arabë izraelitë, janë të dënuar të lënë kufijtë e shoqërisë izraelite dhe nuk mund të marrin pjesë në kulturën strategjike të shtetit si dhe të gëzojnë përfitimet që rrjedhin prej saj. FMI e propagandon imazhin e saj dhe futet në shoqërinë civile duke u angazhuar gjithashtu në aktivitete të ndryshme jo ushtarake, të tilla si argëtimet publike (p.sh. nëpërmjet *Army Radio- Radio Ushtria*).

⁶ A. Davutogllu, Turqia Thellësia strategjike, Logos-A, Shkup, 2010, f. 43-49.

⁷ J. Stoessenger, Përse kombet shkojnë në luftë, Tiranë, f. 348-349.

FMI merr një pjesë të jashtëzakonshme të ekonomisë dhe industrisë izraelite, rreth 16-20% të shpenzimeve qeveritare. Kjo pjesë është më e ulët se nivelet e mëparshme, të cilat arrinin në 40% në mes të 1980, por ende përfaqëson një nga mbrojtjet kombëtare më të kushtueshme në rang botëror.

Shteti ka rrënjësuar më tej kulturën strategjike me anë të formave të ndryshme të përkujtimeve ushtarake. Këtu përfshihen dhe ditët kombëtare për të përkujtuar luftën, shenjtërimin e varrezave ushtarake, paradat dhe shfaqjet e tjera ushtarake. Artistët izraelitë dhe media, tradicionalisht, e kanë mbështetur këtë përpjekje duke përdorur historitë, poemat, filmat dhe suplementet e gazetave për të nderuar heroizmin e ushtarëve izraelitë. Shteti ka përdorur, me ndërgjegje, simbole të tjera për të përforcuar kulturën e tij strategjike, të tilla si përzgjedhja e yllit të Davidit për flamurin kombëtar, si një lidhje mes shtetit të Izraelit dhe paraardhësit të tij në Tokën e Shenjtë. Ndër institucionet e tjera shtetërore që përforcojnë ndjenjën se Izraeli është nën kërcënim të vazhdueshëm dhe se tërë synimet kombëtare dhe ato personale duhet t'i nënshtrohen sigurisë kombëtare, është sistemi arsimor që ndihmon duke shërbyer si shkollë përgatitore për FMI dhe sistemin gjyqësor.

Ndër vite, këto përpjekje kanë krijuar një mbështetje dhe besim të konsiderueshëm në publik, në karakterin e sigurisë kombëtare të Izraelit. Pavarësisht fatkeqësive të saj të herëpashershme, FMI mbetet një nga institucionet më të respektuara të Izraelit⁸.

Subkulturat strategjike

Baruch Kimmerling, një studiues që përfaqëson “valën e tretë” të sociologëve izraelitë, ka identifikuar tre “rryma” brenda shoqërisë izraelite, kultura strategjike në thelb, të cilat kanë edhe të përbashkëta me besimet strategjike, por edhe ndryshime domethënëse. Këto janë “rryma për sigurinë”, “rryma për konflikt” dhe “themelet” apo “rryma për paqen”.⁹

“*Rryma për sigurinë*” beson se Izraeli ka mbetur i mbërthyer në një konflikt për mbijetesë me fqinjët e tij arabë dhe se një humbje më e madhe e ushtrisë izraelite do të çonte në asgjësimin e izraelitëve. Kryesore për të parandaluar këtë është superioriteti ushtarak absolut dhe i përhershëm i Izraelit në rajon.

“*Rryma për konflikt*” pretendon se konflikti izraelito-arab është thjesht një mishërim tjetër i anti-semitizmit historik. Për shkak të pozitës gjeopolitike aktuale, në një të ardhme të afërt, nuk duket të ketë zgjidhje paqësore me fqinjët e Izraelit. E influencuar dukshëm nga mendime realiste, ky grup beson se fuqia dhe forca ushtarake janë të vetmit faktorë që kanë vlerë në marrëdhëniet mes kombeve, etnive apo grupeve të besimeve të ndryshme.

“*Rryma për paqen*” është diametralisht e kundërt me “rrymën për konflikt”. Përkrahësit e saj e shikojnë konfliktin izraelito-arab, si çdo debat tjetër, të negociueshëm dhe të palidhur me persekutimet e izraelitëve në të shkuarën. Sipas

⁸ Luis Roniger, “Organizational Complexity, Trust, and Deceit in the Israeli Air Force,” in Daniel Maman, et al, eds., *Military, State and Society in Israel* (New Brunswick, NJ: Transaction Publishers, 2001), 371-372.

⁹ Baruch Kimmerling, *The Invention and Decline of Israeliness*, 208-228.

këtij këndvështrimi, paqja është rruga drejt zhvillimit të mëtejshëm të demokracisë, rritjes ekonomike dhe progresit kulturor të Izraelit.

Pavarësisht ndryshimeve, midis këtyre kulturave ka edhe ngjashmëri të rëndësishme. Të treja këto rryma perceptojnë një kërcënim real ndaj mbijetesës së Izraelit, si shoqëri e themeluar nga çifutët. Ato gjithashtu pranojnë se ushtria izraelite duhet të përqendrohet te mbijetesë. Në të vërtetë, ndjekësit e rrymës për paqen, përkrahin kthimin e territoreve të pushtuara, janë mbrojtës të flaktë të kapaciteteve bërthamore të Izraelit si mbrojtja e fundit për një shtet izraelit të vogël.

Nga këto tre grupime, “rryma për sigurinë” ka ofruar me efikasitet bazat e kulturës strategjike të Izraelit që nga fillimet e shtetit hebre.

Perceptimi i rrezikut

Në zemër të kulturës strategjike të Izraelit qëndron një perceptim i pandryshueshëm i rrezikut, pabarazia e madhe demografike përballë botës arabe (dhe pan-myslimanizmit në rritje).

Mendimet politike e ushtarake të Izraelit e ndajnë këtë makro kërcënim në një seri rrathësh koncentrikë që janë përgjithësisht gjeografikë për nga natyra (shih fig)¹⁰. Kërcënimi më i afërt është “rrethi palestinez”, i cili përfshin shtetasit palestinezë të Izraelit, si dhe palestinezët që jetojnë në territoret e pushtuara dhe në azil, në vende të tjera. Ky rreth i korrespondon “kërcënimeve të brendshme të sigurisë”, të cilat janë veprimtari kryengritëse dhe sulme të tipit guerrillas kundër objektivave ushtarake e civile izraelite, që burojnë nga brenda kufijve të shtetit.



Në rrethin tjetër, janë shtetet arabe, përfshirë këtu: Libanin, Sirinë, Jordaninë dhe Egjiptin. Këtu, kërcënimi perceptohet gjerësisht në termat e sulmeve të papritura përgjatë kufirit.

Përtej këtij rrethi qëndron mbarë bota arabe (Irak, Arabi Saudite, etj.) dhe myslimane (Iran, Pakistan). Tradicionalisht, kjo botë është parë nga Izraeli si kërcënim i largët, por përdorimi i raketave me rreze të gjatë nga *Saddam Hussein* kundër Izraelit në Luftën e Gjirit Persik, në 1991, bëri që Izraeli të vlerësojë edhe kërcënimin që vjen nga kjo botë.

¹⁰ Baruch Kimmerling, “The Social Construction of Israel’s ‘National Security,’” in Stuart Cohen, ed., *Democratic Societies and Their Armed Forces: Israel in Comparative Context* (London: Frank Cass, 2000), 221-222. See also, Rueven Gal, “The Israeli Defense Forces (IDF): A Conservative or Adaptive Organization?,” in Maman, et al, opcit., 364.

Domosdoshmëria e dhunës dhe Ligji i Luftës

Shteti, duke vepruar nëpërmjet sistemit të rekrutimit të përgjithshëm dhe shërbimit rezervist të FMI, ka krijuar në shoqëri një ndjenjë kërcënimi nga sulmet e befasishme, në kufijtë e fatalizmit. Ish-shefi i Shtabit të FMI, *Rafeal Eitan*, risjell në kujtesë momentin si e thirrën të kthehej në shtëpi nga jashtë kufijve, për të marrë pjesë në një aksion ushtarak: “*E di që jam kthyer në shtëpi...ka luftë. Nuk ankohe, çdokush ka fatin e tij.*”¹¹ Komentet e *Eitan* ngjallën besimin e gjerë në Izrael për paevitueshmërinë e luftës, në harmoni me përpjekjet historike të Judaizmit për të mbijetuar në një ambient armiqësor.¹²

Ndërkohë që lufta duket e paevitueshme në sytë e izraelitëve, ajo nuk është, në asnjë mënyrë, e dëshiruar apo, nëse përdorim formulimin Klauzeviçian,¹³ thjesht një vazhdim i politikës me mjete të tjera.

Duke qenë se lufta është një fenomen shumë negativ në Judaizëm, izraelitët kanë zhvilluar një pikëpamje që transferon përgjegjësitë për luftën te pala që e nis atë. Në thelb, çifutët izraelitë kanë pranuar si pjesë të kulturës së tyre strategjike, dallimin biblik mes luftërave që janë të nxitura nga shteti (të detyrueshme) dhe atyre që janë të ndërmarra nga drejtuesi (fakultative). Përgjithësisht, izraelitët i cilësojnë luftërat e tyre deri më sot si “të detyruara”, me përjashtim të luftërave të vitit 1982 dhe vitit 2006 në Liban.

Studiuesit izraelitë hartuan një dallim me më shumë ngjyrimë, duke përfshirë edhe luftërat “mbrojtëse”, kur armiku “godet i pari”; luftërat “parandaluese” të cilat bëhen për të shkatërruar kërcënimet e mundshme të kundërshtarit dhe luftërat “në përparësi” të cilat kryhen për t’i paraprirë agresionit të menjëhershëm të kundërshtarit. Në lidhje me këtë, ata i karakterizojnë luftërat e viteve 1948, 1969-70, dhe të 1973, thjesht mbrojtëse; luftën e 1956 si parandaluese dhe luftën e 1967 si paraprirëse.¹⁴

Përpjekjet për t’i brumosur ushtarët izraelitë me standarde të larta etike janë institucionalizuar përmes shefit të arsimit të FMI, me gradë Gjeneral Brigade, rabinëve ushtarakë, etj. Siç përmendet në faqen e internetit të FMI, ushtarët e FMI do të veprojnë në përputhje me vlerat dhe urdhrat e FMI, duke iu përmbajtur ligjeve të shtetit dhe normave të dinjitetit njerëzor dhe do të nderojnë vlerat e shtetit izraelit si një shtet hebre dhe demokratik.¹⁵

Ndër këto vlera është dhe koncepti i “pastërtisë së armës”, i cili mbështetet në origjinat e FMI¹⁶. Refuzimi i prerë i disa pilotëve të Forcave Ajrore të Izraelit për të lëshuar

¹¹ Quoted in Efraim Inbar, “The ‘No Choice War’ Debate in Israel,” *Journal of Strategic Studies*, March 1989, 23

¹²Ibid., 23-24.

¹³ Në një fjalim drejtuar oficerëve madhorë të FMI, Kryeministri Menachem Begin deklaroi se: Thënia e famshme e Klauzeviç se lufta është vazhdim i politikës me mjete të tjera nuk ka vend në realitetin e sotëm...Shih dhe Quoted in Inbar, op cit., 33. Clausewitzian thought was further discredited in Israel due to its association with extreme rightist politicians.

¹⁴ Inbar, op cit., 23. Ben-Dor, op cit., 47-49.

¹⁵ Official IDF website: <http://www1.idf.il/DOVER/site/mainpage.asp?sl=EN&id=32>

¹⁶ Ushtarakët meshkuj e femra të FMI do të përdorin armët dhe forcën e tyre vetëm për qëllimin e misionit të tyre, vetëm në masën e nevojshme dhe do të mbajnë humanizmin e tyre edhe gjatë luftimit.

bombat gjatë luftës së vitit 1982 në Liban për shkak të rrezikimit të civilëve, është në përputhje me këtë vlerë.¹⁷

Në fund të 1980-ës, shoqëria civile izraelite u bë më pak respektuese ndaj ushtrisë. Kjo çoi në një valë gjyqesh civile në Izrael për “akte shmangieje”, të kryera nga oficerët dhe ushtarët, veçanërisht ata të elitës “*Mistarvim*” (njësi speciale sulmuese), gjatë *Intifadës*.¹⁸

Më herët, një ekip profesorësh izraelitë, komandantësh dhe ish-gjyqtarësh, hartuan një kod drejtimi ndaj sfidave specifike të luftimeve me intensitet të ulët. Njësitë e rregullta dhe ato rezerviste të FMI janë trajnuar me njëmbëdhjetë rregullat e të vepruarit, të cilat plotësojnë “shpirtin” dhe “vlerat” e ushtrisë.

Përfundime

Analizat tona mbështesin dhe afirmojnë këndvështrimin se kultura, në pamjet e saj publike, strategjike dhe ushtarake organizative është tejet e rëndësishme.

“Këndvështrimet kulturore” të miqve, kundërshtarëve dhe sigurisht të vetes tonë, mund të kenë një efekt drejtues ose formues ndaj vendimeve dhe sjelljes. Në vitin 1972, *Ken Booth* argumentoi se “*Studimet strategjike, të ndara nga zona e studimeve, janë të kota. Neglizhimi i përgjithshëm i zonës së studimeve është një nga kritikantët e cilat mund të ngrihen kundër strategjive*”.

Nevojat për studimin e teorisë dhe realiteti i kudogjendur i kulturës, fatkeqësisht janë me probabilitet të lartë. Kjo nuk ka rëndësi për kuptimin e kulturës strategjike, por mund të jetë fatal për praktikitetin e strategjisë. Mungesa e vullnetit strategjik, bën që drejtuesi apo komandanti të silltet nën hijen e strategjive të tjerëve. Për të s’ka përvoja historike, po “faturë” historike. S’ka potencial strategjik dhe pasuri të gjeografisë së vet, por shanse për t’iu afruar aktorëve të lojërave të mëdha. Në të vërtetë, ndryshimi i gjeografisë dhe i historisë si elementë konstantë, është i pamundur pa elementin njeri, që realizon planifikimin dhe vullnetin strategjik. Nëse i referohemi analizës së fuqisë të *D. Jablonskit*¹⁹, bindemi se planifikimi dhe vullneti strategjik janë faktorë shumëzues të fuqisë kombëtare.

Kultura ka shumë rëndësi. Po kështu, kanë rëndësi dimensionet e tjera të luftës, paqja dhe strategjia. Roli i institucioneve, sidomos i Akademive Ushtarake është i pazëvendësueshëm për studimin e dijeve të kulturës strategjike. *Sir John Polkinghorne* i *Queens’s College* të Britanisë së Madhe, në simpoziumin ndërkombëtar “Vlerat universale dhe problemet e kohës sonë”, 2004²⁰, jep këtë panoramë për dijen dhe

Ushtarët e FMI nuk do të përdorin armët dhe forcën në dëm të njerëzve të cilët nuk janë luftëtarë apo të burgosur lufte dhe do të bëjnë gjithçka që mundën për të shmangur shkakimin e dëmeve ndaj jetës, trupit, dinjitetit dhe pronës së tyre.

¹⁷ Anthony H. Cordesman and Abraham R. Wager, *The Lessons of Modern War, Volume I: The Arab-Israeli Conflicts, 1973-1989* (Boulder, CO: Westview Press, 1990), 113-114.

¹⁸ Peri, op cit., 112-114.

¹⁹ D. Jablonski, *Guidë e Strategjisë së Sigurisë*, Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, Tiranë, 2009.

²⁰ Sir Polkinghorne, John, “Vlerat universale dhe problemet e kohës”, *International Symposium Proceedings*, Academy of Athens, 2004.

kërkimin: “Na është thënë se fjalët “Njih Vetveten” ishin shkruar në muret e tempullit të Delfit si një mesazh nga perënditë. Na duhet t’iu shtojmë këtyre fjalëve një urdhër të urtë “Të njohim botën”. Universitetet dhe Akademitë vazhdojnë të jenë shprehjet e institucionalizuara të vlerës universale të njohurisë. Këto organizma janë gjithashtu burime të njerëzve të përgatitur që mendojnë qartë, një aftësi që padyshim shkon në dobi të shoqërisë. Sidoqoftë krijimi i personelit të përgatitur është thjesht një produkt dytësor i jetës akademike. Qëllimi kryesor i ekzistencës së institucioneve akademike është zbulimi, ruajtja dhe komunikimi i njohurive”.

Bibliografia:

- Domenique Volton, Të shpëtojmë komunikimin, Tiranë, 2009.
- The Third World, Peter Worsley, London, 1967.
- Zyhdi Dervishi, “Sociologji Kulture I”.
- Sociologjia, Anthony Giddens, Polity Press Çabej, 2007.
- Davutogllu, Turqia Thellësia strategjike, Logos-A, Shkup, 2010.
- J. Stoenssenger, Përse kombet shkojnë në luftë, Tiranë.
- Luis Roniger, “Organizational Complexity, Trust, and Deceit in the Israeli Air Force,” in Daniel Maman, et al, eds., *Military, State and Society in Israel* (New Brunswick, NJ: Transaction Publishers, 2001).
- Baruch Kimmerling, *The Invention and Decline of Israeliness*.
- Baruch Kimmerling, “The Social Construction of Israel’s ‘National Security,’” in Stuart Cohen, ed., *Democratic Societies and Their Armed Forces: Israel in Comparative Context* (London: Frank Cass, 2000), 221-222. See also, Rueven Gal, “The Israeli Defense Forces (IDF): A Conservative or Adaptive Organization?,” in Maman.
- Quoted in Efraim Inbar, “The ‘No Choice War’ Debate in Israel,” *Journal of Strategic Studies*, March 1989.
- Official IDF website: <http://www1.idf.il/DOVER/site/mainpage.asp?sl=EN&id=32>
- Anthony H. Cordesman and Abraham R. Wager, *The Lessons of Modern War, Volume I: The Arab-Israeli Conflicts, 1973-1989* (Boulder, CO: Westview Press, 1990).
- D. Jablonski, Guidë e Strategjisë së Sigurisë, Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, Tiranë, 2009.
- Sir Polkinghorne, John, “Vlerat universale dhe problemet e kohës”, International Symposium Proceedings, Academy of Athens, 2004.

Formimi i UÇK-së dhe roli i saj në çlirimin e Kosovës

Gjeneral Brigade Bashkim Jashari

Trajtesë e shkurtuar. *Në aspektin gjeostrategjik dhe gjeopolitik gadishulli i Ballkanit është mjaft i rëndësishëm. Ai është udhëkryqi që lidh Evropën, Azinë dhe Afrikën. Kjo rëndësi shprehet qartë në fjalimin e ish-Presidentit Bill Clinton, se: “Kosova është një vend shumë i vogël, por ajo shtrihet pikërisht në vijën ndarëse të Evropës, Azisë dhe Lindjes së Mesme, është shenja ndarëse ndërmjet islamit dhe kristianizmit; pranë aleatëve tanë turq dhe grekë në jug, aleatëve tanë të rinj Hungarisë, Polonisë dhe Republikës Çeke në veri.”¹*

Lëvizjet çlirimtare të popullit të Kosovës

Historikisht, por në veçanti pas viteve 80-të, në Kosovë ekzistonte një frymë e përgjithshme proteste. Shqiptarët e Kosovës i kishin shpallur tashmë qëllimet politike dhe rrugët e arritjes së tyre. Për më shumë se një dekadë iu përmbajtën vendosmërisht rrugës së protestave paqësore, por autoritetet serbe, formave demokratike iu përgjigjën me anulimin e të gjitha institucioneve politike dhe kulturore të vetëqeverisjes krahinore, duke arritur deri në mosnjohjen e Kosovës si njësi federative shtetformuese, status që ajo e trashëgonte nga Kushtetuta e vitit 1974. Në vitin 1981, në Prishtinë, u zhvillua një nga manifestimet më popullore të asaj periudhe, i cili ishte vullnet i një populli të tërë për qëndresë paqësore. Me këtë manifestim të fuqishëm mbyllet edhe periudha e rezistencës paqësore dhe aktive e popullit të Kosovës.

Pas vitit 1989, Milosheviçi likuidoi përfundimisht autonominë e Kosovës. Zhvillimi i ngjarjeve në Serbi ecte në kah të kundërt me zhvillimet demokratike në Evropë. Kjo klimë e re demokratike pati ndikimet e veta dhe në Kosovë. Pjesa më e madhe e shqiptarëve u ngritën në një lëvizje të gjerë për demokraci, ku në krye të kësaj lëvizjeje u vunë intelektualët më të mirë dhe më në zë të Kosovës. Dëshpërimi se Kosova po mbetej nën sundimin e Serbisë nxiti pjesën më aktive të shqiptarëve të Kosovës të radikalizonin kërkesat dhe shumë shpejt u transformuan në një strukturë ushtarake, që sfidonte autoritetin e shtetit serb me paralajmërime serioze për një lëvizje gjithëpopullore.

¹ Prof. Dr. Pëllumb Danaj “NATO dhe Kosova”.

Rigrupimet politike që ndodhën në Kosovë në fillimet e viteve 90-të bënë që nisma e rezistencës paqësore dhe aktive të kalonte në duart e protagonistëve të rinj. Klasa e re politike ndërtoi programin e forcave të reja, duke premtuar se Republika e Kosovës do të formohej e do të njëhej nëpërmjet bisedimeve politike dhe me dialog. Ajo i bën thirrje popullit të Kosovës të ruajë gjakftohtësinë, të ketë durim, të besojë në *“institucionet paralele”*, të shmangë luftën, të ruajë traditat kombëtare, duke siguruar se një proces referendumi dhe vetëvendosjeje do të kurorëzonte së fundi shpresat e shqiptarëve për ndryshimin e statusit të tyre politik. Një ndikim pritës dha dhe faktori i jashtëm politik, i cili mendonte se problemi shqiptar do të zgjidhej me rënien dhe ndryshimin ideologjik në shkallë botërore, si dhe me demokratizimin e rendit politik në ish--Jugosllavi. Ishte pikërisht kjo periudhë, kur në Evropë dhe më gjerë mendohej se çështja shqiptare në Kosovë do të zgjidhej vetëm *“duke njohur barazinë e të drejtave të qytetarëve”*, pavarësisht nga përbërja etnike. Ndërsa në ish-Jugosllavi, pas paqes së Dejtonit, po rikthehej gjendja e një paqeje të tendosur, në Kosovë lëvizja e ngadalësuar pacifiste e humbi rëndësinë e saj të mëparshme. Zgjedhjet parlamentare të 22 marsit 1998 u kontestuan edhe nga faktorët e brendshëm në Kosovë.

Dhuna policore e ushtarake serbe, shkatërrimi i të gjitha institucioneve shqiptare, zhgënjimi prej rrugës paqësore dhe humbja e shpresës të faktori ndërkombëtar për zgjidhjen e çështjes kosovare, bënë që në vitin 1998 në Kosovë të shpërthente një lëvizje popullore me karakter çlirimtar.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)

Në mjedisin politik shqiptar të Kosovës qysh nga fundi i viteve ‘91 dhe fillimi i viteve ‘92, sido që me përhapje relativisht të vogël, ka qenë e pranishme një lëvizje me karakter çlirimtar. Njësitë e para të armatosura u shfaqen pas kthimit të Komandantit Legjendar Adem Jashari me shokët e tij nga Shqipëria. Nga dhjetori 1991, Adem Jashari dhe shokët e tij fillojnë organizimin dhe zgjerimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në tërë territorin e Kosovës dhe pas këtij organizimi, fillojnë edhe aksionet guerile të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Skënderaj, ku më pas këto aksione u shtrinë edhe në Llap, Dukagjin dhe në tërë territorin e Kosovës, duke marrë përsipër përgjegjësinë e aksioneve luftarake kundër vendosjeve serbe në Kosovë.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës lindi në një moment historik për t’i dalë zot Kosovës, për çlirimin nga pushtuesit serbë dhe për të siguruar jetën e popullit të saj në trojet e veta shekullore. Menjëherë Beogradi e quajti UÇK-në *“forcë terroriste”* dhe një *“grupim separatistësh”*. Madje edhe në vetë qarqet politike të Kosovës, deri në vitin 1996, ekzistonte një klimë e përgjithshme mosbesimi për ekzistencën e saj. Për herë të parë emri i UÇK u përmend edhe në shtypin perëndimor, ku fillimisht ajo cilësohej si *“lëvizje individësh dhe atentatorësh të veçuar”*. Ndërsa në mjetet e informacionit serb, megjithëse UÇK-ja kishte marrë përsipër disa nga aksionet e saj, mohohej ekzistenca e saj.

Më 26 nëntor të vitit 1997, nën udhëheqjen e Adem Jasharit u zhvillua beteja në Rezallë të Re, ku forcat paramilitare serbe pësuan humbje të mëdha, dhe pas kësaj disfate, në ikje për Skënderaj, në fshatin Llaush, ata qëlluan mbi mësuesin Halit

Geci. Në ceremoninë e varrimit, për herë të parë, UÇK-ja doli hapur me uniformën e saj. Ushtria Çlirimtare e Kosovës lindi për t'i dalë zot Kosovës. Misioni i saj kombëtar ishte: shporrja me luftë të armatosur dhe pa kompromis i të gjitha forcave ushtarako-policore serbe nga trojet e Kosovës, rikthimi i lirisë dhe i krenarisë së humbur të çdo qytetari dhe ndërtimi i një shteti demokratik e ligjor të standardeve evropiane në të ardhmen. Nga ana tjetër, pushteti serb filloi të kundërveprojë me forca të milicisë e forca speciale kundër UÇK-së, duke kryer operacione ndëshkuese, sidomos në rajonin e Drenicës.

Më datat 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, Drenica ishte rrethuar nga forcat serbe me 5 mijë trupa dhe artileri të rëndë, tanke, topa dhe helikopterë. Pothuajse të gjitha këto forca atë ditë ishin të drejtuara në Prekaz, me qëllim shfarosjen e familjes së Adem Jasharit. Pas një qëndrese heroike dhe luftimesh të rrepta, pas 72 orësh, ranë heroikisht Adem Jashari me 20 anëtarë të familjes, ndërsa në lagjen Jasharaj ranë gjithsej 54 vetë.

Vrasja e Adem Jasharit shënoi pikën kulmore të rritjes së shpejtë e të menjëhershme të UÇK-së, e cila tashmë nga njësitë e formacionet e vogla, kaloi në formacione të mëdha luftarake. Duke qenë nën presion shumë të madh nga propaganda serbe e cila e quante atë, herë *“organizatë terroriste”*, herë *“marksiste”* dhe herë *“fondamentaliste”*, në maj të vitit 1998 u mor vendimi për krijimin e Drejtorisë Politike të UÇK-se, e cila do të ishte edhe busulla e kësaj ushtrie. Duke parë me vëmendje kronologjinë e ngjarjeve të mëvonshme, do të vëmë re se udhëheqja politike e UÇK-së kreu me sukses katër detyra mjaft të rëndësishme, të cilat do t'i jepnin një shtytje jo vetëm opinionit brenda vendit, por do të sensibilizonin dhe faktorin ndërkombëtar, si:

- Paraqitjen e misionit të saj si ushtri e rregullt.
- Bindjen e faktorit ndërkombëtar, se UÇK nuk ishte ashtu siç e paraqisnin qarqet serbe.
- Sigurimin e mbështetjes së mundshme nga Shqipëria duke shmangur përfshirjen e Shqipërisë në luftë.
- Sigurimin e mbështetjes Evropiane dhe të NATO-s me SHBA-në në krye. Në qershor 1999 në Junik, Ricard Hollbruk u takua me përfaqësues të UÇK-së, ky ishte edhe një moment historik për vetë UÇK-në, i cili shënon edhe njohjen e saj nga SHBA. Më tej, pas takimit të 6 nëntorit të vitit 1998 me Kristofer Hill (në atë kohë Ambasadori i SHBA në Maqedoni), Amerika dhe faktori ndërkombëtar e vlerësonin UÇK-në si një partner serioz në bisedimet për zgjidhjen e çështjes kosovare.

Veprimtaria rezultative në terren, veprimtaria diplomatike e politike, si dhe mbështetja e pandërprerë e SHBA-së, sollën Rambujenë. Në këtë proces të vështirë e intensiv një rol të padiskutueshëm në njohjen e UÇK-së kanë luajtur SHBA me diplomatët e saj. Aq i fuqishëm ka qenë roli i SHBA-së dhe në mënyrë të veçantë, i zonjës Ollbrajt në këtë luftë, saqë operacioni i NATO-s në Kosovë shpesh u quajt nga shtypi i kohës edhe *“Operacioni Ollbrajt”*.

Në fjalët e Gjeneralit amerikan Uesli Klark dallohet lehtë se si po ecte UÇK-ja, kur ai theksonte: *“Në kohën kur përpjekjet diplomatike po lëviznin përpara, unë me*

*komandantët po përcillnim se si javët e fundit Ushtria Çlirimtare e Kosovës ngadalë po ringjallej*².

Presidenti Klinton ka shprehur hapur simpatinë dhe vlerësimin e tij për UÇK-në, kur thotë: *“Megjithëse Millosheviçi ka dëbuar me qindra e mijëra shqiptarë kosovarë nga shtëpitë e tyre, ai nuk ka mundur të eliminojë UÇK-në. Madje radhët e saj po shtohen dita-ditës, ajo ka filluar të ndërmarrë ofensiva kundër forcave serbe, të cilat fshihen skutave për t’u shpëtuar goditjeve*³.

Dalja e UÇK-së në këtë moment shfrytëzohet nga politika serbe për të justifikuar para faktorit ndërkombëtar, mbajtjen e Kosovës nën një tryzni të ashpër ushtarake dhe policore, si dhe për ta patur si pretext për të mos u ulur në tavolinën e bisedimeve me përfaqësuesit legjitimë të shqiptarëve të Kosovës. Deri në mesin e viteve 1998, UÇK-ja kontrollonte gati 80% të territorit të Kosovës. Në luftë e sipër ajo bashkoi vullnetarizmin popullor me përpjekje të suksesshme për përgatitjen dhe veprimet luftarake jo vetëm në shkallë taktike e operative, por edhe në shkallë strategjike. Tashmë, e parë në këndvështrimin strategjiko-politik, UÇK-ja ishte përcaktuar për *“luftë të armatosur dhe pa asnjë kompromis në çlirimin e Kosovës”*. Ajo vijoi të organizohej në shumë njësi të reja, brigada dhe zona operative dhe në të gjitha nivelet u krijuan komandat eprore. Gjatë kësaj periudhe u afirmuan aftësitë komanduese të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe hap pas hapi u krijuan shërbimet e specializuara, duke përfshirë Policinë Ushtarake dhe Drejtorinë Politike të Ushtrisë.

Brigada ishte njësi bazë e UÇK-së në përbërje të së cilës kishte 800-1000 luftëtarë. Në strukturën organizative të saj ishin komandanti, zëvendëskomandanti, shefi operativ, i zbulimit, i personelit, i informacionit, i stërvitjes, i punëve publike dhe shefi i komunikimit të mbrojtjes.

Çdo gjë ishte e centralizuar dhe zbatohet në bazë të kompetencave dhe hierarkisë ushtarake. Me probleme të rëndësishme politiko-ushtarake merrej Shtabi Qendror (i Përgjithshëm) i UÇK-së, i përbërë prej 16 vetash dhe i organizuar me pesë drejtori kryesore, prej të cilave më me influencë ishte Drejtoria Politike.

Në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së përfshiheshin: Drejtoria e Personelit, e Shërbimit Informativ, Operative, e Logjistikës, e Marrëdhënieve Publike dhe Administratës Civile, e Komunikimit dhe Ndërlidhjes, e Financës dhe Ekonomisë, e Informimit Publik dhe Policisë Ushtarake. Në përbërje të SHP ishin dhe 7 Zona Operative: zona e Drenicës, Pashtrikut, Dukagjinit, Llapit, Shalës, Nerodimës dhe Karadakut.

Në fund të muajit maj 1998, pas mobilizimit me forcë të trupave rezerviste, Beogradi urdhëroi një *“mësymje të përgjithshme”* kundër UÇK-së, me objektiv që *“brenda dy-tre javësh”*, ta zhdukte përfundimisht atë. E ndodhur në një situatë të tillë, e paarmatosur mirë për të përballuar një mësymje frontale, që mund të ishte me pasoja katastrofike për të dhe fatet e Kosovës, UÇK-ja mori një vendim të pjekur ushtarak, *tërheqjen me luftim nga disa pozicione të përparuara për të kaluar më në thellësi,*

² Wesley K. Clark, Waging Modern War.

³ Prof. Dr. Pëllumb Danaj “NATO dhe Kosova”.

duke ruajtur kështu forcat dhe mjetet dhe riorganizimin e saj për luftime pasardhëse. Shumë shpejt dhe me hapa të sigurt, UÇK-ja krijoi edhe mbështetjen e saj logjistike, duke e vlerësuar atë si shumë të rëndësishme dhe kyçin e sukseseve. Roli i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë luftës ishte tepër i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm si për fillimin e fushatës ajrore të Aleancës, ashtu edhe për zhvillimin dhe përfundimin me sukses të saj. Merita e parë më e madhe e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte dalja e saj hapur në luftë kundër regjimit serb, si një drejtuese luftarake e organizuar e popullit shqiptar të Kosovës, duke luajtur një rol të madh në ngritjen e ndjenjës kombëtare dhe në kurajimin e popullit të Kosovës për kundërshtimin e regjimit diskriminues të Millosheviçit. Dalja hapur e saj ishte një domosdoshmëri historike dhe një moment vendimtar për t'i dalë zot Kosovës. Organizimi dhe rritja e saj e përditshme e detyruan regjimin serb të tregojë fytyrën e vërtetë brutale, duke ndikuar në sensibilizimin e komunitetit ndërkombëtar.

UÇK-ja u bë faktori themelor i ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës. Ajo përballoi me sukses të gjitha operacionet e spastrimit të ushtrisë serbe për çlirimin e Kosovës, për të mbrojtur dhe siguruar jetën e popullit, si dhe për të patur një jetë të lirë e me dinjitet njerëzor; detyra këto dhe për një ushtri të rregullt. Ajo u fuqizua dalëngadalë në mesin e viteve '90 dhe, megjithëse nuk arriti të bëhej një sfiduese madhore ushtarake, sulmet e saj kundër forcave serbe të sigurimit u bënë irrituese për Millosheviçin.

Në shkurt 1998 forcat serbe kryen një sulm barbar në rajonin e Drenicës. Disa anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjet e tyre u vranë në përpjekje për t'u bërë ballë forcave policore serbe. Megjithëse të pabarabartë në të gjitha drejtimit, sulmet e luftëtarëve të UÇK vazhduan gjatë gjithë pranverës së vitit 1998. Me fillimin e fushatës ajrore kundër Millosheviçit, ushtria serbe, krahas fillimit të spastrimit etnik, filloi po kështu edhe një ofensivë të gjerë dhe me forca të shumta kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke deklaruar se do ta eliminonte atë brenda 5-6 ditësh. Një objektiv të tillë ushtria serbe nuk e arriti asnjëherë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës i rezistoi sulmit të parë serb dhe, ndërsa fushata ajrore përparonte, ajo vazhdonte të rritej, organizohej dhe sulmonte pandërprerë forcat serbe.

Cordesman (analist ushtarak) shkruan se: *“Ashtu si shumë fuqi të mëdha që mendojnë se mund të fitojnë shpejt një luftë me intensitet të ulët kundër një armiku të dobët, por politikisht të motivuar, Serbia mësoi se jo vetëm që nuk mund ta mundte Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës brenda 5-6 ditësh, siç i kishte premtuar komanda e lartë ushtarake serbe Millosheviçit, por nuk mund ta mundte atë kurrë”*.⁴ Nga shumë studiues pranohet se gjatë fushatës ajrore të NATO-s kundër Millosheviçit, Ushtria Çlirimtare e Kosovës jo vetëm që ishte aleate e NATO-s, por edhe realizoi misionin e saj si forcë tokësore e Aleancës. Në radhë të parë ajo ndihmoi NATO-n në sigurimin e të dhënave për objektivat që do të goditeshin, si dhe të dhëna të tjera zbulimi mbi lëvizjet dhe dislokimin e forcave serbe.

Bashkëpunimi i UÇK-së me NATO-n u vu re, në mënyrë të veçantë, me fillimin e mësymjes së UÇK-së në malin e Pashtrikut, ku NATO siguroi asistencën e saj

⁴Cordesman, A.H.: The lessons and non-lessons of the air and missile war in Kosovo <http://www.csis.org/kosovo/Lessons Brief.pdf>.

nëpërmjet sulmeve ajrore kundër forcave serbe që vepronin në këtë rajon. Aviacioni i NATO-s ishte mbështetja ajrore e Brigadës që sulmoi në këtë rajon. Drejtuesit e lartë ushtarakë të NATO-s e quajtën të rëndësishëm këtë sulm dhe e mbështetën atë. Duke folur për këtë sulm, gjenerali Klark, Komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë, thotë se: “*unë e kuptova plotësisht se çfarë do të thoshte për ne sulmi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nëse ajo do të ishte e suksesshme, ajo do të tërhiqte disa batalione serbe në fushë të hapur, ku ne mund t’i sulmonim*”⁵. Nga ana tjetër, mbajtja nga UÇK-ja, e Malit të Pashtrikut dhe e lartësive të tjera përgjatë kufirit Shqipëri-Kosovë, shikohej nga NATO si shumë e rëndësishme për sigurimin e futjes në luftim të forcave tokësore të Aleancës në të ardhmen, nëse një gjë e tillë do të ishte e nevojshme. Kjo pranohet edhe nga gjenerali Klark.

Zbatimi i parimeve të luftës nga UÇK-ja

Ushtria Çlirimtare e Kosovës u organizua mbi bazën e traditave luftarake të popullit shqiptar, si dhe përvojën e luftës partizane. Duke parë epërsinë e madhe të forcave serbe, si formë kryesore të luftës zgjodhi luftën partizane, duke zbatuar më së miri taktikat “*godit dhe largohu*” dhe “*kap pozicione dhe mbaji ato*”. Nëpërmjet kësaj taktike u bë e mundur të kapërcehej epërsia e armikut në forca dhe teknikë luftarake, të ruheshin forcat e veta, të forcohej besimi dhe në veçanti të përmirësohej niveli i drejtimit e komandimit.

Me përgjegjësi u përcaktuan saktë *objektivat strategjike* që do të arriheshin, të cilat duhet të ishin të qarta e të detajuara. Në të njëjtën kohë u bë e qartë ajo çka do të arrihej, humbjet e mundshme të vet UÇK, si dhe dëmet që do ti shkakttoheshin armikut. Zbatimi i *manovrës tërheqëse* me luftim ishte një nga epërsitë kryesore taktike të UÇK-së. *Terreni dhe veprimet* natën ishin aleati kryesor i tyre, sidomos në fillimet e para të luftimeve.

Bindja e palëkundur në fitore ishte një nga arsyet kryesore që pjesëtarët e UÇK-së zhvilluan luftime të pabarabarta si në njerëz, armatim e teknikë luftarake.

Uniteti dhe vetëmohimi mes luftëtarëve, ku mjaft prej tyre kanë dhënë jetën për të shpëtuar shokun, si dhe uniteti me popullin, kanë qenë karakteristika kryesore të luftëtarëve të UÇK-së. Ndër faktorët themelorë që kushtëzuan suksesin e veprimeve luftarake të UÇK-së, padyshim ishte *disiplina* në radhët e tyre. Në librin e tij “*Kosova dhe Ushtria Çlirimtare*”, Gjeneral Lamaj shkruan: “*Nuk besoj të ketë pasur ndonjë ushtri që të ketë dashuruar aq shumë uniformën sa djemtë dhe vajzat e Kosovës. Kjo ushtri, në pikëpamje të disiplinës, kishte standarte të veçanta. Ajo ka dhënë shembullin dhe përvojën më të mirë, që kur nisesh të kryesh një detyrë, e cila është obligim dhe merret në sipërmarrje, duke u bërë pjesë e të përgjithshmes, disiplina është elementi më pak problematik, ose, aspak problematik*”...⁶Me fillimin e goditjeve ajrore të NATO-s, taktikat dhe mënyrat e luftimit të UÇK-së ndryshuan. Ajo dalëngadalë filloi të kthehej në një ushtri të rregullt, ku në duart e saj po merrte jo vetëm nismën taktike, por dhe atë operative e strategjike. Kështu shkallë-shkallë filloi ndërthurja e

⁵ Clark W., *Waging Modern War*.

⁶. “*Kosova dhe Ushtria Çlirimtare*” Gjeneral brigade në rezerve Kudusi Lama fq. 346-347.

taktikës së luftës partizane me atë frontale. Në zonat e Koshares, Pashtrikut, Llapushnikut, UÇK-ja ndërmori dhe operacione mësymëse për marrjen e këtyre territoreve dhe mbajtjen e tyre. Në zonën e Koshares për mbajtjen e korridorit Shqipëri-Kosovë janë zhvilluar luftime të vazhdueshme mbrojtëse e gërshetuar kjo me kundërsulme të shpeshta nga UÇK-ja për marrjen e territoreve të pushtuara.

Taktika e luftës frontale nuk u përdor në një front të pashkëputur dhe nuk u bazua në mbështetjen e fuqishme me artileri, tanke, aviacion e të tjera, sepse ajo nuk i dispononte ato. *Përqendrimi i forcave* u arrit nëpërmjet një manovre të gjerë, e diktuar kjo nga ndryshimi i shpeshtë i gjendjes dhe objektit të sulmit, por dhe nga ndryshimi i shpeshtë i pozicioneve.

Sulmi përballë u gërshetua gjithmonë me *manovrën krahëmarrëse e shpinëmarrëse*. Vlen të theksohet se kjo manovër si rezultat i epërsisë së forcave serbe në mjaft raste diktoi dhe kalimin në mbrojtje të përkohshme, për t'u përgatitur, pritur natën dhe pastaj kalimin në kundërsulme të fuqishme dhe mjaft rezultative.

Vijueshmëria në veprimet luftarake dhe asgjësimi i kundërshtarit pjesë-pjesë ishin parimet dhe rregullat më të rëndësishme të kësaj lufte. Ato gjetën zbatim pothuajse në të gjitha luftimet e zhvilluara. Luftimet e zhvilluara kryesisht ishin të nivelit taktik, por në ndonjë rast ato kaluan dhe në nivel operativ, siç ishin ato të Rahovecit të zhvilluara në 18-21 korrik 1998. Këto luftime shënuan *ballafaqimin e parë* dhe serioz të UÇK me forcat serbe. Këtu u përdor në mënyrë masive nga të dy palët zjarri mbështetës i artilerisë.

Drejtimi taktiko-operativ dhe strategjik i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ishte në lartësinë e duhur. Urdhrat dhe udhëzimet që dërgoheshin në komandat dhe shtabet vartëse studioheshin dhe vlerësoheshin drejt. Me gjithë meritat e padiskutuara, ajo pati dhe probleme, ku nga analiza e thellë e tyre duhet të nxirren mësim: mënyra e *organizimit ushtarak* me struktura jo të qëndrueshme e solide, përgatitja e pamjaftueshme për luftimet bazë si ato mbrojtëse e mësymëse, defektet gjatë planëzimit e zbatimit të vendimit, mungesa e njohurive të mjaftueshme për artin e luftimit dhe armët që merreshin në përdorim, ishin disa nga mangësitë e luftëtarëve të UÇK-së. Po ashtu, ajo nuk mundi dhe nuk vendosi dot struktura solide komandimi, si dhe sistemin e nevojshëm të drejtimit e komandimit të forcave. Me gjithë këto probleme që ekzistonin në radhët e UÇK-së, me plot gojën mund të themi se roli i saj ishte determinues dhe shumëplanësh, pasi ajo brenda një kohe të shkurtër, i riktheu popullit të saj vetëbesimin dhe dinjitetin kombëtar.

Veprimet e faktorit ndërkombëtar dhe NATO-s

Operacioni "Forca Aleate" është modeli më domethënës i luftës së sotme, i ndryshimeve thelbësore që ka pësuar ajo në të gjitha drejtimet. Ai përfaqëson një luftë unike, e para dhe e vetmja që ka zhvilluar Aleanca Euroatlantike, luftë që tregoi fuqinë e saj, karakterin e saj demokratik dhe human, vendosmërinë e saj për dënimin e dhunës, terrorizmit shtetëror e genocidit, si dhe vërtetoi në praktikë nevojën e qëndruesës së NATO-s, pas dilemës mbi ekzistencën e saj me përfundimin e Luftës së Ftohtë.

- Vështirësitë për arritjen e konsensusit nga faktori ndërkombëtar dhe brenda vetë Aleancës

Më 27 dhjetor 1992, administrata e presidentit Bush e paralajmëronte Millosheviçin se: *“në rast të një konflikti në Kosovë, të shkaktuar nga forcat serbe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përgatiten për angazhimin e forcës ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe në vetë Serbinë”*.⁷

Paralajmërimin amerikan dhe Komunitetin Ndërkombëtar, Millosheviçi asnjëherë nuk i morri seriozisht, përkundrazi intensifikoi dhunën dhe represionin në Kosovë, duke çuar kështu në rritjen e revoltës së shqiptarëve, fillimin e luftës së armatosur dhe së fundi, në ndërhyrjen e NATO-s me operacionin “Forca Aleate”. Më 22 mars, në përgjigje të paralajmërimit, Millosheviçi vazhdoi represionin duke i bërë një sfidë të hapur përpjekjeve diplomatike amerikane e ndërkombëtare. Mbas këtij evoluimi të situatës, Këshilli i Atlantikut Veriut (NAC) i dha Sekretarit të Përgjithshëm Solana autoritetin të urdhërojë një operacion me faza. Më 23 mars Hollbruku iku nga Beogradi pa marrë ndonjë konsensus nga Millosheviçi. Solana urdhëroi Gjeneralin Klark të fillonte operacionin “Forca Aleate” mbi ish- Jugosllavi. Megjithatë, deri në fillimin e operacionit, Komunitetit Ndërkombëtar dhe NATO-s ju desh të kalonte shumë vështirësi që kishin të bënin, në radhë të parë, më arritjen e konsensusit brenda vetë Aleancës. Operacioni filloi pa mandatin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Rusia, si aleatja tradicionale e Serbisë, kundërshtoi fuqishëm ndërhyrjen ushtarake dhe pritej që ajo të vendoste veton në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Për të shmangur këtë situatë, NATO nuk e kërkoi mandatin e Këshillit të Sigurimit. Kjo shkaktoi shumë polemika dhe brenda vetë NATO-s për ligjshmërinë e operacionit. Angazhimi i NATO-s në këtë operacion u bë edhe një problem i brendshëm për secilin nga vendet anëtare. Opozita ushtronte presion ndaj qeverive përkatëse respektivisht për mungesën e strategjisë, mosefektivitetin e luftës, për koston, për futjen nga toka, për tërheqje të NATO-s etj, të cilat kishin ndikimin e tyre negativ. Futja e trupave nga toka ishte një tjetër bezdisje. Ndonëse përgjithësisht komponenti ushtarak mendonte se operacioni tokësor ishte i nevojshëm, qeveritë e vendeve të NATO-s, përfshi edhe atë amerikane, nuk kishin vullnetin dhe hezitonin mjaft. Arsyeja ishte frika nga opinioni vendas, i cili ishte shumë i ndjeshëm nga humbja e ushtarëve të vet, si dhe kostoja e lartë e këtij lloj operacioni.

William S. Cohen and Gen. Henry H. Shelton shprehën se duhet pranuar që arritja e konsensusit ndërmjet 19 vendeve demokratike nuk ishte e lehtë dhe mund të arrihej nëpërmjet diskutimeve dhe kompromisit. Sidoqoftë, Aleanca e NATO-s është gjithashtu forca jonë më e madhe. Ishte e vërtetë që ekzistonin diferenca brenda Aleancës. Kjo pritej në një aleancë të demokracive. Por në se NATO si një institucion nuk do t'i ishte përgjigjur kësaj lufte, kjo do të thoshte se Aleanca më e fuqishme e Botës nuk kishte vullnet të konfrontohej me rreziqe serioze të interesave të përbashkëta në pragun e saj.⁸ Ndërsa sipas ish- Komandantit Suprem të NATO-s, Gjeneral Eëslit Klark, në kanalet amerikane kishte predispozicion konstant për të injoruar rezervat e

⁷ Quotet in David Blinder, “Bush warns Serbs not to widen war” New York Times, December 28, 1992.

⁸ William S. Cohen and Gen. Henry H. Shelton, www.defenselink.mil

aleatëve dhe për të goditur objektiva që amerikanët donin të asgjësonin. Gjithmonë ishin amerikanët që këmbëngulnin për objektiva të reja më të ndjeshme, dhe po ashtu, gjithmonë do kishte aleatë që shprehnin dyshime dhe rezerva. Për administratën amerikane, që mezi priste përfundimin e operacionit dhe shmangien e problemeve të ndërhyrjes tokësore, këto rezerva padyshim ishin irrituese. Por megjithëse kishte diskutime në kanalet amerikane për goditje të njëanshme, ne asnjëherë nuk e bëmë. Ne gjithmonë kishim parasysh se asnjë objektiv i vetëm apo komplet objektivash nuk ishte më i rëndësishëm se kohezioni i NATO-s. Ky ishte vendimi më kryesor i fushatës dhe një nga mësimet më të rëndësishme për ruajtjen e unitetit, i cili i jepte çdo vendi të NATO-s përgjegjësi të pashmangshme për rezultatin.⁹ Në Nenin V të Traktatit të Uashingtonit (1949) përcaktohet qartë se: NATO futet në luftë, në rast se njëri prej anëtarëve të saj sulmohet. Kosova nuk ishte anëtare e NATO-s, atëherë çfarë e detyroi Aleancën të sulmonte Serbinë? SHBA dhe aleatët e NATO-s kishin tre interesa të forta gjatë luftës në Kosovë:

Së pari, siguroi se NATO mbetet e bashkuar dhe e fortë. Kjo u pa sidomos në Samitin e Uashingtonit ku të gjithë anëtarët e Aleancës demonstuan solidaritetin e tyre, duke i bërë të qartë kushtet të cilat do të ndërprisnin operacionin dhe njoftuan për një intensifikim të fushatës ajrore.

Së dyti, ndihma ndaj vendeve që prekeshin direkt nga kriza dhe moslejimin e konfliktit që të zgjerohej. Të gjitha vendet ku fluksi i refugjatëve mund të krijonte destabilitet u ndihmuan si financiarisht, ashtu edhe nga ana materiale. Në këtë mënyrë u shmangën problemet e përplasjet që mund të krijoheshin brenda shteteve fqinje.

Së treti, bashkëpunimi konstruktiv me Rusinë. Pavarësisht se fillimisht Rusia kundërshtoi fort operacionin, u arrit që të ruhej konstruktiviteti i marrëdhënieve dhe në fund, Rusia ra dakort të kontribuonte edhe me trupa në zbatimin e paqes. Sigurisht, një rol të madh luajtën edhe nevojat e mëdha të ekonomisë ruse për ndihmat e perëndimit. Kështu, mund të themi se edhe Rusia nuk ishte e interesuar të ndërpriste marrëdhëniet me NATO-n.

Përfundime

Ushtria Çlirimtare e Kosovës u organizua mbi bazën e traditave luftarake të popullit shqiptar, si dhe përvojën e luftës partizane.

Me përgjegjësi u përcaktuan saktë *objektivat strategjike* që do të arriheshin, të cilat duhet të ishin të qarta e të detajuara.

Bindja e palëkundur në fitore ishte një nga arsyet kryesore që pjesëtarët e UÇK-së zhvilluan luftime të pabarabarta si në njerëz, armatim e teknikë luftarake. Uniteti dhe vetëmohimi mes luftëtarëve, ku mjaft prej tyre kanë dhënë jetën për të shpëtuar shokun, si dhe uniteti me popullin, kanë qenë karakteristika kryesore të luftëtarëve të UÇK-së.

Me fillimin e goditjeve ajrore të NATO-s, taktikat dhe mënyrat e luftimit të UÇK-së ndryshuan. Ajo dalëngadalë filloi të kthehej në një ushtri të rregullt, ku në duart e saj

⁹ Wesley K. Clark, *Waging Modern War*, f.430

po merrte jo vetëm nismën taktike, por dhe atë operative e strategjike. Sulmi përballë u gërshetua gjithmonë me manovrën krahëmarrëse e shpinëmarrëse. Vijueshmëria në veprimet luftarake dhe asgjësimi i kundërshtarit pjesë-pjesë ishin parimet dhe rregullat më të rëndësishme të kësaj lufte. NATO, me konsensusin e plotë të vendeve anëtare, kreu dy operacione njëherësh:

Së pari atë luftarak, që konsistoi në mundësimin e kushteve për shndërrimin e Serbisë në një vend demokratik dhe vendosjen e paqes e të normalitetit në Kosovë.

Së dyti, atë humanitar, që parandaloi një katastrofë njerëzore për të shpërngulurit nga Kosova. NATO si ruajtës i paqes, stabilitetit dhe rëndit botëror, lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, më në fund i tha jo barbarisë serbe në Kosovë. Me këtë ndërhyrje të vendosur, NATO i tregoi gjithë botës se atje ku nëpërkëmben të drejtat e njeriut, ku bëhen spastrime etnike dhe ku njëra palë mohon etninë e palës tjetër vetëm se nuk flasin një gjuhë dhe janë të një besimi dhe etnie tjetër, ajo është e gatshme të bashkëpunojë e të kontribuojë në kuadër të një “Koalicioni të Vullnetit” në çdo rajon të botës, pavarësisht nga etniteti dhe besimi fetar. Për të ulur fuqinë ekonomike dhe ushtarake të Serbisë, aviacioni gjuajtës bombardues luajti një rol përcaktues, duke goditur objektivat deri në thellësinë strategjike të vendit, ku padyshim, niveli i lartë teknologjik i avionëve, raketave dhe bombave të përdorura ishin përcaktuese. Marrja e kompetencave të plota në qeverisjen e Kosovës dhe përmbushja e këtyre parakushteve, do ta përshpejtonin zgjidhjen e statusit final të Kosovës drejt pavarësisë.

Bibliografia:

- Çabej E. “Shqipëria ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes “ Tiranë 1998.
- Qosja R. “Çështja Shqiptare”, Tiranë 1998.
- Sinani Sh. “Kosova në gjeopolitikë”, Tiranë 1998.
- Sinani Sh. “Kosova në syrin e ciklonit”. Tiranë 1999.
- Kola H. “Genocidi serb ndaj shqiptarëve në viset e tyre etnike në Jugosllavi 1941-1967”, Tiranë 2000.
- Rizaj S. “Kosova dhe shqiptarët dje, sot dhe nesër” Prishtinë 1992.
- Malkolëm N. “Kosova një histori e shkruar”, Tiranë 2001.
- Dalema M. “Kosova italianët dhe lufta”, Tiranë 2004.
- Judah T. “Kosova luftë dhe hakmarrje”, Tiranë 2002.
- Cordignano F. “Lingua Albanese”, Milano 1931.
- Danaj P. “Kosova dhe NATO”, Tiranë 2005.
- Conte A. “Jalta dhe ndarja e botës”, Tiranë 1994.
- Detrez R. “Kosova, lufta e shtyrë”, Tiranë 2004.
- Mazoëer M. “Ballkani”, Tiranë 2003.
- Revista “NATO and partners”, Nr. 3, 2004.
- Revista “Kosovo one Year On”, Bruksel 2000.
- Lamaj K. “Kosova dhe Ushtria Çlirimtare” Tiranë 2005.
- Krasniqi J. “Kthesa e Madhe”.
- Clark W., Waging Modern War: Bosnia, Kosovo and the future of combat.
- New York: Public Affairs, 2001.

- Cordesman, A.H. The lessons and non-lessons of the air and missile war in Kosovo [http:// www.cisis.org/Kosovo/Lesson Brief.pdf](http://www.cisis.org/Kosovo/Lesson%20Brief.pdf).
- Cohen R.: Cooperative Security: From individual security to international stability. Marshal Center Papers, No 3, 2001
- Cohen W. and Shelton H.: Prepared joint statement on the Kosovo.
- Clark W.: Waging Modern War, US Public Affairs, Perseus Books Group, 2001.
- William S. Cohen and Gen. Henry H. Shelton www.defenselink.mil.
- Peter van Ham: Europe's New defense ambitions: implications for NATO, the US, and Russia. Marshal Center Papers, No 1, 2000.

Fillesat e Shtypit Ushtarak Shqiptar

Kolonel Dr. Zaho Golemi

Trajtesë e shkurtuar. *Për Shqipërinë e shqiptarët është shkruar nga historianë e albanologë, vendas e të huaj. Në fakt publikimet morën zhvillim në shek. XX dhe sidomos pas Shpalljes së Pavarësisë. Botime të karakterit ushtarak për luftërat, ishin shkruar dhe vazhdonin të shkruheshin, por të pjesshme, ku më tepër i jepej përparësi luftërave të popullit shqiptar për t'u çliruar nga sundimi osman, si dhe synimeve që kishin shtetet fqinje për aneksim të trojeve shqiptare.*

Ky boshllëk dhe kjo mungesë për botime ushtarake në hapësirën shqiptare po kompensohej me botime të pjesshme në disa vende të Ballkanit e të Evropës. Këto ishin shkrime në gazeta dhe revista në gjuhën shqipe nga patriotë dhe atdhetarë të diasporës shqiptare. Kështu, në vitet 1883-1887 arbëreshët e Italisë botuan në Kalabri, organin mujor “Flamuri i Arbërit”; ndërsa në vitet 1884-1885, patriotët Sami e Naim Frashëri në Stamboll, botojnë revistën mujore “Drita”, si dhe “Dituria”. Në Bukuresht botohet gazeta “Shqiptari”; në Sofje publikohej “Shqipëria”; në Bruksel Faik Konica në vitin 1897 boton gazetën “Albania”; në Beograd botohet “Kalendari i Kombit” e “Drita”; në Raguzë “Albania”; në Trieste e Romë “Shpresa e Shqypnisë”.

Gjithashtu, gazetat që luajtën rol të madh ishin edhe “Përlindja e Shqipërisë”, “Ylli i dritës”, “Populli”, “Koha e re”, “Vëllazërimi”, “Demokracia”. Revista e gazeta botoheshin edhe në Londër, në Boston të SHBA, në Kajro të Egjiptit etj. Që të gjitha kishin rol në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare.

Këto botime në fakt hynin, përhapeshin e lexoheshin edhe në Shqipëri. Ato luajtën një rol të veçantë në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare, në zgjerimin e lëvizjes çlirimtare dhe masivizimin e saj. Kështu, u bënë pjesë e ndikimit pozitiv në kryengritjet e mëdha të viteve 1908-1911 dhe në fitoren e pavarësisë e krijimin e shtetit shqiptar, më 28 nëntor 1912.

Botimet e kësaj periudhe përshkruajnë mjaft saktë heroizmin dhe trimërinë popullore, duke përcjellë traditën luftarake popullore, të pleksur me elemente të artit luftarak shqiptar të trashëguar në shekuj.

Moment i rëndësishëm për Shqipërinë ka qenë botimi në vitin 1906 i “Programit të çetave”. Kjo ishte një rregullore ku përcaktoheshin përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat

e kryetarit e të anëtarit të çetës dhe të vetë çetës. Kjo rregullore ushtarake mbushte një boshllëk të konsiderueshëm për kohën. Në rregullore shtrohej nevoja e disiplinës dhe e rregullit ushtarak, për zbatimin me fanatizëm të urdhrat të eprorit e të detyrave luftarake, duke hedhur kështu themelet për një organizim ushtarak sipas kohës dhe kushteve në vend. Fakt ishte gjithashtu se rregullorja e parë e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare mban datën 22 prill 1913. Kjo është me një faqe dhe ka 7 nene, që shprehin identitetin kombëtar shqiptar, pas një pushtimi të gjatë prej pesë shekuj nga Perandoria Osmane. Pas rregullores së parë ushtarake, në qershor të vitit 1913 kemi një tjetër rregullore të milicisë (xhandarmërisë) me tre faqe, por e shkruar në gjuhën osmane. Kopja gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit.¹

Duhet pranuar se terminologjia e përdorur në vitin e parë të Pavarësisë mbartte ndonjë orientalizëm të përdorur dhe që ka arritur deri sot në gjuhën shqipe.²

Krijimi i shteti të ri shqiptar dhe Ushtrisë Kombëtare Shqiptare e Shtabit Madhor, krahas problemeve të ngritjes së UKSH-së, bëri që të ngrihej edhe një Komision i Terminologjisë Ushtarake. Komisioni përfshinte personalitete me kulturë të gjerë ushtarake e gjuhësore, të cilët zotëronin gjuhë të huaja dhe njihnin mirë gjuhën shqipe.³

Fjalori ushtarak ishte “i lehtë”, sepse Shqipëria kishte një histori luftërash e betejash të shumta për liri dhe pavarësi kombëtare. Kështu, në gazetën “Liria e Shqipërisë” që botohej në Sofje, për herë të parë më 29 korrik 1913, në artikullin “Kufizat e ushtrisë”, u botua një listë me 26 terma shqip-turqisht. Botimi ishte një nisje e mbarë e terminologjisë ushtarake shqiptare, që u pasua edhe me botime të tjera të shkëputura brenda dhe jashtë vendit.⁴

¹ Kopje e Rregullores së milicisë (xhandarmërisë) me tre faqe në osmanllisht gjendet aktualisht edhe në Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura, Sektori i Dokumenteve Administrativë. Kjo kopje e rregullores është marrë nga AQSH më 21 mars 2009, në kuadër të 45 vjetorit të krijimit të AQFA-së.

² Këtu bëhet fjalë për terminologjinë ushtarake në fjalët: dylbi, fishek, bori, çizme, fitil zjarrpërcjellës, hendeklidhje, top, xhepa zjarri etj., që sigurisht ndryshonin nga terminologjitë ushtarake të gjuhëve ballkanike. Huazimet më të hershme janë zëvendësuar me fjalë nga brumi i shqipes dhe me terma neolatinë.

³ Personalitete të fushës së terminologjisë ishin Major Mustafa Maksuti (Shehu), Kapiten Kamber Sejдини etj., që bënë përpjekje serioze dhe punë të lavdërueshme për krijimin e termave ushtarakë shqip dhe për shqipërimin e kufizave të ushtrisë, siç i quanin ata, sepse momenti historik e kërkonte që edhe në fushën e termave të kishte origjinalitet, mëvetësi, rilindje. Komisioni terminologjik hodhi bazat e një terminologjie të re ushtarake të gjuhës shqipe në kuptimin e vërtetë të fjalës. Në vargun e termave të krijuara prej tyre bëjnë pjesë komanda ushtarake, emërtime të pjesëve të armëve, të veprimeve me zjarr dhe të organizimit ushtarak si: gatitu!, qetësohu!, eja në radhë!, tetësh (për skuadër), tog(ë), tubë, trumbë (për kompani), griq (për batalion), sogorië (për regjiment), ushtër (për gjeneral), deter (për admiral), epror, depror, gjilpërë, këmbëz (e shkrepjes), shënjestër, siguresë, klith (për bori) e klithtar (borizan), etj.

⁴ Në revistën “Zgjimi” të Korçës, në numrat 2, 3 të vitit 1913, u botua një listë me 315 terma e togefjalësha terminologjikë ushtarakë. Në vitin 1912 në Konstanca të Rumanisë u punua Fjalori i ushtrimeve ushtarake të emërtuar “Përvuajtjet vetmore” me 315 komanda dhe ushtrime stërvitore. Në Ushtrinë Mbretërore vijuan përpjekjet për pasurimin e mëtejshëm dhe kodifikimin e terminologjisë ushtarake. U botuan dy fjalorë të emërtuar: “Terminologji ushtarake”, shqip-shpjegues-italisht dhe italisht-shqip me rreth 700 terma, botuar në Tiranë, në 1932 dhe “Manual bisedimi me landë ushtarake” në shqip-italisht-sllavisht me 1350 fjalë e shprehje, botuar në Tiranë në vitin 1933.

Në Statutin themeltar të Mbretërisë shqiptare, në vitin 1928, në artikullin 197 të saj thuhej se: “Liria e fjalës dhe e shtypit është e garantuar, censura parandaluese nuk mund të vihet, përveç në kohë lufte, mobilizimi dhe në raste të jashtëzakonshme të tjera, të parashikuara prej ligjit. Kushtet mbi rregullimin e shtypit, konfiskimi i shtypshkrimeve dhe ndjekjet ligjore mbi gabimet e shtypit caktohen me ligj. Vetëm shtetasit shqiptarë mund të nxjerrin gazeta në Shqipëri”.⁵ Pas organizimit të shtetit mbretëror shqiptar, kemi për herë të parë të organizuar një shtyp ushtarak. Ai kishte strukturat e veta dhe përfshinte shtypshkronjën e vet, në strukturën e vitit 1929, e dokumentuar kjo në Fletoret Zyrtare të këtij viti.⁶

Pas pavarësisë shqiptare dhe në harkun kohor të këtyre dy dhjetëvjeçarëve u publikuan dhe botimet e para për Skënderbeun nga historianë e shkencëtarë si Fan Noli, Gega, Buda, Marinesku, Monti, etj. Historiani i shquar rumun Nikolla Jorga (1841-1940) u pushkatua nga policia fashiste. Ai ka zbuluar në bibliotekën *Laurentina* të Firences, dokumentin e parë të shkruar në gjuhën shqipe “Formulën e pagëzimit: (1462), të shkruar nga këshilltari dhe bashkëpunëtori i Skënderbeut, kryepeshkopi i Durrësit, Pal Ëngjëlli.⁷ Të gjithë këta botuan shkrime për heroin kombëtar, i cili ka qenë një prijës lufte dhe natyra e shkrimeve të tyre rrokte probleme të botës ushtarake dhe qëndresën e shqiptarëve përballë pushtuesve. Intensiteti i studimeve për gjeneralizmin e Skënderbeut në shek. XX është rritur shumë aq sa bibliografia e botimeve për veprën e tij arrin mbi 1.000 libra në 21 gjuhë të ndryshme të globit.

Vitet 1920-1924, në kushtet e shtetit të ri, të një lufte botërore, të përpjekjeve për konsolidim të shtetit, ishin vite të turbullta për shtetin e brishtë shqiptar, kështu që nuk pati ndonjë interes të veçantë në fushën e botimeve ushtarake.

Gjatë viteve 1920-1939 u hodhën hapa të rëndësishëm në ndërtimin dhe fuqizimin e strukturave shtetërore, çka mundësonte të vihen në themele më të organizuara edhe botimet ushtarake. Një numër rregulloresh, instruksionesh e tekstesh mësimore për trupa dhe për shkollat ushtarake ndikuan në ndërtimin e administratës, në rregullimin e jetës së brendshme të ushtrisë, në përgatitjen luftarake të reparteve e në kualifikimin e kuadrove.

Botimi i parë i shtypit ushtarak në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare ishte revista “Buletini dhe e përkohshmja ushtarake” që doli në 1 qershor 1931⁸ dhe pasuesja e

⁵ Sipas Statutit themeltar të Mbretërisë shqiptare i cili, bazuar në dokumente autentike të kohës, theksonte se “Kombi shqiptar, i lirë e kryelartë, me plot shpresa lumturie për kohën e ardhme, me dëshirë të patundshme e plot gjallëri për forcimin e përvetshëm të bashkimit kombëtar dhe për sigurimin e zhvillimit paqësor të Atdheut e të mirës së përgjithshme të popullit, duke respektuar traditat historike të kombit, të cilat pa dyshim i sigurojnë brezit të ardhshëm një mbarëvajtje të meritueshme, në Asamblenë e dytë Kushtetuese, më datë 1 dhjetor 1928, vendos dhe dekreton këtë Statut.

⁶ Fletore Zyrtare, Nr. 40, Vjeti X, Tiranë, e martë 30 qershor 1931. Në këtë fletore zyrtare është publikuar “Dekret Ligj mbi rregullimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare”. Krahas armëve e shërbimeve gjejmë për herë të parë në shtrirje organike edhe një shtypshkronjë ushtarake, bandë ushtarake, depo e përgjithshme, magazinë divizioni, bukëpjekëse ushtarake, etj.

⁷ Revista ushtarake, Nr. 1, viti 2004, Botim i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, f. 70.

⁸ “Buletini dhe e përkohshmja ushtarake” doli në 1 qershor 1931 dhe është botuar gjithsej 75 numra. Në vitin 1938 i njëjti botim nga njeri numër në tjetrin vijonte si vijimësi faqesh dhe që shtypej në

saj “Rivista ushtarake” në vitin 1937. Dalja e revistës së parë ushtarake ishte eveniment i kohës në jetën e Ushtrisë Mbretërore Shqiptare.

Po cila ishte tradita e dy dhjetëvjeçrëve, pas krijimit të Ushtrisë Kombëtare shqiptare? “Revista Ushtarake” nuk ishte përvoja e parë, sepse artikuj të ndryshëm për ushtrinë, organizimin, reformat, ideatorët, modernizimin, uniformat, armatimin, traditën etj., ishin të pranishëm në shtypin e kohës që në vend dhe jashtë hapësirës shqiptare, që me fillimin e shek. XX, ka qenë tepër aktiv. Megjithëse nuk botohej asnjë titull gazete, buletin apo revistë për ushtrinë dhe problematikën e saj, përsëri shkrimet rreth saj gjenin vend në shtypin e shkruar, brenda Shqipërisë dhe në diasporë.

Këto ndikuan në rrugën e gjatë luftarake të popullit për rritjen e vetëdijes kombëtare, si dhe përçuan traditat, përvojën dhe aftësitë luftarake të shqiptarëve në shekuj. Kjo qëndresë shqiptare do të zinte vend edhe në faqet e shtypit ushtarak shqiptar në vitet ’30 të shek. XX. Në gazetën “Përlindja e Shqipërisë” u publikuan veprat e Qeverisë së Vlorës, kryesuar nga Ismail Qemali dhe të intelektualëve shqiptarë, përfshi kolonitë e mërgimtarëve, si dhe të gjitha përpjekjet e para për ngritjen e ushtrisë kombëtare shqiptare, të Ministrisë së Luftës dhe të Shtabit Madhor. Thelbi, qëllimet dhe synimet e “Përlindjes së Shqipërisë” qëndrojnë tek mbrojtja e tërësisë territoriale shqiptare, që ishte njëherazi edhe zëdhënëse besnike e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, tribunë e lëvizjes shqiptare gjithëkombëtare.

Sikurse është e njohur, me krijimin e Mbretërisë Shqiptare u realizua organizimi i parë në fushën e botimeve ushtarake të shtypit ushtarak të shkruar, që synon në respektimin e traditave historike dhe sidomos ushtarake të kombit shqiptar. Dalja e botimit të revistës së parë ushtarake ishte jo vetëm ngjarje e rëndësishme për kohën, por edhe për jetën e vendit, sepse Ushtria Kombëtare ishte një ndër bazamentet më të rëndësishme të qeverisë për periudhën në të cilën kalonte vendi. Edhe zgjidhjet strukturore të vendit përballë *Fuqive të Mëdha* ishin mjaft komplekse kur dihet se, prej vitit 1913, u lanë jashtë trungut shqiptar pothuaj gjysma e trojeve etnike.

Në numrin e parë të “Revistës Ushtarake” ka pasur 8 rubrika që ishin me: Mesazhin e Naltmadhënisë së tij Mbretit; parathënia nga Gjeneral Xhemal Aranitasi; qëllimi i revistës nga drejtorja, shkruar nga nënkolonel *Enrico Grassi*; “Sa gëzim i madh” nga kolonel Akif Pashë Përmeti; “Disiplina” nga kolonel *Giusseppe Vitelli*; “Mbi stërvitjen” nga nënkolonel *De Michelis*; “Bashkëveprimi”, nga kolonel *S. Martino*; Pjesëtime shkrimesh të ndryshme nga nënkolonel *Vivaldi* dhe së fundi një rubrikë “Buletini” me tre faqe gjithsej dhe që kishte 34 emërime ushtarake në të gjitha llojet e armëve e shërbimeve.

Drejtor i revistës ishte italianin nënkolonel *Enrico Grassi*.⁹ Kështu, në ambientet ushtarake shqiptare po flitej edhe për shtypin ushtarak, ndërkohë që letërpunuesit

shtypshkronjën e fuqive armate. Revista ushtarake e përmuajshme bashkëshoqërohej nga maksima “vis unita fortior”, që do të thotë “United Strength is Stronger”, pra “bashkimi bën fuqinë”, (Shënim i autorit).

⁹ Një muaj më vonë në numrin 2, të “Buletinit dhe e përkohshmeja ushtarake”, që ka dalë nga botimi në 1 korrik 1931. Drejtori i saj ishte kolonel *Enrico Grassi*.

dhe libërlidhësit kishin filluar punë në Evropë, që në kohën e Gutenbergut në shek. XV.¹⁰

Në mesazhin e Mbretit Ahmet Zogu¹¹, në numrin e parë të saj, revista ndër të tjera shkruante se: “*Dy sende janë të nevojshme për me i dalë në krye kësaj pune: studimi që e ban të hollë mendjen dhe stërvitja që zhvillon kuptimin praktik. Atdheu, me therorët e tij, ju jep gjithçka asht e mundshme; asht detyra e juaj t’ia shpagoni dashtuninë dhe besimin e tij, tue u banun mësimtarë të zotë, në kohë paqeje e prijsa e trima në kohë lufte, me anë të studimit të papremë dhe të kujdesit me gjith’ zemër*”.¹² Dhe më poshtë vijon: “*Përgatisni mendjen e juaj me zell, me besë e me qëndresë dhe forconi shpirtin e juej me disiplinë të hekurtë dhe me dashtunie atdhetare, për me ken të zotët me ba çdo sakrificë për përballimin e të gjithë vështirësive që mund të pengojnë të mrijtunit e idealit të shenjtë të Atdheut*”.¹³

Përkujdesja serioze e elitës më të lartë politike dhe ushtarake të vendit ndaj shtypit ushtarak duket edhe në përshëndetjen që Komandanti i Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare, Gjeneral Xhemal Aranitasi bënte në “Buletini dhe e përkohshmja ushtarakë”, të titulluar “Parathanje”, që në fakt ishte një “Thirrje!” që iu drejtohej të gjithë pjesëtarëve të Ushtrisë Kombëtare shqiptare: “*Me këtë fashikull del, për herë të parë, një revistë shqiptare ushtarakë që prej formimit të Ushtrisë Shqiptare, e cila do të jetë një bazë e mirë për perfeksionimin e përgjithshëm kultural e ushtarak të gjithë ushtrisë. Dalja e revistës difton një përparim të ri në zhvillimin e ushtrisë, e cila e konsideron si detyrën e saj më të bukur, me ba gjithçka...*”.¹⁴

Ndërsa në mbyllje të “Thirrjes” së Komandantit të Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare, Gjeneral Xhemal Aranitasi theksonte: “*Në këtë vështrim revista në artikujt e saj plot mision do të jetë një udhëheqëse besnike për pjesëtarët e ushtrisë, ajo do të influencojë e do të favorizojë dijen e artë ushtarakë për me arriji sukseset ma të nalta të vertyteve “besnikëri e trimëri” për Mbret e për Atdhe*”.¹⁵ Duhet theksuar se në këtë përshëndetje kishte lavdërime të theksuara.

Edhe në numrat e tjerë që vijuan “Buletini dhe e përkohshmja ushtarakë” ruajti të njëjtën linjë. Në numrin e dytë të revistës nuk kishte përsëri më 8 rubrika, por u zhvillua me 14 rubrika. Godina dhe zyrat e Drejtorisë së Revistës kanë qenë të lëvizshme. Kështu, nga kazerma “Skënderbeg”, drejtoria e shtypit ushtarak u vendos pranë Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, në Bulevardin “*Bennito Musolini*” Nr. 73. Nëse numri 7 i revistës kishte 7 rubrika me 24 faqe, numri 8, publikuar në Kallnuer 1932 dhe që fillon me një urim të *Enrico Grassi*-t, ka 40 faqe gjithsej.

¹⁰ Presën e parë tipografike me shkronja lëvizëse e konstruktoi *Johan Gutenberg*, në shek. XV; ndërsa në fillim të shek. XVI në Evropë kishte mbi 1.000 shtypshkronja. Në fakt, Evropa kishte historinë e vet të shtypit gjatë historisë me periudha para *Gutenberg*-ut deri në vitin 1445; periudhën e zbulimeve të *Gutenberg*-ut, nga viti 1445-1812; të mekanizimit, nga viti 1812-1900; të automatizimit, nga viti 1900-1950, që sigurisht do të pasohej edhe nga periudha e elektronikës, kompjuterizimit dhe internetit.

¹¹ Mesazhi i Mbretit Ahmet Zogu botohej në f. 7, 8 të “Buletini dhe e përkohshmja ushtarakë”.

¹² Buletini dhe e përkohshmja ushtarakë, Nr. 1, Tiranë, 1931, f. 7.

¹³ Ibid., f. 8.

¹⁴ Ibid., f. 9.

¹⁵ Ibid., f. 9.

Më tej, në “Revistën Ushtarake” shohim të bëhej dhe pyetja se cili ishte qëllimi i Revistës Ushtarake.¹⁶ Mirëpo, qëllimi i Revistës Ushtarake ishte i prezantuar në numrin e parë të saj në dy faqe, dhe konkretisht në faqet 11 dhe 12. Ja si shpalosej qëllimi: “*Qëllimi i Revistës asht me përhapë e me pasuruem kulturën ushtarake të kuadrove tue i stërvitë n’at njësi që e ban ushtrinë të bindun me një metodë të vetme e me një vullnet të vetëm*”.¹⁷ Tek qëllimi jepeshin edhe disa nga të dhënat fillestare për të si: “*Revista ishte mujore, e përkohshme, që kishte drejtorin, redaksinë dhe administratën pranë Komandës së Mbrojtjes Kombëtare*”.

Numri i faqeve të Buletinit ishte i lëvizshëm dhe jepte një vijimësi në rritje të faqeve nga 24-40 faqe, ku përmbledheshin shkrime të larmishme, buletini zyrtar me emërime, shkarkime, transferime, si dhe komunikime të ndryshme. Në faqet e saj botoheshin edhe argumente morale e teknike ushtarake, si dhe ngjarje e lajme të huaja. Në fakt, riprodhimet e botimeve të huaja ishin në platformën e saj. Stafi drejtues i kryesuar nga nënkolonel *Enrico Grassi*, në numrin e dytë të saj paraqitet me gradën kolonel e shprehej se: “*Kjo revistë ka me qenë palestra e gjimnastikës së mendjes*”.¹⁸ “*Do të jetë një palestër për të gjithë lexuesit, të cilët kanë me mujtë m’e plotësuar përgatitjen e tyre mendore tue bashkëpunue në këtë revistë*”.¹⁹

“Buletini dhe e përkohshmja ushtarake” iu kushtonte vëmendje të gjithë armëve të ushtrisë, si një mjet i fuqishëm për të ngulur thellësisht ndjenjën e bashkëpunimit. Më konkretisht, në faqet e tij gjejmë: “*Kështu që shtypi, si topi, si pushka, si shpata, si zemrat e të gjithë shqiptarëve ka me qenë një armë e re për shërbimin e besës shqiptare për me i bam të pakapërcyeshme kufijtë e Atdheut e të sigurt marshimin kah fati që i përket. Me këtë frymë po e nis jetën e vet që sjell energji të reja dhe urim të përzemërt për madhësinë e fuqive armate shqiptare*”, përfundon shkrimi redaksional që shpalos qëllimet e shtypit në numrin e parë të “Buletini dhe e përkohshmja ushtarake”.

Në kohën e ringritjes së Ushtrisë Kombëtare shqiptare, dhjetëra ushtarakë të huaj shërbyen me dekret mbretëror shqiptar. I tillë ishte edhe Drejtori i parë i revistës, koloneli italian *Enrico Grassi*. Në dhjetor 1931, drejtori i gazetës botoi një urim me rastin e 8 mujorit të daljes së numrit të parë. “*Kameratë! Kjo revistë e jonë po mbush 8 muaj. Simbas dëshirës së Naltmadhënisë së Tij Mbretit, filloi në maj. Ka ndjekë ligjën e natyrshme. Qiti lule në pranverë e dha frute verore e vjeshtore*”.²⁰

Krahas direktivave se si i mirëpret shkrimet, revista e parë ushtarake, jep edhe këshilla dhe orientime për të marrë shembull nga poeti Gjergj Fishta, si poet i madh kombëtar. Urimi i drejtorit iu drejtohet të gjithë kategorisë së ushtarakëve: “*Të shkruemet asht përfundimi i një vëmendjeje të pashueme. Vetëm ai që mendon thellë ka dijeninë mbi sa shkruhen prandaj dhe është përgjegjës*”.²¹ Karakteri i revistës del qartë në këto

¹⁶ Deri në ditët tona ka ardhur 75 numra të revistës që gjenden në Bibliotekën Kombëtare. Publikimi ka vijuar nga viti 1931 deri në vitin 1938.

¹⁷ Buletinit dhe e përkohshmja ushtarake, Nr. 1, Tiranë, 1931, f. 11.

¹⁸ Ibid., f. 11.

¹⁹ Ibid., f. 12.

²⁰ Buletini dhe e përkohshmja ushtarake, Nr. 7, Tiranë, 1931 f. 325.

²¹ Ibid., f. 326.

radhë: “Revista jonë asht ushtarake, fare ushtarake. Don të jetë shesh i ushtrimit i mendjeve ushtarake..”²² Urimi i drejtorit në tre faqe ishte mjaft poetik dhe synonte të rrënjoste dy elemente thelbësore: progresin përmes bashkimit duke parë në dritë të diellit “fatin shqiptar” dhe urimin e mbyllte me devizën “Rroftë Mbreti! Rroftë Shqipnija!”²³

Koloneli *Enriko Grassi* drejtoi “Buletinin dhe të përkohshmen ushtarake” me profesionalizëm deri në vitin 1933, kur më pas vendi i drejtorit të revistës iu besua nënkolonel *Luigi Bonfatti*, nga viti 1933 deri në 1934. Për tre vjet të tjera nga viti 1934 deri në 1936 revista u drejtua nga major *Leonardo Motzos*. Në vitin 1937 stafi i revistës u ndërrua dhe revistës iu ndryshua emri i saj nga “Buletini dhe e përkohshmja ushtarake” në “Rivista ushtarake”. Nga pamja, nga formati, nga përmbajtja, nga ngjyra dhe nga simbolet që kishte në kopertinë nuk pati asnjë ndryshim.

Në gusht të vitit 1936, për herë të parë, në krye të shtypit ushtarak shqiptar ishte *Toger Shaban Strazimiri* dhe më vonë *Nënkolonel Sami Koka*, i cili e drejtoi këtë revistë të përmuajshme deri në 1939, në numrin 91, pra nga numri 78-91. Revista vijoi të publikohej me 60 faqe, në gjuhën shqipe dhe trajtonte po ato probleme ushtarake si më parë. Me pushtimin fashist italian, shumica e gazetave që dilnin gjatë kohës së mbretërisë e pushuan aktivitetin e tyre dhe filluan të dalin një sërë gazetash të tjera, në shërbim të fashizmit italian.

Ndërmjet revistave dhe gazetave që ndërprejnë aktivitetin ishte dhe “Rivista Ushtarake”, Organ i Komandës së Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare. Ka pasur gjithashtu edhe një revistë të ilustruar me katër faqe të titulluar “Fuqitë e Armatosura të 25-vjetorit”, në vitin 1938.²⁴ Në fakt është publikuar vetëm një numër special, me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë dhe ishte organ i Komandës së Mbrojtjes Kombëtare. Drejtor i kësaj reviste ishte *toger Shaban Strazimiri*. Tematika e shkrimeve gjatë një dekade në shtypin ushtarak ka qenë e larmishme, por e kufizuar brenda limiteve të politikës së “përbashkuar” italo-shqiptare.

Ka pasur dhe numra të veçantë, ku e gjithë revista ishte një përkthim i tematikave të ushtrisë italiane, si dhe i ushtrive të tjera të botës. Në faqet e revistës nuk mungonin edhe botimet enciklopedike të kohës nga shtete, ushtri, teknologji, kazerma, luftëra të njerëzimit në shekuj, zbulime të reja etj. Lexuesi ushtarak i kohës së mbretërisë gjente të dhëna, sikurse janë në artikullin “Armët dhe të tjera”, që bëjnë “autopsinë” e zhvillimeve demografike të ushtrive dhe të shpenzimeve ushtarake të disa prej ushtrive më të përparuara të kohës.²⁵ Kështu po të vëzhgojmë një ndër shkrimet karakteristike të kohës gjejmë të dhëna që lidhen edhe me kostot ushtarake të disa prej ushtrive më të zhvilluara të globit si: Belgjika shpenzon 16.5% të GDP. SHBA 20.1% të GDP; Jugosllavia 18.7% të GDP; Rumania 28.5% të GDP. Turqia 38% të GDP; Shqipëria shpenzonte për ushtrinë, veçanërisht për xhandarmërinë, rreth 40-45% të GDP. Rinia ushtarake shqiptare në nivelet *nëntoger, toger e kapiten*, si dhe gradat e tjera më të larta ishin pak të angazhuar në profilizimin e gazetarisë ushtarake, gjë që mbulohej, jo në pak raste, sikurse thotë një shprehje e popullit tonë “me miell hua”, ku edhe “buka” e letrarizmit ushtarak në shtyp vinte erë italo-perëndimore.

²² Ibid., f. 325.

²³ Ibid., f. 327.

Për publikimet në revistën ushtarake, një burim i rëndësishëm ishin të dhënat për çështjet ushtarake. Ato jepen edhe në dy botimet e Teki Selenicës “Shqipëria në vitin 1927 e ilustruar” (botim i vitit 1928) dhe “Shqipëria më 1937” (botim i vitit 1938); si dhe një libër serioz në fushën e historisë ushtarake i nënkolonelit italian *Raul Vivaldi* “Përmbledhje historike ushtarake” (botim i vitit 1931), i përkthyer në shqip, me rreth 140 faqe, ku trajtohen në mënyrë të përmbledhur historia e luftërave të popullit shqiptar dhe të ushtrisë shqiptare nga lashtësia deri në vitet '20 të shek. XX.

Me pushtimin e Shqipërisë (1939-1944) dolën në treg shumë gazeta e revista, thellësisht propagandistike në shërbim të fashizmit apo nazizmit, si p.sh “Bolletino” (1940), “Buletini i jashtëzakonshëm” (1943-1944), revista e përdyjavshme “Krahët e Luftës” (1941-1942) që botoi 26 numra në Romë, Gazeta “Lirija e Shqipërisë” (1944) organ i Forcave të Armatosura gjermane që botohej në gjuhën shqipe.²⁶ Krahas shtypit ushtarak fashist e më gjerë dolën edhe mjaft gazeta antifashiste, gazeta të njësisve, brigadave sulmuese, batalioneve, divizioneve partizane, qarqeve të çliruara etj. Por botoheshin dhe gazeta poetike të kohës dhe viti 1944 mbahet si viti më i pasur në botimin e gazetave dhe revistave ushtarake, në historikun e të gjithë shtypit shqiptar të krahasuar me shumë dekada. Po renditim disa gazeta e revista të përkohshme të cilat dolën gjatë Luftës së Dytë Botërore. “Buletini i luftës nacionalçlirimtare” (1943-1944), “Buletin i përdyjavshëm” (1944-1945), Revista kosovare “Liria” (1943-1944) e cila botohej në dy gjuhë; gazeta “Mundimi” (1943-1944) si organ politik e propagandistik i aviacionit ushtarak britanik e amerikan, që botohej në Bari dhe shpërndahej në Shqipëri.²⁷

Gazeta të tjera që dolën në këtë periudhë lufte ishin edhe “Përpara në sulm” (1944-1945) që ishte organ politik ushtarak i Br. I S; gazeta “Buçitja” (1944) e Br. V S; gazeta “Ylli çlirimtar” (qershor 1944-1945) i Div. I S; gazeta “Pishtari” (1944), Organ i Br. VIII S; gazeta “Zëri i luftëtarit” (1944) i Br. IV S, gazeta “Horizonti në ndriçim” (1944) i Br. XII S; gazeta “Përpara” (1944) i Div. V S; “Zëri i të riut” (1944-1945) i Br. XII S; “Iriqi” (1944), Organ satirik, ushtarak i Br. VI S; “Thumbi” (1944), Organ satirik ushtarak i Br. VIII S.

²⁴ Shënojmë këtu se 25 vjetori i shtetit shqiptar është festuar në 28 nëntor 1937 dhe revista ka dalë pak muaj më pas, pra në 1938. (Shënimi i autorëve).

²⁵ Kështu në vitin e gjashtë, në botimin e muajit gusht 1936 shkruhej: Belgjika me popullsi 8.7 milionë ka një ushtri 77.000 ushtarakë ose 0.92% e popullsisë dhe shpenzon 16.5% të GDP. SHBA me popullsi 122.7 milionë ka një ushtri 179.000 ushtarakë ose 0.54% e popullsisë dhe shpenzon 20.1% të GDP. Jugosllavia me popullsi 13.9 milionë ka një ushtri 148.000 ushtarakë ose 1.1% e popullsisë dhe shpenzon 18.7% të GDP. Rumania me popullsi 18 milionë ka një ushtri 155.000 ushtarakë ose 1.1% e popullsisë dhe shpenzon 28.5% të GDP. Turqia me popullsi 17 milionë ka një ushtri 140.000 ushtarakë ose 1.1% e popullsisë dhe shpenzon 38% të GDP; etj të dhëna enciklopedike ushtarake. Ndërsa për Shqipërinë e viteve '30-të me një popullsi rreth 1 milionë banore, kishte një forcë ushtarake prej 7 mijë deri në 8 mijë vetë, që shpenzonte për ushtrinë veçanërisht për xhandarmërinë rreth 40-45% të GDP.

²⁶ Numri i parë i “Lirija e Shqipërisë” doli më 19 qershor 1944, me dy faqe. Gazeta shpërndahej çdo dy javë dhe u publikuan gjithsej në 36 numra, deri në nëntor të vitit 1944.

²⁷ Gazeta “Mundimi”, ishte propagandistike dhe informative dhe drejtohej nga major *Barbrok*. Gazeta doli deri në vjeshtë të 1944-s me 38 numra gjithsej, (shënim i autorit).

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri, në pushtet erdhën komunistët, të cilët ndryshuan gjithçka dhe shtypin ushtarak ata e nisën nga e para e sollën një ndryshim rrënjësor, një erë të re ideologjike të gjatë e të vështirë. Në 81 vite të shërbimit të botimeve ushtarake të shtypit të shkruar janë publikuar më se 40 lloje botimesh, një larmi e konsiderueshme për një Forcë të Armatosur, me burime të kufizuara.

Shtypi ushtarak vjen më i konsoliduar se kurrë, me orientim të qartë euroatlantik, me profil perëndimor, zëri dhe imazhi i një Force të Armatosur solide operationale, misionare në veprim, zëri i Forcave të Armatosura Shqiptare, që kanë shkruar histori suksesi si partnere të denja në NATO.

Bibliografia:

- Buletini dhe e përkohshmja ushtarake, Tiranë, 1931-1937; nga Nr.1-78.
- Rivista Ushtarake, Tiranë, 1937-1939; nga Nr. 78-91.
- Rivista “Fuqitë e Armatosura të 25-vjetorit”, Botuar nga Toger Shaban Strazimiri, Tiranë, 1938.
- Revista ushtarake, Nr. 1, viti 2004.
- Fletore Zyrtare, Nr. 40, Vjeti X, Tiranë, e martë 30 qershor 1931.
- Fjalori i ushtrimeve ushtarake të emërtuar “Përvuajtjet vetmore”.
- “Terminologji ushtarake”, fjalor shqip-shpjegues-italisht dhe italisht-shqip me 700 terma, Tiranë, 1932.
- “Manual bisedimi me landë ushtarake” në shqip-italisht-sllavisht me 1350 fjalë e shprehje, Tiranë, 1933.
- Libër “Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj 28 nëntor 1912-22 janar 1914”, (Përmbledhje dokumentash), Tiranë, 1962.
- Raul Vivaldi, Njoftime për historinë ushtarake, Tiranë, 1931.
- Teki Selenica, Shqipëria në vitin 1927 e ilustruar, Tiranë, 1928
- Nexhip Alban, Nesip Kaci, Shqiptarët në Perandorinë Osmane, Monografi “albin”, Tiranë, 1997.
- Koli Xoxe, Ismail Qemali, Tiranë, 1983.
- Vangjel Kasapi, Mehmet Pashë Dërralla, Tiranë, QBU, 1995.
- Sejfi Vllamasi, “Ballafaqime politike në Shqipëri, 1897-1942”, Tiranë 1995.
- DPASH, “Kartela ushtarake”, Viti 1922-1944.
- AQFA, Fonde dokumentare të Drejtorive në Shtabin e Përgjithshëm. pas LIIB
- Historia e Shqipërisë, Vëllimi I, Tiranë, 1959.
- Historia e Ushtrisë shqiptare, pjesa e parë 1912-1944, SHBU, 2000.
- Histori të Popullit shqiptar, Vëllimi III, Tiranë, 2007.
- Periodikët e Revistës Ushtarake, Mbrojtja, Ushtria, Luftëtari
- Revista Arkivi Shqiptar Nr 1-2 viti 2002.
- Stefan Koçi “Fjalor i terminologjisë arkivore”, Tiranë, 2001.
- Periodiku i “Buletini dhe e përkohshmja ushtarake”, 1.6.1931-1939.
- Revista “Xgjimi”, Nr.1,2,3/1913 si dhe Nr 4/1914, botuar në Korçë.
- Kalendar i encilopedik shqip (almanak), Tiranë, 1938.

Çështjet e pazgjidhura të Pakistanit

Kolonel Dritan Demiraj
Komandant i Batalionit të Forcave Speciale

Trajtesë e shkurtuar. *Qeveria qendrore e Pakistanit (ashtu si ajo e Afganistanit) asnjëherë nuk ka pasur ndikim shumë të madh mbi disa nga provincat e saj dhe aq më pak, në agjencitë tribale të saj. Provat e këtyre agjencive shkojnë përtej fitoreve të fundit në zgjedhje të MMA-së (partitë fetare) në NWFP dhe Baluchistan. Deri në vitin 2003, banorët e Provincës Sindh (pjesa më Jugore e vendit) vazhdonin të ndiheshin të dominuar nga “Punxhabët e Zia-ul-Haqit”¹. Ish-Presidenti Zia-ul-Haqi u përpoq të “islamizonte” të gjithë qeverinë Pakistaneze, duke përfshirë edhe agjencinë kryesore të zbulimit (ISI).*

Vlerësimi i tanishëm i të gjitha “çështjeve të pazgjidhura me Pakistanin” është një sipërmarrje tepër e jashtëzakonshme, që do të ketë nevojë për shumë përsëritje dhe detaje, të cilat mendojmë se do të jenë interesante për lexuesit.

Sipas një analisti perëndimor, njësitë bërthamore të Pakistanit janë sulmuar tashmë. Kjo situatë ka ndodhur tre herë, nga gushti i vitit 2007 deri në gusht të vitit 2009. Ndonëse këto sulme nuk kanë qenë të bashkërenduara, përsëri mbeten shqetësuese. Ato janë lëshuar në shënjestrat e mëposhtme: mbi një njësi magazinimi predhash bërthamore në Sargodha, në 1 nëntor 2007; mbi bazën bërthamore të Pakistanit në Kamra, në datën 10 dhjetor 2007 dhe, mbi disa pika hyrëse të fabrika e montimit në Wah Cantonment, në gusht të vitit 2008.

Dy sulmet e fundit ishin me bomba vetëvrasëse. Pjesa më e madhe e zonave bërthamore të Pakistanit gjenden përgjithësisht në afërsi të Islamabadit. Ato janë në Wah Cantonment, Fatehjang, Golra, Sharif, Kahuta, Sihala, Isa Khel Charma, Tarwanah dhe Taxilla². Duke qenë se Sargodha është e njohur si bastion i SSP, mund të mos ketë qenë vendi më i mirë i mundshëm për ruajtjen e raketave.

Politika e fundit qeveritare brenda Pakistanit ishte e qartë; intervistat video-filmike të zyrtarëve më të lartë pakistanezë në Frontline të PBS në tetor të vitit 2009. Ata

¹ . Screeam Chaulia, review of Pakistan, In the Shadow of Jihad and Afghanistan, by Mary Anne Weaver, Asia Times Online, 1 March 2003.

² . “Terrorists hit Pakistani N-Sites Thrice in 2 Yrs”, Times Global (Chennai), 12 Aug 2009, p1.

zyrtarë nuk besonin se Mullah Omari ose Haqqani mund të gjendeshin në ndonjë zonë të tokës Pakistaneze. Gjithashtu, ata nuk pranuan që Pakistani të ketë urdhëruar sulmin me raketa mbi Baitullah Mehsudin. Po ashtu, ata nuk mendonin se ISI, vazhdonte të përdorte krahun e armatosur të partive fetare si përfaqësues. Në thelb, ata nuk kishin vullnet të pranonin mungesën e vazhdueshme të qeverisë së tyre për të pasur kontroll mbi FATA, NWFP dhe Baluchistan. Ata, po ashtu, nuk e marrin parasysh mundësinë se ISI, e cila ka qenë tepër e islamizuar më parë, mund të jetë e pavarur. Pas verifikimit të këtyre të vërtetave të pranuar në përgjithësi, nuk mbetet rrugë për të qenë të sigurt për konkluzionet e tjera të këtyre zyrtarëve. Ka shumë të ngjarë, që përgjigja për paqen në Afganistan të gjendet diku brenda kufijve të fqinjët të tij Lindor.

Përfundimisht, Pakistani i nxori prijësit jashtë ligjit, *LET-in*, në fillim të gushtit të vitit 2009, pas lejitimit që të vepronte në kufijtë për shumë vjet, duke e mbajtur në “listën e kontrollit”. Gjithashtu, u ndaluan edhe 24 organizata të tjera ushtarake që përfshijnë *JuD (MDI)*, *JEM*, *TTP*, *TNSM* dhe *LeJ-in*. Nuk është e qartë nëse në listën e 24 organizatave përfshihet edhe *SSP* ose *Hezb*³. Në 13 gusht të vitit 2009, Islamabadi nxori në pension 32 oficerë të vjetër të ushtrisë nga organizata e rebeluar e ISI-t. Padyshim që kjo u bë për të dekurajuar çdo mbështetje tjetër klandestine për talebanët⁴.

Edhe në rrethet më të mirinformuara Perëndimore, veprimet e mësipërme do të duken se janë të mjaftueshme për të provuar besimin e mirë. Për fat të keq, Pakistani ende ndodhet në Azinë Jugore. Përmes ndikimit të Sun Tzu-së dhe të tjerëve, niveli i intrigës së luftës mbetet i rëndësishëm, më i lartë se ai i shteteve perëndimore. Gjithashtu, duhet trajtuar në mënyrë të përshtatshme niveli i korrupsionit të Pakistanit, ose më saktë, shkalla e përfshirjes në tregtinë mbarë botërore të drogës. Kjo dhe përpjekja e dukshme e dikujt për të përmbysur administratën aktuale të Pakistanit, janë shpjegimet e vetme të mundshme për kaq shumë kaos të brendshëm.

Tashmë ka raportime se Baitullah Mehsudi mund të ketë punuar për liderin e rezistencës afgane Jalaliddin Haqqani⁵. Megjithëse në aleancë të ngushtë me Mullah Omarin, Haqqani ka selinë e tij lokale në Waziristanin Verior.

Në tetor të vitit 2007, një gazetë pakistaneze raportoi se pesë grupe ushtarake ishin bashkuar për të formuar *TTP* në Agjencinë Mohmand të FATA-s. Thuhet se pjesa më e madhe e parave të mbledhura nga Baitullah Mehsud vijnë nga trafikimi i drogës. Gjithashtu, dihet se Haqqani drejton rrjetin më të madh të drogës nga Provinca Pakiya e Afganistanit tek Waziristan-ët⁶.

Nëse Baitullahu ka qenë duke bashkëpunuar me Haqqanin për drogën, atëherë edhe disa aleatë dhe homologë mund të kenë bërë të njëjtën gjë. Haikimullah Mehsudi ka qenë në kontroll të agjencive Orkazai, Kuram dhe Khyber edhe përpara vdekjes së

³ . “Pakistan Bans LET, JuD, and 23 Outfits”, “PoK Also Bans Jihadi Outfits”.

⁴ . “Pakistan Trims Top ISI Chairs” from PTI Islamabad, The Economic Times (Chennai), 13 Aug 2009, p3.

⁵ .Global Security (global security.org), s.v.”Mawlawi Jalaluddin Haqqani”.

⁶ . Peters, Seeds of Terror, p 110.

Baitullahut. Milicët e tij janë pjesë e “shkrirjes së pesë grupeve” që formoi *TTP*, në Agjencinë Mohmand, në tetor të vitit 2007.

TTP nuk është e vetme në FATA-në Jugore. Milicia e Hafiz Gul Bahadurit kontrollon Waziristan-in Verior dhe kështu strehon selitë e Haqqanit. Tribuja Bahadur është Madakhel Waziri.⁷ Milicia e Maulvi Nazirit është e bazuar në Jug të Wanas, Waziristanin tjetër. Ishte nëngrupi Yargul Keil, i klanit Zalikel të fisit Nazir “Ahmed Zair Wazir” që udhëhoqi rezistencën ndaj kërkimeve të ushtrisë pakistaneze në kërkim të selisë së *Al-Qaeda*s në vitin 2004⁸. Naziri është anëtar i nënklanit Kakakhel të Wazirëve Ahmedzai. Fshatrat e rrethuara në atë operacion ishin Shin Warzak, Daza Gundai, Kallu Shad, Ghaw Khawa dhe Khari Kot. Kur trupat pakistaneze bastisën më tej fshatin Kosha, rreth 15-20 “të huaj” u arratisën (ka të ngjarë nëpërmjet një tuneli). Sipas një gazete Pakistaneze, Wana kontrollohet nga Nazirët⁹.

Në shkurt të vitit 2009, Bahaduri dhe Naziri ranë dakord me Baitullah Mehsudin për të formuar *SIM-in* për të ndihmuar Mullah Omarin dhe Osama Bin Ladenin, që të godasin pushtuesit perëndimorë. Tetë muaj më vonë, të dy Waziri-t këmbyen armë dhe bënë marrëveshje me forcat pakistaneze, që të hynin në Waziristan dhe të viheshin në ndjekje të Uzbekëve të bashkuar me *Al-Qaeda*-n dhe me selinë e *TTP-së*¹⁰. Nëse secila palë do të ishte e përfshirë me Haqqanin, atëherë si përfundoi që ofensiva pakistaneze të kishte një të dhënë në lidhje me burimin real të ndikimit destabilizues. Megjithatë, përpara se të hetohet kjo, vendin kryesor duhet ta zërë ofensiva ekstremiste kundër qeverisë qendrore. Islamabadi ka qenë i sulmuar nga dy drejtime të ndryshme.

Në vitin 2008 dhe 2009 pati goditje ekstremiste përmes Swat Valley (Islamabadi i Veriut) dhe u qëlluan një sërë objektivash qeveritare në Rawalpindi (22 km në Jug të tij).

Ndikimi i *Al-Qaeda* në Swat Valley ishte më i dukshëm nëpërmjet pranisë së *TNSM*, *JEM* dhe *IMU*. *TNSM* dhe *JEM* janë të dyja pjesë e IFF të Osama Bin Ladenit (së bashku me *LeJ*). Mendohet se në vitin 2004, *IMU* ofroi sigurinë për selinë e *Al-Qaeda*s në Waziristanin Jugor.

Pastaj sulmet e pjesshme mbi Islamabadin, nga veriu, u drejtuan kryesisht nga *LeJ-i*. Jo vetëm që *LeJ-i* sulmoi selinë e ushtrisë pakistaneze në Rawalpindin e afërt, por gjithashtu vuri kamion bombë në hotelin Marriot të Islamabadit në shtator të vitit 2008 (me mundësi i ndihmuar nga *JEM-i*). *LeJ-i* është padyshim një partner i *Al-Qaeda*s. Në fakt mendohet të jetë “Delta Force” e *Al-Qaeda*s e orientuar në vetëvrasje¹¹.

⁷ . Imtiaz Gul, *The Al-Qaeda Connections, The Taliban and Terror in Pakistans Tribal Areas* (New Dehli, Viking an Imprint of Penguin, 2009), p 276, Peters, *Seeds of Terror*, p 110.

⁸ . Tohid, Owais and Faye Bowers, “U.S. Pakistan Tighten Net on Al-Qaeda”, “Christian Science Monitor”, 22 Mar 2004, pp . 1, 10.

⁹ . “Maulvi Nazir, Group decides to stay neutral” by Iqbal Khattak, *Daily Times* (Pakistan), 19 Oct 2009.

¹⁰ . “Pakistan Cuts Deal with Anti-American Taliban”, p 11.

¹¹ . Raman, “The new Trojan Horse of Al Qaeda”, Mir , *The True Face of Jihadis*, pp 183-184.

Kështu që, jo vetëm disa sindikata të drogës, por edhe *Al-Qaeda* ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë përzierje intrige Aziatiko-Jugore.

Çdokush në Pakistan, duke përfshirë edhe presidentin e tij të ri, tashmë është duke shpresuar se ISI e islamizuar nuk po vazhdon të ndjekë politikën kombëtare nëpërmjet zëvendësimit të “ushtrive”. Ndërmjet përfaqësuesve të njohur të saj, janë si vijon: (1) *Ji* e mbështetur nga milicia afgane e Hekmaytarit; (2) *Hezbi*; (3) *JUI/F* e krijuar nga Talebanët afganë; (4) *LET-i* dhe (5) *JEM-i*¹². Si përfundim i bashkimit ndërmjet *HUM-it* dhe *HUJI-it*, *JEM-i* është rreshtuar ngushtësisht me *JUI/F* dhe Talebanët Afganë. Nga ana tjetër, *Hezbi* u krijua nga *Ji* dhe Hekmatyari në Kashmirin Azad¹³. Në thelb, ISI është mbështetur në mënyrë alternative tek *JUI/F* dhe *Ji* për forcat e saj zëvendësuese.

Në vitin 1996, ISI i Pakistanit inkurajoi mijëra kuadro të armatosura nga *SSP*, *LEJ*, *LET* dhe *HUM*, që të shtonin forcat e Mullah Omarit. Ajo e bëri diçka të tillë për të ndihmuar përfaqësuesin e ri të saj (Talebanët Afganë) për të përmbushur zaptimin e asaj që njihet tashmë si Afganistani i lirë nga Sovjetikët. *Hezb* nuk u bë pjesë e këtij “kontingjenti kuadrosh” (tani quhet “ushtria e islamit”), derisa u zhvendos përsëri në zonën e Kashmirit nga ISI. Përmes detashmenteve të kuadrove, u krijua shtylla e IIF-së së Bin Ladenit në vitin 1998, për pasojë ata u zbrapsën në Pakistan gjatë pushtimit Amerikan të vitit 2001. Pjesëmarrja e tyre në shtimin e aktivitetit radikal brenda Pakistanit mund të ketë për qëllim rrëzimin e qeverisjes aktuale.

Në Brigadën 055 të *Al-Qaedas* ka gjithashtu kontigjente të *HUM-it*, *LET-it* dhe *JEM-it*. Tashmë mendohet se kjo brigadë po reformohet¹⁴. Brigada 313 e *Al-Qaedas* ka përfaqësim të njëjtë: (1) *HUJI* (një anëtar Deobandi i *HUM*); (2) *HMA* (një tjetër degëzim i shkrijes ndërmjet *HUM* dhe *HUJI*); (3) *LET*; (4) *JEM* dhe (5) *LeJ*. Dhe njësitë IIF të *Al-Qaedas* kanë pasur njësi nga *HUM*, *LET*, *JEM*, *LeJ* dhe *HUJI*. Mbështetja e ISI-t për lindjen e *Al-Qaedas* në vitin 1987 nuk është ngushëlluese. Ishte gjithashtu ISI që orkestroi humbjen sovjetike dhe pastaj, në vitin 1994, futi Talebanët për të ardhur në pushtet në Afganistan.

A është Islamabadi tani më i vendosur për të nxjerrë jashtë *Al-Qaeda*?

Gjatë presidencës së Musharrafit, ushtria e Pakistanit bëri disa përpjekje të pasuksesshme për të hequr qafe anëtarët Waziristanë të *Al-Qaedas*. Nuk dihet nëse këto përpjekje ishin me gjysmë zemre, për të qetësuar Perëndimin. Gjithë sa dihet, influenca e *Al-Qaedas* ka vazhduar në të dyja agjencitë tribale.

¹² . “Jaish e-Mohammed profile”, Overseas Security Advisory Council, Global Security News Reports, n.d.Raman, “The new Trojan Horse of Al Qaeda”, Mannes, Profiles of Terror, p 66.

¹³ . Mir, The True Face of Jihadis, pp123-135, Nojumi, The rise of the Taliban in Afghanistan, p128, “Heroin in Pakistan, Sowing the Wild Wind”, CIA report.

¹⁴ . Gunaratanta, Inside Al-Qaeda, pp 40, 206, Ahmed Rashid “Taliban ready for decisive push, Daily Telegraph (London), 22 Jul 1999, “ in Afghanistan, Crisis of Impunity” by Batty and Hoffman, p 32, South Asia Intelligence Review database , s.v. “Tahrek -e-Nafaz-e- Sharihat-e-Mohammadi”, Mir, The true face of Jihadis, pp 123-135, Nojumi, “The Rise of Taliban in Afghanistan, p 128”.

Në sulmin e parë të papritur, në mars të vitit 2004 në Wazaristan-in Jugor gjysmë autonom, që prej vitit 1947, rreth 10.000 trupa Pakistaneze hynë për të dëbuar elementët e *Al-Qaeda*, në mënyrë të veçantë, Uzbekët IMU. Prania e Ushtrisë Pakistaneze në Jugperëndim të Wanas u kundërshtua nga 400-500 militantë të *Al-Qaeda* dhe rreth 2.500 pjesëtarë të tribuve lokale, të cilët ata i kishin rekrutuar dhe stërvitur. Vendasit lokalë ju referohen këtyre pjesëtarëve të tribuve si “Njerëzit e *Al-Qaeda*”¹⁵. Dihet se një nëngrup i fisit Maulvi Nazir ka drejtuar rezistencën, kështu që, ka shumë të ngjarë që të ketë zëvendësuar “Njerëzit e *Al-Qaeda*”. Yar Gul Khel, një nëngrup i klanit të fisit Ahmed Zai Wazir, mendohet se drejton rezistencën ndaj sulmit të vrullshëm të ushtrisë Pakistaneze.

Pasi luftuan për një javë për thyerjen e kordonit të disa fshatrave, forcat Pakistaneze ranë dakord për një armëpushim të përkohshëm, për t’iu bërë të mundur 22 anëtarëve, të negociacionin kalimin e luftëtarëve të dorëzuar. Ndërmjet tyre ishte themeluesi i supozuar i IMU-s, i cili kishte bërë lidhjen e organizatës së tij me *Al-Qaeda*. Negociatat që zgjatën siguruan çështjen përfundimit të luftimeve dhe të dorëzimit të të huajve. Në Wana, zyrtarët pakistanezë bënë përpjekje për të detyruar bashkëpunimin e klanit të Zali Khel, duke kërcënuar me shembjen e shtëpive të liderëve të fiseve¹⁶. Kjo mund t’iu ketë dhënë mundësi liderëve militantë (dhe pjesëtarëve të *Al-Qaeda*-s) të arratisen prej kordonëve të ushtrisë. Më pas, trupat pakistaneze zbuluan dy eskavime: 1) Një tunel rreth 1.5 km të gjatë, nën rrethinat si fortesë, në qytetin e Tellu Shah; 2) “Një tunel 2 km të gjatë që kalonte ndërmjet shtëpive të dy anëtarëve të kërkuar të fisit dhe që të çonte te një përrua”. Nën presionin në rritje, shumë shpejt, udhëheqësi i fisit krijoi një forcë prej 600 pjesëtarësh të armatosur të fisit, për të kapur militantët dhe të pabindurit e njerëzve të klanit. Nëngrupi i klanit Zali Khel u detyrua të paguante një gjobë ditore prej 870\$ dhe do të përballej me shembjen e shtëpive nëse dështonte në kapjen e “terroristëve të huaj”. Pas pak kohe, qeveria e Pakistanit “bëri një marrëveshje me liderët e fisit në Waziristan-in Jugor”. Si rezultat i asaj marrëveshjeje, “zona u bë një vakum fuqie, i cili u mbush shpejt me Talebanë”¹⁷.

Mbas atij presioni të ushtrisë Pakistaneze, në pranverë të vitit 2004, burimet fisnore, le të themi rreth 600 guerile të *Al-Qaeda*, kryesisht arabë, çeçenë dhe uzbekë arritën të mbeteshin brenda dhe në periferi të Waziristanit Jugor. Disa prej personelit të *Al-Qaeda* u takuan në rajonet e mbuluara me pyll të malit të rajoneve Shikai, Bush dhe Khamran¹⁸. Të tjerë shkuan në Veri. Disa nga Uzbekët thjesht u zhvendosën në territorin Mehsud, ndërkohë që të tjerë udhëtuan deri tutje në Waziristan-in Verior.

Në vjeshtë të vitit 2006, autoritetet Pakistaneze nënshkruan një pakt tjetër paqeje, kësaj here me liderët e fisit të Waziristan-it Verior (duke përfshirë padyshim Bahadurin). Pas këtij armëpushimi, komandantët amerikanë vunë re një trefishim të

¹⁵ . Tohid and Bowers, “U.S. Pakistan Tighten Net on Al Qaeda”pp1, 10.

¹⁶ .Owais Tohid, “Pakistan Marks Pro-Al Qaeda Clan”, Cristian Science Monitor, 23 Mar 2004, Tohid, “Al Qaeda supporters strike back in Afghanistan”.

¹⁷ . David Montero, “In border zone, Pakistan Baks off from Taliban”, Cristian Science Monitor, 26 Sep 2006, p 5.

¹⁸ . Tohid, “Pakistan Gains in Al Qaeda Hunt”.

numrit të sulmeve ndërkufitare. Qartazi, “marrëveshjet” e pazbatuara po ndihmonin armikun.

Më pas, duke filluar që prej fundit të marsit të vitit 2007, Presidenti i Pakistanit Musharraf rinovoi marrëveshjen(-et) e paqes me liderët fisnorë të Wazaristanit. Deri në 15 prill të vitit 2007, të vjetrit fisnorë të zonës-Wana, klerikët dhe militantët lokalë (duke përfshirë edhe Nazir) kishin nënshkruar një marrëveshje. Më pas, ushtria Pakistaneze dhe pjesëtarët aleatë të fiseve, duke përfshirë edhe milicinë e Nazirit, nxorën Uzbekët e “bashkuar me *Al-Qaeda*”, jashtë Jugut të Wazaristan-it (dhe sipas Musharraf vranë 300 prej tyre gjatë këtij procesi). Në thelb, ushtria Pakistaneze ka përdorur përçarjen ndërmjet Mehsudëve dhe Wazirëve, duke mbështetur fraksionin e rreshtuar kundër Uzbekëve. Të dyja fiset jetojnë në Waziristan-in Jugor¹⁹ (dhe janë rivalë), por vetëm Wazirët janë vendosur në secilën anë të kufirit Pakistan-Afganistan. Një vendosje e tillë do ta bënte lëvizjen ndërmjet kufijve më të lehtë për vizitorët e *Al-Qaeda*s dhe njëkohësisht, edhe për kontrabandistët e drogës. Që atëherë, Islamabadi ka pak kontroll mbi Waziristan-in Jugor, me garnizonet e tij ushtarake që kufizohen kryesisht në Wana. Duke qenë se Wana shtrihet brenda zonës së ndikimit të Nazir, këto kufizime të kontrollit qeveritar pleksen mirë me kufijtë e hamendësuar të *TTP*. Baitullah Mehsudi nuk duhet t'i ketë nënshkruar këto marrëveshje.

Një kontigjent i ushtrisë u desh të evakuonte pjesën e dominuar Mehsud të Wazaristanit Jugor në vitin 2008, pasi u morën peng 300 trupa. Kjo zonë e kontrolluar nga *TTP* në zonën Veriore të Wanas mendohet se mban të paktën shtatë kampe ku trajnohen vetëvrasësit me bomba. Këto kampe janë në Makeen, Shaktoi, Kanigaram, Dela, Kot Kai, Shawwal dhe Badar. Maluavi Nazir drejton qendra të ngjashme trajnimi në Shikai dhe Baghar. Këto qendra, ashtu si pjesa më e madhe e ndjekësve të tij, ka të ngjarë të jenë në Jug të Wanas²⁰.

Në tetor të vitit 2009, forcat pakistaneze pushtuan përsëri Waziristan-in Jugor. Pas katër ditë luftimesh, ata morën Kot Kai-n, qytetin e Haikimullah Mehsudit. Qari Hussain, organizuesi i skuadrave vetëvrasëse të *TTP*, është gjithashtu nga Kot Kai. Në 18 nëntor, njësitë pakistaneze kishin pushtuar përsëri Fortesën Sararogha, tani një bastion dhe selia e mundshme e *TTP*. Në atë luftim, ata vranë 500 militantë, pasi humbën 70 nga njerëzit e tyre. Fortesa e Sararoghas është pushtuar në mesin e janarit të vitit 2008 nga qindra militantë protalebani, të cilët për pasojë vranë ose rrëmbyen shumë anëtarë të garnizonit të Pakistanit²¹.

Ofensiva e Pakistanit në vitin 2009 kishte si shënjestër të saj “njëmijë deri dymijë Uzbekët e lidhur me *Al-Qaeda*, që ende mendohet se janë në Waziristanin Jugor. Me interes të veçantë janë kampet e kamikazëve (p.sh. Kot Kai) dhe postet e mëparshme. Duke pritur të ketë rezistencë të madhe nga *TTP*, Ushtria Pakistaneze bëri marrëveshje me Nazir dhe Bahadur për shmangien e agresionit. Ata të dy i kishin premtuar besnikëri Baitullah Mehsudit, Mullah Omarit dhe Osama Bin Ladenit në

¹⁹ . Tohid, “Pakistan Marks Pro Al-Qaeda Klan”.

²⁰ . “Pakistan Conflict Map”, Pakistan Captures Mehsuds Hometown, UPI.com, 24 Oct.2009.

²¹ . “Militants Overrun Pakistan Fort”, BBC News online, 17 Jan 2008.

janar të vitit 2009 dhe marrëveshja *SIM* nuk dukej se kishte rëndësi²².

Prerja e marrëveshjeve me mbështetësit e *Al-Qaeda*s mund të ketë kuptim për Sun Tzu, por nuk solli ndonjë të mirë herën e fundit. Marrëveshje të tilla mund të duken sikur dëbojnë *Al-Qaeda*n, por në fakt mbrojnë anëtarët kyç. Presidentit të ri të Pakistanit i duhet vënë në dukje se *Al-Qaeda*a përbën rrezik më të madh për vendin e tij sesa India. Ai duhet të kujtohet gjithashtu, për dështimin e mjerë të politikës paqësore të Musharrafit.

Tani që është vlerësuar pjesërisht sinqeriteti i Ushtrisë Pakistaneze në Wazaristan, mund të kthehemi tek lidhjet e drogës të njërit prej aleatëve të tij.

Formimi i Nazirit i lidhur me qëllimet e Pakistanit

Maulvi Naziri ka shtetësi të dyfishtë, pakistaneze dhe afgane. Megjithëse aktualisht e ka rezidencën në Wazaristanin Jugor, ai udhëton shpesh në provincën Paktika të Afganistanit dhe në Kandahar (ku ka pronën e tij). Provinca Paktika është portali i rrugës së kontrabandës ndërmjet kufijve. Ashtu si Haqqani, lidhja e parë e Nazir ishte me *Hizb-e-Islami* e Hekmaytarit, i preferuari i ISI-t të Pakistanit gjatë ditëve të *xhihadit* antisovjetik. Ai më vonë u bashkua me talebanët Afgane dhe mbetet i rreshtuar politikisht me *JUI/F*²³. Nazir udhëheq 3.000 luftëtarë, të cilët janë kryesisht Waziris. Milicia e tij ka gjithashtu në përbërje edhe talebanë punjabi, të përbërë nga anëtarët e sektarianëve të ndaluar dhe të grupeve militante të Kashmirit. Disa mund t'i përkasin *JEM-it* (transportuesit të drogave drejt Jugut) dhe kampi i atij fraksioni Balakot mund të jetë në zonën e Nazirit.

Selia e Haqqanit është në Wazaristan-in e Veriut, kështu që Bahadur duhet të mbështesë absolutisht kontrabandën e tij të drogës. Dihet se Baitullah Mehsud ka punuar me Haqqanin. Pas të gjitha çarjeve që Nazir ka marrë nga Qeveria e Pakistanit, çdo lidhje kontrabande ndërmjet tij dhe Haqqanit do të tentojë të thyejë atë vendim të qeverisë në çarjen e kanalit të drogës. Deri rreth 90% e heroinës në botë ka ndërprerë transportin përmes Pakistanit Jugor *en route*, për në Botën Perëndimore. Amerika nuk ka për t'i besuar plotësisht qeverisë së atij vendi.

Pas tetorit të vitit 2009, ushtria Pakistaneze sulmoi mbi Waziristanin e Jugut. Pjesa më e madhe e *TTP* u largua për në agjencinë fisnore Orakzai (ose Arakzai). Kjo nuk do të kishte qenë e mundur pa bashkëpunimin e Bahadurit në Waziristanin e Veriut. Orakzai gjendet, pikërisht, në jug të kalimit Khyber dhe Peshawar. Gjithashtu, ky është vendi ku ka bazën *Fedayeene-Islami* i mistershëm. E drejtuar nga Hakeemullah Mehsudi, *Fedayeen-e-Islam* ka marrë përsipër sulme të shumta terroriste dhe sulme kamikaze në të gjithë Pakistanin. Grupi është krijuar nga talebanë të Pakistanit, *Lashkar-i-Jhangvi [LeJ]*, *Jaish-e-Mohammed [JEM]* dhe terroristë të tjerë islamikë nga Pakistani. Bazën e ka në Orakzai dhe në Waziristanin e Veriut. Liderët e vjetër të

²² Gall et al, "Pakistani and Afghan Taliban Unify in Face of U.S.. Influx," Khan, "Taliban rename their group", the nation (Pakistan), "Three Taliban Factions Form Shura Ittehad-ul-Mujahedin", the news Pakistan, 23 Feb 2009.

²³ . Friday Times (Pakistan), 30 Mar 2007, Daily Times (Pakistan) 9 Jan 2009, in "South Waziristans Maulvi Nazir", by Abbas.

Fedayeen-e-Islam përfshijnë Qari Hussain Mehsudin, një ish- përfaqësues i vjetër në Baitullah, i cili trajnon fëmijë kamikazë, dhe Qari Mohammed Zafar, komandanti operacional i sulmit të shtatorit të vitit 2008, mbi hotelin Marriott në Islamabad²⁴. Papritur duket se të gjitha pjesëzat fillojnë të përputhen. Orakzai ndodhet në jug të Agjencisë Khyber.

Nëse droga dilte me të njëjtët kamionë që furnizojnë me pajisje luftarake, atëherë cilido që kontrollon Kalimin Khyber kontrollon edhe kalimin e drogës. Kryekomandanti më i spikatur në Orakzai është një anëtar i klanit Afridi. Ishte Haji Ayub Afridi, i cili drejtonte perandorinë e heroinës dhe ruante sundimin mbi Kalimin Khyber²⁵. Organizata e grupit Tariq është konsideruar si organizata më e fuqishme në Orakzai. E drejtuar nga komandanti Taris Afridi dhe me bazë në Darra Adam Khel, grupi sulmon forcat Pakistaneze të sigurisë në Orakzai, Kohat, Peshawar dhe Hangu. Hakeemullah Mehsud ishte komandanti i forcave talebane në Orakzai (agjencinë fisnore), përpara se të merrte kontrollin e aleancës së terrorit pas vdekjes së Baitullah Mehsudit, në gusht. Dihet se Hakeemullah ka një qendër operacionale në Ghiljo në Orakzai²⁶.

Në thelb, *TTP-ja* po kërkonte strehim në zonën ku kontrolluesi i tij kishte ndikim. Ai kontrollues kishte më shumë interes te droga sesa te rrëzimi i qeverisë Pakistaneze. Në mes të janarit të vitit 2010, një nga gazetatat e pakta amerikane, që ende ka korrespondentët e vet të huaj, konfirmoi dyshimin.

As (është shtuar dyshimi) janë (pakistanezët gjatë ofensivës së tyre FATA) duke lëvizur kundër rrjetit Haqqani në Wazaristanin e Veriut apo Hizb-e-Islami të Hekmatyar përreth Kalimit Khyber²⁷. Vonë, në 10 mars të vitit 2010, NPR News vazhdonte të konfirmonte se ofensiva Pakistaneze në FATA nuk kishte bërë asnjë përpjekje për të përçarë “Rrjetin Haqqani”. As nuk kishte ndërhyrë me “*xihadistët* e bazuar në Kashmir”. Ky shënim i fundit duket se drejtohet për *Hezb*, por shënjestra e tij mund të kenë qenë gjithashtu *HUM*, *LET*, *LeJ* ose *JEM-i*. Duke pasur të njëjtin themelues, *Hezb* dhe *HIG* punojnë mirë së bashku dhe mund të ngatërrohen lehtë në identifikim. Për rrjedhim, spektri i marrëveshjes së fshehtë të qeverisë së Pakistanit me drejtuesit e drogës ka filluar të shtohet. Sidoqoftë, ka gjithashtu prova për hyrje të huaja ose vendase, për të shkatërruar atë qeveri.

Pas sulmit në Selinë e ushtrisë në Rawalpindi, dikush që mbiquhej “Talebanët e Punjabit” mori përsipër këtë sulm. Mendohet se këta talebanë Punjabi janë mbetje të fraksioneve *xihadiste* dhe u dërguan në Afganistan nga ISI në vitin 1996 për të ndihmuar talebanët dhe pastaj u dërguan në Kashmir dhe Jammu për të luftuar indianët. Si pjesë e “Ushtrisë Islamike” klandestine, ata përfundimisht e konsiderojnë veten si *SSP*, *LeJ*, *LET*, *HUM* dhe *Hezb*. *Ji* e bashkuar me *Hezb* nuk ndërthuret mirë me të tjerët, por u përfshi për të paraqitur një kërcënim të brendshëm për Pakistanin. Siç u

²⁴ . “Pakistani Military Hits Taliban in Orakzai”, by Bill Roggio, Long War Journal, 17 Nov 2009.

²⁵ . “Heroin in Pakistan, Sowing the Wind”, a CIA report leaked to and printed by Pakistans Friday Times, 3 Sep 1995, in Seeds of Terror, by Peters, p 60.

²⁶ . “Pakistani Military Hits Taliban in Orakzai”, by Bill Roggio.

²⁷ .Gordon Lubold, “Mullens Charm Offensive”, Christian Science Monitor, 17 Jan 2010, p 19.

theksua më sipër, Talebanët Punjabi konsistojnë më së shumti në elemente nga kombinimi i *Hezbut*, *LET-it* dhe *LeJ-it*, që koordinohet jashtë Lahores. Për fat të keq, ai anëtarësim bën pak për të vendosur një sponsor të përgjithshëm. Sponsor i përgjithshëm mund të jetë *Ji* (me ose pa inkurajim të jashtëm), *Al-Qaeda*, *ISI* ose ndonjë sindikatë droge.

Bibliografia:

- Screem Chaulia, review of Pakistan, In the Shadow of Jihad and Afghanistan, by Mary Anne Weaver, Asia Times Online, 1 March 2003.
- “Terrorists hit Pakistani N-Sites Thrice in 2 Yrs”, Times Global (Chennai), 12 Aug 2009.
- “Pakistan Bans LET, JuD, and 23 Outfits”, “PoK Also Bans Jihadi Outfits”.
- “Pakistan Trims Top ISI Chairs” from PTI Islamabad, The Economic Times (Chennai), 13 Aug 2009.
- Global Security (global security.org), s.v.”Mawlawi Jalaluddin Haqqani”.
- Peters, Seeds of Terror.
- Imtiaz Gul, The Al-Qaeda Connections, The Taliban and Terror in Pakistans Tribal Areas (New Dehli, Viking an Imprint of Penguin, 2009), Petters, Seeds of Terror.
- Tohid, Owais and Faye Bowers, “U.S. Pakistan Tighten Net on Al-Qaeda”, “Christian Science Monitor”, 22 Mar 2004.
- “Maulvi Nazir Group Decides to stay neutral” by Iqbal Khattak, Daily Times (Pakistan), 19 Oct 2009.
- “Pakistan Cuts Deal with Anti-American Taliban”.
- Raman, “The new Trojan Horse of Al Qaeda”.
- “Jaish e-Mohammed profile”, Overseas Security Advisory Council, Global Security News Reports, Mannes, Profiles of Terror.
- Mir, The True Face of Jihadis, Nojumi, The rise of the Taliban in Afghanistan, “Heroin in Pakistan, Sowing the Wild Wind”, CIA report.
- Gunaratanta, Inside Al-Qaeda, Ahmed Rashid “Taliban ready for decisive push, Daily Telegraph (London), 22 Jul 1999, “in Afghanistan, Crisis of Impunity” by Batty and Hoffman, South Asia Intelligence Review database, s.v. “Tahrek -e-Nafaz-e-Sharihat-e-Mohammadi”.
- Tohid and Bowers, “U.S. Pakistan Tighten Net on Al Qaeda”.
- Owais Tohid, “Pakistan Marks Pro-Al Qaeda Clan”, Cristian Science Monitor, 23 Mar 2004, Tohid, “Al Qaeda supporters strike back in Afghanistan”.
- David Montero, “In border zone, Pakistan Baks off from Taliban”, Cristian Science Monitor, 26 Sep 2006.
- Tohid, “Pakistan Gains in Al Qaeda Hunt”.
- Tohid, “Pakistan Marks Pro Al-Qaeda Klan”.
- “Pakistan Conflict Map”, Pakistan Captures Mehseeds Hometown, UPI.com, 24 Oct 2009.
- “Militants Overrun Pakistan Fort”, BBC News online, 17 Jan 2008.
- Gall et al, “Pakistani and Afghan Taliban Unify in Face of U.S. Influx”, “Khan, “Taliban rename their group”, the nation (Pakistan), 23 Feb 2009. “Three Taliban Factions Form Shura Ittehad-ul-Mujahedin”, the news Pakistan, 23 Feb 2009.

- Friday Times (Pakistan), 30 Mar2007, Daily Times (Pakistan) 9 Jan 2009, in “South Waziristans Maulvi Nazir”, by Abbas.
- “Pakistani Military Hits Taliban in Orakzai”, by Bill Roggio, Long War Journal, 17 Nov 2009.
- “Heroin in Pakistan, Sowing the Wind”, a CIA report leaked to and printed by Pakistans Friday Times, 3 Sep 1995, in Seeds of Terror, by Peters.
- “Pakistani Military Hits Taliban in Orakzai”, by Bill Roggio.
Gordon Lubold, “Mullens Charm Offensive”, Christian Science Monitor, 17 Jan 2010.

Terrorism and the internet

MSc. Mimoza (Duka) Xharo,
Chief on Analyses, DIA (Defence Intelligence Agency)

Short commentary. *Internet is considered as an initiator and integrator of cultures, businesses, governments and consumers to communicate with each other. It seems to have provided an opportunity for the creation of a “global city” forum where you can meet and exchange ideas, stimulating and supporting democracy, culture and development all over the world. However, growth in quantity and quality is being challenged by violent websites and the use of extremist organizations of different sorts. Various groups or individuals with different political or ideological goals, united in their willingness to use terrorist tactics, have begun to use the Internet to make propaganda, to communicate among themselves and with their supporters or sympathizers, to publicize their goals and attract supporters and even execute terrorist acts.*

Nowadays, terrorists of different ideological, political and religious beliefs have learned how to attain maximum benefit from the Internet. Easy access, lack of regulations, wide audience, the fast flow of information, and others of the kind, have made the Internet become a very effective tool in the achievement of their goals. Many groups or terrorist organizations have undergone transformation, from a strictly hierarchical organization to semi-independent organizations with independent small cells with no hierarchical commanding line. Through the use of internet, these interconnected groups are able to maintain contact with their members and with other groups.

It is being estimated that in the future terrorists will be organized in a much more decentralized, transnational small groups, linked more through the Internet and horizontal communication and coordination than vertical, which makes it more difficult for intelligence services to identify, monitor and prevent their activity.

Know and educate military people with good moral and psychological values

Ajet Nuellari,
Editor-in-chief of Military Review

Short commentary. *Since primitive wars to most modern ones the military thought*

has historically appreciated the moral component as primary, because when it relates to other material components, military technique, it overturns assessments and various and force balances. High morale is a driving force, with a determining importance, "always a new weapon, a device to win the war, or to turn defeat into a victory."

In our Armed Forces, military academies and schools, all military preparation, political education, psychological preparation, are being reviewed with a special intention of forming the appropriate volitive processes at military men in order to forge their character, and to fulfil the obligations to the nation and homeland.

Love of country is considered as the most important component in the education of military people with a high military combat morale. Knowing and educating moral and psychological qualities, not only in training but also in war, is one of the most difficult issues for commands and staffs, for military personnel and specialists. They are a reflection and synthesis of a number of political, military, economic, social, components etc. All in all, they constitute the objective basis of the education, the norms and principles of morality. Analysis of each of these elements, to identify their role and impact on the indicators of moral and psychological state is an object of special research.

Consensus, the key word for security pacts

Colonel Manushaqe Shehu,
Director of the Directorate of Civil-Military Relations, GS

Short commentary. *Consensus is a key element, which should prevail in roundtable meetings on security pacts. By consensus, the military power turns on such political effects that can withstand a new conflict that may arise or that is ongoing. The following paper focuses mainly on theoretical aspects of consensus, as a politico and philosophical concept.*

Firstly, the paper tries to deal with the concept of consensus, what does it represent as a notion, how is it defined by various scholars and philosophical currents, the role it has played in construction and functioning of the rule of law. The necessity of its achievement lies in the composition and functioning of relevant international organizations, the UN, NATO and the OSCE.

Finally, the paper deals in general with the role of consensus in making important decisions, in the progress of work for the organization and functioning of national security structures, as part of the Euro-Atlantic structures, the significance of its achievement in structures of national security, ranging from Parliament (parliamentary quorum), President, Government to drafting basic documents in the field of national security strategy, defence policy and military strategy in the Republic of Albania.

Achievement of consensus with a great support of participating stakeholders will be accompanied by long-lasting decisions, which in turn will be more easily enforceable. Treatment of consensus in academic levels, will influence, however little, in theoretical

knowledge and awareness of decision-making staff in matters of national security in the Republic of Albania.

Public Communication, an important element of the Albanian Armed Forces activity

MSc. Jaup Zenuni,
English teacher, AFA

Short commentary. *In the information age and the rapid technological development, the Armed Forces as part of NATO structures are facing new challenges that arise from the rapid global developments, NATO new Strategic Concept, from requirements for implementation into practice of the 'smart defence' and the peculiarities of our country. In the framework of the Alliance's new Strategic Concept, its strategic communication as well, public diplomacy as part of it, has undergone significant changes. In the opinion of some people it seems as if public diplomacy is not connected with the Armed Forces (AF), because there are institutions and other actors responsible to deal with this important element of international communication. Such an approach is not only outdated but also counterproductive because in the context of the battle to 'win hearts and minds', which constitutes one of the pillars of 'soft power', the AF today develop an asymmetric war which requires the contributions of public diplomacy in their activity. In this context, the AF should not be considered a simple mechanism of 'strong power' but also as a valuable contributor to our national public diplomacy.*

Key words: *NATO, Armed Forces, Public diplomacy, strategic communication, soft power.*

Science and Military Strategy

LtC ® MSc. Kanan Himaj,
National Centre for Security and Defence

Short commentary. *Science, in the broadest sense of the word, refers to a knowledge and important data system. Fields of science are generally classified into two main areas: natural sciences, which study natural phenomena and social sciences, which study human and social behaviour.*

Science is the argument, the foundation and unifying part of the resistant structure of any system and process, driven by the known. Nothing is possible, nothing can stand without science. So, making the military strategy object of our conception and more than that, it stands as the theory and practice of strategic art, which on the other hand relates to broader phenomena such as peace, crisis and war.

Given the above, to achieve the goal of this reflecting paper, I want to remind the readers that military science has its own place in applied sciences, specifically for the field of defence and security.

The leadership and its social responsibility

Dr. Fatmir Zanaj,
Deputy Rector and Dean of the
Faculty of Diplomacy, "Justinian" University, Tirana

Short commentary. *Not only outstanding personalities of history, but also in everyday life today in various fields of activity we hear praise for certain individuals or groups of people, say for example a group of talented young students that "they will be the future leaders, for certain military leaders distinguished in difficult missions "they are the future leaders of the Armed Forces. "This also happens in other sectors of life, in politics, in economy, science, art, etc.*

The question is: are there any fundamental elements that are present in leadership in all historical periods, regardless of their appearance in each time period carries modifications? That is, can you just explain the phenomenon of leadership within Weberian dyad leader-disciple, or is leadership a social phenomenon, whose content is the resultant of the action of many factors historical and social forces, that a real leader takes into account, as the product of historical era when he acts, including the so-called process of socialization?

Stress management in peacekeeping missions

LtC. Dr. Edlira Kukeli,
Head of Health Education and Doctrine, CMUH

Short commentary. *Stress is the reaction of the human body to change. Peacekeepers are generally capable of withstanding the effects of stress. Traumatic experiences, combined with constant pressure and difficult responsibilities, as being far away, in a foreign culture can cause a level of stress that is difficult to control and understand. Peacekeepers have some degree of stress, and this makes it necessary to adapt to changes in their missions. Peacekeeping personnel should recognize the symptoms of stress and be able to deal with the effects of traumatic situations. Monitoring the process of stress handling and prevention of complications, through a professional medical assistance is more than necessary.*

***The 55- years path of Academy of Armed Forces,
achievements and vision on the future***

Colonel Dr. Agim Sula,
Commander/Rector of Academy of Armed Forces

MG. ® Prof. Dr. Ruzhdi Gjataja,
Lecturer in the Department of Strategy and History, AAF

Colonel ® Selim Shiroka,
Lecturer in the Department of Operations, AAF

Short commentary. *Even though the idea to create an Academy of Armed Forces appears on 1936, there is the 10th of May 1958 marking the creation of the first high education institution of the Armed Forces of Albania. The establishment of this school was the culmination of many efforts, as well as the evidence that in Albania was already created the basis of an advanced and qualitative military thought. It is significant that it was created one year after the State University of Tirana.*

The Academy, called actually Academy of Armed Forces, was established as a State institution, under the Ministry of Defence having a status adopted by the Council of Ministers. The Academy is a high educational, teaching and research institution, serving to the qualification of the senior staff of the Armed Forces.

Klauzevitch's thought on the role and characteristics of the commander

LtC. Behar Mara,
HOC Course participant

MSc. Enrik Ago,
DO lecturer, AAF

Short commentary. *For more than a century, leader, leadership, military leader and leadership as a whole have been an issue of research and they still remain open for more contributions. There are no ultimate definitions, logically there cannot be, regarding the perfect leader and the type of undisputed military leader. Regarding the space of action, change of time, the area of asymmetric operation, leader remains a subject of research. Montgomery said: "To be a commander of whatever rank, first of all you should bear leadership qualities; commanders should be characterized by initiative, they must have a strong character and an ability to bring their relationships as close to their subordinates as possible. "¹*

Nowadays military leaders are required to create a culture of work and training standards, which remain as milestones on the path of integration, dealing with challenges, dangers and fears of tomorrow. This is in full agreement with what Epicurus said that "...knowing is a tool that makes you overcome fear and recreate a spiritual balance." Knowledge of a military leader is not given once and for ever

and neither can it be the “mind of the chair”. Only permanent reading, especially professional reading keeps the leader active and in action because, as prominent French philosopher Diderot stated it, “when people stop reading, they stop thinking.”

Concentration of force and its reaction

LtC. Arben Hoxha,
HOC Course participant

Colonel Selim Troci,
Chief on G3, BrRD

Short commentary. *Concentration of force implies coordination of all elements of combat power to achieve decisive effect on enemy forces in a shorter time. In offensive operations, concentration is one of the basic elements for success. To succeed in rapid concentration of troops, it is necessary to take quick decisions, to organize interaction, carry immediate and organized movement and take measures to protect troops. The largest concentration of military power is the main direction of the assault. Concurrently a sufficient military force is held in hand, so that if a conducive element of the assault is successful it can be strengthened and become the main direction. Offensive forces participating in the operation should be cautious regarding the actions that expose directions of the assault and its starting time. The most important things concerning the concentration of power for military offensive are: speed, troops' protection and fraud.*

Numerical superiority, i.e rapid concentration of the main forces at the crucial point, has often occurred when an assessment of such points is made in the most appropriate direction. This concentration was widely used by Epaminonda, Frederick the Second and Napoleon in the battles against their enemies.

The concentration of forces is a complex operation that, more or less, takes place in all wars, and it fully embodies the idea of giving the decisive attack through this measure, the relatively spontaneously as offensive and relatively as defensive.

The role and importance of reserve military combat situations

LtC Halil Myrteza,
HOC Course participant

Colonel Eduard Bala,
Head of S&H Department, AAF

Short commentary. *This paper intends to give a brief overview of the role of reserves in general and strategic reserves in particular, as one of the principles of the art of war; elaborated by the strategist of military history, Klauzevitch. The paper does not deal with the historical role of the reserve. It briefly deals with the role of reserve in*

general and strategic reserve in particular, based on critical thinking and operational art of war, and gives some conclusions about its role and factors that should be considered during its implementation.

Moreover, besides articulating reserve role, this paper aims at providing concrete reflections on the role of general reserve and strategic reserve in particular in doctrines and military manuals. In the third part the paper reflects applications, concrete examples of the role of reserves in various operations and wars.

Apart from what is mentioned above the purpose of this paper is to give an answer to the central question and debate on whether it is necessary to study the principles of the early war in this period of rapid progress of technology.

In his book “The Meaning of War”, analyst T. Dupoi gives an answer to this question. In this book, Dupoi states that “... the study of the history of previous wars remains important and interesting, history provides the basis to judge upon the anticipated effects of new technology.”²

The elaboration below develops and supports the idea presented above.

Content and meaning of force economization

LtC Arben Kingji,
HOC Course participant

Colonel Fatmir Lokaj,
Chief of the Operations Section, AAF

Short commentary. *Clauzevitch is one of the leading scholars of war, in particular, the theory of war. His legacy concerning the study of war is an indisputable value in the field of military studies. We can say without hesitation that the way he defined war, is considered as the corner stone for almost all the adherent researchers of the field.*

Here is how Klauzevitch describes the uncertainty of conflict:

“War moves in an atmosphere consisting of danger, physical tension, uncertainty and chance. Everything in war is simple, but the simplest thing is difficult and these difficulties, the most unexpected and unforeseen, are collected the produce friction, a slowing brake on the expansion and complete dismissal of violence. These difficulties consist of “risk”, “physical stratin”, “information” or “lack of information” and many other small incalculable circumstances or uncertainties, stemming from the occasion. These are some of the inevitable things that always hamper the war in reality, even to approach the simulated war or war in plans. “

Preparation and execution of military operations and war, in general, is keeping in mind some basic principles that apply in accordance with specific conditions and particular character or action of any military operation. These principles are applicable both in combat operations and in peace support operations.

On the content of Alliance strategy, according to AJP-01(D)

LtC. Leonard Çoku,
HOC Course participant

BG. Ylber Dogjani,
Commander of RPC

Short commentary. *The strategy is the complexity of cooperation and interaction between the objective, methods of use and resources. In the 21st century, the strategy is no more one concept of the security and defence field, both on the international and national level. The strategy includes all the power elements in peace and war time and supports the strategic vision of a State or regional and global alliance.*

Through this summarized paper, we will bring to your attention some principles, concepts and considerations on the content of the Alliance strategy, according to the AJP-01(D), approaching the Klauzevitch thought on the strategy.

The military art and science and their application in military doctrines of AF

LtC. MA Ardian Lulaj,
Head/Lecturer of Strategic Studies Group

Short commentary. *The purpose of this paper is to argue on the issue raised long ago, if war is art or science? How is it reflected in NATO and our Armed Forces military doctrines, but also how it is dealt with by military theorists through the course of time. Questions raised, need treatment and analysis that we try to make in the following elaboration. To this end we read a lot and studied some of the outstanding theorists of the military strategy that have thoroughly addressed this issue.*

Therefore, we refer to the most famous military theorists throughout history, from antiquity, Enlightenment period and modern times. We mostly refer to the well-known theorists like Klauzevitch, Jomini, Dupoi, and the doctrines and manuals of the Alliance and our Armed Forces, which, however, derive from the study of the written literature of written literature and the experience of the above mentioned theorists and experience gained in many military and non-military operations. Scientific methods to come to conclusions about what happens in war, military force management, planning, design and weapons through which it is waged are crucial to explain if war is art or science. Knowledge and understanding of war must be based on science, but its current conduct is mainly art.

Civil-military relations and their coverage in Alliance military doctrines

LtC. Alda Sula,
HOC Course participant
Prof. Dr. Pëllumb Danaj
Lecturer on AAF

Short commentary. *The strategy environment which is already a changing one, has brought a new dynamic on today and future operations, of a wide spectrum, from the classical and military operations to the peacekeeping and humanitarian ones. The Klauzevitch theory over the power control and force using, as well as his “paradoxical trinity”, are important in all this changing strategic environment. This strategic analysis requires from the military operations, the contribution to a comprehensive political-civil-military approach, to manage the crisis by the international community and the necessity of establishing the operational guidelines within the operations area.*

In the Alliance publications introductions, we find, in general terms, the development of operations concept in an inclusive environment, i.e. what we today say that: the military operations cannot take place without a political direction, the support and coordination of all the other civil actors.

Time planning and management

Colonel, Dr. Edmond Braneshi,
Deputy Rector of the Academy of the Armed Forces

Short commentary. *Time is a special stress on the leader for each assigned task has an execution time limit. The leader stands is between the directive (mission) given by the superior and its timely implementation by the subordinate. Thus, he should have a good knowledge of time programming techniques and at the same time possess good organizational skills and a solid character. In this context, this paper provides significant impetus to the independent leading activity, in order that leaders command time factor in logical and analytical way. Therefore, managers should consider several norms which intend to increase the efficiency of the activity of the organization. The environment created should make it possible for the leader and subordinate to think and act in accordance with the common purpose or mission, according to time priority of its implementation without the need of additional instruction.*

Methodical competencies are closely linked with individual skills of military leaders, with the skills to lead and manage people in order to position himself in a convincing way at any moment as a social and legal personality. It is just the ability to successfully manage the time available, the component that will give sense to the activity of a leader as a personality who dominates any kind of situation.

Research, part of the mission of AFA

LtC ® Prof. Asoc. Dr. Agron Agolli,
Coordinator of Research at AFA

Short commentary. *Over 54 years of the activity of the Academy of the Armed Forces, research is displayed through experience of generations, sometimes with the brightness of their creative activity through the years and sometimes wandering among nebulae of dwindling, fade, forgetfulness, disdain and avoidance neglect caused by time and development itself. However, it carries the history of this military institution, its research tradition along with accomplishments and shortcomings.*

Nowadays, the Academy of the Armed Forces, as an elite centre of the military thought of the Armed Forces and as a national value, has a primary and precious role regarding information and the level of knowledge that it provides for the formation and training of military leadership and civilians that deal with security and defence problems in national and regional and beyond. With a clear vision for the future, critical approach to the achievements to date, without repeating what has been repeatedly mentioned, research activities contribute to the mission, the deserved respect, continuous reforming of military education, strengthening and preserving of the institutional dignity and identity.

The Albanian legislation and European one, in the field of security

Dr. Ardian Myslimaj,
Head of Master and Doctoral Programs in AFA
MSc. Etleva Metaj

Short commentary. *This paper bases on an analysis of the alignment process of Albanian legislation with that of EU in the field of security. In this analytical approach, special attention and primacy is given to priorities in the field of security, where the alignment is based, as well as assessment of the steps taken so far by our country.*

The focus has been on legal initiatives undertaken in the framework of the National Plan for the Implementation of the SAA (2009-2014), and legal institutions involved in all activities that are carried out and that are scheduled to be constantly performed.

The selection of fields, whose legislation is analyzed, is made according to the importance given to them in National Strategy for Security and Defence, as well as according to Lisbon Treaty, in the framework of priorities and objectives for a Common Foreign Policy, Security and Defence, namely the Common Policy for Foreign Affairs, Security and Defence, cooperation about national affairs, the fight against organized crime and terrorism and for the Armed Forces.

Some peculiarities of Israeli military thought and strategy

Major General Viktor Bërdo,
Deputy Chief of General Staff of the Armed Forces

“No one starts a war, or rather, no one wants starting a war without being totally clear in his mind what he wants to achieve by that war and how to wage it. Policy objectives render first in importance, operational objectives therefore derive from them.”

Karl von Klauzeviç

Short commentary. *There are key elements that identify people as ethnic groups, race, language, borders, religions, ideologies, etc. If you would like to mention other elements, the list would be endless. Culture is a phenomenon that concerns us all as we face it everywhere, in every moment and in every aspect of life, but it is conditioned by many factors.*

Strategic Culture is associated with inherent uncertainty of wars. Strategic culture is a summary of priorities defined by the decision makers, priorities associated with political objectives of the war and the most effective way to meet them.

The following paper examines culture in general and elaborates on strategic culture, more specifically, considering Israel as a case study, a small country with a consolidated strategic culture.

The formation of the KLA and its role in the liberation of Kosovo

BG Bashkim Jashari

Short commentary. *From the geostrategic and geopolitical aspect Balkan Peninsula is very important. It is the crossroads linking Europe, Asia and Africa. This importance is clearly stated in the speech of former President Bill Clinton: “Kosovo is a very small country, but it lies exactly on the dividing line of Europe, Asia and the Middle East, it is the boundary between Islam and Christianity; close to our Turkish and Greek allies in the south, our new allies Hungary, Poland and the Czech Republic to the north. “⁴ That is why cultures, people and armies of the three continents have collided and defeated in the peninsula. In this context, control over Kosovo means control over the entire central part of Balkan region, due to the fact that it is in the centre and facilitates the handling of the troops and vehicles to the south, east and west.*

In geostrategic view Kosovo is considered as ‘the centre of gravity’ “of the geostrategic triangle Kraljevo-Skopje-Sofia, the centre of which is the city of Nis and where the most important axes of Balkans intersect, Vienna-Nis- Istanbul axis; Budapest- Nis-Thessaloniki; Varna-Sofia-Nis-Pristina-Durres. East Kosovo is

included within this strategic triangle, but if transform this triangle into a circle, Kosovo is entirely included in it. Kosovo has no direct access to the sea. Its links with the Adriatic Sea through Rugova Gorge, north west of Ibër river valley which leads to Montenegro, Ulqin and Tivar; White Drini Valley links Kosovo with Albania, and further to Adriatic and Mediterranean Sea. Lepenic Valley, through the strategic gorge of Kacanik, connects with the Vardar valley and beyond to Thessaloniki.

The origins of the Albanian Military Press

Colonel Dr. Zaho Golemi

Short commentary. *About Albania and Albanian, it is written by historian and albanologists, domestic and foreigner. In fact the publications were developing on the XXth century and mostly after the Proclamation of the Independence. Publications of the military character about wars, were written and continue to be written, but partially, and more priority was given to the wars of Albanian people to be liberated from the Ottoman occupation, as well as against the aims of the neighbouring countries to annexe Albanian territories.*

This gap and this lack, on military publications, in the Albanian area, was compensated by partial publications in several Balkans and Europe countries. These were articles in newspapers and magazines in Albanian language written by patriots of Albanian Diaspora. Therefore on 1883-1887, the Arbëresh of Italy published in Calabria, the monthly organ “Flamuri i Arbërit”; whereas on 1884-1885, the patriots Sami and Naim Frashëri published in Istanbul the monthly magazine “Drita”, as well as “Dituria”. In Bucharest, it is published the newspaper “Shqiptari”; in Sofia, it is published “Shqipëria”, in Brussels, on 1897, Faik Konica published the newspaper “Albania”; in Belgrade it is published “Kalendari i Kombit” and “Drita”; in Ragusa “Albania”; in Trieste and Rome “Shpresa e Shqypnisë”.

The newspapers that have played a major role were also “Përlindja e Shqipërisë”, “Ylli i dritës”, “Populli”, “Koha e re”, “Vëllazërimi”, “Demokracia”. Magazines and newspapers were published in London, Boston of USA, Cairo of Egypt, etc. All these played a role in arising the national conscience.

These publications were entered, spread and read even in Albania. These have played a special role to the arising of the national conscience, in the widening of the liberation movement and its expanding. Thus, they became part of the positive impact on the big insurrections of 1908-1911 and on the victory of the independence and the establishing of the Albanian State, on 28th November 1912.

Unresolvable issues of Pakistan

Colonel Dritan Demiraj,
Commander of Special Forces Battalion

Short commentary. *Pakistan's central government (like the one in Afghanistan) has never had a great impact on some of its provinces and less so in its tribal agencies. Evidence of the latter go beyond the recent election victories of MMA (religious parties) in NWFP and Baluchistan. By 2003, residents of Sindh Province (southern part of the country) continued to feel dominated by "Punjab Zia-ul-Haqi". It was President Zia-ul-Haqi who tried to "islamize" all Pakistani government, including the main intelligence agency (ISI).*

The current assessment of all "unresolvable issues with Pakistan" is a rather extraordinary venture. It might be necessary of more repetition and detail that, in our opinion, might be interesting for readers.

KUJTESË

PËR BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS USHTARAKE

Të nderuar bashkëpunëtorë të Revistës Ushtarake!

“Revista Ushtarake” është një Revistë kërkimore me fokus teoriko-shkencor. Ajo është revistë e elitës ushtarake të FA dhe e analistëve të spikatur civilë që, nëpërmjet shkrimeve të tyre, synojnë jo vetëm të informojnë, por në radhë të parë të ofrojnë zgjidhje për çështjet më të rëndësishme të reformës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes në nivel strategjik, operacional dhe taktik. Pra, prioriteti numër një i RU janë vlerat aplikative të krijimtarisë origjinale të autorit.

Edhe njëherë ftojme studentët e talentuar ushtarakë, akademistët e sistemit të kurseve të larta të AM, instruktorët, pedagogët, punonjësit kërkimorë, analistët, komandantët, shefat dhe trajnuesit e të gjithë institucioneve e njësisve të FA të RSH, analistët e pavarur civilë apo ushtarakë në fushën e Sigurisë e të Mbrojtjes. Në vijim, Redaksia e RU jep disa udhëzime e të dhëna teknike për strukturën e artikujve të autorëve të Revistës Ushtarake, të cilat duhet të respektohen prej tyre.

Struktura e artikullit

Titulli. Emërtimi i artikullit, me tre deri në katër fjalë.

Autori, Bashkautori: Shkruhet emri i autorit ose bashkautorëve të artikullit.

Trajtesa e shkurtuar: Është pjesa që paraprin një artikull. Tek trajtesa autori shkurtimisht, duhet të paraqesë karakteristikat e artikullit (thelbin apo çështjet themelore të trajtesës, synimet e autorit, këndvështrimin, përfundimet ose rekomandimet, etj). Trajtesa nuk zëvendëson parathënien e vetë artikullit. Ajo zë rreth 1/2 e faqes dhe nuk duhet t'i kalojë të 400 fjalët.

Paraqitja, gjatësia: Pjesa kryesore e shkrimit (përfshirë parathënien dhe përfundimet) shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të jetë maksimumi 6-8 faqe kompjuterike (15 000-25 000 shkronja e shenja, duke përfshirë edhe hapësirat përfshi edhe “endnotes” dhe informacionin shtesë.

Formati: Faqja duhet të jetë e formatit A4; Lloji i shkrimit: “Times New Roman”; Madhësia e shkrimit 11. Kryeradha (Paragrafi i ri) përcaktohet me një rresht bosh. Paraqitja e tekstit të jetë e thjeshtë dhe në minimum të alternativave të stileve dhe formatimit. Kapitujt nuk duhet të jenë të numëruar; teksti duhet të ketë një strukturë me maksimumin 3 nivele. Duhet të shmangen tekstet e theksuara me bold apo shkronjat me ngjyra. Shkrimi i pjerrët dhe thonjëzat duhet të përdoren vetëm për citimet e burimeve të përdorura dhe literaturës.

Grafikët, tabelat dhe imazhe të tjera duhet të bëhen të formatuara në grup, duke shmangur shpërbërjen e tyre. Ato duhet të vendosen sa më qartë në një pozicion të përshtatshëm pranë tekstit që i shpjegon ato. Të gjitha imazhet duhet të pasqyrohen në mënyrë të tillë që lexueshmëria të mos ndikohet nga reduktimi i madhësisë dhe printerat bardhë e zi. Nëse një imazh është marrë nga një burim tjetër, është e domosdoshme që të citohet burimi përkatës i tij.

Artikujt duhet të dërgohen të printuar dhe në mënyrë elektronike dhe me CD në Redaksinë e Revistës Ushtarake. Për ata artikuj që nuk i plotësojnë kërkesat e mësipërme të formatit dhe të gjuhës, Redaksia vendos nëse do t'i rikthehen autorëve për përmirësim, apo do të përjashtohen nga procesi i paraqitjes në Këshillin Botues.

Dokumentacioni: Redaksia e RU vlerëson me rëndësi të veçantë paraqitjen, nga çdo autor, të artikujve e trajtesave me referenca dhe “*footnote*” si dhe në fund të materialit të vendosë literaturën e shfrytëzuar. “*Footnote*” duhet të respektojnë në mënyrë korrekte rregullat kombëtare e ndërkombëtare ku të përfshihen; Mbiemri, emri (i autorit që i referohet), titulli i materialit të referimit, emri i entit botues, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqeve ku referohet, numri ISBN, *website*-in ku ndodhet artikulli. (p.sh. *Smith, James, Siguria në Shekullin e 21-të: Histori e panjohur. 2nd edition. New York, London: Oxford University Press, 2006. p..235, ISBN 0071448209, <http://www.iir.cz/display.asp?lng=uk&ida=>*).

Biografia: Së bashku me shkrimin, autori të dërgojë edhe një përshkrim të shkurtër biografik me rreth 100 fjalë ku të përfshijë: emrin, mbiemrin, gradën, pozicionin e punës, arsimimin, angazhimet kërkimore, fotografinë, numrin e telefonit dhe adresën elektronike.

Stili: Shkrimi duhet të paraqesë një strukturë të thjeshtë, duke përdorur tituj dhe nëntituj. Është e rëndësishme që në fund të shkrimit, autori ta mbyllë me disa përfundime dhe rekomandime të cilat duhet të jenë zgjidhje të propozuara në realitetin tonë.

Artikulli nuk duhet të përmbajë material të klasifikuar dhe duhet të zbatojë rregullat e klasifikimit të informacionit.

Artikulli nuk duhet të përmbajë ngjyrimë e as qëndrime politike apo partiake.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni me:

Dega e Botimeve (Redaksia e RU), Qendra e Doktrinës, KDS

Mail: Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, QD, Dega e Botimeve
Kutia Postare 24 23, Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri

Nr. Tel: 00355(4)23 63 465 ext. 516 /1195, 516/ 1159

Mobile: 0664050100 / 0664050202

Nr. Fax: 00355(4)23 69 179

Email: revistaushtarake@aaf.mil.al qdm@aaf.mil.al
ahmet.leka@aaf.mil.al adriatik.domazeti@aaf.mil.al

Shtypur në:
Delta Print Studio
Rr. Maliq Muço, 46
Tel. + 355 4 2244701
E-mail: deltaprint@albmail.com

